

# UDHA E MBARË!



Udha  
e  
mbarë!



SALVATORE SCIASCIA EDITORE

# Udha e mbarë!

**PJESËT E LIGJËRATËS**  
**arbërisht**

**Hora e Arbëreshëvet**  
**2001**

<p>Progetto comunitario KASTRIOTA 2001</p> <p><i>Ente proponente</i> Comune di Piana degli Albanesi</p> <p><i>Paterni</i> Comunità Europea Provincia regionale di Palermo Comune di Palermo</p> <p><i>Comitato scientifico</i> Francesco Altimari Matteo Mandalà Antonino Di Sparti Leonardo M. Savoia</p> <p><i>Comitato tecnico</i> Matteo Mandalà Thoma Rrushi Giuseppe Schirò di Maggio Giuseppe Schirò di Modica</p> <p><i>Struttura, testi, schede didattiche, citazioni letterarie</i> Giuseppe Schirò di Maggio</p> <p><i>Progetto grafico e illustrazioni</i> Giuseppe Strasi <i>con la collaborazione di Daniele Di Fiore</i></p> <p><i>Coordinamento organizzativo</i> Pietro Manali</p>	<p><i>La pubblicazione è stata realizzata con il sostegno di:</i></p>  <p>Comunità Europea</p>  <p>Provincia Regionale di Palermo</p>  <p>Comune di Palermo</p>  <p>Comune di Piana degli Albanesi</p> <p><i>Le informazioni contenute nella presente pubblicazione non riflettono necessariamente la posizione o l'opinione della Commissione Europea.</i></p> <p><i>Si ringraziano</i> Comune di Contessa Entellina Comune di Merzojano Comune di Palazzo Adriano Comune di S. Cristina Gela Università di Palermo Università della Calabria Università di Firenze Istituto Comprensivo di Piana degli Albanesi</p>
---	---

**\*Udha e mbare**

Udha e mbare / Giuseppe Schirò Di Maggio, ... [et al.]. - Caltanissetta : Roma : Sciascia Editore, 2001. - 400 p. : ill. ; 29 cm. - La pubblicazione è stata realizzata con il sostegno di: Commissione europea, Provincia regionale di Palermo, Comune di Palermo, Comune di Piana degli Albanesi

I. LINGUA ALBANESE - Testi scolastici - Scuola dell'obbligo - Manuali

I. SCHIRÒ DI MAGGIO, Giuseppe - II. Comune di Piana degli Albanesi  
491.991 ed. 20.

2001© Comune di Piana degli Albanesi - *Bashkia e Horës së Arbëreshëve*

# MËSIMET

## PJESËT E LIGJËRATËS

faqe 10

### EMRI

MËSIMI 1E	
Emri mashkullor. ....	14
MËSIMI 2E	
Emri femëror. ....	16
MËSIMI 3E	
Femërorja e emrave mashkullorë. ....	18
MËSIMI 4E	
Emri asnjës. ....	23
MËSIMI 5E	
Emri tri gjinitë. ....	24
MËSIMI 6E	
Emri forma e pashquar e forma e shquar. ....	26
MËSIMI 7E	
Emri njëjës e shumës. ....	30
MËSIMI 8E	
Njëjësi e shumësi i emrave mashkullorë. ....	33
MËSIMI 9E	
Njëjësi e shumësi i emrave femërorë. ....	38
MËSIMI 10E	
Njëjësi e shumësi i emrave asnjës. ....	43
MËSIMI 11E	
Lakimi i emrit rase emërore. ....	44
MËSIMI 12E	
Lakimi i emrit rase kallëzore. ....	46
MËSIMI 13E	
Lakimi i emrit njëjës e shumës të rasat emërore e kallëzore të pashquara e të shquara. ....	51
MËSIMI 14E	
Lakimi i emrit të rase gjinore njëjës e pashquar. ....	59
MËSIMI 15E	
Lakimi i emrit të rase gjinore njëjës e shquar. ....	61
MËSIMI 16E	
Lakimi i emrit të rase gjinore shumës e pashquar dhe e shquar. ....	65
MËSIMI 17E	
Lakimi i emrit të rase dhanore njëjës e pashquar. ....	67
MËSIMI 18E	
Lakimi i emrit të rase dhanore njëjës e shquar. ....	69
MËSIMI 19E	
Lakimi i emrit të rase dhanore shumës e pashquar dhe e shquar. ....	71
MËSIMI 20E	
Lakimi i emrit të rase rrjedhore njëjës e pashquar. ....	74
MËSIMI 21E	
Lakimi i emrit të rase rrjedhore njëjës e shquar. ....	76
MËSIMI 22E	
Lakimi i emrit të rase rrjedhore shumës e pashquar dhe e shquar. ....	78
MËSIMI 23E	
Lakimi i parë i emrave. ....	82

<b>MËSIMI 24E</b>	
Lakimi i dytë i emrave.	85
<b>MËSIMI 25E</b>	
Lakimi i tretë i emrave.	88
<b>MËSIMI 26E</b>	
Lakimi i katërt i emrave.	93
<b>MËSIMI 27E</b>	
Emri njohuri të përgjithshme.	97
<b>MËSIMI 28E</b>	
Emri konkret e emri abstrakt.	99
<b>MËSIMI 29E</b>	
Emri i përgjithshëm e emri i përveçëm.	104
<b>MËSIMI 30E</b>	
Emri i numërueshëm e emri përmbledhës.	108
<b>MËSIMI 31E</b>	
Emri i lëndës o i masës.	111
<b>MËSIMI 32E</b>	
Emri i prejardhur.	113
<b>MËSIMI 33E</b>	
Emri i përbërë.	119
<b>MËSIMI 34E</b>	
Emra me prapashitesa zvogëluese o përkëdhelëse.	123
<b>MËSIMI 35E</b>	
Emra me prapashitesa zmadhuese o keqësuese.	126
<b>MBIEMRI</b>	
<b>MËSIMI 1M</b>	
Mbiemri cilësor.	128
<b>MËSIMI 2M</b>	
Mbiemri cilësor prapa emrit.	130
<b>MËSIMI 3M</b>	
Mbiemri cilësor përpara emrit.	134
<b>MËSIMI 4M</b>	
Mbiemri cilësor me një e pa një.	137
<b>MËSIMI 5M</b>	
Gjinia femërore e mbiemrave cilësorë.	142
<b>MËSIMI 6M</b>	
Shumësi i mbiemrave cilësorë.	145
<b>MËSIMI 7M</b>	
Shumësi i parregullt i mbiemrave cilësorë.	150
<b>MËSIMI 8M</b>	
Mbiemri cilësor i emëruar.	152
<b>MËSIMI 9M</b>	
Problemi i nyjave me dy mbiemra cilësorë të njëhëm.	157
<b>MËSIMI 10M</b>	
Paradigma e përgjithshme e nyjave të disa kombinacionë.	161
<b>MËSIMI 11M</b>	
Shkallët e mbiemrit cilësor.	165
<b>MËSIMI 12M</b>	
Mbiemri me prapashitesa zvogëluese e përkëdhelëse.	170
<b>MËSIMI 13M</b>	
Mbiemri me prapashitesa zmadhuese e keqësuese.	173
<b>MËSIMI 14M</b>	
Mbiemri i përbërë.	174

<b>MËSIMI 15M</b>	
Mbiemri dëftor. ....	176
<b>MËSIMI 16M</b>	
Mbiemri pronor te vetat njëfis. ....	179
<b>MËSIMI 17M</b>	
Mbiemri pronor te vetat shumës. ....	186
<b>MËSIMI 18M</b>	
Mbiemra pronorë me emrat e gjirisë. ....	191
<b>MËSIMI 19M</b>	
Mbiemri pyetës. ....	196
<b>MËSIMI 20M</b>	
Mbiemri me kuptim çuditës. ....	198
<b>MËSIMI 21M</b>	
Mbiemri i pacaktuar. ....	200
<b>NUMËRORI</b>	
<b>MËSIMI 1Nu</b>	
Numërorët themelorë. ....	203
<b>MËSIMI 2Nu</b>	
Numëtorët rrethorë. ....	211
<b>PËREMRI</b>	
<b>MËSIMI 1P</b>	
Përemri njohuri të përgjithshme. ....	216
<b>MËSIMI 2P</b>	
Përemri vetor: veta e parë. ....	218
<b>MËSIMI 3P</b>	
Përemri vetor: veta e dytë. ....	220
<b>MËSIMI 4P</b>	
Përemri vetor: veta e tretë. ....	222
<b>MËSIMI 5P</b>	
Përemrat vetorë: format e shkurtra të bashkuara. ....	228
<b>MËSIMI 6P</b>	
Përemri dëftor "ky, kjo, këta". ....	231
<b>MËSIMI 7P</b>	
Përemri dëftor "ai, ajo, atë". ....	234
<b>MËSIMI 8P</b>	
Përemri pronor. ....	237
<b>MËSIMI 9P</b>	
Përemri pronor "jimi, jinja, timtë". ....	238
<b>MËSIMI 10P</b>	
Përemri pronor "jyti, jotja, tatët". ....	240
<b>MËSIMI 11P</b>	
Përemrat pronorë "i tiji, i sajë, të tijtë, i veti-e veta". ....	242
<b>MËSIMI 12P</b>	
Përemri pronor "jyni, jona, tanët". ....	246
<b>MËSIMI 13P</b>	
Përemri pronor "jiji, juaja, tajt". ....	248
<b>MËSIMI 14P</b>	
Përemri pronor "i tyri, e tyrja, të tyrët". ....	250
<b>MËSIMI 15P</b>	
Përemrat lidhorë "çë, i çili". ....	252

<b>MËSIMI 16P</b>	
Përemrat lidhorë të pacaktuar: "kush, çë, çili, sa".	255
<b>MËSIMI 17P</b>	
Përemri pyetës.	257
<b>MËSIMI 18P</b>	
Përemri me kuptim çuditës.	260
<b>MËSIMI 19P</b>	
Përemri i pacaktuar.	261
<b>MËSIMI 20P</b>	
Përemri i pacaktuar i pandërrueshëm.	265
<b>FOLJA</b>	
<b>MËSIMI 1F</b>	
Folja njohuri të përgjithshme.	267
<b>MËSIMI 2F</b>	
Folja "kam" - mënyra dëftore: koha e tashme.	269
<b>MËSIMI 3F</b>	
Folja "jam" - mënyra dëftore: koha e tashme.	271
<b>MËSIMI 4F</b>	
Folja "kam" - mënyra dëftore: koha e pakryer.	273
<b>MËSIMI 5F</b>	
Folja "jam" - mënyra dëftore: koha e pakryer.	275
<b>MËSIMI 6F</b>	
Folja "kam" - mënyra dëftore: koha e kryer e thjeshtë.	277
<b>MËSIMI 7F</b>	
Folja "jam" - mënyra dëftore: koha e kryer e thjeshtë.	279
<b>MËSIMI 8F</b>	
Folja "kam": koha e ardhme.	281
<b>MËSIMI 9F</b>	
Folja "jam": koha e ardhme.	285
<b>MËSIMI 10F</b>	
Kohët e thjeshta të mënyrës dëftore të foljevet: <i>kam</i> e <i>jam</i> .	288
<b>MËSIMI 11F</b>	
Zgjedhimi i parë: koha e tashme e mënyrës dëftore.	290
<b>MËSIMI 12F</b>	
Zgjedhimi i dytë: koha e tashme e mënyrës dëftore.	292
<b>MËSIMI 13F</b>	
Zgjedhimi i tretë: koha e tashme e mënyrës dëftore.	295
<b>MËSIMI 14F</b>	
Koha e pakryer e mënyrës dëftore.	297
<b>MËSIMI 15F</b>	
Koha e kryer e thjeshtë.	301
<b>MËSIMI 16F</b>	
Koha e ardhme.	305
<b>MËSIMI 17F</b>	
Kohët e përbëra: koha e kryer e mënyrës dëftore.	310
<b>MËSIMI 18F</b>	
Koha e kryer e plotë e mënyrës dëftore.	313
<b>MËSIMI 19F</b>	
Mënyra dëftore: koha e kryer e tejkohar.	315
<b>MËSIMI 20F</b>	
Mënyra dëftore: koha e ardhme e përporme.	316

<b>MËSIMI 21F</b>	
Mënyra dëftimore: gjithë kohët.	320
<b>MËSIMI 22</b>	
Mënyra lidhore: koha e tashme.	321
<b>MËSIMI 23F</b>	
Mënyra lidhore: koha e pakryer.	324
<b>MËSIMI 24F</b>	
Mënyra lidhore: koha e kryer.	326
<b>MËSIMI 25F</b>	
Mënyra lidhore: koha e kryer e plotë.	328
<b>MËSIMI 26F</b>	
Mënyra kushtore: koha e tashme.	330
<b>MËSIMI 27F</b>	
Mënyra kushtore: koha e kryer.	335
<b>MËSIMI 28F</b>	
Mënyra dëshirore: koha e tashme.	338
<b>MËSIMI 29F</b>	
Mënyra dëshirore: koha e kryer.	342
<b>MËSIMI 30F</b>	
Mënyra urdhërore: koha e tashme.	344
<b>MËSIMI 31F</b>	
Format e pashtjelluara: pjesorja, paskajorja, përcjellorja.	350
<b>MËSIMI 32F</b>	
Kuadri përmbledhës i foljes.	355
<b>MËSIMI 33F</b>	
Zgjedhimi i foljevet ndihmëse.	356
<b>MËSIMI 34F</b>	
Zgjedhimi vepron.	358
<b>MËSIMI 35F</b>	
Zgjedhimi vepron: folje kalimtare e jokalimtare.	360
<b>MËSIMI 36F</b>	
Zgjedhimi pësor e vetvetor: njohuri të përgjithshme.	362
<b>MËSIMI 37F</b>	
Zgjedhimi pësor-vetvetor.	365
<b>MËSIMI 38F</b>	
Mbi "foljen".	369
<b>PJESËT E PANDRYSHUESHME</b>	
<b>MËSIMI 1Nd</b>	
Ndajfolja.	370
<b>MËSIMI 1Par</b>	
Parafjala.	375
<b>MËSIMI 1L</b>	
Lidhëza.	380
<b>MËSIMI 1Pj</b>	
Pjesëza.	388
<b>MËSIMI 1Pas</b>	
Paschirra.	391
<b>MËSIMI PËRMBLEDHËS</b>	
Pjesët e Ligjëratës.	396



## VEPRA TË KUJTUARA E SHKURTIME

**Giuseppe Schirò** (= **GS**), (1865-1927), nga Hora e Arbëreshëvet.

**CT** = Canti Tradizionali ed altri Saggi delle Colonie Albanesi di Sicilia - Napoli, 1923.

**CS** = Canti Sacri - Napoli, 1907.

**Dheu** = Te dheu i huaj - Palermo, 1940.

**Këthimi** = Firenze, 1954, a cura di G. Schirò Junior.

**Prose e canti sacri** = Ed. Rubbettino, 1997, a cura di M. Mandalà.

**Rapsodie** = Rapsodie Albanesi - Ed. Rubbettino, 1997, a cura di M. Mandalà.

**Milo** = Milo e Haidhe - Ed. Rubbettino, 1997, a cura di M. Mandalà.

**Mons. Paolo Schirò** (1866-1930) (= **MPS**), nga Hora e Arbëreshëvet.

**FZ** = "Fiala e t' in' Zoti" 1912-1915 - Hora e t' Arbëreshëvet.

**Mesha e Shën Jan Gojartit** - Palermo 1964, a cura di G. Schirò.

**Nicolò Figlia** (= **NF**), (1682?-1769), nga Munxifsi-Mezzojuso.

**Codice** = Il Codice Chieutino - Comune di Mezzojuso, 1995, a cura di M. Mandalà.

**Francesco Crispi Glaviano** (= **FCG**), (1852-1933), nga Pallaci.

**MT** = Mbi Malin e Trundafilet - Palermo, 1963, a cura di M. Sciambra.

Ndo citacionë nga veprat e tjervet autorë, gjith'e gjithë të

**Nicola Brancato** (1675-1741) nga Hora e Arbëreshëvet,

**Nicolò Chetta** (1742-1803) nga Kuntisa,

**Pietro Chiara** (1840-1915) nga Pallaci,

e zglodhëm dhe e nxorëm nga "Canti tradizionali..." kujtuar lart.

Arciprete **Giorgio Schirò** (1907-1992) (= **AGS**), nga Hora e Arbëreshëvet.

**Libri i Kreshmëvet** - 1983

**Giuseppe Schirò Di Maggio** (= **GSMaj**)

**Batracomiomachia** = Lufta e Mivet me Brethqit - Piana degli Albanesi, 1975.

**Fatosat** = Fatosat - trimat e rinj arbëreshë apo arsyeja e gjëravet - 1977.

**Paja** - 1983.

**Shumë vizita** - 1986.

**Orëmira** - 1988.

**Për Tokën** = Për Token fisnike të Horës - 1989.

**Kërkuesit** - 1994.

### SHËNIM

U morën para sysh vepra shkruar arbërisht e jo ato shkruar shqip nga autorë arbëreshë të sotëm.

**f.** = faqe

**sht.** = shtyllë (*colonna*)

**str.** = strofë

**vj.** = vjershë, *verso*

**r.** = radhë, *rink*

**n.** = numër.

## SI MËND T' VUHET NË DORË TEKSTI

Kush mëson mënd të ketë dy mënyra kryesore të vunj në dorë sa më mirë MËSIMET që gjen te kjo gramatikë:

E para tuke vatur prapa MËSIMEVET si do "urdhëri i ligjëratës":

EMRI > MBIEMRI > NUMËRORI > PËREMRI > FOLJA > NDAJFOLJA > PARAFJALA > LIDHËZA > PJSËZA > PASTHIRRMA

E dyta tuke lidhur MËSIMET sipas rendit të çdo sektori:

MËSIMI 1Emri > MËSIMI 1Mbiemri > MËSIMI 1Numërori > MËSIMI 1Përemri > MËSIMI 1Folja > MËSIMI 1Ndajfolja > MËSIMI 1Parafjala > MËSIMI 1Lidhëza > MËSIMI 1Pjesëza > MËSIMI 1Pasthirrma

e pra:

MËSIMI 2Emri > MËSIMI 2Nyja > MËSIMI 2Mbiemri etj.

O si një ndëlgon më mirë.

## PER L'USO DEL TESTO

Si possono individuare due modi per utilizzare al meglio le LEZIONI di questa grammatica.

Il primo consiste nel seguire le LEZIONI secondo lo schema delle "parti del discorso":

NOME > AGGETTIVO > NUMERALE > PRONOME > VERBO > AVVERBIO > PREPOSIZIONE > CONGIUNZIONE > PARTICELLA > INTERIEZIONE

Il secondo, nel collegare le LEZIONI seguendo l'ordine numerico di ciascun settore:

LEZIONE 1Nome > LEZIONE 1Aggettivo > LEZIONE 1Numerale > LEZIONE 1Pronome > LEZIONE 1Verbo > LEZIONE 1Avverbio > LEZIONE 1Preposizione > LEZIONE 1Congiunzione > LEZIONE 1Particella > LEZIONE 1Interiezione

e quindi:

LEZIONE 2Nome > LEZIONE 2Articolo > LEZIONE 2Aggettivo etj.

O con altre opzioni didattiche.

## SHËNIME

Tekstet e shënimit u shkruan sipas të folurit arbërisht të Horës.

Terminologjia tipike e gramatikës është ajo shqipe, si vendosi Komiteti shkencor i Projektit "Kastrioti 3000". Për shembull: "emra" në vend të "emre" arbërisht; "çilësor" në vend të "çilësor"; "numra" në vend të "numere"; etj.

Te kjo gramatikë përdoren dy variante të formave joveprore arbëreshe, si "bëhet" e "bënet".

Pjesëzat "tue" e "tuke" përdoren të dya.

Disa forma të shqipes së sotme ndodhen ndër kllapa pranë formave arbëreshe.

## NOTE

I testi e le note sono nella parlata italo-albanese di Piana.

La terminologia prettamente grammaticale è quella albanese d'Albania, come stabilito dal Comitato scientifico del Progetto "Kastrioti 3000". Esempi: "emra" al posto di "emre" italo-albanese; "çilësor" al posto di "çilësor"; "numra" al posto di "numere"; ecc.

Nella presente grammatica vengono usate le due varianti passive arbëreshe, come "bëhet" e "bënet".

Le particelle "tue" e "tuke" sono in uso entrambe.

Alcune forme della lingua shqipe standard sono inserite tra parentesi accanto alle forme arbëreshe.

## «MORFOLOGJIA»

### Pjesët e ligjëratës.

“Pjesët e ligjëratës” ?

Çë janë ?

Çilat janë ?

Ti di gjë ?

Zglidh e vëre' !

“Mbre Vito, miku jim e jyti dje vanë me makinën Palermë sa të shihjën dy film të bukur. ”

Çë janë fjalët këtu sipër ?  
Janë “pjesë të ligjëratës” (litisht: parti del discorso).

## Vëre':

➤ “mbre”	ë	<b>pasthirmë</b>
➤ “Vito”	ë	<b>emër</b>
➤ “miku”	ë	<b>emër</b>
➤ “jim”	ë	<b>mbiemër</b>
➤ “e”	ë	<b>lidhëz</b>
➤ “jyti”	ë	<b>përemër</b>
➤ “dje”	ë	<b>ndajfolje</b>
➤ “vanë”	ë	<b>folje</b>
➤ “me”	ë	<b>parafjalë</b>
➤ “makinën”	ë	<b>emër</b>
➤ “Palermë”	ë	<b>emër</b>
➤ “sa”	ë	<b>lidhëz</b>
➤ “të”	ë	<b>pjesëz</b>
➤ “shihjën”	ë	<b>folje</b>
➤ “dy”	ë	<b>numëror</b>
➤ “film”	ë	<b>emër</b>
➤ “të bukur”	ë	<b>mbiemër</b>

Gjithë fjalët që na thomi janë “pjesë të ligjëratës”!

## Çilat janë, sa janë e si ndahen ?

Zgllith e mëso më parë se gjithqish çilat janë e si ndahen:

### PJESËT E LIGJËRATËS **ARBËRISHT**

#### ● pjesë të ndryshueshme (= çë ndërrojën):

- emri = burri, gruaja, tryesa, dashuria, buka, etj.
- mbiemri = i mirë, e bukur, i gjerë, e madhe, etj.
- numërori = një, dy, tre, tri, i tretë, i pestë, etj.
- përemri = u, ti, ai, ajo, mua, më, të, i tij, i çili, etj.
- folja = kam, jam, rri, vete, vinj, ha, thom, etj.

#### ● pjesë të pandryshueshme (= çë ngë ndërrojën):

- ndajfolja = kur, poshtë, pak, shumë, papritur, etj.
- parafjala = te, me, nga, për, në, përpara, prapa, etj.
- lidhëza = e, o, se, sa, prandaj, posa çë, etj.
- pjesëza = tue (tuke, duke), ngë, jo, o (po), pa, etj.
- pasthirrma = mbre, o!, mirëmbërëma, qevarrisu, etj.

Vëre' naní këtë tabele:

ARBËRISHT- SHQIP	LITISHT
<b>PJESËT E NDRYSHUESHME</b>	<b>LE PARTI VARIABILI</b>
emri	il nome
mbiemri	l' articolo
numërori	l' aggettivo
përemri	(= il numerale)
folja	il pronome
	il verbo
<b>PJESËT E PANDRYSHUESHME</b>	<b>LE PARTI INVARIABILI</b>
ndajfolja	l' avverbio
parafjala	la preposizione
lidhëza	la congiunzione
pjesëza	(= la particella)
<u>pasthirrma</u>	<u>l'interiezione</u>
<b>10</b>	<b>9</b>

Te gluha e sotme shqipe "nyja" (litisht: "l'articolo") ngë ë ndër pjesët e ligjëratës; atë mënd t'ë gjesh te emri, te mbiemri, te numërori e te përemri. Arbërisht sot i vemi prapa asaj rregullje.

Andaj, sa janë "pjesët e ligjëratës"?

Pjesët e ligjëratës janë "10" (dhjetë).

Na do t'i njohjëm një për një.

#### SHKURTIME

Emri = **E**

Mbiemri = **M**

Numërori = **Nu**

Përemri = **P**

Folja = **F**

Ndajfolja = **Nd**

Parafjala = **Par**

Lidhëza = **L**

Pjesëza = **Pj**

Pasthirrma = **Pas**

## MËSIMI 2E

Emri femëror.

*Nani vëre':*

gruaja



vajza



pela



maçja



lulja



shpia



Marta



Çë janë

vajza



gruaja



pela



maçja



lulja



shpia



Marta?



Janë “emra” edhe këta, ma (por) janë emra “femërorë”, femre!

Thuaj e shkruaj ti ca emra “femërorë”:

arra



buka



penda



arra, buka, penda,

---

---

Atëherë te gluha jonë kemi

*emra mashkullorë e emra femërorë.*



*kali*  
*mashkull*



*pela*  
*femre*



*shpia*  
*femre*



*muri*  
*mashkull*



*mëma*

*tata*



## MËSIMI 3E

Femërorja e emrave mashkullorë.

Vëre':



noni

nona



maçi

maçja



Çë janë këta emra këtu sipër?

Janë emra **mashkullorë** me emrat **femërorë** te ana:

emër mashkullor < noni      nona > emër femëror

emër mashkullor < maçi      maçja > emër femëror

Si duket mirë, emri mashkullor me emrin femëror gliten.

Emri  
mashkullor  
me emrin  
femëror gliten!



Ah, gliten?



Ma (por) jo gjithë emrat mashkullorë gliten me emrat femërorë të tyre.

Vëre':



burri	gruaja
<b>djali</b>	<b>vajza</b>
tata	mëma
vovi	nusja
gjeli	pula
kali	pela
kau	lopa



Arbërisht emri femëror çë i jipet njerëzvet e kafshëvet shumë herë ndërron nga emri mashkullor.

Këtu poshtë kemi ca emra të kafshëvet çë te gramatika kanë vetëm o gjininë mashkullore o atë femërore:

### VETËM MASHKULLORË

gjalpri  
**miu**  
**xhapiu**  
etj.



### VETËM FEMËRORË

dhelprja  
**flutura**  
hardhja  
**rosa**  
etj.



- Kur ngë kemi emrin mashkullor o femëror të kafshëvet e duam t'i dimë gjininë:
- për të bërë emrin mashkullor i shtohet fjala "mashkulli i...": mashkulli i dhelpres;
  - për të bërë emrin femëror i shtohet fjala "femrja e...": femrja e miut.

Vëre' nani si bën femërori i ca emrave mashkullorë të titujvet o të profesionëvet:

**arbërisht**  
 datur - daturisë  
 prufisur - prufisurisë  
 perëndi - perëndeshë  
 rregj - rrexhinë

**shqip**  
 doktor - doktoreshë  
 profesor - profesoreshë  
 perëndi - perëndeshë  
 mbret - mbretëreshë



## USHTRIME

1 - Vër edhe ti në korrrespondencë emrat mashkullorë me ata femërorë që gjen këtu poshtë:

- i jati, i kunati, i kushëriu, lalëbukuri, i nipi, plaku, i vëllai, zogu;
- e motra, e mbesa, plaka, zoga, e jëma, e kunata, e kushërira, motrëmëma.

lalëbukuri >< motrëmëma

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ >< \_\_\_\_\_

*lalëbukuri*



*motrëmëma*

2 - Lidh me një vijë ← → emrat mashkullorë e emrat femërorë të llojësë:



c(u)japi  
**gjeli**  
 derri  
 qeni  
 dashi

delja  
 bushtra  
 dhia  
**pula**  
 dosa



e këta:



bualli  
 luani  
 gomari  
 ulku  
**aríu** (ursi)

ulkonja  
**arúsha**  
 buallica  
 luanesha  
 gomarja



3 - Zglidh emrat e kafshëvet o të insektevet te “Shembujt letrarë” më përpara e, në ngë i njeh, thuaj si i thërresjëm na sot edhe me fjalë italiane.

bushtra = \_\_\_\_\_ | \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ | \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ | \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ | \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ | \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ | \_\_\_\_\_

## Shembuj letrarë

Ca të thëna me animej (kafshë) e insekte. (CT – Fjalë të motshëme – f. 88 e tjera)

Bushtra çë nxiton shumë, piell **këlyshë** të verburë. (n. 24)

Brethku ngë këndon në të that. (n. 30)

Breshka shan **kërmillin** e kungulli bucjelen. (n. 31)

Brumbulli të shpie te plëht. (n. 32)

Çëdo **mizë** ngë bën mjalt. (n. 34)

Kali i húa të lë mbë rrugë. (n. 39)

Ka të flasnjë **kau**, e flet paramenda! (n. 45)

Kur kisha **dhenët**, s'kisha mentë:

kur m'erdhën mentët, **dhenët** i kishen ngrënë **qenët**. (n. 51)

Kur **dhelpra** ngë arrën te rrushi, thot se isht aguridhe. (n. 53)

Kur **pula** ngë kemi, me **dhelprën** ngë zëhemi. (n. 57)

Kë **dele** bënet, **ulku** e ha. (n. 101)

Dy **gjela** në një plëh, ngë mënt të rrin. (n. 120)

Dy **maçe** mundjën një **ari**. (n. 121)

**Gajdhuri** bie barin e ai e ha. (n. 156)

Isht ler kush ka t'e he **pishkun** e dejtut. (n. 192)

**Morri** ngulet edhe te nyet. (n. 221)

Më mirë krye **miu**, se bisht **luani**. (n. 245)

**Mushk?** A shqelbe, a ánje! (n. 255)

Pak, se isht **dhije!** (n. 293)

Pak të folë e vesh **derri!** (n. 294)

**Pelë**, shkluhë e grua / as mirren as jipen hua. (n. 296)

Sa të vraç **pleshtin**, mos digj pështrimin. (n. 332)

Thirmën e **búallit** e gjegjen ógajit e bógažit. (n. 376)

U zot, ti zot; **lopën** kush e kulot? (n. 382)

Zure **gjarpërin?** Shtypi kryet ! (n. 409)

Kush ka gjizë e **kaciqë** / vete në kurtëje e ka liqë. (n. 428)

**Maçëja** lot me **miun**, më para se t'e he. (n. 474)

**Sorra** ng'i nxier syt **sorrës**. (n. 507)

Vate me **kal** e u pruar me **gomâr** ! (n. 522)

... **ulkonja** e Merkut (f. 496, vj. 2 nga e sprasmja)



... tue bredhur bashk me **viçin** rrij **ariu**; // bashkë me **drërët** / **bisha** rroj ... //...

u pa me **qenqin ulku**...

(CS – LXII, f. 98/99, vj. 9/14)

...**terët** tim e **shtëzët** të májme klenë therturë e gjithqish janë gati.

(FZ – Viti i parë, e 1<sup>a</sup> e shtatorit 1912, n. 28 – f. 1, sht. 1, r. 12)

## MËSIMI 4E

Emri asnjanes.

E naní vëre' mirë këto fjalë:

brumit




të ftohtit



të ngrohtit



misht



Çë janë?

Janë “emra” që ngë venë bashkë në (as) me emrat *mashkullorë* në (as) me emrat *femërorë*: janë emra “*asnjanës*” (jo meshkuj e jo femre; jo të njerës anë e jo të jetrës anë: *as - një - anës*); (asnjanës = litisht: neutro).

Thuaj e shkruaj edhe ti, me ndihmën e mësuesit të gluhës arbëreshe, ca emra “*asnjanës*”:

të lyerit, të luarit, vajit.

---

---

## MËSIMI 5E

Emri: tri gjinitë.

Mëso e kujto !

kali



pela



misht



Pamë se fjalët “*kali, pela, misht*” janë “*emra*”:

“*kali*” ë emër “*mashkullor*”

“*pela*” ë emër “*femëror*”

“*misht*” ngë ë emër *mashkullor* e ngë ë emër *femëror*: ë emër “*asnjanës*”.

MASHKULLORË janë:

Marku, djali, burri, kali, **qeni**, shkopi



FEMËRORE janë:

Marta, vajza, gruaja, pela, **lulja**, dhia



JO MASHKULLORË E JO FEMËRORE = **ASNJANËS** janë:  
**të ngrënit**, të ftohtit, brumit, ujët





**Arbërisht kemi:**

- emra **mashkullorë**
- emra **femërorë**
- emra **asnjanës** !

## USHTRIME

Shkruaj te vendi ç'i nget dhjetë (10) emrat mashkullorë, dhjetë emrat femërorë e dhjetë emrat asnjanes që gjen këtu poshtë:

miku, nusja, ujët, të falurit, Sara, Gjergji, vera, uthulla, vajt, Luka, noni, qielli, mjegulla, të ngrënit, tëtimt, pula, lopa, mushku, dera, biçikleta, plepi, plaku, brumit, lesht, klëmshit, të folurit, fiku, mëllaga, druri, të bredhurit.

**Mashkullorë:**



miku,

---

---

**Femërorë:**



nusja,

---

---

**Asnjanes:**



ujët,

---

---



## MËSIMI 6E

Emri forma e pashquar e forma e shquar.



*Vëre' mirë:*



*Një burrë vate përjashta.*

*Burri i Marës vate përjashta.*



*Një mëmë kërkon të birin.*



*Mëma e Maries ë te kuçina.*

*Mish sot ngë kemi.*



*Misht ë te digani.*

- burrë - burri
- mëmë - mëma
- mish - misht

Arbërisht, si te gluha shqipe, kemi për nga emër (mashkullor, femëror, asnjans) *dy forma*:

- *njera* çë na thotë se *ngë njobjëm* njeriun o kafshën o shërbesin për të çilin flasjëm;
- *jetra* çë na thotë se e *njobjëm* njeriun o kafshën o shërbesin për të çilin flasjëm.

### Shih si:

**burrë** = “një burrë” çili isht isht

**burri** = “burri” i Maries (për shembull) çë ti njeh se ë i Maries

**mëmë** = “një mëmë” çila isht isht

**mëma** = “mëma” e Maries (për shembull) çë ti njeh si “mëmë e Maries”

**mish** = “ca mish” çilët isht isht

**misht** = “misht” çë ë te digani (për shembull) e jo tjerët mish

Ato *dy forma* te gramatika thuhën kështu:

- *forma e pashquar* (për një emër çilin isht isht)  
(litisht thuhet: forma indeterminata)
- *forma e shquar* (për emrin çë njihet)  
(litisht thuhet: forma determinata)

### Vëre' pameta

#### FORMA E PASHQUAR

burrë  
mëmë  
mish

#### FORMA E SHQUAR

burri  
mëma  
misht



## USHTRIME

1 - Vër te njëra anë emrat që janë te forma “e pashquar” (një njeri, një kafshë o një shërbes çili isht isht), e te jetra anë emrat që janë te forma “e shquar” (njeriun, kafshën, shërbesin që dimë si ë) :

qen, tryesë, molla, dardhë, lopa, pendë, kal, qeni, tryesa, dardha, lopë, mollë, kali, krimbi, fleta, penda, krimb, kuçinë, këmisha, fletë, këmishë, lugë, kuçina, luga, mik, sumbë, miku, sumba, halë, të ngrënë, të folur, hala, të ngrënit, të folurit.

### EMRA TË PASHQUAR

qen, \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

### EMRA TË SHQUAR

molla. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

2 - Shtoi fjalëvet që janë pa të plota (pa “mbaresë” = pa “desinencë”) atë që i duhet të kemi fjalë që mënd të ndëlgonen:

- 1) Buka ë te tryes\_a .
- 2) Qen\_\_ leh.
- 3) Një vajz\_\_ si kjo ng'e kam parë kurrë te Hor\_\_ .
- 4) Ai burr\_\_ e ajo gru\_\_ ngë dinë kush jam.
- 5) Burr\_\_ e grua\_\_ klenë bërë ka yn' Zot.
- 6) Pishk\_\_ që bleve ish i shkuar.
- 7) Kal\_\_ i Markut ë i bardhë.
- 8) U kam një këmish\_\_ blu.
- 9) Dardhavet i zuri krimb\_\_ .
- 10) Dje bleva një pul\_\_ .



Kujto:

Një vajzë



Vajza jime, Mara



Një djalë



Marku, djali i Marës



Të ngrënë



Të ngrënit it çë bën mëma

## MËSIMI 7E

Emri njëjës e shumës.

Te **MËSIMI 6E** zgjidhe këto fjalë të pashquara e të shquara:



burrë - burri

mëmë - mëma

mish - misht



Ma për sa “burra, mëma, mishra”, flasjëm?

Po për “një” burrë, për “një” mëmë, për “një” copë mish flasjëm!

E kur do flasjëm për “shumë” burra, për “shumë” mëma, për “shumë” mishra ?

**Zglith e vëre’ mirë !**

Ata janë *burra*.



*Burrat* e Horës janë të mirë.

Ato janë *mëma*.



*Mëmat* e Horës janë të mira.

*Mishra* ngë kemi tek e prëmtja.



*Mishrat* i shesjëm të shtunë e të dielë!

Si shohjëm, ngë kemi më “*një burrë, një mëmë, një copë mish*”, ma (por) ata emra u bënë më “*shumë*” se “*një*”, vje’ më rarë:

“*shumë burra*”, “*shumë mëma*”, “*shumë mishra*”!

**Ashtu thomi se:**

- a) kur kemi vetëm *një njeri, një kafshë, një shërbes*, te gramatika ai emër thuhet se ndodhet te *numri “njëjës”* (litisht: numero singolare);  
b) kur kemi përpara më *shumë se një njeri, më shumë se një kafshë, më shumë se një shërbes*, ai emër te gramatika thuhet se ndodhet te *numri “shumës”* (litisht: numero plurale):

një > njëjës

shumë > shumës

Edhe *shumësi*, si *njëjësi*, ka “formën e pashquar” (litisht: forma indeterminata) e “formën e shquar” (litisht: forma determinata).

**Shih si :**

**burra** = “ca burra” çilatdo

**burrat** = “burrat” e Horës (për shembull) që ti di kush janë

**mëma** = “ca mëma” çilatdo

**mëmat** = “mëmat” e Horës (për shembull) që ti di kush janë

**mishra** = “ca mishra” çilatdo

**mishrat** = “mishrat” që janë piqen te zjarri (për shembull) e jo tjerët

Vëre' naní këto tabele:

## NUMRI NJËJËS

FORMA E PASHQUAR

**burrë**

mëmë

mish



FORMA E SHQUAR

**burri**

mëma

misht

## NUMRI SHUMËS

FORMA E PASHQUAR

**burra**

mëma

mishra



FORMA E SHQUAR

**burrat**

mëmat

mishrat

## USHTRIME

Vër te njera anë dhjetë (10) emrat që ti ndëlgon se ndodhen te numri njëjës (i pashquar e i shquar) e te jetra anë dhjetë (10) emrat që ti ndëlgon se ndodhen te numri shumës (i pashquar e i shquar):

noni, djemtë, vajzat, bari, shpia, dhe, kuej, shpitë, miq, libër, mushk, dhera, ulq, malet, buka, djali, gërshtëret, ulku, derë, mushq.

NUMRI **NJËJËS**

noni, \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI **SHUMËS**

djemtë, \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## MËSIMI 8E

Njëjësi e shumësi i emrave mashkullorë.

Nani çë di më shumë se sa dije, vëre' mirë emrat çë vijën, sa t'i përdorësh si nget te "numri njëjës" e te "numri shumës", kur të vjen dishirimi të shkruash arbërisht.

### EMRA MASHKULLORË

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar / e shquar



arbëresh - arbëreshi\*  
artist - artisti  
italian - italiani  
profesor - profesori  
shkrimtar - shkrimtari  
shqiptar - shqiptari  
turist - turisti

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar / e shquar

arbëreshë - arbëreshët\*  
artistë - artistët  
italianë - italianët  
profesorë - profesorët  
shkrimtarë - shkrimtarët  
shqiptarë - shqiptarët  
turistë - turistët



Si shohjëm, këta emra mashkullorë këtu sipër, e disa të tjerë, kanë shumësin me "-ë".

\*\*\*\*\*



burrë - burri  
derr - derri  
glëmb - glëmbi  
plesht - pleshti

burra - burrat  
derra - derrat  
glëmbe - glëmbat  
pleshta - pleshtat



Si shohjëm, këta emra mashkullorë këtu sipër, e disa të tjerë, kanë shumësin me "-a".

\*\*\*\*\*



grusht - grushti  
hon - honi  
kujtim - kujtimi  
mal - mali  
vend - vendi

grushte - grushtet  
hone - honet  
kujtime - kujtimet  
male - malet  
vende - vendet



Si shohjëm, këta emra mashkullorë këtu sipër, e disa të tjerë, kanë shumësin me "-e".  
Te gluha shqipe këta emra me "e" te shumësi bëhen femërorë; arbërisht qëndrojnë mashkullorë.

\*\*\*\*\*



## SHËNIM

\* Emri o më mirë mbiemri i emërzuar “arbëresh”, për nonërat tanë kish edhe “nyjën-artikullin”: “*i* arbëresh, *e* arbëreshe”.

Ca shembuj i gjegjemi edhe sot, kur flet ndonjeri më plak:

“Hóra e t’ Arbëreshëvet”

e andaj sipas metatezës (litisht: metatesi):

U jam **trabresh** ! U jam **trabreshe** !

**Hóra e t’ Arbëreshëvet** >< Hóra e **Trabreshëvet**



Viti i pára. Ngà Hóra e t’ Arbëreshëvet, 90 tu kjershórit 1912. N. 19.

# Fiála e t’in’ Zóti

*Fára*  
isht *Fiála e Peronllis*.  
(Luc. VIII. 11)

*... jáve*  
*fála e shavólltis*  
Dèl ngà *jávæ*. *Í klé d’argóar*. (Att. XIII. 26).

## Shembuj letrarë.

I krështeu **i arbresh**  
(NF – Codice – f. 45, titull)

...një vashë ng’ish litire, / ng’ish litire se ish **e Arbreshe**.  
(NF – Codice – Kënkëzë – f. 59, vj. 197/198)

Oi ti mal sot smolu!... / Mbi Bërrirzen tënde vën / gjith jemi na **t’arbresh**!  
(FCG – Mbi Malin e Trundafilet – f. 14, IX, vj. 1/3)



## TJERË EMRA MASHKULLORË

Kur ti ngë di si bën shumësi i disa emrave mashkullorë çë të duken të thatë të mësonen, vëre' këtu poshtë e disa i gjen. Për tjerët emra vëre' te një fjalor.

### EMRA MASHKULLORË

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar / e shquar

armik – armiku  
artikull – artikulli  
asht – ashti  
at – ati  
avull – avulli  
bar – bari  
bir – biri  
c(u)jap – c(u)japi  
dash – dashi  
dell – delli  
disk – disku  
djale – djali  
dushk – dushku  
ftua – ftoi  
glu – gluri  
(gju – gjuri            - *shqip* -  
ka – kau  
kal (kalë) – kali  
kalli – calliu (calliri)  
krua – kroi  
krushk – krushku  
kumat – kunati  
kungull – kungulli  
kushëri – kushëriu (kushëri)  
lëmë – lëmi  
lëng – lëngu  
lumë – lumi  
mashkull – mashkulli  
mik – miku  
njeri – njeriu  
plak – plaku  
popull – populli  
qiell – qielli  
shekull – shekulli  
shembull – shembulli  
shi – shiu

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar / e shquar

armiq – armiqtë  
artikuj – artikujt  
eshtra – eshtrat  
(t)atra – (t)atrat / etër – etërit (*shqip*)  
avuj – avujt  
barëra – barërat  
bij – bijtë  
c(u)jep – c(u)jepetë  
desh – deshtë  
dej – dejtë  
disqe – disqet  
djelm – djelmtë / djem – djemtë  
dushqe – dushqet  
ftonj – ftonjtë  
glunj – glunjët  
gjunjë – gjunjë  
qe – qetë  
kuëj – kuëjt / kuaj – kuajt  
kallinj – kallinjët  
kronje – kronjet  
krushq – krushqit  
kUNETË – kUNETËT / kUNETËR, kUNETËRIT  
kunguj – kungujt  
kushërinj – kushërinjtë  
lëme – lëmet / lëmenj - lëmenjtë  
lëngje – lëngjet  
lume – lumet / lumenj – lumenjtë  
meshkuj – meshkujt  
miq – miqtë  
njerëz – njerëzit  
pleq – pleqtë  
popuj – popujt  
qiej – qiejt  
shekuj – shekujt  
shembuj – shembujt  
shira – shirat

thes – thesi  
thua – thoi  
ulk – ulku  
(ujk – ujku      - *shqip* -  
vëlla – vëllai (vëllau)  
vit – viti

these – theset / thasë – thasët  
thonj – thonjtë  
ulq – ulqit  
ujq – ujqit  
vëllezër – vëllezërit  
vite – vitet / vjet – vjetët \*

\* vite = kur ngë dihet sa janë: vitet e fëmijërisë;

vjet = kur ka bashkë ndo numër o thotë sa: pesë vjet; për shumë vjet.



## USHTRIME

Di të vësh fjalën ç' i duhet te vendi ç' i nget ?

NJËJËS: mik, thua, shiu, vëlla, mashkull, kushëri, disk, avull, lënk, bari, lumi, qielli, plak, kali, shekulli

- 1 - Tim vëllai i dhëmb një \_\_\_\_\_.
- 2 - Kam një \_\_\_\_\_ të Rikardo Koçante.
- 3 - Nini isht \_\_\_\_\_ jimi.
- 4 - **Jim \_\_\_\_\_ ë më i math se u.**
- 5 - Marieja pati një \_\_\_\_\_.
- 6 - Kur ziejëm brumit kuçina bëhet plot me \_\_\_\_\_.
- 7 - Mua më pëlqen brumit me \_\_\_\_\_.
- 8 - \_\_\_\_\_ sot isht i fjellët.
- 9 - Jim \_\_\_\_\_ isht bir i motrëmëmës.
- 10 - **Noni ë \_\_\_\_\_ stern.**
- 11 - Delet vanë te \_\_\_\_\_.
- 12 - Gjergji u vu kaluar te \_\_\_\_\_.
- 13 - Morëm pishqit te \_\_\_\_\_.
- 14 - Kur zë \_\_\_\_\_ lagen gjithqish.
- 15 - \_\_\_\_\_ ka njëqind vjet.



**SHUMËS:** disqet, thonjtë, miq, kungujt, kallinj, eshtrat, avuj, vëllezër, djem, kushërinjtë, shirat, dushqë, kuej, glunjë, vjet

- 1 - Marku e Marieja janë \_\_\_\_\_.
- 2 - U los ngaditë me Steun, përcë na jemi \_\_\_\_\_.
- 3 - Markun te festat jerdhën e e gjetën \_\_\_\_\_.
- 4 - Kur te dimri zënë fill \_\_\_\_\_ ngë mënd dilet më jashta.
- 5 - **Te të korrat arat janë plot me \_\_\_\_\_.**
- 6 - Nonës i dhëmbjën \_\_\_\_\_.
- 7 - Pashë nonën që vëhej më \_\_\_\_\_ përpara Shën Gjergjit.
- 8 - Silvana sot preu \_\_\_\_\_.
- 9 - \_\_\_\_\_ mua ngë më pëlqejën e i ha noni.
- 10 - Me ujët të ngrohtë banji më mbulonet me \_\_\_\_\_.
- 11 - Më parë te festa e Shën Mërisë rridhjen \_\_\_\_\_.
- 12 - Xhuzepe e Xhorxho janë \_\_\_\_\_ të mirë.
- 13 - Dy \_\_\_\_\_ prapa isha më i vogël.
- 14 - **Kur fryn era fluturojën fletë, kartë e \_\_\_\_\_.**
- 15 - \_\_\_\_\_ e Klaudio Baljonit më pëlqejën.



**NJËJËS E SHUMËS:** dushk, bij, pleq, ftoi, asht, kau, barëra, dashin, kronjet, lumi

- 1 - Me hyri një \_\_\_\_\_ te syu.
- 2 - Qeni jiku me një \_\_\_\_\_ te goja.
- 3 - Marieja ka tre \_\_\_\_\_ të mirë.
- 4 - \_\_\_\_\_ i glet mollës.
- 5 - I jerdhi syu \_\_\_\_\_.
- 6 - **Më parë gratë mblojën ujët te \_\_\_\_\_.**
- 7 - Te marsi përjashta mblonet me \_\_\_\_\_.
- 8 - Noni e nona janë \_\_\_\_\_.
- 9 - \_\_\_\_\_ isht plot me ujë.
- 10 - Miqtë poqën \_\_\_\_\_.



## MËSIMI 9E

Njëjësi e shumësi i emrave femërorë.

Vëre' nani ca emra femërorë të *numri njëjës* e të *numri shumës* sa t'i përdorësh si nget kur ke dishirim të shkruash mirë arbërisht.

### EMRA FEMËRORE

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar / e shquar

arë	–	ara
arrë	–	arra
dardhë	–	dardha
dërrasë	–	dërrasa
farë	–	fara
fushë	–	fusha
flutur	–	flutura
gropë	–	gropa
kanistër	–	kanistra
kezë	–	keza
kumbull	–	kumbulla
lopatë	–	lopata
mëmë	–	mëma
pelë	–	pela
petull	–	petulla
rrotë	–	rrota
shpatull	–	shpatulla
shportë	–	shporta
trumbetë	–	trumbeta
tryesë	–	tryesa
thikë	–	thika
vetull	–	vetulla

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar / e shquar

ara	–	arat
arra	–	arrat
dardha	–	dardhat
dërrasa	–	dërrasat
fara	–	farat
fusha	–	fushat
flutura	–	fluturat
gropa	–	gropat
kanistra	–	kanistrat
keza	–	kezat
kumbulla	–	kumbullat
lopata	–	lopatat
mëma	–	mëmat
pela	–	pelat
petulla	–	petullat
rrota	–	rrotat
shpatulla	–	shpatullat
shporta	–	shportat
trumbeta	–	trumbetat
tryesa	–	tryesat
thika	–	thikat (thikë – thikët)
vetulla	–	vetullat



anë	–	ana
brinjë	–	brinja
bukë	–	buka
buzë	–	buza
degë	–	dega
ditë	–	dita
fjalë	–	fjala
fletë	–	fleta
gërshërë	–	gërshëra

anë	–	anët
brinjë	–	brinjët
bukë	–	bukët
buzë	–	buzët
degë	–	degët
ditë	–	ditët
fjalë	–	fjalët
fletë	–	fletët
gërshërë	–	gërshërët

gozhdë – gozhda  
 ijë – ija  
 jetë – jeta  
 këmishë – këmisha  
 këpucë – këpuca  
 lopë – lopa  
 lugë – luga  
 mollë – molla  
 orë – ora  
 pjeshkë – pjeshka  
 sisë – sisa  
 shegë – shega

gozhdë – gozhdët (gozhdat,-at)  
 ijë – ijët  
 jetë – jetët  
 këmishë – këmishët  
 këpucë – këpucët  
 lopë – lopët  
 lugë – lugët  
 mollë – mollët  
 orë – orët  
 pjeshkë – pjeshkët  
 sisë – sisët  
 shegë – shegët



dele – delja  
 faqe – faqja  
 lule – lulja  
 nuse – nusja  
 poçe – poçja


dele – delet  
 faqe – faqet  
 lule – lulet  
 nuse – nusët  
 poçe – poçet



**dhi** – **dhia**  
 fuqi – fuqia  
 shpi – shpia  
 shtëpi – shtëpia

**dhi** – **dhinë**  
 fuqi – fuqinë  
 shpi – shpinë  
 shtëpi – shtëpinë

- shqip -



Naní vëre' e mëso mirë këta emra femërorë:

### EMRA FEMËRORE

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar / e shquar



derë – dera  
dorë – dora  
gjë – gjëja  
**grua** – **gruaja**  
natë – nata

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar / e shquar

dyer – dyert  
duar – duart  
gjëra – gjërat  
**gra** – **gratë**  
net – netët



#### KANË VETËM NJËJËSIN

Forma e pashquar / e shquar

besë – besa  
shëndetë – shëndeta  
**vapë** – **vapa**  
zali – zalia



#### KANË VETËM SHUMËSIN

Forma e pashquar / e shquar

të fala – të falat  
të korra – të korrat  
të mbjella – të mbjellat  
**të vjela** – **të vjelat**

## USHTRIME

Di të vësh fjalën ç' i duhet te vendi ç' i nget ?

### NJËJËS

fusha, flutur, arrë, dërrasa, shpatulla, thika, këpucë, gozhdë, lule, dora, pjeshka, nata, grua, fjala, degë


- 1 - Kush e çajti këtë \_\_\_\_\_ te ky ulli ?
- 2 - Kërkova të zëja një \_\_\_\_\_, por (ma) si u qasa fluturoi.
- 3 - **Xhovani të diel vuri një parë \_\_\_\_\_ të reja.**
- 4 - Kjo \_\_\_\_\_ isht e shoqja e Ntonit.
- 5 - \_\_\_\_\_ më e mirë isht ajo që ngë thuhet.
- 6 - Vate te \_\_\_\_\_ të punojë vreshtën.
- 7 - \_\_\_\_\_ isht plot me ize.
- 8 - Mikut tim i dhemb \_\_\_\_\_.
- 9 - Çajti një \_\_\_\_\_ e e hengri.
- 10 - **Marku me miqtë bënë një kalive me \_\_\_\_\_.**
- 11 - Ngjiti një \_\_\_\_\_ te muri.
- 12 - \_\_\_\_\_ ka pesë glishtra.
- 13 - Xhovanës dhëndri i dha një \_\_\_\_\_.
- 14 - \_\_\_\_\_ ngë pret.
- 15 - \_\_\_\_\_ jui vë te luga e zëmrës.



### SHUMËS

mollë, fjalë, delet, shpatulla, petullat, lule, degët, fletët, duart, gra, dyert, lugët, kofshët, dhi, fuqitë

- 1 - Bleva dy kile \_\_\_\_\_ të bardha.
- 2 - Te Kalivari hëngrëm \_\_\_\_\_.
- 3 - Mbillni \_\_\_\_\_ se ë erë e fortë.
- 4 - Ntoni ka \_\_\_\_\_ të gjera.
- 5 - Mos ia prit \_\_\_\_\_ dardhës.
- 6 - \_\_\_\_\_ **hanë barin.**





- 7 - Pashë ca \_\_\_\_\_ që kërkojnë bar te shkëmbet e malit.  
 8 - I tha dy \_\_\_\_\_ të bukura të ngushëlloj mikun.  
 9 - Xhovana lajti tajurët, qelqet e \_\_\_\_\_.  
 10 - Të rremet kanë \_\_\_\_\_ të shkurtura - thotë proverbë.  
 11 - Shërbeu aqë shumë se pra i ranë \_\_\_\_\_.  
 12 - Te prilli e te maji përjashta mblonet me \_\_\_\_\_.  
 13 - \_\_\_\_\_ e ullirit janë më të vogla se ato të dardhës.  
 14 - **Me Markun rrojën tri \_\_\_\_\_: e jëma, e motra e nona.**  
 15 - Mbaj \_\_\_\_\_ te vendi !



## NJËJËS E SHUMËS

besë, të falat, të vjelat, vetullat, poçja, ditët, vapa, nusja, netët, dyer

- 1 - Ke \_\_\_\_\_ se ai vate xathur njera te pici i malit ?  
 2 - Te gushti këtu \_\_\_\_\_ ë e fortë.  
 3 - Marku Maries i dërgoi vetëm \_\_\_\_\_!  
 4 - Më parë thjerrët i ziejën te \_\_\_\_\_.  
 5 - \_\_\_\_\_ te dimri janë më të glata.  
 6 - Emigranti dhëmbbron \_\_\_\_\_ të priret te Hora.  
 7 - **Te \_\_\_\_\_ na citemi me rrush.**  
 8 - Ntoni Markut i dha një grusht te \_\_\_\_\_.  
 9 - \_\_\_\_\_ e la !  
 10 - \_\_\_\_\_ ngë ka ajo shpi.



## MËSIMI 10E

Njëjësi e shumësi i emrave asnjane.

Vëre' naní ca emra *asnjane* në *numrin njëjës* e në *numrin shumës* sa t'i përdorësh si nget kur ke dishirim të shkruash bukur arbërisht.

### EMRA ASNJANËS

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar / e shquar

brumë - brumit

të folë - të folit

o të folur - të folurit

mish - misht

të ngrënë - të ngrënit

ujë - ujët

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar / e shquar

brumra - brumrat

të fola - të folat

o të folura - të folurat

mishra - mishrat

të ngrëna - të ngrënat

ujëra - ujërat

etj.

**Vër re!** Shumësi i emrave asnjane bëhet femëror: *ujëra të frohta*.

#### KANË VETËM NJËJËSIN

Forma e pashquar / e shquar

të jecur - të jecurit (të ecur - të ecurit)

të frohtë - të frohtit

lesh - lesht

tëtim - tëtimt (edhe mashkullor: tëtim - tëtimi, tëtime - tëtime)



#### USHTRIME

Vër fjalën ç' i duhet te vendi ç' i nget:

*të ngrënit, tëtim, ujërat, ujë, lesht.*

- 1 - \_\_\_\_\_ sot ngë i pëlqeu.
- 2 - Mos dil pa xhakë se merr \_\_\_\_\_.
- 3 - **Ëm ca \_\_\_\_\_ se kam etë.**
- 4 - Flë butë te \_\_\_\_\_.
- 5 - Gjithë \_\_\_\_\_ ven' e sosjën te dejt.



## MËSIMI 11E

Lakimi i emrit: rrasa emërore.

### VËR RE!

Sa të mos bëjmë të rëndë Ligjëratën,  
te MESIMET 11/22 japjmë si  
shembuj vetëm emra mashkullorë e  
femërorë.

Vëre' mirë si janë të lidhura këto fjalë:

Djali ha.



Vajza ha.



Nani na pyejëm:

Kush ha? = “djali”, “vajza”.

Çë isht e bën *djali*? = Isht e “ha”.

Çë isht e bën *vajza*? = Isht e “ha”.

Na ka dimë këto shërbise:

Çë janë te gramatika “djali” e “vajza”?

Çë ë “ha”?

Te gramatika emri “djali” e emri “vajza” janë *kryefjalë* (litisht: *soggetto*);

“ha” ë folje (litisht: *verbo*).

Çë do të thomi me fjalën “kryefjala”? Do të thomi se

- “kryefjala” ë “fjala në krye”, vje' më rarë se rri në “krye të fjalisë”, se ë fjala çë jep urdhërit, çë kumandar, protagoniste;
- folja “ha” pra na thotë çë isht e bën “kryefjala”.

E ngë kemi sosur! Arbërisht kemi njetër komplikacionë.

Zglith fjalitë (proposicionët) pameta:

Djali i ha.



Vajza a ha.



Përçë “djali” ka mbaresën (desinencën) me “i” ?

Përçë “vajza” ka mbaresën me “a” ?

Përçë fjalët “djali” e “vajza” si “kryefjalë” ven’ë sosjën te kasela “emërore” o më mirë te “rasa emërore”. Do t’ë ndëlgosh më mirë tuke vërejtur tabelat te MËSIMET çë vijën.

**Litisht** thuhën kështu:  
*kryefjalë* = soggetto;  
*emërore* = nominativo;  
*rasa emërore* = caso nominativo.

## USHTRIME

1 – Shkruaj te ana emrin çë të duket se ë “kryefjala” te shembujt këtu poshtë.

1 - Sara rrjedh.

Kush rrjedh? \_\_\_\_\_

2 - La<sup>o</sup> Gjergji vete përjashta.

Kush vete përjashta? \_\_\_\_\_

3 - Djali këndon.

Kush këndon? \_\_\_\_\_

4 - Mëma lan pethkat.

Kush lan pethkat? \_\_\_\_\_

5 - Qeni leh.

Kush leh? \_\_\_\_\_



## MËSIMI 12E

Lalimi i emrit: rasa kallëzore.

Nani vëre' mirë si janë lidhur këto fjalë:

Djali ha mjajtin.



Vajza ha mollën.



E pyejëm:

Çë isht e ha “djali” ? = Isht e ha “mjajtin” .

Çë isht e ha “vajza” ? = Isht e ha “mollën” .

Pamë çë janë te gramatika “djali” e “vajza” e pamë çë ë “ha”.

E “mjajtin” e “mollën” çë janë ?

Zglith mirë:

“mjajtin” ë *kundrinë e drejtë* (litisht: complemento diretto o complemento oggetto) e edhe

“mollën” ë *kundrinë e drejtë*.

E çë do të thomi me fjalët “kundrinë e drejtë” ?

Do të thomi se

- fjala vënë te “kundrina e drejtë” ë pjesë komplementare e të folurit, çë, lidhur me foljen (litisht: verbo), na thotë më mirë çë ish e bën “kryefjala”, na thotë ku vet' e sos e bëma e kryefjalës .

E ngë kemi sosur !

Zglidhi pameta fjalitë: Djal*i* ha mjajt*in*.  
Vajz*a* ha moll*ën*.



Pamë se fjala “djal*i*” ka mbaresën me “*i*” e pamë se “vajz*a*” ka mbaresën me “*a*”.

E përçë fjala “mjajt*in*” e ka me “*in*”

e fjala moll*ën*” e ka me “*ën*” ?

Përçë fjala “mjajt*in*” me fjalën moll*ën*” si “*kundrina të drejta*” ven’ e sosjën te kasela “*kallëzore*” o më mirë te “*rasa kallëzore*” e mbaresat (desinencat) “*-in*” e “*-ën*” na e thonë.

Do t’i ndëlgosh gjagjë më shumë tuke vërejtur tabelat te MËSIMET çë vijën.

Litisht thuhet kështu:

*kundrinë e drejtë* = complemento diretto o complemento oggetto;

*kallëzore* = accusativo;

*rasa kallëzore* = caso accusativo.

#### SHËNIM

Për foljen “ha” vëre’ te kapitulli i saj; si nani ë mirë të dish se “foljet” çë kanë prapa “*kundrinën e drejtë*” janë “folje kalimtare” (litisht: verbi transitivi) = çë lënë të shkojnë të bëjnë e kryefjalës te *kundrina e drejtë*: Vajza > ha > mollën.

#### Zglidh e mëso!

Fjalët çë sheh këtu sipër vijën nga gluha arbëreshe:

“*kallëzonj*” (= rrivelar, rrëfyenj, akusar) (shkrimtarët tanë të vjetër këtë fjalë e kanë mbajtur mend);

Fjala italiane “complemento” arbërisht del kështu:

“*plotës*”, vje’ më rarë “çë mblon, plotëson (i plotë)”;

“*kundrinë*” thuhet për “*kundrinën e drejtë*”;

e, si do të shohësh, fjala “*kundrinë*” thuhet edhe te “*kundrina e zhdrejtë*” (litisht: complemento indiretto o complemento di termine).

## USHTRIME

1 – Thuaj çila ë “kryefjala” e çila “kundrina e drejtë” te shembujt këtu poshtë.

**Shembull:** Vajza ha mollën.

**Kush ?**

Vajza



**Çë bën ?**

ha



**Çë ?**

mollën



1) *Vajza ha mollën.*

Vajza = kryefjalë

ha = folje

mollën = kundrinë e drejtë

2) *Marku ka qenin.*

Marku = \_\_\_\_\_

ka = folje

qenin = \_\_\_\_\_



3) *La' Gjergji mbjeth llapsana.*

La' Gjergji = \_\_\_\_\_

mbjeth = folje

llapsana = \_\_\_\_\_

4) *Sara lan dheun.*

Sara = \_\_\_\_\_

lan = folje

dheun = \_\_\_\_\_



5) *Qeni kerkon të ngrënë.*

Qeni = \_\_\_\_\_

kërkon = folje

të ngrënë = \_\_\_\_\_



2 - Te çila "rasë" vete kryefjala e te çila kundrina e drejtë?

- kryefjala vete te rasa emërore
- kundrina e drejtë vete te rasa kallëzore

Kështu:

1) Vajza ha mollën.

Vajza = kryefjalë > rasë emërore  
mollën = kundrinë e drejtë > rasë kallëzore



2) Marku ka qenin.

Marku = \_\_\_\_\_ > \_\_\_\_\_  
qenin = \_\_\_\_\_ > \_\_\_\_\_



3) La' Gjergji mbjeth llapsana.

La' Gjergji = \_\_\_\_\_ > \_\_\_\_\_  
llapsana = \_\_\_\_\_ > \_\_\_\_\_



### Si naní ke parë e ke mësuar:

emra *mashkullorë*, emra *femërorë*, emra *asnjanës*

- te forma e pashquar e te forma e shquar
- te numri njëjës e te numri shumës
- te rasa emërore - si kryefjalë
- te rasa kallëzore - si kundrinë e drejtë



## Sa shërbise ke mësuar ?

U mësova emrat mashkullorë.



U edhe ata femërorë.

Mos harro ata asnjnës !



U i mësova emrat asnjnës !

U i di të gjithë sa janë  
te "forma e pashquar" !



U edhe te "forma e shquar" !

Te numri njëjës ...



E te numri shumës !

Te "rasa emërore"  
me "kryefjalën" ?



E te "rasa kallëzore"  
me "kundrinën e drejtë" ?

Ngë jini lodhët  
me gjithë këto ?



E çë ke parë ! E di  
sa kemi të mësojëm ?



## MËSIMI 13E

Lakimi i emrit njëjës e shumës të rasat emërore e kallëzore të pashquara e të shquara.

Nani zglith mirë këtë rrëfim:

Nga një ushtrim arbërisht i njëi  
nxënësje të skollës së mesme të Horës.

### LULET

Një herë pashë një burrë liti, që mbaj ca lule te dora. Ishën lule të bukura. Litiri pa ca burra te kafeu, u qas e i dha atyre një lule për nga një sa të ia qilljën të shoqevet te shpia.

La' Gjergji, që isht atje, thërriti burrin që dhuroj lule e i tha se ai lulen të shoqes ngë ia qillëj, se thotse: "Çë ish festa e '8 Marsit', çë ka i qell lulet sime shoqe?"


La' Gjergji ndërkaq vërej atë lule që kish te dora; ish një lule vërtet e gjallë. Ai liti thërriti burrat që ishën atje te ana e i tha: "Mos pritni të jetë festa e '8 Marsit' t'i qillni lulet gravet tuaja: një lule qellur papritur isht një shërbes që mënd të ndërronj jetën tëj!"

Ata burra ngë thanë gjë. Kushedi në ia qellën lulet të shoqevet!

Dihet se lulet gravet i pëlqejën!

Burrat disa herë këto shërbise ngë i ndëlgojën.

Burri e lulja thomse ngë venë dakord.



**Vëre' mirë** këto fjali të rrëfimit:

me fjalën “burrë”:

pashë një burrë, pa ca burra, thërriti burrin, thërriti burrat, ata burra  
ngë thanë gjë, burrat këto shërbise ngë i ndëlgojën, burri.

e me fjalën “lule”:

ca lule, ishën lule të bukura, dha një lule, dhuroj lule, lulen të shoqes  
ngë ia qillëj, lulet, vërej atë lule, ish një lule e gjallë, qillni lulet gravet,  
një lule qellur papritur, kushedi në ia qellën lulet, lulet gravet i pëlqejën,  
lulja.

Si sheh, kemi shumë forma e ca duken paraç, ma (por) ngë janë paraç:

*burrë, burrë, burra, burrin, burrat, burra, burrat, burri*

e

*lule, lule, lule, lulen, lule, lulet, lulet, lulja.*

Përçë gjithë këto forma ?

Arbërisht, si edhe shqip, ë normale, përçë te fjalët e mësipërme

ca janë te **numri njëjës i pashquar**

ca janë te **numri shumës i pashquar**

ca te **numri njëjës i shquar**

ca te **numri shumës i shquar**

ca janë **kryefjalë**

ca janë **kundrina të drejta**

e, si mësove më lart,

**kryefjala** vete te **rasa emërore,**

**kundrina e drejtë** vete te **rasa kallëzore.**



Vëre' këto dy tabele:

**NUMRI NJËJËS**  
**EMËR MASHKULLOR**

EMËRORE	Forma e pashquar (një) burrë	Forma e shquar burri
KALLËZORE	(një) burrë	burrin



**EMËR FEMËROR**

EMËRORE	Forma e pashquar (një) lule	Forma e shquar lulja
KALLËZORE	(një) lule	lulen



Te këto tabele kemi:

burrë – burri

lule - lulja

burrë – burrin

lule - lulen



Nani vëre':

**NUMRI SHUMËS**  
**EMËR MASHKULLOR**

EMËRORE	Forma e pashquar (ca) burra	Forma e shquar burrat
KALLËZORE	(ca) burra	burrat



**EMËR FEMËROR**

EMËRORE	Forma e pashquar (ca) lule	Forma e shquar lulet
KALLËZORE	(ca) lule	lulet



Te këto tabele kemi:

burra – burrat

lule – lulet

burra – burrat

lule - lulet

Si nani mbaj mend atë që sheh shkruar;  
më atëj do t'i ndëlgosh gjagjë më shumë!

## USHTRIME

1 - Vër te vendi i tyre, te tabelat më poshtë, tetë (8) fjalë "burrë..." e tetë (8) fjalë "lule...", që ndodhen abrënda ushtrimevet si kryefjalë o kundrina të drejta.

Kujto se: *kryefjala* > rasi emërore, *kundrina e drejtë* > rasi kallëzore.

- 1 - **Bleva ca lule** (kundrinë e drejtë).
- 2 - Lulet (kundrinë e drejtë) ngë ia dhashë.
- 3 - Sa lule (kryefjalë) që janë këtu !
- 4 - Sa burra (kryefjalë) që janë te qaca !
- 5 - Burrat (kryefjalë) vanë përjashta.
- 6 - Burrë (kryefjalë) i mirë, la' Ndrica !
- 7 - Ngë e njoh atë burrë (kundrinë e drejtë).
- 8 - Mbjodha një lule (kundrinë e drejtë).
- 9 - Lulen (kundrinë e drejtë) që mbjodha ia dhashë mëmës.
- 10 - Burri (kryefjalë) buria e gruaja mavria ! - thëshjën gratë antike.
- 11 - **Lulja** (kryefjalë) **u ter**.
- 12 - Lulet (kryefjalë) u tertën.
- 13 - Burrin (kundrinë e drejtë) tim e dua mirë ! - tha nona.
- 14 - Pashë shumë burra (kundrinë e drejtë) te qaca.
- 15 - Lule (kryefjalë) ë vajza jote !
- 16 - Pashë burrat (kundrinë e drejtë) që vejën përjashta.



### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / e shquar

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / e shquar

EMËRORE	<u>burrë (6)</u>	<u>burri (10)</u>	_____	_____
KALLËZORE	_____	_____	_____	_____

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / e shquar

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / e shquar

EMËRORE	<u>burra (4)</u>	_____	_____	_____
KALLËZORE	_____	_____	<u>lule (1)</u>	_____



2 - Si fjala " burrë " bëjnë fjalët " glëmb " e " derr " : më para vëreji e pra shkruaji.

1 - Më hyri një glëmb te glishti.

2 - Nona më nxori glëmbin që më kish hyjtur te glishti.

3 - Lulet më të bukura kanë glëmba.

4 - Te staja pashë një derr.

5 - Derrat hanë gjithqish.

6 - La' Steu rriti derrin.

7 - Sa derra që janë këtu !

8 - Glëmbat ia nxore ?

9 - Përyashta pashë derrat e la' Steut.

10 - Glëmbat shpojnë.

11 - Derrin jiku ka staja.

12 - Kam një glëmb te glishti.

13 - Glëmbi shpon.

14 - Sa glëmba që janë aty!

15 - Ca derra jikën ka staja.

16 - Një derr kërkoi të jikëj.



### NUMRI NJËJËS

glëmb - glëmbi

Forma e pashquar / e shquar

derr - derrin

Forma e pashquar / e shquar

EMËRORE

KALLËZORE

### NUMRI SHUMËS

glëmba - glëmbat


Forma e pashquar / e shquar

derrat - derrat

Forma e pashquar / e shquar

EMËRORE

KALLËZORE



3 - Si fjala "lule" bëjnë fjalët "nuse" e "dele": më para vëreji e pra shkruaji.

- 1 - Pë' Pashkë vajzat u veshën *nuse*.
- 2 - U dje u veshën *nuse*.
- 3 - *Nusja ë e bukur*.
- 4 - La' Gjergji ka njëqind *dele*.
- 5 - *Delet e la' Gjergjit janë të gjitha të bardha*.
- 6 - I vëllai i la' Gjergjit ka vetëm një *dele*.
- 7 - Somenatë ca *dele* ishën te Fusha.
- 8 - *Nuset* ishën të bukura.
- 9 - Përpoqa *nusen* e i dhashë një *lule*.
- 10 - Mjola *delen* e të vëllait të la' Gjergjit.
- 11 - Dje pashë një *nuse*.
- 12 - *Delet* i njej pekurari (delmeri).
- 13 - *Nuset* arbëreshe i përpoqa ka Shën Mitri.
- 14 - *Delja u zbuar*.
- 15 - Dhromit pashë ca *nuse*.
- 16 - Një *dele* u zbuar.



### NUMRI NJËJËS

**lule - lulja**

Forma e pashquar / e shquar

**dele - delja**

Forma e pashquar / e shquar

EMËRORE  
KALLËZORE

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### NUMRI SHUMËS

**lule - lulet**

Forma e pashquar / e shquar

**dele - delet**

Forma e pashquar / e shquar

EMËRORE  
KALLËZORE

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_




Më atej do të shohësh “lakimet” e të gjithë emravet mashkullorë e femërorë.

*Lakim = deklinacionë, vje’ më rarë si ndërron arbërisht emri te fjalimet, te diskutet çë bëjëm.*


Si nani, sa të mos ndëlgosh se të gjithë emrat janë si “burrë-burri” e si “lule-lulja”, shih si bëjën “ulk-ulku” e “mollë-molla”.

## NUMRI NJËJËS

### EMËR MASHKULLOR

EMËRORE	Forma e pashquar	Forma e shquar	
KALLËZORE	(një) ulk (një) ulk	ulku ulkun	


### EMËR FEMËROR

EMËRORE	Forma e pashquar	Forma e shquar	
KALLËZORE	(një) mollë (një) mollë	molla mollën	




## NUMRI SHUMËS

### EMËR MASHKULLOR

EMËRORE	Forma e pashquar	Forma e shquar	
KALLËZORE	(ca) ulq (ca) ulq	ulqit ulqit	

### EMËR FEMËROR

EMËRORE	Forma e pashquar	Forma e shquar	
KALLËZORE	(ca) mollë (ca) mollë	mollët mollët	



## SHËNIM 1.

Rasa emërore.

Mbajën rasën emërore edhe ca parafjalë (litisht: prepozicioni): “ka” o “nga” e “te”.

Përpara fjalës çë zë me zanore (vokale) o sa të mos përpiqen shumë bashkëtingëllore (konsonanti) me të njëjtin tingull, “ka” o “nga” e “te” marrjën një “-k”.

Shembuj:

U vinj **ka** (nga) Hora e Arbëreshëvet.

U vajta **te** Hora e Arbëreshëvet.

Vate **tek** e motra.



Për “ngak” vëre’ te pjesa e ligjëratës: “**parafjala**”.

## SHËNIM 2.

Rasa kallëzore.

Mbajën rasën kallëzore parafjalët *me, në, nëpër, mbi, për, etj.*


Shembuj:

Shiu ra **mbi** arat.

Fëmijët rrinë **me** nonën.

Të ngrënit ë **mbi** tryesën e shtruar.

Për Markun gjithë jemi miq.



## MËSIMI 14E

Lakimi i emrit te rase gjinore njëjës e pashquar.

Vëre' mirë si lidhen fjalët te këto fjalë:



Marku ë bir i njëi *burri* të mirë.



Më pëlqen përfilli i njëi *lulje* si kjo.



Sh(të)pia e këtij *burri* ë e madhe.



Fletët e kësaj *lulje* janë të gjera.

**Gjejëm:** (i) (njëi) burri (i) (njëi) lulje (e) (këtij) burri (e) (kësaj) lulje

**Ti pyen:**

i kujt ë bir Marku?  
i kujt ë përfilli çë të pëlqen?  
e kujt ë shtëpia e madhe?  
të kujt janë fletët e gjera?



**E merr këto përgjegje:**

i njëi burri të mirë  
i njëi lulje si kjo  
e këtij burri  
të kësaj lulje



**Çë janë fjalët “burri, lulje” te gramatika ?**

**Janë: “plotës dallimi” o “përcaktorë”.**

**E te çila “rasë” vete “plotësi i dallimit”?**

**“Plotësi i dallimit” vete te “rasa gjinore”.**

“Plotësi i dallimit” e “rasa gjinore” litisht thuhet kështu:

- plotës dallimi = complemento di specificazione
- rasë gjinore = caso genitivo

Thuhet *plotës dallimi*, përçë përcakton (specifikar) e dallon (distinguir) emrin.

Si naní jemi e flasjëm për “plotësin e dallimit” e për “rasën gjinore” në “formën e pashquar”.

Vëre’ këtë tabele që dal’ e dalë vete tuke u bërë më e plotë:

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / ...

EMËRORE	(një) burrë
GJINORE (i, e, të)	(njëi) burri
KALLËZORE	(një) burrë



#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / ...

(një) lule
(i, e, të) (njëi) lulje
(një) lule



### USHTRIME

Vër te vendi ç’ i nget këto fjalë *plotës dallimi* :

burri, lulje, gruaje, shpije, kali, maçi, djali, vajzje, mali, lumi.

- 1 - Lartësia e atij \_\_\_\_\_ isht 1.333 metre mbi dejt.
- 2 - Ujët e atij \_\_\_\_\_ u ter.
- 3 - Miku i atij \_\_\_\_\_ isht po ai qen.
- 4 - Mera (hjauri) e asaj \_\_\_\_\_ ngë më pëlqen.
- 5 - I zoti i këtij \_\_\_\_\_ isht la’ Ndrica.
- 6 - I shoqi i asaj \_\_\_\_\_ isht la’ Nini.
- 7 - E zonja e atij \_\_\_\_\_ isht vo’ Lena.
- 8 - Dhëndri i asaj \_\_\_\_\_ ë i bukur.
- 9 - Muri i asaj \_\_\_\_\_ isht e gorrromiset.
- 10 - E shoqja e atij \_\_\_\_\_ pret një fëmijë.



## MËSIMI 15E

Lakimi i emrit te rasa gjinore njëjës e shquar.

Kemi parë si del *forma e pashquar e rasës gjinore*.

Nani shohjëm si del *forma e shquar* (litisht: determinata) e *rasës gjinore*.

Zgledhjëm këto fraza:



Qeni ë miku i burrit.



Përfilli i lules, çë ke te dora, ë i bukur.



Mendja e burrit ë e fortë.

Fleta e lules, çë ke te dora, ë e gjerë.



Gjejëm: (i) burrit (i) lules (e) burrit (e) lules

Ti pyen:

*i kujt* ë mik qeni?

*i kujt* ë përfilli çë të pëlqen?

*e kujt* ë mendja e madhe?

*e kujt* ë fleta e gjerë?

E merr këto përgjegje:

*i burrit* (e jo i kafshës, për shembull)

*i lules*, çë ke te dora

*e burrit* (e jo e kafshës, p. sh.)

*e lules*, çë ke te dora



Fjalët *(i,e) burrit* e *(i,e) lules* janë “plotës dallimi” në formën e shquar të rasës gjinore.

Vëre' këtë tabelë:

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

... / Forma e shquar

#### EMËR FEMËROR

... / Forma e shquar

EMËRORE

burri



lulja



GJINORE

(i, e) burrit

(i, e) lules

KALLËZORE

burrin

lulen

E kjo ë tabelja e njëjësit të *pashquar* e të *shquar*, **mashkullor** e **femëror**, te *rasat emërore, gjinore e kallëzore*.

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / Forma e shquar

EMËRORE

(një) burrë

burri

GJINORE

(i, e, të) (njëi) burri

(i, e, të) burrit

KALLËZORE

(një) burrë

burrin



#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / Forma e shquar

EMËRORE

(një) lule

lulja

GJINORE

(i, e, të) (njëi) lulje

(i, e, të) lules

KALLËZORE

(një) lule

lulen



## USHTRIME

1 - Vër te vendi ç'i nget këto fjalë në *rasën gjinore*:

(i) burrit, (i) dorës, (e) Xhovanës, (i) nonit, (e) nonës, (e) malit, (i) vajzës, (e) Gjergjit, (i) librit, (i) kalit, (e) pelës, (i) bukës, (e) tryesës, (e) shpisë, (e) kalit

- 1 - Gruaja isht e zonja e \_\_\_\_\_.
- 2 - **Qeni isht miku i** \_\_\_\_\_.
- 3 - Gjergji isht i nipi i \_\_\_\_\_.
- 4 - Nona e \_\_\_\_\_ isht e mirë.
- 5 - Xhovana isht e mbesa e \_\_\_\_\_.
- 6 - Lartësia e \_\_\_\_\_ Picuta isht 1.333 metre mbi dejt.
- 7 - Nusja e \_\_\_\_\_ isht e bukur.
- 8 - I zoti i \_\_\_\_\_ isht la' Ndrica.
- 9 - Mësalla e \_\_\_\_\_ isht e bardhë.
- 10 - Mëza isht e bija e \_\_\_\_\_.
- 11 - Hjauri i (mera e) \_\_\_\_\_ çë del ka furri më pëlqen.
- 12 - **Dhëndri i** \_\_\_\_\_ **isht i glatë.**
- 13 - Femra e \_\_\_\_\_ isht pela.
- 14 - Me dhëmb glishti i vogël i \_\_\_\_\_ së drejtë.
- 15 - **Vendi i** \_\_\_\_\_ **te libreria isht ai.**



2 - Nënvizò (sotolinear) fjalët në “rasën gjinore” të ky rrëfim këtu poshtë.

## APARTAMENTI I XHOVANËS

Apartamenti ku rri Xhovana ë i math. Ashtu si hyhet, shohjëm “hyrjen”, një dhomë (stancë, kambër) e (të) vogël që jep të një korridor, nga i çili duken dyert e apartamentit.

E para derë jep të salla e pritjes; pra të ana e drejtë ë dhoma e Markut e tek e shtrëmbra dhoma e Xhovanës.

Më atëj vjen kuçina, dhoma e të ngrënit e dhoma ku flënë prindrat.


Bashkë me në ë miku i Markut, Gjergji, i çili thotë se Marku ka një dhomë të bukur.

Mikja e Xhovanës, Mara, thotë se më e bukur ë dhoma e Xhovanës.

Hyrja e apartamentit ë e zbardhur me të bardhë, sa të ketë më shumë dritë; dhoma e Markut me të verdhë e dhoma e Xhovanës me ngjyrën (kullurin) e trëndafiles.

Të dhoma e Markut gjegjemi ca muzikë.

Muzika e diskut ë moderne.



## MËSIMI 16E

Lakimi i emrit të rrasa gjinore shumës e pashquar dhe e shquar.

Vëre' mirë këto fjali:

Fuqia e disa *burrave* ë e madhe.



Fletët e disa *luleve* janë të gjera.

Fjalët *burrave* e *luleve* ndodhen të “numri shumës”, të “forma e pashquar”, janë “plotës dallimi” e venë, si pamë, të “rasa gjinore”.

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / ...

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / ...

EMËRORE  
GJINORE  
KALLËZORE

(ca) burra  
(i, e, të) (ca) burrave  
(ca) burra



(ca) lule  
(i, e, të) (ca) luleve  
(ca) lule



E vëre':

Fuqia e *burravet* ë e madhe.

Fletët e *lulevet* të këtij kopshti janë të gjera.

Fjalët *burravet* e *lulevet* ndodhen të “numri shumës”, të *forma e shquar*, janë “plotës dallimi” e venë të “rasa gjinore”.

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

... / Forma e shquar

#### EMËR FEMËROR

... / Forma e shquar

EMËRORE  
GJINORE  
KALLËZORE

burrat  
(i, e, të) burravet  
burrat

lulet  
(i, e, të) lulevet  
lulet



E kjo ë tabelja e shumësit të *pashquar* e të *shquar*, mashkullor e femëror, te *rasat emërore, gjinore e kallëzore*.

### NUMRI SHUMËS EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / Forma e shquar

EMËRORE	(ca)	burra		burrat
GJINORE	(i, e, të)	(ca)	burrave	(i, e, të) burravet
KALLËZORE	(ca)	burra		burrat



### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / Forma e shquar

EMËRORE	(ca)	lule		lulet
GJINORE	(i, e, të)	(ca)	luleve	(i, e, të) lulevet
KALLËZORE	(ca)	lule		lulet



### USHTRIME

Vër te vendi ç' i nget këto fjalë në *rasën gjinore shumës, të pashquar e të shquar*:

(i atyre) deleve, (i) lulevet, (i atyre) djemve, (e atyre) vajzave, (e) malevet, (e) duarvet, (i atyre) grave, (i) librevet, (e atyre) zogave, (e) dardhavit.

1 - I zoti i atyre \_\_\_\_\_ ë la' Marjani.

2 - I jati i atyre \_\_\_\_\_ vate të shërbej Palermë.

3 - Mera (hjauri) i \_\_\_\_\_ mbulon gjithë shpinë.

4 - Mëma e atyre \_\_\_\_\_ shërben gjithë ditën e ditës.

5 - Lartësia e \_\_\_\_\_ ë më pak se 1300 metre.

6 - Vendi i \_\_\_\_\_ ë te libreria.

7 - Kostumi i atyre \_\_\_\_\_ ë shumë antik.

8 - Krahët e atyre \_\_\_\_\_ janë të gjerë.

9 - Glishtrat e \_\_\_\_\_ janë dhjetë.

10 - Fletët e \_\_\_\_\_ u bënë të verdha.



## MËSIMI 17E

Lakimi i emrit te rase dhanore njëjës e pashquar.

Nani vëre' këta shembuj të ri.

I dhashë dy euro njëi *burri*.



I preva bishtin njëi *lulje*.

Gjëm: (njëi) burri (njëi) lulje

Ti pyen:

kujt i dhashë dy euro?  
kujt i preva fletët?

E merr këto përgjegje:

njëi burri  
njëi lulje



Çë janë fjalët *burri*, *lulje* te gramatika ?

Janë: *kundrina të zhdrejta* !

E te çila "rasë" vete *kundrina e zhdrejtë* ?

*Kundrina e zhdrejtë* vete te *rasa dhanore*.

*Kundrina e zhdrejtë e rase dhanore* litisht thuhet kështu:

- *kundrinë e zhdrejtë* = complemento indiretto o di termine
- *rasë dhanore* = caso dativo

Vëre' tabelen që vete tuke u mbluar:

## NUMRI NJËJËS

### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / ...

EMËRORE	(një) burrë
GJINORE	(i, e, të) (njëi) burri
DHANORE	(njëi) burri
KALLËZORE	(një) burrë

### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / ...

	(një) lule
(i, e, të) (njëi)	lulje
(njëi)	lulje
(një)	lule



## USHTRIME

Vër te vendi ç' i nget fjalët në *rasën dhanore* njëjës të pashquar:  
(atij) burri, (asaj) vajzje, (njëi) djali, (njëi) lisi, (atij) plaku, (njëi) mavriu,  
(asaj) gruaje, (asaj) maçje, (atij) kali, (atij) libri.

- 1 - Xhoi i tha asaj \_\_\_\_\_ se e do pë' nuse.
- 2 - I thashë atij \_\_\_\_\_ të nxirrëj makinën ka garazhi.
- 3 - Vo' Lena i dha dy bukë njëi \_\_\_\_\_.
- 4 - **Pali asaj \_\_\_\_\_ i huajti umbrelen (parakullën) se bij shi.**
- 5 - La' Pepi i dha pruyenën atij \_\_\_\_\_.
- 6 - **Nini asaj \_\_\_\_\_ i dha të haj një pishk i (të) tërë.**
- 7 - Mara i shqorri një faqe atij \_\_\_\_\_, që i huajtën.
- 8 - **Steu i dha ndihmë atij \_\_\_\_\_ sa të shkojë te jetra anë e dhromit.**
- 9 - Sara i dha një shplakë njëi \_\_\_\_\_ që i vej aprapa.
- 10 - La' Gjergji i preu degët njëi \_\_\_\_\_.



## MËSIMI 18E

Lakimi i emrit te rasa dhanore njëjës e shquar.

Vëre' nani formën e shquar të kundrinës së zhdrejtë te numri njëjës.

*Burrit* i nget të shërbenjë shumë.



*Lules* çë më dhe i preva bishtin.

Gjejëm: burrit lules

Ti pyen:

*kujt* i nget të shërbenjë shumë?  
*kujt* i preva glëmbat?

E merr këto përgjegje:

*burrit* i nget  
*lules* çë më dhe



Fjalët “burrit” e “lules” janë “kundrina të zhdrejta” në formën e shquar e venë “te rasa dhanore”.

Vëre' tabelen:

	NUMRI NJËJËS	
	EMËR MASHKULLOR	EMËR FEMËROR
EMËRORE	... / Forma e shquar	... / Forma e shquar
GJINORE	burri	lulja
DHANORE	(i, e, të) burrit	(i, e, të) lules
KALLËZORE	burrit	lules
	burrin	lulen

## USHTRIME

Vër te vendi ç' i nget këto fjalë në *rasën dhanore të shquar*:  
nuses, mikut, mëmës, lules, qenit, fëmijës, dardhës, karroqes, kashtës, librit

- 1 - Dhëndri i mori dorën \_\_\_\_\_.
- 2 - Gjergji i tha \_\_\_\_\_ të luaj balunin.



- 3 - Valentina i shturi një asht \_\_\_\_\_ të Xhoit.
- 4 - La' Nini i preu degët \_\_\_\_\_.
- 5 - Mëma i jep klëmshit \_\_\_\_\_.
- 6 - Ndrica i nxori fletët \_\_\_\_\_.
- 7 - I lypi \_\_\_\_\_ ca bukë me marmelatë.
- 8 - Marieja i shqorri një faqe \_\_\_\_\_ të gjeografisë.
- 9 - Xhoi i dha një shqelb \_\_\_\_\_.
- 10 - Vito i dha zjarr \_\_\_\_\_.



## MËSIMI 19E

Lakimi i emrit të rrasë dhanore shumësi e pashquar dhe e shquar.

Nani vëre' si bën shumësi në formën e pashquar.

I (u) dhamë dorën disa *burrave*.



I (u) premë bishtrat disa *luleve*.

Fjalët: (disa) *burrave* (disa) *luleve* janë “kundrina të zhdrejta” në “numrin shumësi” të “formës së pashquar” e venë të “rasa dhanore”.

Vemi te tabelja e shumësit të pashquar:

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / ...

EMËRORE	(ca) burra
GJINORE	(i, e, të) (ca) burrave
DHANORE	(ca) burrave
KALLËZORE	(ca) burra

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / ...

(ca) lule
(i, e, të) (ca) luleve
(ca) luleve
(ca) lule

E në formën e shquar:

I (u) dhamë dorën *burravet*.



I (u) premë bishtrat *lulevet*.

Fjalët: *burravet* *lulevet* janë “kundrina të zhdrejta” në “numrin shumësi” të “formës së shquar” e venë të “rasa dhanore”.

## Tabelja

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

#### EMËR FEMËROR

	... / Forma e shquar	... / Forma e shquar
EMËRORE	burrat	lulet
GJINORE	(i, e, të) burravet	(i, e, të) lulevet
DHANORE	burravet	lulevet
KALLËZORE	burrat	lulet



E këtu kemi tabelen e plotë të të gjitha rasavet, që kemi parë:

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

#### EMËR FEMËROR

	Forma e pashquar / e shquar		Forma e pashquar / e shquar	
EMËRORE	(një) burrë	burri	(një) lule	lulja
GJINORE	(i...) (njëi) burri	(i...) burrit	(i...) (njëi) lulje	(i...) lules
DHANORE	(njëi) burri	burrit	(njëi) lulje	lules
KALLËZORE	(një) burrë	burrin	(një) lule	lulen

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

#### EMËR FEMËROR

	Forma e pashquar / e shquar		Forma e pashquar / e shquar	
EMËRORE	(ca) burra	burrat	(ca) lule	lulet
GJINORE	(i...) (ca) burrave	(i...) burravet	(i...) (ca) luleve	(i...) lulevet
DHANORE	(ca) burrave	burravet	(ca) luleve	lulevet
KALLËZORE	(ca) burra	burrat	(ca) lule	lulet



## USHTRIME

Vër te vendi që i nget këto fjalë në rasën dhanore shumë:  
fëmijëvet, dardhavet, turistëvet, maçevet, miqvet

- 1 - Për Pashkë \_\_\_\_\_ i (u) dhanë ve të kuqe.
- 2 - I (u) premë degët \_\_\_\_\_.
- 3 - I (u) thamë \_\_\_\_\_ të luajën me ne.
- 4 - \_\_\_\_\_ i (u) qellëm ca të ngrënë.
- 5 - \_\_\_\_\_ i (u) rrëfyejtëm një pullare.



## SHËNIM - “i” e “u”.

Çë ë ajo “i” çë vete bashkë me *burrave* e me *luleve* ?

Ajo “i”, çë kemi parë se vete bashkë me kundrinën e zhdrejtë, thërritet “përemër vetor i vetës së tretë të numrit njëjës në *formën e shkurtër*” (litisht: pronome personale di terza persona singolare in forma sintetica).

Ajo “u”, çë kemi parë se vete edhe ajo bashkë me “kundrinën e zhdrejtë”, ë “përemër vetor i vetës së tretë të numrit shumës në *formën e shkurtër*” (litisht: pronome personale di terza persona plurale in forma sintetica).

Te Hora e Arbëreshëvet, te gluha e përditshme këtë “u” te numri shumës ngë e kemi e te vendi i saj thomi “i” edhe te shumësi. Shqip te shumësi ë “u”.

Njëjës “i” :

I thashë **atij burri** të nxirëj makinën.

Shumës “i” (u):

I (u) thashë **atyre burrave** të nxirjën makinën.

E ngjitur me përemrin vetor te forma e shkurtër në rasën kallëzore :

Njëjës “ia”:

- **Kujt “ia”** the të nxirëj makinën ? **Ia = i (atij) + e (atë)**

- **“Ia”** thashë **atij burri**. **I thashë atij burri atë.**



Shumës “ia” (ua):

- **Kujt “ia” (ua)** the të nxirjën makinët ? **Ia > ua = u (atyre) + e (atë)**

- **“Ia” (ua)** thashë **atyre burrave**. **U thashë atyre burrave atë.**

Shkrimtarët tanë atë “u”, përemër vetor të vetës së tretë në formën e shkurtër, te shumësi disa herë e kanë shkruar drejt:

“ Ahierna **atyre u** erdhi në ment e Bukura Fatë ”  
(GS - CT - Novelline popolari, f. 354, r. 9).

Ashtu ngë ë për “ua”; shih si:

“ Flamurin e fitova u e **j-a** dhash **atyre** ”  
(GS - si lart - f. 369, r. 5 nga e spraxmja).

**Vëre’:** j = i, më moderne; ja = ia.



## MËSIMI 20E

Lakimi i emrit te rrasa rrjedhore njëjës e pashquar.

Vëre' mirë këto shprehje (fjalë):



Ai djalë ka fuqí *burri*.



Dërmova ca thele *bukje*.

Këtu vdiset *vapje*.



Gjejëm: burri bukje vapje

Ti pyen:

çë fuqí ka aí ?  
çë thele dërmova?  
si vdiset këtu ?

E ke këto përgjegje:

aí ka fuqí *burri*  
dërmova thele *bukje*  
këtu vdiset *vapje*.



Çë janë fjalët “*burri, bukje, vapje*” te gramatika ?

Janë plotës të disa llojesh:

“burri” ë “*plotës i cilësisë*”  
“bukje” ë “*plotës i lëndës*”  
“vapje” ë “*plotës i shkikut*”

E te çila “*rasë*” venë ata “*plotës*”?

Ata “*plotës*” çë pamë e ca të tjerë venë te “*rasa rrjedhore*”!

## Vëre' mirë:

“Plotësit” e “rasa rrjedhore” litisht thuhen kështu:  
plotës i cilësisë = complemento di qualità  
plotës i lëndës = complemento di materia  
plotës i shkakut = complemento di causa  
rasë rrjedhore = caso ablativo

Vëre' naní tabelat me “rasën rrjedhore” te numri njëjës i pashquar:

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / ...

EMËRORE	(një) burrë
GJINORE	(i, e, të) (njëi) burri
DHANORE	(njëi) burri
KALLËZORE	(një) burrë
RRJEDHORE	(njëi) <b>burri</b>

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / ...

	(një) lule
(i, e, të)	(njëi) lulje
	(njëi) lulje
	(një) lule
	(njëi) <b>lulje</b>



### USHTRIME

Vër te vendi çë i nget këto fjalë në rasën rrjedhore njëjës të pashquar: mëllagje, shpije, gëzimi, përjashtje, të ngrëni.

- 1 - Vo' Gjergja ë grua \_\_\_\_\_ .
- 2 - La' Ndrica ë burrë \_\_\_\_\_ .
- 3 - Somenatë piva një dekot (zërje) \_\_\_\_\_ .
- 4 - Ndienj hjaur (merë) \_\_\_\_\_ .
- 5 - **Marku bën saute (kërcime)** \_\_\_\_\_ .



## MËSIMI 21E

Lakimi i emrit te rasa rrjedhore njëjës e shquar.

Nani ca shembuj me numrin njëjës te forma e shquar e rasës rrjedhore:

Gjithë gjërat e kafshët (animejt) janë përposh *burrit*.



Maçja u fsheh përposh *tryesës*.



Ndanëz *lules* ndihet më mirë era e t' ëmbël.



E kjo ë tabelja:

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

... / Forma e shquar

EMËRORE  
GJINORE  
DHANORE  
KALLËZORE  
RRJEDHORE

burri  
(i, e, të) burrit  
burrit  
burrin  
burrit

#### EMËR FEMËROR

... / Forma e shquar

lulja  
(i, e, të) lules  
lules  
lulen  
lules

Ca parafjalë si *anës, asipra, brënda, ndanëz, glatë (gjatë), mbatanë, përpara, përposh, prej, rreth, rrëzë, etj.* mbajën rasën rrjedhore.

Shembuj:

*anës lumit, ndanëz lumit, glatë lumit,  
përpara tryesës, ndanëz tryesës, rreth tryesës ...*

Shprehjet “*dhromit*”, “*rrugës*”, “*shpisë e shpisë*”, “*murit e murit*”, “*dheut e dheut*” etj. janë “plotës të vendit” (litisht: complementi di luogo), e më parë te gramatika ishën vërejtur si “gjinore vendore” (litisht: genitivi locativi).

Shembuj:

*Dhromit përpoqa Ndricën.  
E pashë rrugës.  
Shpisë e shpisë i kemi fëmijët e gjitonëvet !  
Hardhja jicëj murit e murit.  
Shiu lahej murit e murit.  
Xhëllona i fërkonej dheut e dheut.*



## USHTRIME

Vër te vendi që i nget këto fjalë në rasën rrjedhore njëjës të shquar:  
honit, skollës, zjarrit, lumit, murit.

- 1 - Marku jicëj rrëzë \_\_\_\_\_.
- 2 - **Brënda** \_\_\_\_\_ **lozjën pishqit.**
- 3 - Vito më prisëj përpara \_\_\_\_\_.
- 4 - Na dje vamë mbatanë \_\_\_\_\_.
- 5 - **Gjithë morën vend rreth** \_\_\_\_\_.



## MËSIMI 22E

Lakimi i emrit te rrasa rrjedhore shumës e pashquar dhe e shquar.

Vëre'

Ata djem (djelm) kanë fuqi *burrash*.



Preva një trofë *lulesh*.



Fjalët *burrash* e *lulesh*, si plotës të cilësisë e të lëndës, janë vënë te numri shumës i pashquar i rasës rrjedhore.

Këtu kemi tabelat :

	NUMRI SHUMËS	
	EMËR MASHKULLOR	EMËR FEMËROR
	Forma e pashquar / ...	Forma e pashquar / ...
EMËRORE	(ca) burra	(ca) lule
GJINORE	(i, e, të) (ca) burrave	(i, e, të) (ca) luleve
DHANORE	(ca) burrave	(ca) luleve
KALLËZORE	(ca) burra	(ca) lule
RRJEDHORE	(ca) <b>burrash</b>	(ca) <b>lulesh</b>

E nani vëre'

Veç *burravet* ngë ish njeri te kafeu.



Rreth *lulevet* lozjën fluturat.



Fjalët burravet e lulevet, mbajtur nga parafjalët “vec” e “rreth”, janë vënë te numri shumës i pashquar i rasës rrjedhore.

Tabelet:

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

... / Forma e shquar

EMËRORE	burrat
GJINORE	(i, e, të) burravet
DHANORE	burravet
KALLËZORE	burrat
RRJEDHORE	burravet

#### EMËR FEMËROR

... / Forma e shquar

lulet
(i, e, të) lulevet
lulevet
lulet
lulevet



Tabela e tërë e lakimit (deklinationës) të njëi emri mashkullor e të njëi emri femëror:

### NUMRI NJËJËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / e shquar

E.	(një) burrë	burri
Gj.	(i...) (njëi) burri	(i...) burrit
Dh.	(njëi) burri	burrit
K.	(një) burrë	burrin
Rr.	(një) burri	burrit

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / e shquar

(një) lule	lulja
(i...) (njëi) lulje	(i...) lules
(njëi) lulje	lules
(një) lule	lulen
(një) lulje	lules

### NUMRI SHUMËS

#### EMËR MASHKULLOR

Forma e pashquar / e shquar

E.	(ca) burra	burrat
Gj.	(i...) (ca) burrave	(i...) burravet
Dh.	(ca) burrave	burravet
K.	(ca) burra	burrat
Rr.	(ca) burrash	burravet

#### EMËR FEMËROR

Forma e pashquar / e shquar

(ca) lule	lulet
(i...) (ca) luleve	(i...) lulevet
(ca) luleve	lulevet
(ca) lule	lulevet
(ca) lulësh	lulevet



## USHTRIME

### 1- Zglidh këto shprehje:

- 1 - **Te dheu janë shumë degë arrje.**
- 2 - Çajta ca degë ullinjsh.
- 3 - **Këto janë shërbise grash.**
- 4 - **Këto janë këpucë gruaje.**
- 5 - U lodha së jecuri.
- 6 - Dhromit shkuam te Gjergji.
- 7 - Përpara meje ngë tha gjë.
- 8 - Përpara teje ai trëmbet.
- 9 - Ca prej\* jush ka venë përjashta.
- 10 - Ca prej\* nesh ka rrinë këtu.
- 11 - **Marku nxori delen jashta kalives.**
- 12 - Gruja ngë rri llargu burrit.
- 13 - Burri ngë rri llargu gruas.
- 14 - Dërrasa u nda dy copash.
- 15 - Dërrasa u nda n'dysh.
- 16 - U lodha së foluri.
- 17 - Veç lulevet, ngë pruri gjë.
- 18 - Ndanëz nesh rri një plak.
- 19 - Ndanëz shtëpisë kemi një garazh.
- 20 - Vajzat sot ngë rrinë llargu djemvet.
- 21 - Djemtë sot ngë rrinë llargu vajzavet.
- 22 - Marku bën diskurse (ligjërrata) fëmijësh.
- 23 - Jic, dilëm syshit!
- 24 - Maçja isht e vdes tëtimit.



#### SHËNIM

\* "Prej" me rasën rrjedhore përdoret të shkruamet arbëreshe, ndërsa te gluhja e përditshme na përdorjëm parafjalët "nga" e "te", që mbajën rasën emërore.

2 - Nani çë ke mësuar lakimin e emrit mashkullor e femëror, shkruaj gjithë rasat, format e numrat në të çilat mënd të ndodhen këto fjalë këtu përposh, tuke vërejtur lakimet te tablelet:

	<u>rasa</u>	<u>forma</u>	<u>numeri</u>
luleve	gjinore , dhanore	e pashquar	shumës
lulevet			
lules			
lule			
lulje			
lulesh			
lulja			
burrat	emërore, kallëzore	e shquar	shumës
burra			
burrë			
burravet			
burrave			
burrash			
burrit			

## SHËNIM

Sa janë sot **lakimet** (deklinaconët) te gluha arbëreshe ?

Janë **4** (katër):

**2** (dy) për emrat mashkullorë;

**1** (një) për emrat femërorë;

**1** (një) për emrat asnjanes

## SHKURTIME

Rasat shkurtonen kështu:

EMËRORE	▶	E.
GJINORE	▶	Gj.
DHANORE	▶	Dh.
KALLËZORE	▶	K.
RRJEDHORE	▶	Rr.



## MËSIMI 23E

Lakimi i parë i emrave.

Zglith:

*Mali* u mblua me mjegulla.



*Ftoi* ka hjaur (erë) të mirë.

Sara vete te skolla me të *vëllain*.



Zgloodha dy faqe të *librit* të gjeografisë.

Mirr emrat:

mali, ftoi, vëllain, libri.

Këta emra mashkullorë mbajën një “-i” te lakimi njëjës (te deklinaciona singolare) e ashtu thomi se bëjnë pjesë të “lakimi i parë”.

Te MËSIMET e mëparshëm ke parë lakime me emra mashkullorë si *djalë* – *djali*, *burrë* – *burri*; nanë vëre’ ca tjerë te tabelat këtu poshtë.

## LAKIMI I PARË EMRA MASHKULLORË

mal - mali

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) mal	mali
Gj.	(i...) (njëi) mali	(i...) malit
Dh.	(njëi) mali	malit
K.	(një) mal	malin
Rr.	(njëi) mali	malit

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) male	malet
(i...) (ca) maleve	(i...) malevet
(ca) maleve	malevet
(ca) male	malet
(ca) malesh	malevet

ftua - ftoi

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) ftua	ftoi
Gj.	(i...) (njëi) ftoi	(i...) ftoit
Dh.	(njëi) ftoi	ftoit
K.	(një) ftua	ftoin
Rr.	(njëi) ftoi	ftoit

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) ftonj	ftonjtë
(i...) (ca) ftonjve	(i...) ftonjvet
(ca) ftonjve	ftonjvet
(ca) ftonj	ftonjtë
(ca) ftonjsh	ftonjvet

vëlla - vëllai

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) vëlla	vëllai
Gj.	(i...) (njëi) vëllai	(i...) vëllait
Dh.	(njëi) vëllai	vëllait
K.	(një) vëlla	vëllain
Rr.	(njëi) vëllai	vëllait

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) vëllezër	vëllezërit
(i...) (ca) vëllezërve	(i...) vëllezërvet
(ca) vëllezërve	vëllezërvet
(ca) vëllezër	vëllezërit
(ca) vëllezërish	vëllezërvet

libër - libri

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) libër	libri
Gj.	(i...) (njëi) libri	(i...) librit
Dh.	(njëi) libri	librit
K.	(një) libër	librin
Rr.	(njëi) libri	librit

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) libre	libret
(i...) (ca) libreve	(i...) librevet
(ca) libreve	librevet
(ca) libre	libret
(ca) libresh	librevet

Si duket mirë këtu sipër, **emrat mashkullorë të lakimit të parë mbajën një "-i"** te gjithë rasat e njëjësit, nxjerrë emërori e kallëzori i pashquar.

Shumë janë emrat mashkullorë që lakohen (deklinares) te numri njëjës si këta që pamë.

Mbajëm mend këtë tabelë të përgjithshme për emrat mashkullorë që mbajën një “-i” te njëjësi:

<b>LAKIMI I PARË</b>				
<b>EMRA MASHKULLORË</b>				
	<b>NUMRI NJËJËS</b>		<b>NUMRI SHUMËS</b>	
	Forma e pashquar/ e shquar		Forma e pashquar/ e shquar	
E.	---	-i	---	-t / të
Gj.	-i	-it	-ve	-vet
Dh.	-i	-it	-ve	-vet
K.	---	-in	---	-t / të
Rr.	-i	-it	-sh	-vet

### USHTRIME

Bëj lakimet këtu poshtë, tuke mbajtur mend gjithë atë që mësove.

1

RASA                      FORMA E PASHQUAR                      FORMA E SHQUAR

	NUMRI NJËJËS	
E.	thua (si "ftua")	_____
Gj.	_____	_____
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____



NUMRI SHUMËS

E.	_____	_____
Gj.	_____	_____
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____



2

NUMRI NJËJËS

E.	lis	_____
Gj.	lisi	_____
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____



NUMRI SHUMËS

E.	lise (lisa)	liset (lisat)
Gj.	_____	_____
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____



## MËSIMI 24E

Lakimi i dytë i emrave.

Vëre' mirë nani këto fjali:

*Mikut tim i thonë Vito.*



Fleta ra te *dheu*.



Më dhëmb *krahu*.



Mirr emrat:

mikut, dheu, krahu.

Këta emra mashkullorë mbajën një “-u” te *lakimi njëjës* e ashtu thomi se bëjnë pjesë te “lakimi i dytë”.

Tabelet:

### LAKIMI I DYTË EMRA MASHKULLORË

krah - krahu

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) krah	krahu
Gj.	(i...) (njëi) krahu	(i...) krahut
Dh.	(njëi) krahu	krahut
K.	(një) krah	krahu
Rr.	(njëi) krahu	krahut

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) krahë	krahët
(i...) (ca) krahëve	(i...) krahëvet
(ca) krahëve	krahëvet
(ca) krahë	krahët
(ca) krahësh	krahëvet

### mik - miku

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) mik	miku
Gj.	(i...) (njëi) miku	(i...) mikut
Dh.	(njëi) miku	mikut
K.	(një) mik	mikun
Rr.	(njëi) miku	mikut

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) miq	miqtë
(i...) (ca) miqve	(i...) miqvet
(ca) miqve	miqvet
(ca) miq	miqtë
(ca) miqsh	miqvet

### dhe - dheu

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) dhe	dheu
Gj.	(i...) (njëi) dheu	(i...) dheut
Dh.	(njëi) dheu	dheut
K.	(një) dhe	dheun
Rr.	(njëi) dheu	dheut

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) dhera	dherat
(i...) (ca) dherave	(i...) dheravet
(ca) dherave	dheravet
(ca) dhera	dherat
(ca) dherash	dheravet

Si duket mirë këtu sipër, **emrat mashkullorë** të lakimit të dytë mbajën “-u” te gjithë rasat e njëjësit, nxjerrë emërori e kallëzori i pashquar.

Këtu poshtë kemi ca emra që lakohen te numri njëjës si “mik-miku” e “krah-krahu” (te numri shumës, në vëren mirë tabelen e përgjithshme, lakimi ë paraç për të gjithë emrat mashkullorë, femërorë e asnjanes);

arí - aríu (*shumës*: arinj - arinjtë)

armik - armiku (*shumës*: armiq - armiqtë)

barí - baríu (*shumës*: barinj - barinjtë) (**arbërisht përdita**: pekurar)

bark - barku (*shumës*: barqe - barqet)

dushk - dushku (*shumës*: dushqe - dushqet)

ka - kau (*shumës*: qe - qetë)

krushk - krushku (*shumës*: krushq - krushqit)

mi - miu (*shumës*: mi - mitë o minj - minjtë)

njerí - njeríu (*shumës*: njerëz - njerëzit)

plak - plaku (*shumës*: pleq - pleqtë)

**ulk - ulku** (*shumës*: ulq - ulqit)

etj.



Mbajëm mend këtë tabelë të përgjithshme për emrat mashkullorë që mbajnë një “-u” te njëjës:

### LAKIMI I DYTË EMRA MASHKULLORË

	NUMRI NJËJËS		NUMRI SHUMËS	
	Forma e pashquar/ e shquar		Forma e pashquar/ e shquar	
E.	---	-u	---	-t / të
Gj.	-u	-ut	-ve	-vet
Dh.	-u	-ut	-ve	-vet
K.	---	-un	---	-t / të
Rr.	-u	-ut	-sh	-vet

### USHTRIME

Shkruaj lakimin e këtyre emrave mashkullorë:

1

RASA	FORMA E PASHQUAR	NUMRI NJËJËS	FORMA E SHQUAR
------	------------------	--------------	----------------

E.	<u>plak</u>		_____
Gj.	_____		_____
Dh.	_____		_____
K.	_____		_____
Rr.	_____		_____

NUMRI SHUMËS

E.	<u>pleq</u>		_____
Gj.	_____		_____
Dh.	_____		_____
K.	_____		_____
Rr.	_____		_____

2

NUMRI NJËJËS

E.	<u>ka</u>		_____
Gj.	_____		_____
Dh.	_____		_____
K.	_____		_____
Rr.	_____		_____

NUMRI SHUMËS

E.	_____		_____
Gj.	_____		_____
Dh.	_____		_____
K.	_____		_____
Rr.	_____		_____

## MËSIMI 25E

Lakimi i tretë i emrave.

Zglith:

*Fusha* ë plot me bar.



Sara rrjedh si *flutur*.



*Mollës* i zuri krimbi.

Marku pi klëmsh *delje*.



*Dhia* u hip te shkëmbi.



Mirr emrat:

fusha, flutur, mollës, delje, dhia.

Këta emra femërorë bëjnë pjesë të “lakimi i tretë”, tek i çili venë gjithë emrat e **gjinisë femërore**.

Tabelet:

**LAKIMI I TRETË**  
**EMRA FEMËRORE**  
fushë - fusha

**NUMRI NJËJËS**

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një)	fushë	fusha
Gj.	(i...)	(njëi) fushje	(i...) fushës
Dh.	(njëi)	fushje	fushës
K.	(një)	fushë	fushën
Rr.	(njëi)	fushje	fushës

**NUMRI SHUMËS**

Forma e pashquar/ e shquar

(ca)	fusha	fushat
(i...)	(ca) fushave	(i...) fushavet
(ca)	fushave	fushavet
(ca)	fusha	fushat
(ca)	fushash	fushavet

**flutur - flutura**

**NUMRI NJËJËS**

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një)	flutur	flutura
Gj.	(i...)	(njëi) fluturje	(i...) fluturës
Dh.	(njëi)	fluturje	fluturës
K.	(një)	flutur	fluturën
Rr.	(njëi)	fluturje	fluturës

**NUMRI SHUMËS**

Forma e pashquar/ e shquar

(ca)	flutura	fluturat
(i...)	(ca) fluturave	(i...) fluturavet
(ca)	fluturave	fluturavet
(ca)	flutura	fluturat
(ca)	fluturash	fluturavet

Për tjerë emra që kanë shumësin me "-a" vëre' te **MËSIMI 9**.

**mollë - molla**

**NUMRI NJËJËS**

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një)	mollë	molla
Gj.	(i...)	(njëi) mollje	(i...) mollës
Dh.	(njëi)	mollje	mollës
K.	(një)	mollë	mollën
Rr.	(njëi)	mollje	mollës

**NUMRI SHUMËS**

Forma e pashquar/ e shquar

(ca)	mollë	mollët
(i...)	(ca) mollëve	(i...) mollëvet
(ca)	mollëve	mollëvet
(ca)	mollë	mollët
(ca)	mollësh	mollëvet

Për tjerë emra që kanë shumësin me "-ë" vëre' te **MËSIMI 9**.

**dele - delja**

**NUMRI NJËJËS**

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një)	dele	delja
Gj.	(i...)	(njëi) delje	(i...) deles
Dh.	(njëi)	delje	deles
K.	(një)	dele	delen
Rr.	(njëi)	delje	deles

**NUMRI SHUMËS**

Forma e pashquar/ e shquar

(ca)	dele	delet
(i...)	(ca) deleve	(i...) delevet
(ca)	deleve	delevet
(ca)	dele	delet
(ca)	delesh	delevet

Për tjerë emra që kanë shumësin me "-e" vëre' te **MËSIMI 9**.



## dhi - dhia

### NUMRI NJËJËS

	Forma e pashquar/ e shquar	
E.	(një) dhi	dhia
Gj.	(i...) (njëi) dhije	(i...) dhisë
Dh.	(njëi) dhije	dhisë
K.	(një) dhi	dhinë
Rr.	(njëi) dhije	dhisë

### NUMRI SHUMËS

	Forma e pashquar/ e shquar	
	(ca) dhi	dhitë
(i...)	(ca) dhive	(i...) dhivet
	(ca) dhive	dhivet
	(ca) dhi	dhitë
	(ca) dhish	dhivet

Për tjerët emra që kanë theksin (litisht: l'accento) tek e sprasmja shkronjë o janë fjale njërrokëshe (litisht: parole monosillabiche), vëre' te **MËSIMI 9**.

## folë - foleja

### NUMRI NJËJËS

	Forma e pashquar/ e shquar	
E.	(një) folë	foleja
Gj.	(i...) (njëi) foleje	(i...) folesë
Dh.	(njëi) foleje	folesë
K.	(një) folë	folenë
Rr.	(njëi) foleje	folesë

### NUMRI SHUMËS

	Forma e pashquar/ e shquar	
	(ca) folë	foletë
(i...)	(ca) foleve	(i...) folevet
	(ca) foleve	folevet
	(ca) folë	foletë
	(ca) folësh	folevet



Mbajëm mend këtë tabelë të përgjithshme për emrat femërorë:

## LAKIMI I TRETË EMRA FEMËRORË

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	---	-a / -ja
Gj.	-je	-s / së
Dh.	-je	-s / së
K.	---	-n / në
Rr.	-je	-s / së

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

	---	-t / të
	-ve	-vet
	-ve	-vet
	---	-t / të
	-sh	-vet

### Kujto

se te numri shumës  
lakimi ë gjithë një  
për emrat mashkullorë, femërorë  
e asnjans.

## USHTRIME

Shkruaj lakimin e këtyre emrave femërorë:

RASA

FORMA E PASHQUAR

FORMA E SHQUAR

NUMRI NJËJËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

mëmë (si "fushë")

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI SHUMËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

mëma

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI NJËJËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

lopë (si "mollë")

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI SHUMËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI NJËJËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

shpi  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI SHUMËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



NUMRI NJËJËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

grua  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

NUMRI SHUMËS

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

gra  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



gratë  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## MËSIMI 26E

Lakimi i katërt i emrave.

Zglith.



Kam pirë shumë *ujë*.



*Të folurit* tat më pëlqen.

Mirr emrat:

*ujë, të folurit.*

Këta emra asnjans bëjnë pjesë të “lakimi i katërt”, tek i çili venë gjithë emrat e gjinisë asnjans.

Emrat si “të folur -it, të ngrënë-it, etj.” përdoren më shumë të numri njëjës; megjithatë këtu poshtë gjen lakimin edhe të numri shumës.

Vëre’ tabelat.

### LAKIMI I KATËRT EMRA ASNJANËS *ujë - ujët*

#### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) ujë	ujët
Gj.	(i...) (njëi) uji	(i...) ujit
Dh.	(njëi) uji	ujit
K.	(një) ujë	ujët
Rr.	(njëi) uji	ujit

#### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) ujëra	ujërat
(i...) (ca) ujërave	(i...) ujëravet
(ca) ujërave	ujëravet
(ca) ujëra	ujërat
(ca) ujërash	ujëravet

## të folur – të folurit

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	(një) të folur	të folurit
Gj.	(i...) (njëi) të foluri	(i) të folurit
Dh.	(njëi) të foluri	të folurit
K.	(një) të folur	të folurit
Rr.	(njëi) të foluri	të folurit

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

(ca) të folura	të folurat
(i...) (ca) të folurave	(i) të foluravet
(ca) të folurave	të foluravet
(ca) të folura	të folurat
(ca) të folurash	të foluravet



Mbajëm mend këtë tabelë të përgjithshme për emrat asnjane:

## LAKIMI I KATËRT EMRA ASNJANËS

### NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar/ e shquar

E.	---	-t /-it
Gj.	-i	-it
Dh.	-i	-it
K.	---	-t /-it
Rr.	-i	-it

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar/ e shquar

---	-t
-ve	-vet
-ve	-vet
---	-t
-sh	-vet



## USHTRIME

1 - Shkruaj lakimin e këtyre emrave asnjane:

RASA

FORMA E PASHQUAR

FORMA E SHQUAR

NUMRI NJËJËS

E.	<u>mish</u>		<u>misht</u>
Gj.	<u>mishi</u>		_____
Dh.	_____		_____
K.	_____		_____
r.	_____		_____

NUMRI SHUMËS

E.	<u>mishra</u>		_____
Gj.	_____		_____
Dh.	_____		_____
K.	_____		_____
Rr.	_____		_____



### NUMRI NJËJËS

E. të ngrënë  
 Gj. \_\_\_\_\_  
 Dh. \_\_\_\_\_  
 K. \_\_\_\_\_  
 Rr. \_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

### NUMRI SHUMËS

E. të ngrëna  
 Gj. \_\_\_\_\_  
 Dh. \_\_\_\_\_  
 K. \_\_\_\_\_  
 Rr. \_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_



## 2 - Bëj nani ca ushtrime mbi lakimet që ke mësuar.

Zgjidh këtë rrëfim:

### Xhuhai sot

Thomse gjithë dimë pullaret e Xhuhait e sa shërbise të rralla, sa mos të thomi të lëna, ai bëri.

Por sot, te kjo jetë moderne, që mënd t' i vij te kryet Xhuhait të bëj?

Në, për shembull, e jëma i thëshëj se i lipsej "DASHI", vje' më rarë "detersivi" me të çilin sot lahen pethkat, ai që mënd të bëj?

Sigurisht Xhuhai do të vej përjashta te një mik i tyji, te bariu, që thuhet edhe delmeri, i zoti i delevet, e do t' i lipëj një "dash", mashkullin e delevet!

E jëma e Xhuhait, nga ana e saj, do të gëzonej kur shihëj dashin, se ashtu pë' ca ditë ajo e i biri mënd të hajën mish dashi; por pethkat si do t' i laj?



E në e jëma pra i thëshëj Xuhait të dhizëj “larësen” (la lavatriçi), ai çë do të bëj? Sigurisht Xuhai do të mirrëj një shkrep, një çirin, e do të dhizëj “larësen” !



E në e jëma i thëshëj Xuhait: “Shuaj lampadhinën!”, ai çë do të rrij gjithë ditën e ditës t’i fryj lampadhinës sa t’e shuaj?

**Vër një vijë (linie) përposh lakimit ku ti ndëlgon se venë këto fjalë, çë zglohdhëm te rrëfimi:**

Xuhai	=	<u>lakimi i parë</u>	i dytë	i tretë	i katërt
pullaret	=	lakimi i parë	i dytë	<u>i tretë</u>	i katërt
jetë	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
kryet	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
shembull	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
e jëma	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
mik	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
bariu	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
delmeri	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
i zoti	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
delevet	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
dash	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
mashkullin	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
ana	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
ditë	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
mish	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
shkreps	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt
lampadhinën	=	lakimi i parë	i dytë	i tretë	i katërt

## MËSIMI 27E

Emri: njohuri të përgjithshme.



Kemi mësuar se *emri* ka

### • tri gjini

- **mashkullore** > burri
- **femërore** > gruaja
- **asnjanëse** > të folurit

### • dy numra

- **njëjës** > burri, gruaja, të folurit
- **shumës** > burrat, gratë, të folurat

### • dy forma

- **e pashquar** > burrë, grua, të folur
- **e shquar** > burri, gruaja, të folurit

### • katër lakime

- **dy mashkullorë**
  - ▶ **i pari lakim** > burrë, -i
  - ▶ **i dyti lakim** > mik, -u
- **një femëror**
  - ▶ **i treti lakim** > grua, -ja
- **një asnjanës**
  - ▶ **i katërti lakim** > të folur, -it

*Emri* arbërisht ka gjithë këto shërbise që kemi parë.

Por “emri” që ë ?


*Emri* ë ajo pjesë e ndërrueshme e ligjëratës, me të çilën thërresjëm njerëz, kafshë, sende, ide, koncepte, ndjenja (sintimente).



## Emri ë:

- *i përgjithshëm* (litisht: **comune**): arra, buka, djali, fryma, miqësia, etj.;
- *i përveçëm* (litisht: **proprio**): Marku, Picuta, Sara, Siçillja, etj.;
- *konkret* (litisht: **concreto**): arra, burri, flutura, Marku, lulja, guri, libri, etj.;
- *abstrakt* (litisht: **astratto**): dashuria, miqësia, gëzimi, etj.;
- *i numrueshëm* (litisht: **numerabile**): një kal, dy kuej, tre kuej, etj.
- *përmbledhës* (litisht: **collettivo**): djalëria, gjindja, pleqëria, etj.;
- *i prejardhur* (litisht: **derivato**): artisti, djalëria, kosovari, shkrimtari, etj.;
- *i përbërë* (litisht: **composto**): bukëljepuri, bukëmora, kryepriifti, etj.;
- *i ndërruar me prapashtesa* (litisht: **alterato con suffissi**) zvogëluese, përkëdhelëse, zmadhuese, keqësuese: djalosh, plakarush, vajzote, burrac, etj.

Do t'i shohjëm një për një gjithë këto lloje emrash.



## MËSIMI 28E

Emri konkret e emri abstrakt.

Vërë:



Piva ca *verë*.



Zgjedha këtë *libër*.

*Hjaur* i mirë ndihet te *kuçina*!



Sara mban më duar *qenin*.

Prëmë te qëroi (qielli) vërejta *yzet*.



Nga *shpia* jime shoh po *malet*.

Çë janë

*libër, verë, hjaur, qenin, yzet, malet*?

Janë “emra konkretë”.

Thuhen “emra konkrete” përçë i shohjëm, i ndiejëm, i ngasjëm; vje’ më rarë se janë emra që bien nën **pesë shqisat** (litëisht: sensi) tona:

**të parit** 

drin-drin



**të gjegjurit** (shqip: të dëgjuarit)

**të hjurarturit** (shqip: të nuhaturit)



**ghusti** (të ngjepsurit, të ngjiruarit; shqip: të shijuarit)

**të ngarit** (shqip: të prekurit)



Marku **vëren** panoramin.

U **gjegjem** këndimet e Vitot.



Mara **hjurar** lulen.



Djali **ncajar** (ngjeps) marmelatën.



Sara **kariçjar** qenin (i bën dhelka qenit).




## Nani vëre':



Pa *dashuri* njeriu ngë rron.

Çë *gëzim* të jesh këtu!

*Miqësinë* njeriu e kërkon.



Çë janë *gëzim*, *dashuri*, *miqësinë* ?

Janë “emra abstraktë” e thuhën ashtu përçë ndodhen vetëm te trutë tona, te mendimi jynë, vje' me rarë se ngë mënd t' i shohësh, ngë mënd t' i gjegjesh, ngë mënd t' i ngaç e andaj ngë *bien nën pesë shqisat tona*.

Arbërisht thujse (kuasi) gjithë emrat abstraktë përdoren vetëm te numri njëjës.



## USHTRIME

Lidh me nje vijë emrat (6 konkretë e 5 abstraktë) me kaselen ç' i nget.

emër  
konkret

era  
hajdhia  
honi  
bukuria  
lëvdia  
lapsi  
shpia  
ujët

durimi (paçenca)  
liria (litisht: la libertà)  
brumit

emër  
abstrakt

AKTI III - SKENA II (Vërgolli, Amelia-fantazmë, Bardhylli)

- BARDHYLLI – (Hyn nga jashtë. Vërgollit:) Flet vetem? (Amelia priret e dhizet te fytyra me harënë)
- VËRGOLLI – Ngë flas vetëm ...
- BARDHYLLI – E me kë *alura* ...
- VËRGOLLI – Ngë t'e thom.
- BARDHYLLI – *Alura* flet vetëm!
- VËRGOLLI – (Me zë të lartë) Ngë flas vetëm!
- BARDHYLLI – E mos lurij!
- VËRGOLLI – T'e thom!
- BARDHYLLI – (Me tonin e sfidës) Thuame!
- VËRGOLLI – Flas me një vajzë... (Amelia qëndron e vëren Bardhyllin me sy dashurije).
- BARDHYLLI – Një vajzë? Ngë shoh vajza këtu! Ku ë? (Amelia gjegjet me kureshtje)
- VËRGOLLI – Ti ngë e sheh!
- BARDHYLLI – E ti e sheh?
- VËRGOLLI – U e shoh!
- BARDHYLLI – E si ë?
- VËRGOLLI – E bukur shumë...
- AMELIA – Oh, Vergo', je i mirë!
- VËRGOLLI – (Me zë të lartë) Ngë jam i mirë!
- BARDHYLLI – Ngë je i mirë? E di, ma përçë e thua!?
- VËRGOLLI – Flisja me "atë" e jo me tyj!
- BARDHYLLI – (Me ironi) Thuame kur flet me "atë" e kur flet me mua!
- VËRGOLLI – Ka të njohënj kush jç!
- BARDHYLLI – Kë, mua?
- VËRGOLLI – Tyj!
- BARDHYLLI – E bëjëm këtë "njohje"! Si ë "ajo"?
- VËRGOLLI – T'e thashë: e bukur shumë! (Amelja nkuqet)
- BARDHYLLI – Si i thonë...
- VËRGOLLI – Amelja!
- BARDHYLLI – Ah, Amelja! Për këtë, kur lurije, thëshje "Amelja!" È vajza jote?
- VËRGOLLI – Jo ngë ë vajza jime: ngë më do! (Pret e vëren nën sy të vëllain) Do tyj!
- AMELIA – Oh, zëmra si më kërcen!
- BARDHYLLI – Do mua? (Merr vend përballë të vëllait duke dëftuar interes).
- VËRGOLLI – Èj, do tyj!
- AMELIA – Më mirren sytë!
- BARDHYLLI – E ku ë! (Vëren këtej e atej)
- VËRGOLLI – Këtje ë, ndanzë derës...
- AMELJA – Jam këtu!
- VËRGOLLI – (Ameljes) Ngë të gjegjet!
- BARDHYLLI – Ngë më gjegjet?
- VËRGOLLI – Me "atë" flisja!
- BARDHYLLI – E çë të tha!?

- VËRGOLLI – Se ë aty!
- BARDHYLLI – (Vanitoz, Ameljes:) Oh, dua të të njoh! Dua të të ... ngas!
- VËRGOLLI – E thëshja u: ti vete njize te duart! “Të të ngas!” Dora ish “*il veicolo*” i dashurisë! Si bën të mos ngaç? Adhami kur pa Evën më parë e vërejti, ma të shihëj mos ish bërë ghumje var’ e e ngau! (Bardhyllit:) E ti ngite!
- BARDHYLLI – (Ameljes) Ku je?
- AMELJA – Qasem u tek ti! (Vjen nga ana këtej, ndërsa Bardhylli vete te ana atej).
- BARDHYLLI – Ku je?
- VËRGOLLI – (Çë drejton skenën) Ajo e këtje e ti je aty!
- BARDHYLLI – (Ameljes) Nani çë di se më do mua edhe u dua tyj! Ma ku je?
- AMELJA – Oh, m’e tha, m’e tha se më do! I t’ëmbël, i dashur... (Jec dal’e dalë si në endërr, ndërsa kërkon t’ i qaset Bardhyllit)
- VËRGOLLI – (Me zë të madh) Duhij të dy! Festë e madhe! Gëzim i madh!
- BARDHYLLI – U jam këtu e ti ku je?
- AMELJA – I dshuri, i t’ëmbli, i miri...
- BARDHYLLI – (Vërgollit:) Ma ku ë?
- VËRGOLLI – Ngë të sheh!
- AMELJA – Ngë më sheh?
- VËRGOLLI – Ngë të sheh!
- BARDHYLLI – Ngë më sheh?
- VËRGOLLI – Ngë flas me tyj o me mirë flas me të dy: duhij, ma ngë shihij! “*Amore a non prima vista!*”
- BARDHYLLI – Je më lua, ëh?
- VËRGOLLI – Jo. Vajza ë aty, aqë e bukur se ti kaq të bukura ngë ke parë kurrë!
- BARDHYLLI – Je lua, e di!
- VËRGOLLI – Jo ngë los. T’e thashë: ti ngë e sheh e ngë kam çë të të bënj!
- AMELJA – Oh, përçë më lë!
- VËRGOLLI – (Ameljes) Ngë të sheh!
- AMELJA – I qasem u. (Qaset)
- VËRGOLLI – Bardhyll, aty te ana e ke!
- BARDHYLLI – Këtu?
- VËRGOLLI – O, aty... aty: ngite, bracara (përqafoje)!
- BARDHYLLI – Kështu? (Përqafon ajrin)

(GSMAJ – Shumë Vizita)



## MËSIMI 29E

Emri i përgjithshëm e emri i përveçëm.

Zglith:



Hëngra *bukë e arra*, tujur te *tryesa*, bashkë me ca *fëmijë* e me *Markun*.

*Sara Matranga* e *e jëma* bëjnë *të plotit* më parë se *Natallet*, *festa* më e ndier te *Hora*.



*Maçit* tim i thonë *Fufi*.



**A**

Çë janë emrat

*bukë, arra, tryesa, fëmijë, e jëma, të plotit, festa, maçit ?*

Janë “**emra të përgjithshëm**”, vje’ më rarë emra që kanë përbashkë gjagjë që i bën të gliten në përgjithësi (litishit: in generale) brënda grupit të tyre. Emrat e përgjithshëm janë ata që kemi parë te kjo gramatikë njera më naní *te gjinia, te numri, te forma, te lakimi*.

**B**

E çë janë

*Markun, Sara, Matranga, Natallet, Hora, Fufi ?*

Jane “**emra të përveçëm**”, vje’ më rarë emra që ngë kanë gjë përbashkë, përçë nga emër ka, *vetëm ai*, gjagjë që i bën të mos gliten me tjerët.

“**Emrat e përveçëm**” shkruhen ngaherë me gërmën (letrën) e parë të madhe, *Hora*, e te lakimi kanë, të shumtat e herëvet, vetëm njëjës in e shquar.

• Janë **emra të përveçëm**:

- **emrat e njerëzvet**: Marku, Sara, Xhushi, Nini, etj.
- **mbiemrat e njerëzvet**: Kamarda, Matranga, Skjirò, etj.;
- **emrat e kafshëvevet**: Bubu, Fufi, Lili, Titi, etj.;
- **emrat e gjeografisë**: Hora, Palerma, *lumi* Belice, *rruga* Kastriota, “Fusha e Zonjavevet”, etj.;
- **emrat që kanë të bëjnë me historinë**: Krishtërimi, Rilindja (*Rinascimento e Risorgimento*), Lufta e dytë botërore, etj.;
- **emrat e institucionëvevet**: Universiteti i Palermës, Bashkia (Municipipi) e Horës, etj.
- **emrat e librevevet, të rivistavevet, të filmevevet, etj.**: “Il Giornale di Sicilia”, “Panorama”, “Çenerentola”, “Kapuçeti i kuq”, etj.;
- **emrat e astronomisë**:

arbërisht *	litisht	shqip
Dielli	Sole	Dielli
	Mercurio	Mërkuri
Ylli i menatës	Venere	Afërdita, Ylli i mëngjesit
<b>Dheu</b>	<b>Terra</b>	<b>Toka</b>
	<b>Marte</b>	<b>Marsi</b>
	<b>Giove</b>	<b>Jupitéri</b>
	<b>Saturno</b>	<b>Saturni</b>
	<b>Urano</b>	<b>Urani</b>
	<b>Nettuno</b>	<b>Neptuni</b>
	<b>Plutone</b>	<b>Plutoni</b>
	<b>Orsa Maggiore</b>	<b>Arúsha e Madhe</b>
	<b>Orsa Minore</b>	<b>Arúsha e Vogël</b>
	<b>Stella Polare</b>	<b>Ylli Polar</b>





\* Arbërisht emrat e planetëve të sistemit diellor e të yzevet i thomi në gluhë italiane, nxjerrë Diellin, Hënzën, Dheun, që shkruhen me gërmën e parë të madhe vetëm kur flitet për astronomi. "Ylli i menatës" ndodhet te parkalesitë e rruzarit, thënë për Shën Mërinë. Mërkuri ndodhet si Shën Mërkuri.

Ndo *shembull letrar* me emrat e perëndivët greke:

**Xhevi** = **Jinia** = **Zëfsi** = litisht: Giove

**Apluni** = litisht: Apollo

**Poseidani** = litisht: Poseidone (Greqi), Nettuno (Romë)

...i hyjnushmi djalë i **Xhevit**/e i **Semeles** llorebardhë/dejtarëve Tyrrenë/në mëngjes u duk.

(GS - Këthimi - f. 226, vj. 25/28)

... thom se **Apluni** o **Poseidani** / a po thom se **Jinia** i vet /është i lumi.

(GS - Këthimi - f. 226, vj. 55/57)

... **Zëfsi** ati / lipisi për të mjerat njize pati.

(GSMaj - Batracomiomachia arbërisht - f. 59, str.15, vj. 5,6)

## Vëre'.

Disa herë emri i përveçëm bëhet i përgjithshëm për antonomazi (litisht: antonomàsia).

### Shembuj:

- Bën **çiçeronin**\* te një musé Palermë.

\* Nga mbiemri i oratorit romak *Marco Tullio Cicerone*, që si "orator" flisëj shumë, ashtu si flet shumë "çiçeroni", kur na thotë që janë shërbiset antike që gjënden te museu ku vemi.



- Për festat, zbillëm dy butijë **shampanjë**\*.

\* Shampanjë - *Champagne* (Francë) ë vendi ku bëhet vera e njohur e që i jep edhe emrin butijës.



## USHTRIME

Lidh me nje vijë emrat me kaselen ç' i duhet.

emër  
i përgjithshëm

Lishëndri  
molla  
dardha  
mali  
Spata  
Parísi  
kali  
Argjentina  
penda  
Lisa

emër  
i përveçëm



### Shembuj letrarë

Yll i mëngjesit. Lutu ti për ne.

(GS – Canti Sacri – f. 155)

Sa pran ishën ata Turqë / para trimavet të Dibrës / e të Krujës e t' Tyranës, / të Kavajës e t' Shën Jakut, / të Peqinit, t' Elbasanit / e t' rrethinavet e tyre ?

(GS – Këthimi – f. 70, vj. 32/ 37)

... e nuk di se edhe mbi cilat / besë t' Hindit e t' Persis, / për 'ta kronje t' Krishtërimit / sa t' Evrenjëvet të shkruarat / e sa ato në mos më shumë, / e mbi të vjetërit mystere / të Pelazgëvet t' hieruashëmë / e t' Adonit e t' Isidës.

(GS – Këthimi – f. 154, vj. 77/ 84)

Te qyteza e vjetër e Leshit / hypej Mili e kish për anë / Mano Bona e Xeta Cokun / bashk me trima. U printe t' gjithëve / Doda Lleshi kapidani / çë si i gjakut të Gjon Markut, / e si i shtërnip i Dukagjinit / ishte atje në vent të Prëngës /...

(GS – Këthimi – f. 248, vj. 1/8)



Ndër lot / prifti plak Dimitër Frëngu / me të nxeht i lutej Zotit / ...

(GS – Këthimi – f. 252, vj. 72/74)


## MËSIMI 30E

Emri i numërueshëm e emri përmbledhës.

Vëre' mirë:



E nanë vëre':



Gjindja flet.



Mbrëmanet mbjidhet *pleqëria e gjtonisë*.

Si shohjëm këtu sipër, kemi:

- emra të numërueshëm, që numëronen: *një kal, dy kuej, tre kuej, vje' më thënë emra me njëjës in e shumës in, që janë më të shumtit;*

● emra që ngë numëronen: *gjindja, pleqëria, gjitonia*, vje' më thënë emra që kanë vetëm njëjës, ma (por) janë "përmbledhës" (litisht: collettivi), se flasin për grupe njerëzish, kafshësh, gjërash:

gjinde, -ja = shumë njerëz

gjitoni, -a = shumë gjitonë

djalëri, -a = shumë djem

pleqëri, -a = shumë pleq

mëndër, -dra = shumë dhi, shumë dele, etj.

Disa herë edhe ndo emër si "mëndër, -dra", "popull, -i" etj, mënd të ketë shumësin: "mëndrat", "popujt":

*Mëndrat* ndodhen jashta Horës.

*Popujt* e jetës janë shumë.

*Folja* që vete bashkë me emrat "përmbledhës" mënd të vuhet edhe te shumësi:

*Gjindja* flet.

*Gjindja* flasin.

## USHTRIME



Lidh me një vijë emrat (6 të numrueshëm e 5 jo) me kaselen që i duhet.

emër  
i numrueshëm

dera  
fula  
turma  
shkopi  
lulja  
ghodha  
maçja  
delja  
tufa  
lopa  
luzma

emër  
përmbledhës

Fjalët "fula, turma, ghodha, tufa, luzma" janë sinonime.

## Shembuj letrarë.

... një **luzmë** e madhe **gjindesh**.

(FZ – Viti i parë – 25 të gushtit 1912, n. 27, f. 2, sht. 1, r. 9)

... gjegji të shkoj një **luzmë gjinde**...

(FZ – Viti i parë – e 1<sup>a</sup> e dhjetorit 1912, n. 41, f. 1, sht. 1, r. 5)

Kur ish hera të çilej lufta ndër Israelitë e Filistenjë nga **godhët** e këtireve dolli një burrë që i thoshjen Goliath...

(FZ – Viti i katrët – 9 të majit 1915, n. 12 – f. 3, sht. 1 – Dhiata e vietrë)

Shkoi pra Nikollë Realli, / **tufën** lule m' e shpërishi.

(CS – f. 10, VIII, vj. 7,8)

U e bukura me ku vënt / bëra lulet **tufa tufa**...

(CS – f. 10, IX, vjer. 1,2)

Te një fushë e madhe, **tufët** armike disa herë u përpoqën...

(CS – Novelline popolari – IX, f. 396, e sprasmja)

Mburonjat klen të **godhëvet** të reja / të lyer' kapake t' vjetërish hërnarë...

(GSMaj – Batracomiomachia arbërisht – f. 37, str. 8, vjer 1,2)

**Tufat** u shoh, shoh armët e mërin...

(GSMaj – Batracomiomachia arbërisht – faqe 31, str. 25, vjer 5)

... kur **tufa** e mivët mori e brënda u pruar;

e gjith te nj' ditë lufta kle mbaruar.

(GSMaj – Batracomiomachia arbërisht – f. 65, str. 23, v. 5,6)

**Pleqëria** ka ëndrra / të përbëra nga kujtime

(GSMaj – Mas Rushi – n 13, vj. 1,2)

KAFSHANJERIU - Gjithë Hora isht e hipet këtu: një **luzmë** ...

(GSMaj – Kërkuesit – Akti III, Skena II, f. 27)

## MËSIMI 31E

Emri i lëndës o i masës.

Zglith.

Marku vuri *benzinën* te motorini.




Nga menatë Vito e Mara pinë *klëmshit*.

Mbloi qelqin me *verë*.



Viçi hëngri gjithë *kashtën*.



Çë janë

*benzinën, klëmshit, verë, kashtën?*

Janë emra të lëndës o të masës (litisht: nomi di materia o di massa) e thërriten ashtu përçë flasjën për lëndë o për masë çë ngë mënd të numëronen; andaj me *njëjës* na thonë se kemi përpara një *tërësi*.

Emrat e lëndës mënd të kenë edhe shumësin, por marrjën si një farë kuptimi cilësor; për shembull: *Verërat* e Mëndapertit janë të forta.

Ca emra tjerë çë ngë numëronen:

*bar, gjizë, krunde, miell, mjajt, uthull, etj.*

## USHTRIME

Vër emrat e lëndës këtu poshtë te vendi që i nget:  
hekuri, grurët, elb, udhosin, tabak.

1 – Te dita e Sënta Lluçisë na hëngrëm \_\_\_\_\_ .

2 – Kisha kollën e piva një dekot (zierje) me \_\_\_\_\_ e fiq.

3 – **Mas' Rushi mbloi pipën me \_\_\_\_\_ .**

4 – Te forxha shërbenet \_\_\_\_\_ .

5 – Marku \_\_\_\_\_ ngë e ha.



### Shembuj letrarë

Me **bar** e me lule / gjith' jeta pështronet.  
(Canti sacri – XLV – f. 64, vj. 1, 2)

**Hekuri** s' ment t'i bëj gjë pyllit, në mbruri i sopatës nënk ish druri.  
(CT – Fjalë të motshëme – f. 97, n. 178)

**Hekurin** e lik e ha zjarri.  
(CT – Fjalë të motshëme – f. 115, n. 466)

Prura pak për Zot te math:  
katër **gjizë** e dicá **djath**.  
(CT – Canti sacri – LXXXIX, f. 239, str. 16, vj. 5,6)

Erdhën bashk tre demëtorë  
me ca **klumsht** e me ca **shtalp**,  
ashtu si ju ndodhën n' dorë;  
prun e **mjalt** e **miell** e **gjalp**...  
(CT – LXXXIX, f. 240, str. 21, vj. 1,4)

Kur ë hera pran e t' ngrënit / djali merr nga trasta **bukën** / e më para e ha me **klëmsht** /  
për së dyti e ha me **gjizë** / për së treti e ha me **gjalp** / për së katërti me **shtalp** / pran me  
**djath** akoma t' njomë / pran me **udhos** të thatë krejt / pran me **gjizë** të kuprime / e ndë  
vonë sipër pi / ndo dy qelqe **klëmsht** me shkumë...  
(GSMaj – Fatosat, Bariu – vj. 79/89)

## MËSIMI 32E

Emri i prejardhur.

Vëre'

*Artist* i mirë ë Pali.



*Bukuria* e vajzavet tona ë e madhe.

*Të ngrënit* ish pa kripë.



Çë janë

*artist, bukuria, të ngrënit?*

Janë “emra të prejardhur” (litisht: nomi derivati) e thuhën ashtu se lehen nga “fjalë të parme” (litisht: parole primitive):

- ◆ *artist* < vjen nga emri “art”;
- ◆ *bukuria* < vjen nga mbiemri “i bukur”;
- ◆ *të ngrënit* < vjen nga pjesorja (litisht: participio) e foljes “ha = ngrënë”.

Shumë emra na sot i marrjëm nga djalekti siçilljan e nga gluha italiane.

Në ti do t’ shkruash bukur arbërisht, zgjidh mirë ka (nga) vijën fjalët tona arbëreshe e me pak punë mënd të qosësh fjalorin tënd.



## Emra të prejardhur nga *emra* :

### ● çë daljën me “-ar”:

gazetar	nga →	gazetë (arbërisht: xhournalist nga → xhournali)
këpucar	nga →	këpucë (arbërisht edhe: skarpar nga → skarpa)
kopshtar	nga →	kopsht (arbërisht edhe: jardinar nga → jardini)
kosovar	nga →	Kosova
librar	nga →	libër, libri
lopar	nga →	lopë (arbërisht edhe: vakar nga → vacca)
patrar	nga →	Patret
rrokar	nga →	Rrokat
shëmitrar	nga →	Shën Mitri
etj.		

### ● çë daljën me “-ier”:

bankier	nga →	bankë
karrocier	nga →	karrocë
magaxinier	nga →	magaxin
portier*	nga →	portë
etj.		

\* portier: ai çë ruan portën te baluni e ai çë ruan hyrjen e pallacevet.

### ● çë daljën me “-ist”:

artist	nga →	art
barist	nga →	bar (kafeu)
kamionist	nga →	kamion
kitarrist	nga →	kitarrë
etj.		

### ● çë daljën me “-tar”:

farkëtar	nga →	farkë* (arbërisht edhe: forxhar nga → forxha)
këngëtar	nga →	këngë
etj.		

\* Arbërisht na qëndroi folja “farkonj” çë na thomi “frakonj”: - Frakonj kalin.

● **çë daljën me “-ëri”, “-ësi”, “-ëzi” (emra abstraktë):**

burrëri	nga →	burrë
djalëri	nga →	djalë
dhelperi	nga →	dhelpre
mjeshtëri	nga →	mjeshtër
nusëri	nga →	nuse
pleqëri	nga →	pleq (shumësi i emrit “plak”)
vajzëri	nga →	vajzë
trimëri	nga →	trim
miqësi	nga →	miq (shumësi i emrit “mik”)
djallëzi	nga →	djall
etj.		



**Emra të prejardhur nga *mbiemra* :**

● **çë daljën me “-i”, “-ëri”, “-ësi”, “-si” (emra abstraktë):**

bukurí	nga →	i bukur
diturí	nga →	i ditur
lirí	nga →	i lirë
lumturí	nga →	i lumtur
njohurí	nga →	i njohur
pasurí	nga →	i pasur
varfëri	nga →	i varfër
verbëri	nga →	i verbër
ëmbëlsi	nga →	i ëmbël
glatësi	nga →	i glatë
gjerësi	nga →	i gjerë
lartësi	nga →	i lartë
lënësi	nga →	i lënë
mathësi	nga →	i math
nxhtësi	nga →	i nxhtë
pabësi	nga →	i pabesë
poshtërsi	nga →	i poshtër
rëndësi	nga →	i rëndë
thellësi	nga →	i thellë
vjetërsi	nga →	i vjetër
zëmërgjerësi	nga →	zëmërgjerë
etj.		

● **çë daljën me “-ësirë” “-ëtirë”:**

errësirë	nga →	i errët
hapësirë	nga →	i hapur
lagësirë	nga →	i lagët
thatësirë	nga →	i thatë
shkretëtirë	nga →	i shkretë
etj.		



**Emra të prejardhur nga folje :**

● **çë daljën me “-atë”:**

administratë	nga →	administrar o administroj
dhuratë	nga →	dhuronj
lëngatë	nga →	lëngonj
ligjëratë	nga →	ligjëronj
organizatë	nga →	organizuar o organizonj
shtrengatë	nga →	shtrengonj
uratë	nga →	uronj
urdhuratë	nga →	urdhuronj e urdhëronj
etj.		

● **çë daljën me “-ës”:**

nxënës	nga →	nxë e xë
shitës	nga →	shes
kërkues	nga →	kërkonj
krijuese	nga →	krijonj
mësues	nga →	mësonj
etj.		

● **çë daljën me “-iesë”, “-esë”:**

fshiesë	nga →	fshinj
martesë	nga →	martonj
mbulesë	nga →	mbulonj e mblonj
ndërtesë	nga →	ndërtonj e dërtonj
etj.		

● **çë daljën me “-ësi”:**

mundësi	nga →	mund e mënd
këndaqësi	nga →	këndaq
etj.		

● **çë daljën me “-im”:**

drejtim	nga →	drejtonj
kërcim	nga →	kërcenj
pëlqim	nga →	pëlqenj
rrëfim	nga →	rrëfyenj
rrëmbim	nga →	rrëmbenj
shkrim	nga →	shkruanj
trashëgim	nga →	trashëgonj
urim	nga →	uronj
etj.		

● **çë daljën me “-imë”:**

gorromimë	nga →	gorromis
(u)lurimë	nga →	(u)lurinj
psherëtimë	nga →	psherëtonj e psherëtinj
shërtimë	nga →	shërtonj e sherëtonj
etj.		

● **çë daljën me “-je”:**

blerje	nga →	ble
folje	nga →	flas
njohje	nga →	njoh
shitje	nga →	shes
etj.		

● **emra femërorë te shumësi vetëm:**

të fala	nga →	fal
të korra	nga →	korr
të mbjella	nga →	mbiell e mbjell
të vjela	nga →	vjel
etj.		

## Vëre' ca emra asnjanes të prejardhur:

- **nga mbiemra** (emërzohet mbiemri asnjanes):

të bardhit	<b>nga</b> →	i bardhë
të gjelbërit	<b>nga</b> →	i gjelbër (virdi)
të kaltërit	<b>nga</b> →	i kaltër (axurru)
të kuqit	<b>nga</b> →	i kuq
të verdhit	<b>nga</b> →	i verdhë (xhallu)

- **nga folje** (emërzohet pjesorja):

të folit e të folurit	<b>nga</b> →	flas, folë e folur
te jecurit	<b>nga</b> →	jec, jecur
të ngrëni	<b>nga</b> →	ha, ngrënë
të klarit	<b>nga</b> →	kla, klarë
të qeshurit	<b>nga</b> →	qesh, qeshur
të shiturit	<b>nga</b> →	shes, shitur
të shkruarit	<b>nga</b> →	shkruanj, shkruar

etj.



## USHTRIME

Pa vrejtur shembujt, çë zgjedhe më lart, lidh me një vijë *emrat e përgjithshëm me emrat abstraktë* të prejardhur nga ata. Si ke sosur, mënd të vëresh shembujt lart, sa të shohësh në bëre ndo gabim (litisht: errore).

**burrë**  
**djalë**  
**dhelpre**  
**mjeshtër**  
**nuse**  
**pleq**  
**vajzë**  
**trim**  
**miq**  
**djall**

**trimëri**  
**burrëri**  
**djallëri**  
**pleqëri**  
**vajzëri**  
**djalëri**  
**miqësi**  
**nusëri**  
**mjeshtëri**  
**dhelperri**

## MËSIMI 33E

Emri i përbërë.

Zglith.



Marku disa herë ë *kryethatë*.



Për *mesditë* pula kokoris se bën venë.



Sara lurin si *gojëmadhe*.

Sa rri të thuash litisht “*respiro*”  
thuj arbërisht “*frymëmarrje*”.

Çë janë

*kryethatë, mesditë, gojëmadhe, frymëmarrje?*

Janë “emra të përbërë” (litisht: *nomi composti*). Thuhen ashtu se dajën nga lidhja (të lidhurit) e

- **dy emrave:** mes + ditë = mesditë;

- **njëi emri me një mbiemër:** gojë + madhe = gojëmadhe;

krye + thatë = kryethatë;

- **njëi emri me një folje:** frymë + marr + (mbaresa) -je = frymëmarrje;  
etj.

Arbërisht i kemi ca emra të përbërë çë thomi edhe sot:

bukëmorë, bukëljepur, kryederr, kryefarri, kryeprift, etj.

Ca emra të vjetër o të përbërë nga shkrimtarët arbëreshë i gjejëm te letërsia:  
atdhe, dhetundje, mëmëdhe, tataplak, tatëlosh, mëmëloshe, etj.

**Ca emra të përbërë** të gluhës shqipe janë të bukur të dihen e të shkruhen e ngë i duhet shumë të ndëlgonen:

armëpushim, -i	= kur armët pushojën së shkrehuri, litisht: armistizio
bregdet, -i	= ana e dheut që nget dejtin, spjaxha
bukëpjekës, -i	= ai që pjek bukë, furnari
bukëshitës, -i	= ai që shet bukë, furnari o putighari
ditëlindje, -ja	= dita kur një lehet, litisht: compleanno
dorëheqje, -ja	= ai që heq dorë, rritiraret, dimitiret, litisht: dimissioni
dorëshkrim, -i	= shkruar me dorë, litisht: manoscritto
gurskalitës, -i	= ai që skalit-shërben gurin, skalpelini
hekurudhë, -a	= udha hekuri, ferruvia
këmbëngulje, -ja	= ngul këmbë, nsistir, litisht: insistenza
këpucëbërës, -i	= ai që bën kepucë, skarpari
kryeartikull, -i	= litisht: articolo di fondo in un giornale
kryeministër, -tri	= litisht: capo del governo
kryemjeshtër, -tri	= kapumastru
kryengritje, -a	= revolucjonë
kryeqytet, -i	= litisht: capitale di uno stato
kryevepër, -pra	= kapulavuru
letërkëmbim, -i	= korrispondencë me të shkruame
luledielli, luljadiellit	o lulja e diellit = xhirasole
lulëkuqe, -ja	= paparinë
lulelakër, -kra	= vrokull, litisht: cavolfiore
marrëveshje, -ja	= marr vesh, litisht: accordo
mikpritje, -ja	= kur një pret mikun, litisht: ospitalità
pijeshitës, -i	= ai që shet pije-bibite
pikëpamje, -ja	= litisht: opinione, punto di vista
pjesëmarrës, -i	= ai që merr pjesë, litisht: partecipante
rrobaqepës, -i	= ai që qep rroba-pethka, kustureri
rrugëdalje, -ja	= solucjonë, litisht: via d' uscita
udhëkryq, -i	= litisht: incrocio stradale
vëmendje, -ja	= kur një rri atentu, litisht: attenzione
vendbanim, -i	= vendi ku banojmë, ku rrimë, residenza
zëvendës, -i	= ai që zë vendin e njetri, litisht: sostituto
etj.	



Te **shumësi** emrat e përbërë ndërrojnë vetëm elementin e dytë, tuke i shtuar mbaresat e gjinivet, si pamë te lakimet e emrave.

Ca shembuj:

**I PASHQUAR**

bregdete  
bukëpjekës  
dorëshkrime  
hekurudha  
kryeartikuj  
kryevepra  
lulëkuqe

**I SHQUAR**

bregdetet  
bukëpjekësit  
dorëshkrimet  
hekurudhat  
kryeartikujt  
kryeveprat  
lulëkuqet

etj.

Emri “luledielli” te shumësi bën kështu:

**I PASHQUAR**

luledielli

**I SHQUAR**

lulet e diellit



## USHTRIME

1 - Mirr pesë emra të përbërë e ndaji, me ndihmën e mësuesit të gluhës arbëreshe, sipas përbërjes: **emër + emër**, **emër + mbiemër**, **emër + folje**.

<b>emër + emër</b>	<b>emër + mbiemër</b>	<b>emër + folje</b>

2 - Kërko të thuash me çilat fjalë janë të përbërë këta emra arbërisht:

	<b>emër + emër</b>	<b>emër + mbiemër</b>	<b>emër + folje</b>
bukëmorë =			
bukëljepur =			
dhetundje =			
kryederr =			
kryethatë =			



## Shembuj letrarë

29 t' gushtit – Përmendet sot e krëmtohet shën Janji **Krie-preri**,  
(FZ – Viti i parë – e 1<sup>a</sup> e shtatorit 1912, n. 28, f. 4, r. 1)

Gjith-nji-herie jerdhi një **dhe-tundie** ...  
(FZ – Viti i katërt, 9 të mait 1915, n. 12, f. 2, sht. 1, r. 23, 24)

- Te ku vete, o **tatë loshi**?  
(CT – f. 36, XXIV, vj. 56)

- Te ku vete, o **mëma loshe**?  
(CT – f. 38, XXIV, vj. 76)

- Ku vete ti, **mëmë loshia**?  
(CT – f. 42, XXV, vj. 43)

...lakra prura e **bukëmorë**.  
(CT – Canti sacri, LXXXIX - f. 240, str. 18, vj. 6)

Dëftomë, o **faqemollë**,  
se ment ti ke të hollë.  
(CT – Novelline popolari – V, f. 374, r. 11)

... Kaluar te **Kryekau**, ç'ish më i shpejti ... kal çë kish...  
(CT – Novelline popolari – IX, f. 400, r. 3)

O **syzezë, meschollë**,  
krip ke t' dredhur si fëkjollë;  
si një dardhë ti je e bardhë.  
Klofshe dardhë, a klofshe ftua,  
s'je për tjerë, po për mua.  
Eja e puthmë, se të dua !

(CT - XX - f. 337)

### Fjalor

syzezë = me sy të zez

meschollë = me mesin e hollë

fëkjollë = li, liri, **litisht**: lino

## MËSIMI 34E

Emra me prapashtesa zvogëluese o përkëdhelëse.

Zglith mirë:

Vito ë një *djalot* i mirë  
e Sara një *vajzote* si shihen pak.



Marku ë një *burriçel*  
e e motra një *gruaiçele*.



Ca *vashëza* u veshën arbërsisht.



Çë janë

djalot, vajzote, burriçel, gruaiçele, vashëza ?

Janë *emra zvogëlues* e *përkëdhelës* (litisht: **diminutivi** e **vezzeggiativi**).

Arbërisht kemi pasur e kemi prapashtesa (litisht: suffiksi) që i ndërrojnë domethënien emrit, tuke i shtuar herë *zvogëlim* o *përkëdhelje*, herë *zmadhim*, herë *keqësim*.

### SHËNIM

Vija (litisht: la linea) që ndan emrat “zvogëlues” nga emrat “përkëdhelës” ë shumë e hollë. Varet (dipindir) gjithëgjithë nga konteksti. Për shembull, në ti thua: “Ajo vajziçele kujt ë bijë?” – te konteksti, “vajziçele” ka domethënie “zvogëluese”. Në ti thua: “Oh, vajziçelja jime!” - te konteksti, “vajziçelja” ka domethënie “përkëdhelëse”.

Emrat me prapashtesën “-ot, -ote” kanë më shumë domethënie “zvogëluese” se “përkëdhelëse”.

Ca emra të tjerë me prapashtesa që përdoren edhe sot, nën ndikimin (litisht: influenza) e djalektit siçilljan:

- me prapashtesën “-içel, -içele”: djaliçel, vajziçele; kaliçel, peliçele; maçiçel, maçiçele; qeniçel, qeniçele; shpiçiçele; etj. etj.;
- me prapashtesën “-ot, -ote”: kopilot, kopilote; etj.

E me prapashtesa më të vjetra arbëreshe (ndonjë përdoret edhe sot):

- me “-iq, -iqe” (nga djalekti siçilljan): dhomatiq, etj.;
- me “-ishk”: djalishk, etj.;
- me “-osh”: djalosh, etj.;
- me “-th” për emrat mashkullorë: birth, djalëth, kalëth, etj.;
- me “-ush, -ushe”: plakarush, plakarushe; etj.
- me “-zë” për emrat femërorë: bukëzë (edhe: bukëz), lulezë, maçezë, sh(të)pizë, etj.

Ca emra tjerë, gjithëgjithë ata të përveçëm, sot marrjen prapashtesa siçilljane e disa herë italiane:

Vituci, Vituca, Xhorxhini, Xhorxhínia, Sarinelja, Ninucu, Liuça, Nikolinu, etj.

### E vogliçelja e nonit!



## USHTRIME

Tuke vërejtur shembujt që gjen te faqet e ketij **MËSIMI**, shkruaj një letër njëi mikut o mikje, ku, me fjalë plot me prapashtesa zvogëluese e përkëdhelëse, i fton gjithë dashurinë o miqësinë tënde.



### Shembuj letrarë

Tek ato ditë streksi se, kur ish' e vejëm te parkalesia, një **vajëzote**, ... na jerdhi përpara...  
(FZ - Viti i katërt 9 të majit 1915, n. 12, f. 1, sht. 1, r. 1, 2)

"Ti ngë mëndë luftosh me atë të huaj se je **djalishk**..."  
(FZ - Viti i katërt 9 të majit 1915, n. 12, f. 4, sht. 1, r. 17,18)

... mori **dhomatiqe** kashtje, i lidhi te bishtrat e dhelpëravet e i dha zjarr.  
(FZ - Viti i katërt 21 të majit 1915, n. 5, f. 3, sht. 2, r. 15/17)

Se ti tryesë e **tryesëzë**,  
e gëlirë, e **frenurëzë**,  
thujme ti t' **vërtetëzën**:  
Kush e bëri **nusezën**?  
(CT - f. 14, XII, vj. 11/14)

Patsh' uraten, **birthi** i jim.  
(CT - f. 34, XXIV, vj. 11)

Për në dhromit sheh të jatin, / sheh të jatin **plakarush**.  
(CT - f. 36, XXIV, vj. 53, 54)

Bën ca dhrom e sheh të jëmën, / sheh të jëmën **plakarushe**.  
(CT - f. 38, XXIV, vj. 72,73)

Nani **vjetëzit** më shkuan, / shkuan vjetët edhe ditët...  
(CT - f. 38, XXIV, vj. 85)

Shpejt arrën te dera e klisë, / te ku **gjurmëza** edhe isht.  
(CT - f. 38, XXIV, vj. 94,95)

Po kur sosi nëndë vjetë  
m'i vate një **ëndërrëzë**.  
Ajo ish e **trëmburëzë**,  
sa m'i trëmbi **gjumëthin**,  
**gjumëthin** e natës.  
(CT - f. 40, XXV, vj. 4/8)

Ra në derë të klisë / e dëndi flamurin, / e më lidhi **kalëthin**.  
(CT - f. 42, XXIV, vj. 52)

**Djaloshi** u bë i kuq i kuq, e i rëfyejti të tëra të papritëmet e veta.  
(CT - Novelline populare, XV - f. 477, r. 1)

## MËSIMI 35E

Emra me prapashtesa zmadhuese o keqësuese.

Zglith mirë:

Gjergji ë një *kopilac* dy metresh!



Marku disa herë duket një *djalac* stratje (rrugje).

Çë janë

kopilac, djalac ?

Janë emra me prapashtesa zmadhuese e keqësuese (litisht: accrescitivi e peggiorativi).

### SHËNIM

Edhe këtu vija çë ndan emrat “zmadhues” nga emrat “keqësues” ë shumë e hollë. Për shembull, në ti thua: “Ai burrac ë jim kushëri.” – te konteksti, “burrac” ka domethënie “zmadhuese”. Në ti thua: “Ëh, burrac i lik !” - te konteksti, “burrac” ka domethënie “keqësuese”.

Te këto prapashtesa shihet ndikimi i djalektit siçilljan.

Ca emra të tjerë:

- me prapashtesën “-ac, -ace”: barkac, birac, burrac, ghajdhurac, gruace, kopilac, kopilace, plakac, plakace, qenac, vajzace; etj.
- me prapashtesën zmadhuese “-un, -une”: burrun, djalun, vajzune, etj.

## USHTRIME

Bëji një intervistë nonëravet tat o ndonjëi plaku, tuke i lypur të të thetë shprehje në të çilat ndodhen fjalë me prapashtesa zmadhuese e/o keqësuese e pran shkruaji këtu.

### Shprehje

Ë, ghajdhurac!  
Ë, ghajdhurun!  
Janë vashëzace!  
Janë djelmacëra!



### Ndo shembull letrar

SQEVA – Monkë "di casa"... do m'e bunj time bijë, monkë "di casa"!

MJESHTRI – Monkë "di klaustura"... njera çë ngë harron atë kërcill **lakruni**!

...

FILOMENA – U e harrova... Koliqën!

MJESHTRI – (I tërbuar) E sheh, e sheh se ng'e harrove? Jo **Kolac** o Kolakrë! Ma Ko-li-qën!

(GSMaj – Paja – Akti III, Skena II, në të sosur)

## « MBIEMRI »

### MËSIMI IM

Mbiemri cilësor.

Vëre' këto fjalë:

Djalë *i mirë* ë Ndrica!



Vajzë *e mirë* ë Silvana!

Te Hora kemi djem *të mirë*.



Te Hora kemi vajza *të mira*.

Mish *të mirë* më shitën dje.



Marrjëm naní këto fjalë:

*i mirë, e mirë, të mirë, të mira, të mirë.*

Çë janë ?

Janë mbiemra cilësorë (litíshkë: aggettivi qualificativi).

Mbiemri cilësor ë ajo pjesë e ndërrueshme (e ndryshueshme) e ligjëratës, që vete bashkë me emrin sa t'i shtonjë gjagjë që emri vetëm ngë ka.

Vëre' si.

Kur, për shembull, na thomi:

djalë, vajzë, mish,

me fjalën e vetme “djalë”, me fjalën e vetme “vajzë”, si me fjalën e vetme “mish”, na ngë thomi gjë më shumë se faktin të kemi përpara një “djalë”, një “vajzë”, ca “mish”;

e pra thomi:

djalë i mirë, vajzë e mirë, mish të mirë

kur i shtojmë fjalët “i mirë”, “e mirë”, “të mirë”, kemi përpara jo një “djalë” çilin isht isht, jo një “vajzë” çilën isht isht, jo ca “mish” çilët isht isht, por një “djalë i mirë”, një “vajzë e mirë”, ca “mish të mirë”.

Këta janë **mbiemrat cilësorë** !

#### Fjalor

çilësi = litisht: qualità;  
çilësor = litisht: qualitativo  
e qualificativo.



#### USHTRIME

Vëri emrin që të duket se rri më mirë ndanëz mbiemravet që ke këtu poshtë:

unazë, ghajdhur, qen, purtekë, vajzë, kal, djalë, shkallë, shpi, plep, brumë, ujë

\_\_\_\_\_ e artë      \_\_\_\_\_ e glatë      \_\_\_\_\_ e bukur

\_\_\_\_\_ i bukur      \_\_\_\_\_ i rrallë      \_\_\_\_\_ i shkurtur

\_\_\_\_\_ i zgjuar      \_\_\_\_\_ e hollë      \_\_\_\_\_ të ngrohtë

\_\_\_\_\_ e madhe      \_\_\_\_\_ i trashë      \_\_\_\_\_ të ngridhur



## MËSIMI 2M

Mbiemri cilësor prapa emrit.

Vëre’.

Burrë i urtë, Gjergji!



Burri i urtë njihet!

Grua e butë, Karmen!



Gruaja e butë qos shpinë.

Te hora kemi ujë të pijshëm.



Ujë e (të) pijshëm ngë lipset.

Burra të urtë ka Hora!



Burrat e urtë njihen!

Gra të buta ka Hora!



Gratë e buta qosjën shpitë.

Te Hora kemi ujëra të pijshme.

Ujërat e pijshme ngë lipsen.



Çë shohjëm te shembujt këtu sipër ?

Shohjëm se “mbiemrat cilësorë” ndërrojën gjini e ndërrojën nyjë.

Andaj thomi se

● mbiemri cilësor përshtatet (akordaret) me emrin te gjinia (mashkullore, femërore, asnjënjës) e te numri (njënjës, shumës). Kur mbiemri ka nyjën, kjo përshtatet me rasën e emrit (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore).

Vëre' ca lakime:

### Emër mashkullor + mbiemër i nyjshëm

#### NUMRI NJËJËS

E.	<b>Forma e pashquar</b> (një) djalë i mirë
Gj. (i, e, të)	(njëi) djali të mirë
Dh.	(njëi) djali të mirë
K.	(një) djalë të mirë
Rr.	(njëi) djali të mirë



#### Forma e shquar

djali i mirë  
djalit të mirë  
djalit të mirë  
djalin e mirë  
djalit të mirë

#### NUMRI SHUMËS

E.	<b>Forma e pashquar</b> (ca) djem (djelm)të mirë
Gj. (i, e, të)	(ca) djemve të mirë
Dh.	(ca) djemve të mirë
K.	(ca) djem të mirë
Rr.	(ca) djemsh të mirë



#### Forma e shquar

djemtë (djelmtë) e mirë  
djemvet të mirë  
djemvet të mirë  
djemtë e mirë  
djemvet të mirë

### Emër femëror + mbiemër i nyjshëm

#### NUMRI NJËJËS

E.	<b>Forma e pashquar</b> (një) vajzë e mirë
Gj. (i, e, të)	(njëi) vajzje të mirë
Dh.	(njëi) vajzje të mirë
K.	(një) vajzë të mirë
Rr.	(njëi) vajzje të mirë



#### Forma e shquar

vajza e mirë  
vajzës së mirë  
vajzës së mirë  
vajzën e mirë  
vajzës së mirë

#### NUMRI SHUMËS

E.	<b>Forma e pashquar</b> (ca) vajza të mira
Gj. (i, e, të)	(ca) vajzave të mira
Dh.	(ca) vajzave të mira
K.	(ca) vajza të mira
Rr.	(ca) vajzash të mira



#### Forma e shquar

vajzat e mira  
vajzavet të mira  
vajzavet të mira  
vajzat e mira  
vajzavet të mira

Vëre' edhe këtë lakim me një emër asnjanes + mbiemër :

### Emër asnjanes + mbiemër i njëshëm

#### NUMRI NJËJËS

##### Forma e pashquar

- E. (një) të ngrënë të mirë  
Gj. (i, e, të) (njëi) të ngrëni të mirë  
Dh. (njëi) të ngrëni të mirë  
K. (një) të ngrënë të mirë  
Rr. (njëi) të ngrëni të mirë



##### Forma e shquar

- të ngrënit e (të) mirë  
të ngrënit të mirë  
të ngrënit të mirë  
të ngrënit e (të) mirë  
të ngrënit të mirë

#### NUMRI SHUMËS

##### Forma e pashquar

- E. (ca) të ngrëna të mira  
Gj. (i, e, të) (ca) të ngrënavë të mira  
Dh. (ca) të ngrënavë të mira  
K. (ca) të ngrëna të mira  
Rr. (ca) të ngrënash të mira



##### Forma e shquar

- të ngrënat e mira  
të ngrënavet të mira  
të ngrënavet të mira  
të ngrënat e mira  
të ngrënavet të mira

Mbiemri cilësor, kur vjen prapa emrit, qëndron ashtu si ë, pa lakim; përshtatet vetëm te gjinia e te numri.



## USHTRIME

Bëj edhe ti lakimet këtu poshtë, sa të vësh më mirë përshtatjen (konkordancën) me emrin e mbiemrin e nyjshëm.

Emër mashkullor + mbiemër i nyjshëm

NUMRI NJËJËS

FORMA E PASHQUAR/ E SHQUAR

NUMRI SHUMËS

FORMA E PASHQUAR/ E SHQUAR

E.	burrë i bukur
Gj. (i)	
Dh.	
K.	
Rr.	

Emër femëror + mbiemër i nyjshëm

NUMRI NJËJËS

FORMA E PASHQUAR/ E SHQUAR

NUMRI SHUMËS

FORMA E PASHQUAR/ E SHQUAR

E.	grua e bukur
Gj. (i)	
Dh.	
K.	
Rr.	

Emër zanjantë + mbiemër i nyjshëm

NUMRI NJËJËS

FORMA E PASHQUAR/ E SHQUAR

NUMRI SHUMËS

FORMA E PASHQUAR/ E SHQUAR

E.	mish të zier
Gj. (i)	
Dh.	
K.	
Rr.	



### Shembuj letrarë

Ditë **e bukurë**, çë solli / **fat të madh**, e çë na dhes / me dëshir edhe me besë / për atvëndin **e vërtes**!

(CS –Canti Sacri – XLIX – f. 183, str. 5)

O mbret **i nokërrith**...

(CS –Canti Sacri – LXXXVI – f. 232, str. 1, vjet. 1)

I biri ish një **trim i mirë**, **i fuqishëm** e me zëmbrë **të madhe**; e bija ish **shumë e hjeslime**, **e glutë** e **e hollë**, si një thuprë **e rgiëndëtë**.

(CS – Novelline popolari, II – f. 357, r. 2/4)

## MËSIMI 3M

Mbiemri cilësor përpara emrit.

Vëre' mirë:



I urti djalë flet pak.



E bukura vajzë rri te vendi i saj.

Çë shohjëm te fjalitë këtu sipër ?

Shohjëm se mbiemri cilësor vjen më parë se emri e se ë emri, këtë herë, çë qëndron ashtu si ë, ndërsa mbiemri cilësor ndërron mbaresën.

Vëre' tabelat me mbiemrin përpara emrit:

### Mbiemër i nyjshëm + emër mashkullor

#### FORMA E SHQUAR

	NUMRI NJËJËS		NUMRI SHUMËS
E.	i miri djalë		të mirët djem
Gj. (i, ...)	të mirit djalë		të mirëvet djem
Dh.	të mirit djalë		të mirëvet djem
K.	të mirin djalë		të mirët djem
Rr.	të mirit djalë		të mirëvet djem

### Mbiemër i nyjshëm + emër femëror

#### FORMA E SHQUAR

	NUMRI NJËJËS		NUMRI SHUMËS
E.	e mira vajzë		të mirat vajza
Gj. (i, ...)	të (së) mirës vajzë		të miravet vajza
Dh.	të (së) mirës vajzë		të miravet vajza
K.	të mirën vajzë		të mirat vajza
Rr.	të (së) mirës vajzë		të miravet vajza

Edhe një shembull me mbiemrin përpara emrit asnjans, megjithëse janë të rrallë të folurit e të shkruarit, veç ndoherë të poezia:

Mbiemër i nyjshëm + emër asnjans

FORMA E SHQUAR

E.	NUMRI NJËJËS	të mirët të ngrënë
Gj. (i, ...)	të mirit të ngrënë	
Dh.	të mirit të ngrënë	
K.	të mirët të ngrënë	
Rr.	të mirit të ngrënë	



NUMRI SHUMËS	të mirat të ngrëna
të miravet të ngrëna	të miravet të ngrëna
të mirat të ngrëna	të miravet të ngrëna
të mirat të ngrëna	të miravet të ngrëna

● Si shohjëm, mbiemri cilësor lakohet vetëm të forma e shquar; edhe nyjat marrjën rasën e mbiemrit.

SHËNIM

Mbiemrin cilësor përpara emrit e kemi edhe me shkallën krahasore të sipërisë absolute (litisht: superlativo assoluto).

Shembuj:

*Më të mirin* djalë e pashë te Hora.

*Më të mirën* vajzë e pashë te Hora.

*Më të mirëvet* djem i (u) dhashë një dhuratë.

*Më të miravet* vajza i (u) dhashë lulet!

*Më të mirët të ngrënë* e gjen te Hora.

*Më të mirat të ngrëna* i bura te Hora.

USHTRIME

Bëj edhe ti lakimet këtu poshtë, sa të vëresh më mirë përshtatjen e mbiemrit me emrin, çë qëndron ashtu si ë.

Mbiemër i nyjshëm + emër mashkullor

FORMA E SHQUAR

	NUMRI NJËJËS	NUMRI SHUMËS
E.	i bukuri djalë	të bukurit djem
Gj. (i, ...)		
Dh.		
K.		
Rr.		

Mbiemër i nyjshëm + emër femëror  
FORMA E SHQUAR

	NUMRI NJËJËS	NUMRI SHUMËS
E.	e bukura vajzë	të bukurat vajza
Gj.	(i, ...)	
Dh.		
K.		
Rr.		



### Shembuj letrarë

Një gluhë si ëngjull / e de, sa t' lëvdonjë / tij, **vokërrënë** Zonjë, / edhe kush të të bë. // Në shekullit pa sosl / nj' **i madh** Perëndi, / çë vetiu shih' e dij, / i shtu sit mbi tij.  
(NF – Codice chieutino – Kënkë VII, faqe 90, vjer. 1/8)

#### **Të shnduamet** lakuriqe...

(FCG – Mbi Malin e Trundafiletvet – XXI – f. 32, vj. 1)

... me **e hollë** frushkullimëzë...

(GS – Milo e Haidhe – I, f. 4, vjer. 19)

... sit çë kishën gjith magjin / e **të gjelburës** vetmij ...

(GS – Milo e Haidhe – I, f. 6, vjer. 44, 45)

... me **i lir** murmur, lumi jikëj.

(GS – Milo e Haidhe – I, f. 6, vjer. 68)

... tek **i rrimti** qiell flurorë...

(GS – Milo e Haidhe – I, f. 8, vjer. 87)

... me **të lartin** qiparis...

(GS – Milo e Haidhe – III, f. 12, vjer. 22)

... ndienj **të math** gëzim. / Në faj kur jam e bie, / Për ngarje e **t' ziut** armik, / të truhem tij e jikë / **i fliquri** mendim.

(Canti Sacri, 1907 – XXIII, faqe 27, vj. 8/12)

**Të lartit** Bir, o Virgjërë, / lutu nani për ne, / të rrim me **shëjten** dre...

(CS – Canti Sacri – LIV – f. 189, str. 2)

**Të së bekuames** Virgjërë / lëvdi këndojëm sot.

(CS – Canti Sacri – LV – f. 191, vjer. 1)

Posa arrun në **t' vrërtë** shpellë...

(CS – Canti Sacri – LXXXVII – f. 233, str. 3, vjer. 1)

E gjegjem **t' ëmbllin** zë çë më thot...

(CT – Mino – f. 500, vj. 1)

Të Zotit tënë **të posaçëm** hir...

(CT – Mino – f. 500, vj. 2 nga e sprasmja)

#### UJALOR

i, e vokërr = i vogël  
i, e shnduam = i, e shëmtuam  
i, e gjelbur = i, e gjelbër = virdi  
i, e lir = i, e lire = liberu  
i, e rrimtë = litisht: ceruleo, azzurro  
i, e fliqur = i, e fëlliqur = litisht: sporco, immondo, impuro  
i, e vrërtë = i, e vrërtët = litisht: oscuro, fosco, tenebroso  
i posaçë, e posaçme = litisht: speciale

## MËSIMI 4M

Mbiemri cilësor me *nyjë* e pa *nyjë*.



Vëre':

Marku ë djalë **i mirë** e bujar.



Arbëreshët te klisja kanë ritin **bizantin**.

La' Gjergji ë njeri **i butë** e **zëmërgjerë**.



Sara ë një vajzë **e mirë** e bujare.

Për njerëzit ujët ë **jetësor**.



Çilët janë te fjalitë këtu sipër **mbiemrat cilësorë me nyjë** ?  
Janë *i mirë, e mirë, i butë*.

E **mbiemrat cilësorë pa nyjë** ?

Janë *bujar, bujare, bizantin, zëmërgjerë, jetësor*.

Si shohjëm, arbërisht kemi mbiemra cilësorë “me nyjë” e “pa nyjë”:

djalë *i mirë*, vajzë *e mirë* = i mirë, e mirë : mbiemër me nyjë  
djalë *bujar*, vajzë *bujare* = bujar, bujare : mbiemër pa nyjë



Ë të thuhet se më të shumtit mbiemra cilësorë kanë nyjën.

Lakimet e mbiemrave me nyjë i ke te MËSIMI 2; vëre' naní lakimet me mbiemrat pa nyjë.

**Emër mashkullor + mbiemër pa nyjë**  
**NUMRI NJËJËS**

	<b>Forma e pashquar</b>		<b>Forma e shquar</b>
E.	(një) djalë		djali
Gj. (i,e,të)	(njëi) djali	← <b>bujar</b>	djalit
Dh.	(njëi) djali		djalit
K.	(një) djalë		djalin
Rr.	(njëi) djali		djalit

**NUMRI SHUMËS**

	<b>Forma e pashquar</b>		<b>Forma e shquar</b>
E.	(ca) djem		djemtë
Gj. (i,e,të)	(ca) djemve	← <b>bujarë</b>	djemvet
Dh.	(ca) djemve		djemvet
K.	(ca) djem		djemtë
Rr.	(ca) djemsh		djemvet

**Emër femëror + mbiemër pa nyjë**  
**NUMRI NJËJËS**

	<b>Forma e pashquar</b>		<b>Forma e shquar</b>
E.	(një) vajzë		vajza
Gj. (i,e,të)	(njëi) vajzje	← <b>bujare</b>	vajzës
Dh.	(njëi) vajzje		vajzës
K.	(një) vajzë		vajzën
Rr.	(njëi) vajzje		vajzës

**NUMRI SHUMËS**

	<b>Forma e pashquar</b>		<b>Forma e shquar</b>
E.	(ca) vajza		vajzat
Gj. (i,e,të)	(ca) vajzave	← <b>bujare</b>	vajzavet
Dh.	(ca) vajzave		vajzavet
K.	(ca) vajza		vajzat
Rr.	(ca) vajzash		vajzavet

**Emër asnjanes + mbiemër i nyjshëm**  
**NUMRI NJËJËS**

<b>Forma e pashquar</b>			<b>Forma e shquar</b>	
E.	(një) të ngrënë		të ngrënit	
Gj.	(i,e,të) (njëi) të ngrëni	← <b>jetësor</b>	të ngrënit	← <b>jetësor</b>
Dh.	(njëi) të ngrëni		të ngrënit	
K.	(një) të ngrëni		të ngrënit	
Rr.	(njëi) te ngrëni		të ngrënit	

**NUMRI SHUMËS**

<b>Forma e pashquar</b>			<b>Forma e shquar</b>	
E.	(ca) të ngrëna		të ngrënat	
Gj.	(i,e,të) (ca) të ngrënave	← <b>jetësore</b>	të ngrënavet	← <b>jetësore</b>
Dh.	(ca) të ngrënave		të ngrënavet	
K.	(ca) të ngrëna		të ngrënat	
Rr.	(ca) të ngrënash		të ngrënavet	



Sa të qosësh të folurit e të shkruarit tat, këtu poshtë gjen **ca mbiemra cilësorë, me nyjë e pa nyjë**; te ana gjen edhe si i thua ti sot me fjalë litire o me perifrazë arbëreshe.

**MBIEMRA ME NYJË**

i afërm, e afërme  
i aftë, e aftë  
i arsyeshëm, e arsyeshme  
i ashpër, e ashpër  
i avullshëm, e avullshme  
i besëm, e besme  
i bëshëm, e bëshme  
i bindshëm, e bindshme  
i çuditshëm, e çuditshme  
i delirë, e delirë  
i dëmshëm, e dëmshme  
i dëtyruar, e dëtyruar  
i dishëm, e dishme  
i duruashëm, e duruashme  
i egër, e egër  
i fajshëm, e fajshme  
i fatosëm, e fatosme  
i fëlliqur, e fëlliqur  
i fillëm, e fillme  
i frikësuar, e frikësuar  
i frikosëm, e frikosme

**SI I THOMI SOT ME FJALË LITIRE O ME PERIFRAZË**

çë na rri ndanëz  
*abili*, çë di të shërbenjë mirë  
*ragionevole*, çë ka tru  
*aspru*, *aspra*  
çë ë si avull  
çë ka besën  
*rrobustu*, *rrobusta*  
*ubbidienti*, *docile*  
*meraviglioso*, *meravigliosa*  
*puro*, pullitu, pa maqe  
*danius*, *danuse*, çë bën dëm  
*obligatu*, *kustrinxhirtur*  
çë di, *sapienti*  
çë mënd të durohet, çë mënd *supurtaret*  
*sarvaxbe*  
*kolpevoli*  
*fatartur*, plot me fat, *furtunat*  
*llordu*  
*solitario*, -a, i vetëm, e vetme  
me dre, me frikë, i trëmbur, e trëmbur  
trëmbisar, trëmbisare

i fuqishëm, e fuqishme  
 i gatuar, e gatuar  
 i gjelbër, e gjelbër  
 i hidhët, e hidhët  
 i hjeshëm, e hjeshme  
 i kaltër, e kaltër  
 i kënd(a)qur, e kënd(a)qur  
 i mallëngjyer, e mallëngjyer  
 i moçëm, e moçme  
 i ndyrë, e ndyrë  
 i pafajshëm, e pafajshme  
 i qëndisur, e qëndisur  
 i rrahur, e rrahur  
 i rrethuar, e rrethuar  
 i shëndoshtë, e shëndoshtë  
 i shkëlqyeshëm, e -shme  
 i shpejtë, e shpejtë  
 i shpeshtë, e shpeshtë  
 i tepërt, e tepërt  
 i turpshëm, e turpshme  
 i thyer, e thyer  
 i thyeshëm, e thyeshme  
 i vrerët, e vrerët

#### MBIEMRA PA NYJË

atdhetar, -e  
 besnik, -e  
 bujar, -e  
 dinak, -e  
 dhelpëror, -e  
 faqebardhë  
 faqelarë  
 fatkeq, fatkeqe  
 fatmirë,  
 fatzi, fatzezë  
 fisnik, -e  
 guximtar, -e  
 katolik, -e  
 hënetar, -e  
 jetësor, -e  
 madhështor, -e  
 mizor, -e  
 mundësor, -e  
 orthodhoks, -e  
 qiellor, -e  
 vjeshtor, -e  
 zëmërgjerë

me fuqi, rrobustu, -a  
 priparartur, prontu, -a  
 viridi  
 amaru, -a  
 grazioso, -a, ghracjus, ghracjuse  
 azzurro, -a, axurru, -a  
 kuntent, kuntente  
 commosso, -a  
 çë ka vjeçtë, plak, -ë  
 i ngrasharrm, e ngrasharrme, llordu  
 çë ngë i ftes, çë ngë ka faj, pa kolpa  
 ricamato, -a, rrahmartur  
 battuto, bastonato, -a  
 çirkondartur  
 me shëndetë  
 brillante, çë shkëlqen  
 veloçi  
 frekuenti  
 superfluo, superflua, troppu, troppa  
 vergognoso, -a  
 i çajtur, e çajtur  
 fragile, fraxhili  
 skuru, -a, plot me mjegulla

patriota  
 fedeli  
 nobili, aristokratiku, -a  
 furbu, -a; skahtërë, skahtre  
 furbu, -a  
 çë del vittorioso, -a; onesto, -a  
 çë ë puro, onesto  
 sfurtunat, -e  
 furtunat, -e  
 svinturat, -e, disgracjat, -e  
 nobili  
 coraggioso, -a, kuraxhus, kuraxhuse  
 katoliku, -a  
 lunatico, -a  
 vitali  
 maestoso, -a  
 crudele  
 vittorioso, -a  
 ortodosu, -a  
 celesti  
 autunnale  
 generoso, xbenerosu, -a

## USHTRIME

Vër mbiemrin cilësor, me një o pa një, te vendi i mbiemraset çë na thomi me fjalë litire o me perifrazë arbëreshe.

- |  |                                 |
|--|---------------------------------|
| 1 - Marku ë djalë <u>kuraxhus</u> .      | 1 - Marku ë djalë _____.        |
| 2 - Kam një mik <u>me fuqj</u> .         | 2 - Kam një mik _____.          |
| 3 - Mësuesi jim ë njeri <u>çë di</u> .   | 3 - Mesuesi jim ë njeri _____.  |
| 4 - Një mike jime ndihet <u>nobili</u> . | 4 - Një mike jime ndihet _____. |
| 5 - Noni jim ë <u>xhenerosu</u> .        | 5 - Noni jim ë _____.           |
| 6 - Sara ë nje vajzë <u>ghracjuse</u> .  | 6 - Sara ë një vajzë _____.     |
| 7 - Mali sot ë <u>plot me mjegulla</u> . | 7 - Mali sot ë _____.           |
| 8 - Bari si nanë ë <u>virdi</u> .        | 8 - Bari si nanë ë _____.       |
| 9 - Dejtj sot ë <u>axurru</u> .          | 9 - Dejtj sot ë _____.          |
| 10 - Duket një maçe <u>sarvaxhe</u> .    | 10- Duket një maçe _____.       |

### Shembuj letrarë

... mos të bësh deshmë **të rreme** ...  
(FZ – 24 të nëndorit 1912, n. 40 – f. 1, sht. 1, r. 12)

**Mundësor**, mbi dyzet ditë, / te Parrajsi Krishti u ngjit...  
(Canti Sacri, 1907 – Shenjet e Rruazarit – f. 4, vj. 7)

... jam te lufta **e keqe** / me gjalpërin **armik**.  
(Canti Sacri, 1907 – XLIII – faqe 63, vj. 20/24)

I vete më një mik **i vërtet**, / se te brezi një kuletë.  
(CT – Fjalë të motshëme - f. 98, n. 197)

**Kështenjor** isht kësheti; / siu i saj **i riimt** si deti ...  
(CS – III – f. 318, str. 2, vj. 1)

... një trim ... **i bukur, i fort, zëmbërak, e i mëntëshëm**...  
(CT – Novelline popolari, VII, faqe 388, r.8/9)

... ish **i bukur**, jo më pak se sa **i hjeshëm e guximtar**...  
(CT – Novelline popolari, VII, f. 388, r. 10, 11 nga e sprasmja)

Sa **dinake** janë grat !  
(CT – Novelline popolari, VIII, f. 393, e sprasmja)

...je vajzë **hënetare**, / se si hënza ti, o **mizote**, / po ndërton për dita fare.  
(CT – XXII – f. 336)

2 - qëndrojnë ashtu si janë e të **mashkullori** e të **femërori** :

faqebardhë  
faqelarë  
zëmërbardhë\*  
zëmërgjerë  
etj.

\* me zëmrën e bardhë, e mirë; litërisht: puro, nobile.

3 – gjinia femërore e këtyre mbiemrave bën kështu:

<b>mashkullor</b>	<b>femëror</b>
fatlig	fatligë
fatzi	fat <del>zi</del> zë
zëmërzi	zëmër <del>zi</del> zë

etj.



## USHTRIME

Vër te **gjinia femërore** këta mbiemra që ndodhen te **gjinia mashkullore**.

- 1 - Burrë i **ndershëm** ë la' Ndrica.
- 2 - Miku jim ë **besnik**.
- 3 - Kam një kal i (të) **zi**.
- 4 - Marku ka një laps i (të) **kuq**.
- 5 - Djali ë i **fuqishëm**.

- 1 - Grua \_\_\_\_\_ ë vo' Lena .
- 2 - Mikja jime ë \_\_\_\_\_ .
- 3 - Kam një pelë \_\_\_\_\_ .
- 4 - Marku ka një pendë \_\_\_\_\_ .
- 5 - Vajza ë \_\_\_\_\_ .



### Shembuj letrarë

... e trua j të gjithëve të mberjën fort tek in' Zot me zëmbërë **e kuxuame** ... E u suall tek in' Zot një lusmë **e madhe**.

(FZ – Viti i parë – 5 të ma it 1912, n. 11 – f.4, sht. 1, r.12/17)

... shqyponjë **e zeshkë**.

(CS – Novelline popolari – IX, f. 397 r. 5)

## MËSIMI 6M

Shumësi i mbiemrave cilësorë.

### SHUMËSI I MBIEMRAVET MASHKULLORË

Zglith e vëre' mirë:

#### Njëjës

Burrë i ndershëm ë la Ndrica!

Burri i ndershëm mban fjalën.

Njeri guximtar ë la' Gjergji.

Njeriu guximtar ngë trëmbet.

#### Shumës

Burra të ndershëm kemi te Hora!

Burrat e ndershëm mbajën fjalën.

Njerëz guximtarë kemi te Hora.

Njerëzit guximtarë ngë trëmben.

Çilët janë mbiemrat te numri njëjës e çilët te numri shumës ?

Janë

te **njëjësi**: “ i ndershëm, guximtar ” ;

te **shumësi**: “ të ndershëm, e ndershëm, guximtarë ”.



Të kujtosh si bëjnë te **shumësi** mbiemrat mashkullorë, vëre' mirë këta shembuj:

### Mbiemra të nyjshëm

- ndërron vetëm nyja

#### NUMRI NJËJËS

i bardhë  
i gjallë  
i mirë  
i urtë  
i besëm  
i djeshëm

#### NUMRI SHUMËS

të bardhë  
të gjallë  
të mirë  
të urtë  
të besëm  
të djeshëm

i sotëm	të sotëm
i nesërm	të nesërm
i kuq	të kuq
i rritur	të rritur
i zgjuar	të zgjuar
i zgjuar	të zgjuar
i ndershëm	të ndershëm
i shkëlqyem	të shkëlqyem
i shkëlqyer	të shkëlqyer

etj.



## Mbiemra të panyjshëm

shumësi merr mbaresën “ë”

### NUMRI NJËJËS

arbëresh  
besnik  
guximtar  
italian  
shqiptar  
siçilljan  
trëmbësar

### NUMRI SHUMËS

arbëreshë  
besnikë  
guximtarë  
italianë  
shqiptarë  
siçilljanë  
trëmbësarë

etj.

pa ndërruar

### NUMRI NJËJËS

krijues\*  
veprues\*\*

### NUMRI SHUMËS

krijues  
veprues

\* çë krijon (litisht: creativo); \*\* çë vepron, çë shërben. I gjen te shkrimet e sotëm arbëreshë.

## SHUMËSI I MBIEMRAVET FEMËRORË

Nani zglidh:

### Njëjës

Grua **e ndershme** ë vo' Lena!

Gruaja **e ndershme** qos shpinë.

Vajzë **guximtare** ë Sara!

Vajza **guximtare** ngë trëmbet.

### Shumës

Gra **të ndershme** kemi te Hora!

Gratë **e ndershme** qosjën shpitë.

Vajza **guximtare** kemi te Hora!

Vajzat **guximtare** ngë trëmben.

Çilët janë mbiemrat te numri njëjës e çilët te numri shumës ?

Janë

te **njëjësi**: “ e ndershme, guximtare ” ;

te **shumësi**: “ të ndershme, e ndershme, guximtare ”.



Të kujtosh si bëjën te **shumësi mbiemrat femërorë**, vëre' mirë këta shembuj:

### Mbiemra të nyjshëm

- ndërron vetëm nyja

#### NUMRI NJËJËS

**e** besme  
**e** djeshme  
**e** sotme  
**e** nesërme  
**e** ndershme  
**e** shkëlqyeme  
**e** zgjuame  
**e** kuqe

#### NUMRI SHUMËS

**të** besme  
**të** djeshme  
**të** sotme  
**të** nesërme  
**të** ndershme  
**të** shkëlqyeme  
**të** zgjuame  
**të** kuqe

etj.



- ◆ ndërron nyja e shumësi merr mbaresën “-a”

#### NUMRI NJËJËS

e bukur  
e mësuar  
e rritur  
e zgjuar  
e shkëlqyer

#### NUMRI SHUMËS

të bukura  
të mësuar  
të rritura  
të zgjuara  
të shkëlqyer

etj.

- ◆ ndërron nyja e mbaresa e njëjësit “-ë” te shumësi bëhet “-a”

#### NUMRI NJËJËS

e bardhë  
e gjallë  
e mirë  
e verdhë  
e thatë

#### NUMRI SHUMËS

të bardha  
të gjalla  
të mira  
të verdha  
të thata

etj.



## Mbiemra të panyjshëm

- pa ndërruar

#### NUMRI NJËJËS

arbëreshe  
besnike  
guximtare  
italiane  
krijuese  
shqiptare  
siçilljane  
trëmbësare  
vepruese

#### NUMRI SHUMËS

arbëreshe  
besnike  
guximtare  
italiane  
krijuese  
shqiptare  
siçilljane  
trëmbësare  
vepruese

etj.

## USHTRIME


Vër këto fjali këtu poshtë te numri shumës (një > dy).

### Njëjës

- 1 - Dje Palermë pashë një arbëresh.
- 2 - Ai balun i kuq ë i Markut.
- 3 - Ajo vajzë e zgjuame ë jime motër.
- 4 - Një kalë i bardhë rrjedh te fusha.
- 5 - Marku ka një mike shqiptare.

### Shumës

- 1 - Dje Palermë pashë \_\_\_\_\_
- 2 - Ata \_\_\_\_\_
- 3 - Ato \_\_\_\_\_
- 4 - \_\_\_\_\_
- 5 - \_\_\_\_\_



### Shembuj letrarë

... sy të parrëfyeshmë...

(CS - Novelline popolari - V, f. 375 r. 12)

Çë sy të kaltërtë atà! Çë krip të rrudhur...

(CS - Novelline popolari - VII, f. 388 r. 13)

...veshi muret me petë të hekurtas...

(CS - Novelline popolari - VII, f. 387 r. 5)

#### FJALOR

i parrëfyeshëm, e -shme = litisht:   
indescrivibile

i, e kaltërt = litisht: azzurro, -a

i, e rrudhur = litisht: riccio, -a; ricciuto, -a

i, e hekurt = litisht: ferreo, -a

## MËSIMI 7M

Shumësi i parregullt i mbiemrave cilësorë.

Vëre' naní këto shprehje:



Djali i math vete te skolla.

Ata janë djem të mëdhenj.



Shkoi një kalë i zi.

Shkuan dy kuej të zes.



Vajza e madhe vete te skolla.

Ato janë vajza të mëdha.

Si shihet, mbiemrat “ i math (i madh) ” e “ i zi ” te shumësi **mashkullor** ndërrojën

i math (i madh) = shumës: të mëdhenj

i zi = shumës: të zes (shqip: të zinj)

e te gjinia **femërore** njëjës e shumës bëjnë kështu:

e madhe = shumës: të mëdha

e zezë\* = shumës: të zeza.\*

\* Mbiemri femëror “e zezë” ka rregullën normale të shumësit të mbiemrave femërorë: “të zeza”. Shembuj: Shkoi një pelë e zezë. Shkuan ca pela të zeza.

Ndonjë mbiemër tjetër:

### MASHKULLOR

Njëjës	Shumës
i glatë	të glet
i keq	të keq ( <b>ship:</b> të këqij)
i lartë	të lertë ( <b>ship:</b> të lartë)
i ri	të ri ( <b>ship:</b> të rinj)
i vogël	të vegjij ( <b>ship:</b> të vegjël)

### FEMËROR

Njëjës	Shumës
e glatë	të glata
e keqe	të keqe ( <b>shqip:</b> të këqija)
e lartë	të larta
e re	të reja
e vogël	të vogla*

\* Mbiemri femëror "e vogël" te shumësi zbier "ë-jën" e merr mbaresën normale shumës: "të vogla". Marku na huajtí biçikletën e vogël. Na kemi dy biçikletë të vogla.

### USHTRIME

Vër këto fjali këtu poshtë te numri shumës (një > dy).

#### Njëjës

- 1 - U kam një qen i (të) math.
- 2 - U kam një maçe e madhe.
- 3 - U kam një biçikletë e (të) vogël.
- 4 - U kam një kalë i (të) zi.
- 5 - U kam një biçikletë e (të) re.

#### Shumës

- 1 - U kam dy qen të \_\_\_\_\_
- 2 - \_\_\_\_\_
- 3 - \_\_\_\_\_
- 4 - \_\_\_\_\_
- 5 - \_\_\_\_\_



#### Ndo shembull letrar

Ju ç'edhe te gjithë të keqet, / ... / mbani krezitë të lert / e nkë zbirij kurrë zëmrije...  
(FCG - MT - X - f. 16, vj. 1, 4)

Disa ka trimat më të lertë...

(CT - Novelline populari, V - f. 373, r. 12)

## MËSIMI 8M

Mbiemri cilësor i emërzuar.

Zglith:

I miri ngë i trëmbet njeriu, i ligu i trëmbet gjithëve.

Çilat vajza përpoqe?

Përpoqa një e (të) vapkë e një e (të) qosme

E mira na gëzon, e liga na helmon.

Bëj të mirë gjithëve e të lik mosnjeriu.

Çë janë mbiemrat cilësorë

i miri, i ligu, e vapkë, e qosme, e mira, e liga, të mirë, të lik ?

Janë mbiemra cilësorë “të emërzuar” (litishit: aggettivi sostantivati), vje’ më rarë se te fjalía zënë vendin e emrit te të gjitha funksionët që ai ka. Gjithë mbiemrat cilësorë në fakt mënd të emërzohen.

Te shembujt më lartë ë sikurse thomi:

i miri = njeriu i mirë  
një e vapkë = një grua e vapkë  
e mira = të bëmat e mira  
të mirët = të bërit të mirë

Shembuj tjerë:

Ndih të mirin të qëndronjë i mirë. Ndih të ligun të mos qëndronjë i lik.

Harro të mirën e kujto të ligën.

Të mirët që më ka bërë noni ngë m’e ka bërë njeri!

Si shohjëm te fjalitë këtu sipër, mbiemri cilësor i emërzuar ka funksionën e substantivit e përdoret ashtú; andaj te fjalía (frazá) mënd të jetë kryefjalë, kundrinë e plotës.

- Mbiemrat e emërzuar si “**e mira, e liga, të mirët, të liktë o të ligtë**” kanë vlerë abstrakte. Këtu kemi dy tjerë: e bukura; e vërteta.

Shembuj:

**E bukura** ë se Marku vate më këmbë te Sheshi!

La' Gjergji me tha një **të vërtetë (të fletë)**: gjithë ujërat ven'e sosjën te dejt!

- Këta mbiemra të emërzuar mashkullorë e femërorë kanë vlerë konkrete:

### MASHKULLORË

#### njëjës

(një) i besëm - i besmi  
 (një) i dejmë - i dejmi  
 (një) i lënë - i lëni  
 (një) i math - i madhi  
 (një) i qosëm - i qosmi  
 (një) i shklepur - i shklepuri  
 (një) i shurdhur - i shurdhuri  
 (një) i vapkë - i vapku  
 (një) i varfër - i varfëri  
 (një) i vogël - i vogli

#### shumës

(ca) të besëm - të besmit  
 (ca) të dejmë - të dejmit  
 (ca) të lënë - të lënit  
 (ca) të mëdhenj - të mëdhenjtë  
 (ca) të qosëm - të qosmit  
 (ca) të shklepur - të shklepurit  
 (ca) të shurdhur - të shurdhurit  
 (ca) të vapq - të vapqit  
 (ca) të varfër - të varfërit  
 (ca) të vegjij - të vegjiit

etj.

### FEMËRORË

#### njëjës

(një) e besme - e besmja  
 (një) e dejme - e dejmja  
 (një) e lënë - e lëna  
 (një) e madhe - e madhja  
 (një) e qosme - e qosmja  
 (një) e shklepur - e shklepura  
 (një) e shurdhur - e shurdhura  
 (një) e vapkë - e vapka  
 (një) e varfër - e varfëra  
 (një) e vogël - e vogla

#### shumës

(ca) të besme - të besmet  
 (ca) të dejme - të dejmet  
 (ca) të lëna - të lënat  
 (ca) të mëdha - të mëdhatë  
 (ca) të qosme - të qosmet  
 (ca) të shklepura - të shklepurat  
 (ca) të shurdhura - të shurdhurat  
 (ca) të vapka - të vapkat  
 (ca) të varfëra - të varfërat  
 (ca) të vogla - të voglat

etj.

Shembuj:

Prëmë një **i dejmë** i këndoj hënëzës.

**Të vapqit** te jeta janë më shumë se **të qosmit**.

**Te varfërit** e **të varfërat** te vendet afrikanë janë ndutu shumë.

Mëma flet për të bijat: - **E madhja** e **e vogla** ngë venë dakord.

- Edhe mbiemrat e fjalës “kullúr - kullúri” (shqip: ngjyrë, -a):

(një) <b>i bardhë</b>	- i bardhi
(një) <b>i gjelbër</b>	- i gjelbëri
(një) <b>i kaltër</b>	- i kaltëri
(një) <b>kështenjor</b>	- kështenjori
(një) <b>i kuq</b>	- i kuqi
(një) <b>qiellór</b>	- qiellori
(një) <b>i verdhë</b>	- i verdhi
(një) <b>i zi</b>	- i ziu



etj.

#### Shembuj:

Ëm kullurin **i (e) kuq** se ka sos disinjin.  
 Ëm **të kuqin** se ka sos disinjin (vizatimin).  
 Ëm ngjyrën **e kuqe** se ka sos vizatimin.

Një **i kuq** si ky ku e gjen? Me një **i (të) kaltër** si ky merr dritë gjithë kambra (dhoma)!  
 Zbardha shpinë me një **qiellor** i (të) bukur! **I bardhi** i rri mirë te muret ajashta.  
**I verdhi** i vesë ngë më pëlqen. Me **të gjelbër** janë të ngjyera (nkullurirtur) dyert.

- Janë mbiemra të emëruar edhe mbiemrat e popujvet :

arbëreshi - Arbëreshët, siçilljani - Siçilljanët, italiani - Italianët, shqiptari - Shqiptarët, etj.

#### Shembuj:

Më mirë se gjithë shërben **arbëreshi**. Na rrimë te Hora e **Arbëreshëvet**.



## USHTRIME

- 1 - Te fjalitë këtu poshtë vër mbiemra të emëruar te vendi i mbiemravet cilësorë:**

- 1 – Një burrë i shklepur hiqej dal' e dalë.
- 1 – Një \_\_\_\_\_ hiqej dal' e dale.
- 2 – Një burrë i qosmë na huajti makinën e tij.
- 2 – Një \_\_\_\_\_ na huajti makinën e tij.
- 3 – Me kullurin **i (e) kuq** ngë vjen mirë dera!
- 3 – Me \_\_\_\_\_ ngë vjen mirë dera!



**2** - Zglith këto dy të shkruame (njera pa mbiemra të emëruar, tjetra me mbiemra të emëruar) e thuaj çila rrjedh më mirë arbërisht:

1 – U kam një maçe e (të) shurdhur e një maçe e (të) shklepur: maçja e shurdhur i gjegjet më mirë se u përçë bën finta, bën skurse ngë gjegjet, ma i gjegjet mirë; maçja e shklepur kur e vërejëm shklepon, kur ngë e vërejëm rrjedh e kërcen (sotar) e bën loprën. Maçja e shurdhur mi ngë zë se thotse ngë i gjegjet; maçja e shklepur mi ngë zë se thotse ngë mënd t' i rrjedhënj aprapa. U kam dy maçe çë u bën të zonjat!



2 – U kam një maçe e (të) shurdhur e një maçe e (të) shklepur: e shurdhura i gjegjet më mirë se u përçë bën finta, bën skurse ngë gjegjet, ma i gjegjet mirë; e shklepura kur e vërejëm shklepon, kur ngë e vërejëm rrjedh e kërcen (sotar) e bën loprën. E shurdhura mi ngë zë se thotse ngë i gjegjet; e shklepura mi ngë zë se thotse ngë mënd t' i rrjedhënj aprapa. U kam dy maçe çë u bën të zonjat!



### Shembuj letrarë

E dërgoi shërbëtorët e 'tij, sa të thërisjën **të ghrizurit** te dasmët, e ata ngë dejën t'i vejen. E pameta dërgoi tjerë shërbëtorë, tue thënë: Thónii **të ghrizurëvet**: Shi', se u triesën time e dërtova... ejani te dasmët.

(FZ – Viti i parë – e 1<sup>a</sup> e shtatorit 1912, n. 28 – f. 1, sht. 1, r. 5/12)

E ndë ju bëfshit **të mirë** atire çë ju bëjën **të mirë**, çë hje do të kini?

(FZ – Viti i parë – 29 të shtatorit 1912, n. 32 – f. 1, sht. 1, r. 8/11)

**E keqëja** të shpie në derë t' armikut.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 94, n. 133)

**E rremëja** shklepon.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 95, n. 142)

**Fatziu**, vete të bënj kryk, e shkul syt me glishtërat.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 95, n. 148)



**I fëlliquri** shokë do.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 184)

**I huaji**, në të prën, ngë te ngëlin.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 185)

**I madhi** gjëme-madhi.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 187)

**I marri** i bën udhë të dejturit.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 188)

**I mbituri** s' ka dre për lagsirë.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 189)

**I ndermi** të nderon; / **i dhuniami** të dhunon.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 190)

**I pasuri** i dashuri.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 191)

**I shum** si lumi; **i paku** si gjaku.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 193)

**I vapëk** e **i lënë** dy vapkëzi.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 194)

**I vëlu** s'e beson **t' urëtin**.

(CT – Fjalë të motshëme – f. 98 , n. 195)

Besë u kam se i madhi yn' Zot / gjithë **t' mirët** lumëron / e se **t' liqët** n' Pisë i çon. / Besë u kam këtë **t' vërtetë**.

(CT – Canti sacri. VIII – f. 131, st. 3)

Natën, si sqyfter, fluturoi te dritësorja, te ku kish par **të bukurën**, e pran, si milingonë, hiri nga një gavërë te dhoma, te ku ajo ish e flëj.

(CT – Novelline popolari – f. 440, r. 6 nga e sprasmja)

Bir i aft i s'vjetrës farë, / mbi **të lertit** lart u çove; / dolle **i pari** ndër **të parë** / ndër **të ndermëvet** u shtrove.

(CT – Mino – IV – f. 504, vj. 5/8)

## MËSIMI 9M

Problemi i nyjavet me dy mbiemra cilësorë të nyjshëm.


Zgllith këtë rrëfim e vëre' mirë si shkruhen nyjat kur te fjalia kemi më shumë se një mbiemër.

### Djali që do mirë skollën

Djali i urtë e i mirë që përpoqa dje, më tha me fjalë të buta e të qëruame se - thotse - ngë ka jardhur te skolla përçë ka pasur rrusanien; më tha se i ka dishpëlqyer se ka zbjerrë gjithë ato ditë të bukura e të dobishme skollje e se nestër ka vinjë pameta, se rrusania i shkoi.

Atij i ka dishpëlqyer edhe se ngë ka parë miqtë e dashur e të zgjuam, si edhe miket e mira e të dashura, të çilëvet e të çilavet i (u) ka thënë të mos vejën t'e gjejën sa të mos i (u) ngjij rrusanien.

Më tha edhe, i lëvdishmi e i sjellshmi djalë, se ka nostalgji për profesorët e dishëm e të përgatitur, të çilëvet i (u) dërgon të falat e sinqerta e të përzëmërta.



#### FJALOR

te qëruame = **litisht:** appropriate, forbite  
i lëvdishmi = **litisht:** lodevole;  
e dishëm = që dinë;  
e sinqerta = **litisht:** sinceri;

të dobishme = **litisht:** utili;  
i sjellshmi = **litisht:** educato;  
të përgatitur = **litisht:** preparati culturalmente;  
të përzëmërta = që daljen ka zëmra; **litisht:** cordiali.

Marrjëm naní emrat bashkë me mbiemrat te rrëfimi që zglohdhëm e shohjëm si ndërrojën nyjat sipas lakimevet (deklinaconëvet):

- Djali **i urtë** e **i mirë** = emër mashkullor njëjës, rasa emërore e shquar; nyjat e mbiemrave janë: **i, i;**
- me fjalë **të buta** e **të qëruame** = emër femëror shumës, rasa kallëzore e pashquar; nyjat janë: **të, të;**
- ditë **të bukura** e **të dobishme** = emër femëror shumës, rasa kallëzore e pashquar; nyjat janë: **të, të;**
- miqtë **e dashur** e **të zgjuam** = emër mashkullor shumës, rasa kallëzore e shquar; nyjat janë: **e, të;**
- miket **e mira** e **të dashura** = emër femëror shumës, rasa kallëzore e shquar; nyjat janë: **e, të;**
- **i lëvdishmi** e **i sjellshmi** djalë = mbiemra mashkullorë njëjës, rasa emërore e shquar, me nyjat: **i, i;**
- për profesorët **e dishëm** e **të përgatitur** = emër mashkullor shumës, rasa kallëzore e shquar; nyjat: **e, të;**
- të falat **e sinqerta** e **të përzëmërta** = emër femëror shumës, rasa kallëzore e shquar, nyjat janë: **e, të.**

Vëre' tabelat këtu poshtë me

**emër + mbiemër të nyjshëm + mbiemër të nyjshëm.**



**Emër mashkullor + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i nyjshëm**

### NUMRI NJËJËS

	Forma e pashquar	Forma e shquar
E.	(një) djalë <b>i urtë e* i mirë</b>	djali <b>i urtë e i mirë</b>
Gj.	(i...)	(i...) djalit <b>të urtë e të mirë</b>
Dh.	(njëi) djali <b>të urtë e të mirë</b>	djalit <b>të urtë e të mirë</b>
K.	(një) djalë <b>të urtë e të mirë</b>	djalin <b>e urtë e të mirë</b>
Rr.	(njëi) djali <b>të urtë e të mirë</b>	djalit <b>të urtë e të mirë</b>

### NUMRI SHUMËS

	Forma e pashquar	Forma e shquar
E.	(ca) djem <b>të urtë e të mirë</b>	djemtë <b>e urtë e të mirë</b>
Gj.	(i...)	(i...) djemvet <b>të urtë e të mirë</b>
Dh.	(ca) djemve <b>të urtë e të mirë</b>	djemvet <b>të urtë e të mirë</b>
K.	(ca) djem <b>të urtë e të mirë</b>	djemtë <b>e urtë e të mirë</b>
Rr.	(ca) djemsh <b>të urtë e të mirë</b>	djemvet <b>të urtë e të mirë</b>



## Emër femëror + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i nyjshëm

### NUMRI NJËJËS

	Forma e pashquar	Forma e shquar
E.	(një) vajzë <b>e</b> urtë <b>e*</b> <b>e</b> mirë	vajza <b>e</b> urtë <b>e</b> <b>e</b> mirë
Gj.	(i...) (njëi) vajzje <b>të</b> urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë	(i...) vajzës <b>të</b> ( <b>së</b> ) urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë
Dh.	(njëi) vajzje <b>të</b> urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë	vajzës <b>të</b> ( <b>së</b> ) urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë
K.	(një) vajzë <b>të</b> urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë	vajzën <b>e</b> urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë
Rr.	(njëi) vajzje <b>të</b> urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë	vajzës <b>të</b> ( <b>së</b> ) urtë <b>e</b> <b>të</b> mirë

### NUMRI SHUMËS

	Forma e pashquar	Forma e shquar
E.	(ca) vajza <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira	vajzat <b>e</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira
Gj.	(i...) (ca) vajzave <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira	(i...) vajzavet <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira
Dh.	(ca) vajzave <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira	vajzavet <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira
K.	(ca) vajza <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira	vajzat <b>e</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira
Rr.	(ca) vajzash <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira	vajzavet <b>të</b> urta <b>e</b> <b>të</b> mira

\* kjo " e ", çë përpjek të lakimet të lidhëz (litisht: congiunzione) e ngë ka kifarë (punë) me nyjat.



## Emër asnjansë+ mbiemër i nyjshëm + mbiemër i nyjshëm

### NUMRI NJËJËS

	Forma e pashquar	Forma e shquar
E.	(një) mish <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë	mishtë <b>e</b> ( <b>të</b> ) njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë
Gj.	(i...) (njëi) mishit <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë	(i...) mishit <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë
Dh.	(njëi) mishit <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë	mishit <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë
K.	(një) mish <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë	mishtë <b>e</b> ( <b>të</b> ) njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë
Rr.	(njëi) mishit <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë	mishit <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mirë

### NUMRI SHUMËS

	Forma e pashquar	Forma e shquar
E.	(ca) mishra <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira	mishrat <b>e</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira
Gj.	(i...) (ca) mishrave <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira	(i...) mishravet <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira
Dh.	(ca) mishrave <b>të</b> njomë <b>e</b> <b>të</b> mira	mishravet <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira
K.	(ca) mishra <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira	mishrat <b>e</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira
Rr.	(ca) mishrash <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira	mishravet <b>të</b> njoma <b>e</b> <b>të</b> mira



## USHTRIME

Vër njëjën ç' i duhet përpara mbiemravet, tuke pasur një sy te shembujt që ke parë.



- 1 – Fola me dy vajza \_\_\_ bukura e \_\_\_ zgjuame.
- 2 – Fola me ca djem \_\_\_ bukur e \_\_\_ zgjuam.
- 3 – Djali \_\_\_ sjellshëm e \_\_\_ dashur vate Palermë.
- 4 – Maçevet time \_\_\_ bardha e \_\_\_ zeza i qella klëmshit.
- 5 – Qenvet tim \_\_\_ butë e \_\_\_ dashur i qella ca mish \_\_\_ zier.
- 6 – Dje fola me vajzën \_\_\_ glatë e \_\_\_ bukur që pashë tek ti.
- 7 – E di se maçet \_\_\_ bardha e \_\_\_ zeza duan klëmshit me viskote!
- 8 – Qentë \_\_\_ butë e \_\_\_ dashur lozjën me maçet \_\_\_ buta e \_\_\_ dashura.
- 9 – Dje i dërgova një kartulinë mikes \_\_\_ dashur e \_\_\_ mirë që rri Napul.
- 10 – Mikut \_\_\_ sinqertë e \_\_\_ dashur i dhashë një çikullatë.



### Shembuj letrarë

T'u lumt goja, o e Bukurë, për ato fjalë **të mira** e **të buta**, që ti the për mua!  
(C.T. – Novelline popolari, IX – f. 403, r. 10 nga e spravnja)

Ndër këtë, të tërë gropën e kish mbushur një mjegullë **e zezë** e **e dendurë** ...  
(CT – Novelline popolari – X, f. 416, r. 7, 8)

... ujërat rrodhen te lumi... me rrym **të gjerë** e **të qetëm**...  
(CT – Novelline popolari – X, f. 416, r. 18, 19)

## MËSIMI 10M

Paradigma e përgjithshme e nyjave të disa kombinacionë.

Sa herë ke gjegjur këto shprehje?



Nona: - Djali **i** vogël, **i** mirë e **i** rrallë **i** nonës!

Noni: - Vajza **e** vogël, **e** mirë e **e** rrallë **e** nonit, eja këtu!



Çë shohjëm te fjalitë këtu sipër?

Shohjëm tre mbiemra të nyjshëm e një emër mbajtur nga nyja e rasës gjinore:

tre mbiemra = **i** vogël, **i** mirë e **i** rrallë - **e** vogël, **e** mirë e **e** rrallë;

nyja e rasës gjinore = **i** nonës - **e** nonës.



Sa "nyja"!



Zglith mirë shembujt  
çë vijën!



Si shkruhen drejt?

Vëre', ndërkaq, paradigmen e përgjithshme të nyjavet.

## PARADIGMA E PËRGJITHSHME E NYJAVET

### EMËR MASHKULLOR + TRE MBIEMRE TË NYJSHËM NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar		Forma e shquar	
E.	+ i ..., i ... e* i ...	E	+ i ..., i ... e i ...
Gj. Dh. K. Rr.	+ të ..., të ... e të ...	Gj. Dh. Rr.	+ të ..., të ... e të ...
		K.	+ e ..., të ... e të ...

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar		Forma e shquar	
E. Gj. Dh. K. Rr.	+ të ..., të ... e të ...	E. K.	+ e ..., të ... e të ...
		Gj. Dh. Rr.	+ të ..., të ... e të ...

### EMËR FEMËROR + TRE MBIEMRE TË NYJSHËM NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar		Forma e shquar	
E.	+ e ..., e ... e* e ...	E.	+ e ..., e ... e e ...
Gj. Dh. K. Rr.	+ të ..., të ... e të ...	Gj. Dh. Rr.	+ të (së) ..., të ... e të ...
		K.	+ e ..., të ... e të ...

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar		Forma e shquar	
E. Gj. Dh. K. Rr.	+ të ..., të ... e të ...	E. K.	+ e ..., të ... e të ...
		Gj. Dh. Rr.	+ të ..., të ... e të ...

### EMËR ASNJANËS + TRE MBIEMRE TË NYJSHËM NUMRI NJËJËS

Forma e pashquar		Forma e shquar	
E.	+ të ..., të ... e* të ...	E.	+ e (të) ..., e (të) ... e e (të)
Gj. Dh. K. Rr.	+ të ..., të ... e të ...	Gj. Dh. Rr.	+ të ..., të ... e të ...
		K.	+ e (të) ..., të ... e të ...

### NUMRI SHUMËS

Forma e pashquar		Forma e shquar	
E. Gj. Dh. K. Rr.	+ të ..., të ... e të ...	E. K.	+ e ..., të ... e të ...
		Gj. Dh. Rr.	+ të ..., të ... e të ...

\* kjo "e", çë sheh te lalçimet, ë lidhëz (litisht: congiunzione) e ngë ka kifarë (punë) me nyjat.

## USHTRIME

- ◆ Zgledhjem bashkë këto tabele e thomi çilat fjalë e çilat nyja ndërrojnë te lakimi:

### 1 EMËR MASHKULLOR + MBIEMËR I NYJSHËM + EMËR FEMËROR

#### NUMRI NJËJËS

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(një) djalë i vogël i nonës	djali i vogël i nonës
Gj.	(i, ...)(njëi) djali të vogël të nonës	(i, ...) djalit të vogël të nonës
Dh.	(njëi) djali të vogël të nonës	djalit të vogël të nonës
K.	(një) djalë të vogël të nonës	djalin e vogël të nonës
Rr.	(njëi) djali të vogël të nonës	djalit të vogël të nonës

#### NUMRI SHUMËS

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(ca) djem të vegjij të nonës	djemtë e vegjij të nonës
Gj.	(i, ...)(ca) djemve të vegjij të nonës	djemvet të vegjij të nonës
Dh.	(ca) djemve të vegjij të nonës	djemvet të vegjij të nonës
K.	(ca) djem të vegjij të nonës	djemtë e vegjij të nonës
Rr.	(ca) djemsh të vegjij të nonës	djemvet të vegjij të nonës

### 2 EMËR FEMËROR + MBIEMËR I NYJSHËM + EMËR MASHKULLOR

#### NUMRI NJËJËS

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(një) vajzë e vogël e nonit	vajza e vogël e nonit
Gj.	(i, ...)(njëi) vajzje të vogël të nonit	(i, ...) vajzës të (së) vogël të nonit
Dh.	(njëi) vajzje të vogël të nonit	vajzës të (së) vogël të nonit
K.	(një) vajzë të vogël të nonit	vajzën e vogël të nonit
Rr.	(njëi) vajzje të vogël të nonit	vajzës të (së) vogël të nonit

#### NUMRI SHUMËS

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(ca) vajza të vogla të nonit	vajzat e vogla të nonit
Gj.	(i, ...)(ca) vajzave të vogla të nonit	vajzavet të vogla të nonit
Dh.	(ca) vajzave të vogla të nonit	vajzavet të vogla të nonit
K.	(ca) vajza të vogla të nonit	vajzat e vogla të nonit
Rr.	(ca) vajzash të vogla të nonit	vajzavet të vogla të nonit

### 3 EMËR ASNJANËS + MBIEMËR I NYJSHËM + EMËR FEMËROR

#### NUMRI NJËJËS

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(ca) mish të njomë të lopës	misht e (të) njomë të lopës
Gj. Dh. K. Rr.	si mashkullori	

#### NUMRI SHUMËS

si femërori



◆ Mënd të bëjëm një qind shembuj tjerë si ata që pamë, ku duken mirë fjalët e nyjat që ndërrojnë e ato që ngë ndërrojnë te lakimi. Shohjëm edhe këta shembuj, që mënd të plotësosh ti vet:

**1 EMËR MASHKULLOR + EMËR MASHKULLOR + MBIEMËR I NYJSHËM  
NUMRI NJËJËS**

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(një) djalë i burrit të glatë	djali i burrit të glatë
Gj.	(i, ...) (njëi) djali të burrit të glatë	(i, ...) djalit të burrit të glatë
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____

**NUMRI SHUMËS**

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(ca) djem të burrit të glatë	djemtë e burrit të glatë
Gj.	(i, ...) (ca) djemve të burrit të glatë	(i, ...) djemvet të burrit të glatë
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____

**2 EMËR MASHKULLOR + EMËR FEMËROR + MBIEMËR I NYJSHËM  
NUMRI NJËJËS**

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(një) djalë i gruas të (së) glatë	djali i gruas të (së) glatë
Gj.	(i, ...) (njëi) djali të gruas të (së) glatë	(i, ...) djalit të gruas të (së) glatë
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____

**NUMRI SHUMËS**

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	(ca) djem të gruas të (së) glatë	djemtë e gruas të (së) glatë
Gj.	(i, ...)(ca) djemve të gruas të (së) glatë	(i, ...) djemvet të gruas të (së) glatë
Dh.	_____	_____
K.	_____	_____
Rr.	_____	_____

**E vëre'**

**EMËR FEM. + MBIEMËR I NYJSH. + EMËR MASHK. + MBIEMËR I NYJSH.  
NUMRI NJËJËS**

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	këpucë e trashë e burrit të hollë	këpuca e trashë e burrit të hollë

e tjera

**NUMRI SHUMËS**

	FORMA E PASHQUAR	FORMA E SHQUAR
E.	këpucë të trasha të burrit të hollë	këpucët e trasha të burrit të hollë

e tjera

## MËSIMI 11M

Shkallët e mbiemrit cilësor.

Na thomi:

Vajza e bukur u martua.



Mara duket më e madhe se Marta.

Ina ë aq e bukur sa e urtë.

Marta ë më pak e hollë se Mara.



Sara ë më e mira e të gjithave.

Pashë një vajzë shumë e (të) bukur.



Vëre' naní këtë shkallë me mbiemrat që zglodhe:



më e mira shumë e bukur



më e madhe më pak e hollë aqë e bukur sa e urtë

e bukur

◆ Çë ë “e bukur” vënë poshtë te shkalla?

Ë një mbiemër vënë te “shkalla pohore” (litisht: grado positivo), vje' më rarë mbiemri cilësor normal.

◆ E çë janë “më e madhe, më pak e hollë, aqë e bukur sa e urtë” vënë te shkalla më lart ?


Janë mbiemra vënë te “**shkalla krahasore**” (litisht: grado comparativo), vje’ më rarë se ndo gjagjë ë më shumë o më pak o paraç se gjagjë tjetër:

- më e madhe = **shkalla krahasore e sipërisë** (litisht: comparativo di maggioranza);
- më pak e hollë = **shkalla krahasore e ultësisë** (litisht: comparativo di minoranza);
- aqë e bukur sa e urtë = **shkalla krahasore e barazisë** (litisht: comparativo di uguaglianza).

◆ E çë janë “shumë e bukur, më e mira” ?

Janë mbiemra vënë te “**shkalla sipërore**” (litisht: grado superlativo), vje’ më rarë së më lart se aqë ngë mënd të vemi:

- më e mira = **shkalla sipërore relative** (litisht: superlativo relativo);
- shumë e bukur, ndutu e bukur = **shkalla sipërore absolute** (litisht: superlativo assoluto).



## USHTRIME

1 - Këtu poshtë ke shtatë mbiemra për tri shkallët: gjeji e shkruaji te shkalla që i nget.

	POHORE	SHKALLËT KRAHASORE	SIPËRORE
më i madhi			më i madhi
të mira			
të holla			
aq i bukur sa...			
më të mirë se...			
më të mirët			
më kuq se...			
shumë i kuq			
shumë të kuqe			
i bardhë			
e verdhë			
të hollë			
më të bardhat			
aqë të kuqe sa...			
sa i butë aqë...			
më të kuqet			
më të verdha se...			
shumë të bukura			
e glatë			
i shkurtur			
sa i mirë aqë...			

2 - Shkruaj "shkallën krahasore" te ana e këtyre mbiemrave që janë te shkalla pohore:

### SHK. POHORE

### SHKALLA KRAHASORE

e sipërisë

e barazisë

e ultësisë

i rrallë	më i rrallë	aqë i rrallë	më pak i rrallë
e glatë			
e gjerë			
i butë			
bujar			

3 - Shkruaj "shkallën sipërore" te ana e këtyre mbiemrave që janë te shkalla pohore:

### SHK. POHORE

### SHKALLA SIPËRORE

relative

absolute

i rrallë	më i rralli	shumë i rrallë
e glatë		
e gjerë		
i butë		
bujar		

## KUJTO

1 - Arbërisht, si pamë, **shkalla krahasore e sipërisë** bëhet tue i shtuar shkallës pohore "ndajfoljen" (litisht: l'avverbio) "më".

Shembull:

Marku ë **më** i mirë.

Në pra kemi të krahasojëm (konfrontarjëm) dy elemente gramatikorë, atëherë të dytit element i shtohet "lidhëza" "se".

Shembull:

Mara ë më e bukur **se** Sara.

2 - **Shkalla krahasore e ultësisë** bëhet tue i shtuar shkallës pohore ndajfoljen "më pak".

Shembull:

Sara ë **më pak** e bukur (**se** Mara).

3 - **Shkalla krahasore e barazisë** bëhet tue i (u) shtuar ndajfoljet "aqë... sa..." o "sa... aqë..." mbiemraves që duam të krahasojëm, të vëmë përkrahu.

Shembuj:

Sara ë **aqë** e urtë **sa** ë bujare.

Sara **sa** ë e urtë **aqë** ë bujare.

4 - **Shkalla sipërore absolute** bëhet tue i shtuar shkallës pohore ndajfoljen "shumë" (o "gjithë" o "fort", etj.).

Shembuj:

Mara ë **shumë** e bukur.

Shën Mëria **gjithë** shejte na ruan.

5 - **Shkalla sipërore relative** formohet tue bërë të shquar mbiemrin e shkallës krahasore të sipërisë.

Kështu:

Shkalla krahasore e sipërisë, që pamë lart: Marku ë **më i mirë**.

**Shkalla sipërore relative:** Marku ë **më i miri**.

Në pra kemi të krahasojëm të parin element me të dytin që ë i përgjithshëm (litisht: generico), atëherë i dyti element vete te rasi gjinore o te rasi emërore me parafjalën "te".

Shembuj:

Marku ë më i miri **i djemvet**.

Marku ë më i miri **te djemtë**.

6 - **Shkalla sipërore absolute** mënd të bëhet edhe kështu:

■ tue i shtuar "sa" mbiemrit pohor;

shembull:

**Sa e bukur** ë Hora jonë!

- tue përsëritur (rripitirtur) mbiemrin pohor;  
shembull:

Katarina kish një vestë **të bukur të bukur!**

- tue përsëritur mbiemrin pohor e tue i shtuar të dytit mbiemër parashtesën  
(litisht: il prefisso) "stër-";  
shembull:

Vend **i bukur e i stërbukur** ë Hora!

- tue i shtuar mbiemrit pohor ndonjë fjali si "sa ngë mënd më", "sa ngë mënd të thuhet", "sa ngë mënd t'ish më", etj.;

shembull:

Vajza ish **e bukur sa ngë mënd më.**



### Ca shembuj letrarë

... kish një bir **aqë të bukur, sa** gjithë vashazit e dishirojën për shoq.  
(C.T. – Novelline populari, I – f. 353, radhë 1,2)

Perpara shpis s' rregjiti jisëj një vajzë e varfërë, po **e hjeshme** edhe **e mirë sa ngë mënt t'ish më...**  
(C.T. – Novelline populari, I – f. 353, r. 3,4)

Disa ka trimat **më të lertë...**  
(C.T. – Novelline populari, V – f. 373, r. 12)

Një herë e një herë ish një rreq, çë kish një bijë të vetëme, po **më të bukurë se** drita e diellit, **më të hjeshme se** hënza; **më të dishme se** një qint të dishme.  
(C.T. – Novelline populari, V – f. 372, r. 1/3)

...Një bir bulku, **mendrak sa ngë mënt t'ish më...**  
(C.T. – Novelline populari, V – f. 373, r. 15)

E bukura **e bukurë** ish e **më e bukurë** u bë.  
(C.T. – Novelline populari, V – f. 375, r. 10)

Një herë e një herë ish një njeri **shumë i qosëm...**  
(C.T. – Novelline populari, VI – f. 377, r. 1)

Një përrua gjaku **të zi të zi** e të nxeht gufoi... nga qafa e këputurë...  
(C.T. – Novelline populari, X – f. 416, r. 12, 13)

Djaloshi u bë **i kuq i kuq**, e i rrëfyejti të tëra të papritëmet e veta.  
(C.T. – Novelline populari, XV – f. 477, r. 1)

Kështu tue folë, ajo e hjeshme u shporr, tue lënë atá **fort të mallëngjyer e të thekurë** në zëmbëret.  
(C.T. – Novelline populari, XV – f. 477, r. 1)

## MËSIMI 12M

Mbiemri me prapashtesa zvogëluese e përkëdhelëse.

Zglith mirë:



Djali ë i vogliçel,  
do thom i shkurturot,  
po ka një fuqi!

Vajza ë e holliçele,  
jo e trashote do thom,  
e rri mirë ashtú.



Çë janë

i vogliçel, i shkurturot, e holliçele, e trashote ?

Janë mbiemra zvogëlues e përkëdhelës (litisht: aggettivi diminutivi e vezzeggiativi).

Si për “emrin” edhe për “mbiemrin cilësor” arbërisht kemi pasur e kemi prapashtesa (litisht: suffissi) çë i ndërrojën domethënien mbiemrit, tuke i shtuar herë zvogëlim o përkëdhelje, herë zmadhim, herë keqësim.

### SHËNIM

Si për “emrin”, edhe këtu vija çë ndan mbiemrat “zvogëlues” nga mbiemrat “përkëdhelës” ë shumë e hollë.

Mbiemrat e ndërruar me prapashtesën “-içel, -içele” her’e herë kanë më shumë domethënie “përkëdhelëse” se “zvogëluese”.

Mbiemrat e ndërruar me prapashtesën “-ot, -ote” ndo herë kanë më shumë domethënie “zvogëluese” se “përkëdhelëse”.

### Ca mbiemra tjerë:

- me prapashtesën “-içel, -içele” (nga djalekti siçilljan: *-iceddu > granniceddu*): i bukuriçel, e bukuriçele; i kuçiçel, e kuçiçele; i lëniçel, e lëniçele; i madhiçel, e madhiçele; i miriçel, e miriçele; i plotiçel, e plotiçele; i rremiçel, e rremiçele; i shkurturiçel, e shkurturiçele; i trashiçel, e trashiçele; etj.;
- me prapashtesën “-el, -ele” (nga djalekti siçilljan: *-eddu > vastaseddu*): i shëmtuamel, e shëmtuamele, etj.;
- me prapashtesën “-liq, -liqe” e “-lliq, -lliqe” (nga djalekti siçilljan: *-icchiu > tunnulicchiu*): tundulliq, -e; etj..
- me prapashtesën “-ot, -ote” (nga djalekti siçilljan: *-ottu > simpliciottu*): i trashot, e trashote; etj.;

### Ca mbiemra me prapashtesa më të vjetra arbëreshe:

- me prapashtesën “-osh, -oshe”: bukurosh, bukuroshe, etj.;
- me prapashtesën “-ush, -ushe”: plakarush, plakarushe; i vogëlush, e vogëlushe, etj.;
- me prapashtesën “-th” për mbiemrat mashkullorë: i vapkëth, i vogëlith, etj.;
- me prapashtesën “-zë” për mbiemrat femërorë: e búkurëzë, etj.

## USHTRIME

1 - Bëj *zvogëlues* o *përkëdhelës* mbiemrat këtu poshtë, tuke i vënë mbaresat çë i duhen:

1 – plak	_____	2 – i mirë	_____
3 – i hollë	_____	4 – i shkurtur	_____
5 – e madhe	_____	6 – e lënë	_____
7 – e bukur	_____	8 – e trashë	_____

2 - Nxiri mbaresat *zvogëluese* o *përkëdhelëse* këtyre mbiemrave e bëji të thjeshtë (litish: *semplici*):

1 – i rremiçel	_____	2 – plakarush	_____
3 – i vapkëth	_____	4 – i shkurturot	_____
5 – e plotiçele	_____	6 – e kuçiçele	_____
7 – e vogliçele	_____	8 – e bukuroshe	_____



## Ndo shembull letrar

Kostantini **i vogëlith**...

(C.T. – f. 30, XXIII, vj. 1)

Kostantini kalin nget, /atë kal **të mbrimurith**.

(C.T. – f. 38, XXIV, vj. 92,93)

O mbret **i nokërrith**, Zot me pushtet...

(C.T. – f. 232, LXXXVI, vj. 1)

Jam **i vapkëth** delëmer.

(C.T. – f. 240, LXXXIX, str. 17 vj. 5)

Ndejmë duarët, gjella jime, / tek **i përvëlúamthi** gjë.

(C.T. – f. 243, LXXXIX, str. 32 vj. 1,2)

Flëjmë, Isuth, **i búkurith**.

(C.T. – f. 244, LXXXIX, str. 39 vj. 5)

Zonja shëjte e **c búkurëzë**...

(C.T. – f. 239, LXXXIX, str. 15 vj. 1)

### FJALOR

**i nokërrith** (i **nókërr** = i vogël)

**i përvëlúamthi** (i **përvëlúam** = i ngrohtë shumë, çë djek)

**i mbrimurith** (i **mbrimur** = fukús, çë zien, i zgjuam)

## MËSIMI 13M

Mbiemri me prapashtesa zmadhuese o keqësuese.

Zglith mirë nani:

Marku ë bujarún, por  
ndo herë ë i rremunác!



Sara ë e mirace!



Çë janë

bujarún, i rremunác, e mirace ?

Janë *mbiemra zmadhues* o *keqësues* (litisht: aggettivi accrescitivi o peggiorativi).

Ca tjerë

- me prapashtesat *-ac, -ace* : i glatac, e glatace; i madhac, e madhace; etj.  
me prapashtesat *-un, -une*, të arbëreshuar nga djalekti siçiljan: masarun, masarune; pullitun, pullitune; sangutun, sangutune; etj.

### SHËNIM

Prapashtesat *-ac, -ace* thomse i kishëm o thomse i morëm nga djalekti siçiljan (*beddazzu*), por ato *-un, -une* ia morëm drejtpërdrejt (*bugiarduni*).

Gluha shqipe prapashtesat *"-ac, -ace"* i ka vetëm me ndëlgim (kuptim) keqësues.

### Ndo shembull letrar

MARA – Kish ligj kush m'e tha se je ... se je ...

SINA – Se je ... e madhace !

(GSMaj – Orëmira – f. 61, akti III, skena VI)

OSHËTARI – Kafshë, gorrromise ka qafa e malit këtë i rremunac !

(GSMaj – Kërkuetit – f. 34, akti III, skena VII)

## MËSIMI 14M

Mbiemri i përbërë.

Zglith me vëmendje këta shembuj letrarë:

...e u dëftua nga herë Zoti Perëndi **i gjithëmëndëmi** ...

(FZ - Viti i katërt - 28 të shkurtit 1915 , n. 2, f. 4, sht. 1, r. 7)

Ai ka t' më ruanjë nga duart e ketij të huaji **të parrethprerë**

(FZ - Viti i katërt - 9 të majit 1915 , n. 12, f. 4, sht. 1, r. 25/27)

...kle qellur te parrajsi e gjegj të fola **të pa-rrëfieme** ...

(FZ - Viti i parë - 6 të tetorit 1912 , n. 33, f. 3, sht. 2, r. 14/16)

O zot, **i dashamirë** me ne...

(MPS - Mesha e Shën Jan **Gojartit** )

Bukën tënë **të përditshme** ëna neve sot.

(MPS - Mesha e Shën Jan **Gojartit**)

Zonjë e butë edhe **e pashoqe**...

(CT - f. 198, LX, str. 3, vj. 19)

Rregjërësja plakë, ... i priti me gas **të pathënëshëm**.

(CT - Novelline popolari, IX - f. 397, r. 20)

...Zjerma ish... i bukur, **flokart** ...

(CT - Novelline popolari, X - f. 418, r. 4)

**Çë janë**

i gjithëmëndëmi, të parrethprerë, të parrëfieme, i dashamirë, të përditshme, e pashoqe, të pathënëshëm, flokart ?

**Janë mbiemra të përbërë.**

Letërsia jonë e vjetër e gjith'e gjithë përkthimet liturgjike janë plotë me fjalë e me mbiemra të përbërë !

## Mbiemrat e shembujvet që pamë përbëhen kështu:

i gjithëmëndëm, e gjithëmëndme = **mbiemër + folje** = gjithë + mënd;

i, e parrethprerë = **pjesëzë + emër + folje** = pa + rreth + prerë;

i parrëfiem, e parrëfieme = **pjesëz + folje** = pa + rrefyeni;

i, e dashamirë = **folje + ndajfolje** = do + mirë;

i përditshëm, e përditshme = **parafjalë + emër** = për + ditë;

i pashok, e pashoqe = **pjesëzë + emër** = pa + shok, shoqe;

i pathënëshëm, e pathënëshme = **pjesëz + folje** = pa + thënë;

flokart, flokarte = **emër + mbiemër** = flokë + i artë.

## Tjerë shembuj letrarë

... Zjermës i vanë syt te unaza e u zbet, përse pa se guri i **paçëmoshëm** ... zëj fill të murrej.

(CT – Novelline popolari, IX – f. 41R, r. 18)

Na e dim, atje u ndodh / ku lëftohej i **përmëndmi**.../ Skëndërbeg!

(FCG – MF – f. 6, IV, vj. 8)

### SHËNIM

Te gluha më moderne ndodhen “përbërje” me dy o tre mbiemra të lidhur me vijë.

**Shembuj:** Kemi një problem **tekniko-shkencor**.

Ai ë i biri i njëi burri **italo-anglo-shqiptar**.

Ajo ë e bija e njëi gruaje **italo-anglo-shqiptare**.

Si duket mirë, të parit element të mbiemrit i shtohet një “-o” e pra ngë ndërrohet më; i sprasmi element ë ai që merr mbasesat e mbiemrit sipas rregullave të njohjës.

**Mbiemri i përbërë mënd të ndodhet edhe kështu:**

Ajo turbinë jec me fuqi **elektromagnetike**.

### USHTRIME

Zgjidh, me grupin e klasës tënde (sate), ndonjë pughare të libri “*Canti tradizionali ed altri saggi...*” e nxir pra mbiemrat që të duken të përbërë, tuke i bërë analizën e prejardhjes (ka vijën).

## MËSIMI 15M

Mbiemri dëftor.

Zglith e vëre'!

*Ky* libër ë i Markut.

*Këta* libre janë të Markut.

*Kjo* vajzë ha pak.

*Këto* vajza hanë pak.

*Ai* djalë flë shtuara.

*Ata* djem flëne shtuara.

*Ajo* vajzë vete te skolla.

*Ato* vajza venë te skolla.

Libri ë i *këtij* djali.

Libri ë i *këtyre* djemve.

Libri ë i *kesaj* vajzje.

Libri ë i *atyre* vajzave.

*Këta* të ngrënë ngë më pëlqen.

*Ata* ujë ngë mënd të pihet.



Çë janë

*ky, këta, kjo, këto, ai, ata, ajo, ato, këtëj, këtyre, kesaj, atyre, këta, ata* janë *mbiemra dëftorë* (litisht: aggettivi dimostrativi).

- Të jenë *mbiemra dëftorë* i duhet ngaherë te ana një emër me të çilin lidhen te gjinia, te numri e te rasa.
- Në ngë kanë emrin te ana, janë *përemra* (litisht: pronomi).
- *Mbiemrat dëftorë* lakohen.

## MBIEMRAT DËFTORË

## "ky", mashkullor

	Njëjës
E.	ky burrë
Gj.	(i...) këtij burri
Dh.	këtij burri
K.	këtë burrë
Rr.	këtij burri

	Shumës
	këta burra
(i...)	këtyre* burrave
	këtyre* burrave
	këta burra
	këtyre* burrave

## "kjo", femëror

	Njëjës
E.	kjo grua
Gj.	(i...) kësaj gruaje
Dh.	kësaj gruaje
K.	këtë grua
Rr.	kësaj gruaje

	Shumës
	këto gra
(i...)	këtyre* grave
	këtyre* grave
	këto gra
	këtyre* grave

## "këta", asnjënjës

	Njëjës
E.	këta mish
Gj.	(i...) këtij mishi
Dh.	këtij mishi
K.	këta mish
Rr.	këtij mishi

	Shumës
	këto mishra
(i...)	këtyre* mishrave
	këtyre* mishrave
	këto mishra
	këtyre* mishrave

\* Arbërisht ndodhet edhe kjo formë: këtyreve (vëre' te shembujt letrarë).

## Si "ky", "kjo" e "këta" lakohen edhe

**ai** (ai, i atij, atij, atë, atij; ata, i atyre, atyre, atyre, ata, atyre)

**ajo** (ajo, i asaj, asaj, atë, asaj; ato, i atyre, atyre, ato, atyre)

**ata** (atë, i atij, atij, ata, atij; ato, i atyre, atyre, ato, atyre)

**ky** përdoret për shërbise, për kafshë o për njerëz që kemi ndanëz

**ai** përdoret për shërbise, për kafshë o për njerëz që kemi llargu.

## USHTRIME

Vër mbiemrat dëftorë “ky” e “ai” te ana e emrit.

	<u>ky</u>	<u>ai</u>
Dh.	_____ burrave	_____ gruaje
K.	_____ burrë	_____ burra
Gj.	_____ gruaje	_____ të ngrëni
E.	_____ vajza	_____ vajzë
Dh.	_____ vajzje	_____ vajzave
Dh.	_____ djemve	_____ djali
E.	_____ të ngrënë	_____ të verdhë
K.	_____ mish	_____ lule
Gj.	_____ lulje	_____ druri
Rr.	_____ druri	_____ luleve



### Ndo shembull letrar

Kundra **ktireve** shtat kreravet...

(NF – Codice – f. 51, r. 9 nga e sprasmja)

“... Jani pagëzoi me ujë, po ju kat jini pagëzuar te Shpirti Shejt pas **ktireve** pak ditë”.

(FZ – Viti i parë - 7 të prigjith 1912, n. 7, f. 4, sht. 2, r. 17/19)

### SHËNIM

Mbiemrat dëftorë, çë sheh ketu poshtë, arbërisht ngë i kemi te gluha e folur, por ë mirë të dish se gluha shqipe i ka:

- i, e, të tillë (litisht: tale);
- i, e, të këtillë (litisht: tale vicino);
- i, e, të atillë (litisht: tale lontano).

## MËSIMI 16M

Mbiemri pronor te vetat njëjës.

Zglith e vëre'!

Libri *jim* ë i madh sa libri *jyt* e sa libri *i tij*.

Miqtë *tim* ngë janë si miqtë *tat*.

Vajza *jime* ë e glatë si vajza *jote* e si vajza *e tij*.

Miket *time* ngë janë si miket *tote*.

Libri *i saj* ka kopertinën e shqerrë.

Penda *e saj* ngë shkruan mirë.

Miket *e saja* ngë janë si miket *time* o si miket *e tija*.

Të folurit *tim* ngë i pëlqen.



Çë janë

*jim, jyt, i tij, tim, tat, jime, jote, e tij, time, tote, i saj, e saj, e saja, time, e tija, tim?*

- Janë *mbiemra pronorë* të vetës së parë, të dytë e të tretë njëjës (litisht: aggettivi possessivi di prima, seconda e terza persona singolare).
- Të jenë *mbiemra pronorë* i duhet ngaherë te ana një emër me të çilin lidhen te gjinia, te numri e te rasa.
- Në ngë kanë emrin te ana, janë *përemra*.
- Kur *mbiemrat pronorë* kanë nyjën, kjo te lakimi ndërron si kemi parë për tjerët mbiemra.



Vëre' mirë tabelat.

## Veta e parë njëjës



### “jim / tim”, mashkullor

	Njëjës	Shumës
E.	djali <b>jim</b> (shqip: im)	djemtë <b>tim</b> (shqip: e mi)
Gj.	(i, ...) djalit <b>tim</b>	(i, ...) djemvet <b>tim</b> (shqip: të mi)
Dh.	djalit <b>tim</b>	djemvet <b>tim</b> (shqip: të mi)
K.	djalin <b>tim</b>	djemtë <b>tim</b> (shqip: e mi)
Rr.	djalit <b>tim</b>	djemvet <b>tim</b> (shqip: të mi)

Shembuj:

Djali **jim** ë i mirë.

Fuqia e djemvet **tim** ë e madhe.



### “jime / time”, femëror

	Njëjës	Shumës
E.	vajza <b>jime</b> (shqip: ime)	vajzat <b>time</b> (shqip: e mia)
Gj.	(i, ...) vajzës <b>time</b> (shqip: sime)	(i, ...) vajzavet <b>time</b> (shqip: të mia)
Dh.	vajzës <b>time</b> (shqip: sime)	vajzavet <b>time</b> (shqip: të mia)
K.	vajzën <b>time</b>	vajzat <b>time</b> (shqip: e mia)
Rr.	vajzës <b>time</b> (shqip: sime)	vajzavet <b>time</b> (shqip: të mia)

Shembuj:

Vajza **jime** ë e mirë.

Buzët e vajzës **time** qeshjën gjithmonë.



### “tim / time”, asnjës

	Njëjës	Shumës
E.	të folurit <b>tim</b> tjerat si mashkullori	të folurat <b>time</b> * (shqip: e mia) si femërori

\* vlen si shembull, përçë te shumësi ngë ndutu përdoret.

Shembuj:

Të folurit **tim** ë të butë.

Fuqia e të folurit **tim** ë e madhe.

## Veta e dytë njëjës



### “jyt / tat”, mashkullor

#### Njëjës

E.	djali <b>jyt</b> (shqip: yt)
Gj.	(i, ...) djalit tënd
Dh.	djalit tënd
K.	djalin tënd
Rr.	djalit tënd

#### Shumës

	djemtë <b>tat</b> (shqip: e tu)
(i, ...)	djemvet <b>tat</b> (shqip: të tu)
	djemvet <b>tat</b> (shqip: të tu)
	djemtë <b>tat</b> (shqip: e tu)
	djemvet <b>tat</b> (shqip: të tu)

#### Shembuj:

Pashë djalin tënd çë shërbej.  
Djemtë **tat** janë të butë.



### “jote / tote”, femëror

#### Njëjës

E.	vajza <b>jote</b>
Gj.	(i, ...) vajzës tënde (shqip: sate)
Dh.	vajzës tënde (shqip: sate)
K.	vajzën tënde
Rr.	vajzës tënde (shqip: sate)

#### Shumës

	vajzat <b>tote</b> (shqip: e tua)
(i, ...)	vajzavet <b>tote</b> (shqip: të tua)
	vajzavet <b>tote</b> (shqip: të tua)
	vajzat <b>tote</b> (shqip: e tua)
	vajzavet <b>tote</b> (shqip: të tua)

#### Shembuj:

I dhashë një lule **vajzës tënde**.  
**Vajzat tote** janë të buta.  
I falem **zotërisë sate!**



### “tat / tote”, asnjënjës

#### Njëjës

E.Gj.Dh.K.Rr. të folurit **tat**

#### Shumës

të folurat **tote**\* (shqip: e tua)  
si femërori

\* vlen si shembull, përçë te shumësi ngë ndutu përdoret.

#### Shembuj:

**Të folurit tat** ë të butë.  
**Fuqia e të folurit tat** ë e madhe.

## Veta e tretë njëjës



### “i tij”, mashkullor emri pronar

	Njëjës	Shumës
E.	djali i tij	djemtë e tij
Gj.	(i, ...) djalit të tij	(i, ...) djemvet të tij
Dh.	djalit të tij	djemvet të tij
K.	djalin e tij	djemtë e tij
Rr.	djalit të tij	djemvet të tij

#### Shembull:

La' Gjergji vete përjashta; djali i tij vete te skolla.

#### Vëre':

- La' Gjergji ë emër mashkullor
- > djali ë emër mashkullor
- > i tij ë mbiemri pronor ç'i duhet.



### “e tij”, mashkullor emri pronar

	Njëjës	Shumës
E.	vajza e tij	vajzat e tija
Gj.	(i, ...) vajzës të (së) tij	(i, ...) vajzavet të tija
Dh.	vajzës të (së) tij	vajzavet të tija
K.	vajzën e tij	vajzat e tija
Rr.	vajzës të (së) tij	vajzavet të tija

#### Shembull:

La' Gjergji vete përjashta; vajza e tij vete te skolla.

#### Vëre':

- La' Gjergji ë emër mashkullor
- > vajza ë emër femëror
- > e tij ë mbiemri pronor ç'i duhet.



### “e tij”, mashkullor emri pronar

	Njëjës	Shumës
E.K.	të folurit e tij	të folurat e tija *
Gj. Dh. Rr.	të folurit të tij	si femërori

\* vlen si shembull, përçë te shumësi ngë ndutu përdoret.

#### Shembuj:

Marku ë djalë i mirë; të folurit e tij ë të butë.

### “i saj”, femëror emri pronar

	<b>Njëjës</b>
E.	djali <b>i saj</b>
Gj.	(i, ...) djalit të saj
Dh.	djalit të saj
K.	djalin e saj
Rr.	djalit të saj

	<b>Shumës</b>
	djemtë <b>e saj</b>
(i, ...)	djemvet të saj
	djemvet të saj
	djemtë e saj
	djemvet të saj

#### Shembull:

**Vo' Marieja** rri te shpia; **djali i saj** vete te skolla.

#### Vëre':

**Vo' Marieja'** ë emër femëror

> **djali** ë emër mashkullor

> **i saj** ë mbiemri pronor ç'i duhet.



### “e saj”, femëror emri pronar

	<b>Njëjës</b>
E.	vajza <b>e saj</b>
Gj.	(i, ...) vajzës të saj (shqip: së saj)
Dh.	vajzës të saj (shqip: së saj)
K.	vajzën e saj
Rr.	vajzës të saj (shqip: së saj)

	<b>Shumës</b>
	vajzat <b>e saja</b>
(i, ...)	vajzavet të saja
	vajzavet të saja
	vajzat e saja
	vajzavet të saja

#### Shembull:

**Vo' Marieja** rri te shpia; **vajza e saj** vete te skolla.

#### Vëre':

**Vo' Marieja'** ë emër femëror

> **vajza** ë emër femëror

> **e saj** ë mbiemri pronor ç'i duhet.



### “e saj”, femëror emri pronar

	<b>Njëjës</b>
E. K.	të folurit <b>e saj</b>
G. Dh. Rr.	të folurit të saj

	<b>Shumës</b>
	të folurat <b>e saja</b> *
	<b>si femërori</b>

\* vlen si shembull, përçë te shumësi ngë ndutu përdoret

#### Shembuj:

**Sara** ë vajzë e mirë; **të folurit e saj** ë të butë.

#### Vëre':

**Sara** ë emër femëror

> **te folurit** ë emër asnjanes

> **e saj** ë mbiemri pronor ç'i duhet.



Te veta e tretë bën pjesë edhe mbiemri pronor “ i vet ”.

	“i vet”		“e vet”	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	
<b>Shumës</b>				
E.	djali i vet	djemtë e vet	vajza e vet	vajzat e veta
Gj. (i..)	djalit të vet	(i..) djemvet të vet	(i..) vajzës të (së) vet	(i..) vajzavet të veta
Dh.	djalit të vet	djemvet të vet	vajzës të (së) vet	vajzavet të veta
K.	djalin e vet	djemtë e vet	vajzën e vet	vajzat e veta
Rr.	djalit të vet	djemvet të vet	vajzës të (së) vet	vajzavet të veta

### Vëre’:

- mbiemri “i vet, e vet” **arbërisht** përdoret vetëm te të shkruamet letrare;
- mbiemri “i vet, e vet” mënd të vuhet te vendi i “i tij, i saj, e tij, e saj, i tyre, e tyre”;

#### shembuj:

Marku do mirë kalin e vet. >< Marku do mirë kalin e tij.

Miqtë e Markut kanë kuejt e vet. >< Miqtë e Markut kanë kuejt e tyre.

Sara do mirë pupën e vet. >< Sara do mirë pupën e saj.

Miket e Sarës kanë pupat e veta. >< Miket e Sarës kanë pupat e tyre.

- kur her’ e herë ndodhet ndonjë kundërshtim se ngë dimë kujt ë një gjë, atëherë mbiemri “i vet, e vet” vuhet si mbiemër i kryefjalës e jo si mbiemër i tjerëvet elemente të fjalisë;

#### shembull:

Marku i dha Vitot biçikletën e tij.

Çilën biçikletë i dha Marku, të tijën o atë çë Vito, për shembull, i kish huajtur? Në na do t’ thomí se Marku i huajti biçikletën i të çilës ë pronar (i zoti), ka shkruajëm kështu:

Marku i dha Vitot biçikletën e vet.

Në te vendi i Vitot ish Sara, ngë kishëm problem:

Marku i dha Sarës biçikletën e tij.

## USHTRIME

Vër vetën e parë, të dytë e të tretë njëjës të këtyre mbiemrave pronorë te vendi që i nget: tim, jim, jote, tënd, tat, tote, të tij, e saj, të saja, të tijja.

- 1) Djalit \_\_\_\_\_ i thonë Vito.
- 2) Djalit \_\_\_\_\_ ngë e njoh.
- 3) Vajza \_\_\_\_\_ vete te skolla.
- 4) Burri \_\_\_\_\_ vate përjashta. - tha vo' Marieja.
- 5) Vajzat \_\_\_\_\_ janë të bukura.
- 6) Djemtë \_\_\_\_\_ janë të rritur.
- 7) Vo' Lena ë nonë; e mbesa \_\_\_\_\_ thërritet Sara.
- 8) La' Gjergji ka një djalë; djalit \_\_\_\_\_ i thonë Marku.
- 9) Mara i dha një dhuratë (rrigall) mikevet \_\_\_\_\_.
- 10) Marku i dha një lule mikevet \_\_\_\_\_.



### Shembuj letrarë

Nga bijt e tu po jam...  
(CS - XXXVI - f. 51, vj. 6)

...vetëheja e 'saj' ashtu si ajo isht.  
(FZ - Viti i parë - 15 te dhjetorit 1912, n.43, f. 4, sht. 1, 14 nga e sprasmja)

"...Davidi i tha: - Mos u trëmb, shërbëtori jiti vete e lufton në atë Filistë."  
(FZ - 9 të mait 1915 - f. 4, Dhiata e vjetër, X)

"E Davidi u përgjegj Saullit: - U kulotëja delet e tatës tim..."  
(FZ - 9 të mait 1915 - f. 4, Dhiata e vjetër, X)

...Sot Zoti të jep te duart time, e u ka t' vras e ka t' të shkul kriet..."  
(FZ - 9 të mait 1915 - f. 4, Dhiata e vjetër, X)

Njerëzia e jote më imundi!  
(CT - Novelline popolari - V, f. 375, r. 3 nga e sprasmja)

Zjerma e Bardhëkuqëja rrijtin atje një tre muajë e pran u këthyen në vent të vet...  
(CT - Novelline popolari - X, f. 426, r. 6 nga e sprasmja)

Pran i rrëfyejti punën e vetë.  
(CT - Novelline popolari - VI, f. 377, r. 2 nga e sprasmja)

I falem zotëris sate, o zonjë!  
(CT - Novelline popolari - VI, f. 379, r. 13)

...me këmbët tote ...  
(CT - Novelline popolari - XV, f. 480, r. 19)

## MËSIMI 17M

Mbiemri pronor te vetat shumës.



Zglith e vëre'!

Kali *jynë* ë i madh sa kali *jij* e sa kali *i tyre*.

Miqtë *tanë* ngë janë si miqtë *taj* o si miqtë *e tyre*.

Vajza *jonë* ë e glatë si vajza *juaj* e si vajza *e tyre*.

Miket *e tyre* ngë janë si miket *tona* o si miket *tuaja*.

Çë janë

*jynë, jij, i tyre, tanë, taj, jonë, juaj, e tyre, tona, tuaja?*



Janë *mbiemra pronorë* të vetës së parë, të dytë e të tretë shumës



### Veta e parë shumës



“jynë / tanë”, mashkullor

#### Njëjës

E.	djali <i>jynë</i>	(shqip: ynë)
Gj.	(i, ...) djalit <i>tënë</i>	(shqip: tonë)
Dh.	djalit <i>tënë</i>	(shqip: tonë)
K.	djalin <i>tënë</i>	(shqip: tonë)
Rr.	djalit <i>tënë</i>	(shqip: tonë)

#### Shumës

	djemtë <i>tanë</i>
(i, ...)	djemvet <i>tanë</i>
	djemvet <i>tanë</i>
	djemtë <i>tanë</i>
	djemvet <i>tanë</i>

#### Shembuj:

Pashë djalin *tënë* çë shërbej.

Djemtë *tanë* janë të butë.

◆  
“jonë / tona”, femëror

		Njëjës	
E.		vajza <b>jonë</b>	
Gj.	(i, ...)	vajzës <b>tënë*</b>	(shqip: sonë)
Dh.		vajzës <b>tënë*</b>	(shqip: sonë)
K.		vajzën <b>tënë</b>	(shqip: tonë)
Rr.		vajzës <b>tënë*</b>	(shqip: sonë)

		Shumës	
		vajzat <b>tona</b>	
(i, ...)		vajzavet <b>tona</b>	
		vajzavet <b>tona</b>	
		vajzat <b>tona</b>	
		vajzavet <b>tona</b>	

**Shembuj:**

I dhashë një lule **vajzës tënë**.

**Vajzat tona** janë të buta.

\* Për rasat gjinore, dhanore e rrjedhore njëjës ndo shkrimtar i vjetër arbëresh ka shkruar “sënë” tuke jui qasur formës shqiptare.

◆  
“tanë / tona”, asnjënjës

		Njëjës	
E.Gj.Dh.K.Rr.		të folurit <b>tanë</b>	

		Shumës	
		të folurat <b>tona*</b>	
		si femërori	

\* vlen si shembull, përçë te shumësi ngë ndutu përdoret.

◆  
Veta e dytë shumës

◆  
“jij / taj”, mashkullor

		Njëjës	
E.		djali <b>jij</b>	(shqip: juaj)
Gj.	(i, ...)	djalit <b>tëj</b>	(shqip: tuaj)
Dh.		djalit <b>tëj</b>	(shqip: tuaj)
K.		djalin <b>tëj</b>	(shqip: tuaj)
Rr.		djalit <b>tëj</b>	(shqip: tuaj)

		Shumës	
		djemtë <b>taj</b>	(shqip: tuaj)
(i, ...)		djemvet <b>taj</b>	(shqip: tuaj)
		djemvet <b>taj</b>	(shqip: tuaj)
		djemtë <b>taj</b>	(shqip: tuaj)
		djemvet <b>taj</b>	(shqip: tuaj)

**Shembuj:**

Pashë **djalin tëj** çë shërbej.

**Djemtë taj** janë të butë.





### “juaj / tuaja”, femëror

#### Njëjës

E.	vajza <b>juaj</b>	
Gj.	(i, ...) vajzës <b>tëj</b>	(shqip: suaj)
Dh.	vajzës <b>tëj</b>	(shqip: suaj)
K.	vajzën <b>tëj</b>	(shqip: tuaj)
Rr.	vajzës <b>tëj</b>	(shqip: suaj)

#### Shumës

	vajzat <b>tuaja</b>	
(i, ...)	vajzavet <b>tuaja</b>	
	vajzavet <b>tuaja</b>	
	vajzat <b>tuaja</b>	
	vajzavet <b>tuaja</b>	

#### Shembuj:

I dhashë një lule **vajzës tëj**.  
**Vajzat tuaja** janë të buta.



### “taj / tuaja”, asnjënjës

#### Njëjës

E.Gj.Dh.K.Rr. të folurit **taj**

#### Shumës

të folurat **tuaja** \*  
si femërori

\* vlen si shembull, përçë te shumësi ngë ndutu përdoret.



## Veta e tretë shumës



### “i tyre / e tyre”, mashkullor

#### Njëjës

E.	djali <b>i tyre</b>	
Gj.	(i, ...) djalit <b>të tyre</b>	
Dh.	djalit <b>të tyre</b>	
K.	djalin <b>i (e) tyre</b>	
Rr.	djalit <b>të tyre</b>	

#### Shumës

	djemtë <b>e tyre</b>	
(i, ...)	djemvet <b>të tyre</b>	
	djemvet <b>të tyre</b>	
	djemtë <b>e tyre</b>	
	djemvet <b>të tyre</b>	

#### Shembuj:

Pashë **djalin e tyre** çë shërbej.  
**Djemtë e tyre** janë të butë.

## “e tyre / e tyre”, femëror

### Njëjës

E.	vajza <b>e tyre</b>	
Gj.	(i, ...) vajzës të tyre	(shqip: së tyre)
Dh.	vajzës të tyre	(shqip: së tyre)
K.	vajzën e tyre	
Rr.	vajzës të tyre	(shqip: së tyre)

### Shumës

	vajzat <b>e tyre</b>	
(i, ...)	vajzavet të tyre	
	vajzavet të tyre	
	vajzat e tyre	
	vajzavet të tyre	

### Shembuj:

I dhashë një lule **vajzës të (së) tyre**.

**Vajzat e tyre** janë të buta.



## “e tyre / e tyre”, asnjënjës

### Njëjës

E.Gj.Dh.K.Rr. të folurit **e tyre**

### Shumës

të folurat **e tyre** \*  
si femërori

\* vlen si shembull, përçë të shumësi ngë ndutu përdoret.

## USHTRIME

Vër vetën e parë, të dytë e të tretë shumës të këtyre mbiemrave pronorë të vendi çë i nget: jynë, tënë, jonë, tona, tëj, taj, tuaja, juaj, e tyre, të tyrë.

- 1) Djali \_\_\_\_\_ gjeti shëbërtyrë.
- 2) Mikut \_\_\_\_\_ i dhanë një medalje.
- 3) Vajza \_\_\_\_\_ ka pesë vjeç.
- 4) **Miqrë** \_\_\_\_\_ **vanë te mali**.
- 5) Vajzat \_\_\_\_\_ janë të bukura.
- 6) Shpia e mikevet \_\_\_\_\_ ë e madhe.
- 7) Nonit \_\_\_\_\_ si i thonë ?
- 8) Nona \_\_\_\_\_ bëri brumit te shpia.
- 9) Djemtë \_\_\_\_\_ janë të zgjuar.
- 10) Miqvet \_\_\_\_\_ mos i kish besë.



## Ca shembuj letrarë

...kjo krëmtë **juaj** ...

(NF - Codice - XVI, f. 112, vjer. 21)

Ashtu ndje mëkatët **tona**...

(CS - III, f. 6, vj. 13)

Ti çë ruajte Gjyshrat **tanë**...

(CS - LIII, f. 74, vj. 5)

Si përingërat, na duam / Po të mbajëm vehten **tënë**...

(CS - LIII, f. 75, vj. 10)

Një dëshir ka zëmbra e **jonë**...

(CS - LIII, f. 75, vjer. 18)

Lutjen **tënë** ti digjo...

(CS - LIII, f. 76, vj. 2)

Zoti i **jinë** u bë njeri...

(CS - LVII, f. 80, vj. 9)

"E Saulli i tha Davidit: - Jec e kloft me tij **in'** Zot.

(FZ - 9 të mait 1915 - f. 4, Dhiata e vjetër, X)

... vllathit **t' tyre**... // ...në duarë **t' tyre**...

(CT- CIV - f. 286, str. 9 e 10)

- me shengun e **t' yn'** Zoti...

(CT- CIV - f. 294, str. 10)

Zoti dëmark: i parë i horës **tënë**...

(CT- X- f. 380, vjer. 1)

...her' e herë shkronjën **tënë** e bëjëm na me duarët **tona**.

(CT - Novelline popolari - XII - f. 455, e sprasmja)

...të na ngushëllonjë me fjalën e tij ashtu të ëmbël te hera e sprasme e gjellës **tënë**.

(GS - Prose - XIX, f. 342, r. e sprasme)

...isht rrenja e besës **tënë**.

(GS - Prose - XXI, f. 344, r. 6 nga e sprasmja)

## MËSIMI 18M

Mbiemra pronorë me emrat e gjirisë.

Zglith e vëre'



Jime bijë ë nuse.

Jyt nip vate te skolla e jot mbesë qëndroi te shpia.

E motra vete Palermë te skolla.

I vëllai mori diplomën.

Jim bir ka dhjetë vjeç.



Çë janë

jim (bir), jime (bijë), jyt (nip), jot (mbesë), e (motra), i (vëllai) ?

Janë mbiemra pronorë, vënë përpara emravet të gjirisë, e ndodhen vetëm te njëjësi; shih:

- vetën e parë > jim, jime
- e dytë > jyt, jot
- e tretë > i, e



## Veta e parë njëjës

“jim bir”

	Njëjës
E.	jim bir
Gj.	(i, ...) tim biri
Dh.	tim biri
K.	tim bir
Rr.	tim biri

	Shumës
	tim bij
(i, ...)	tim bijve
	tim bijve
	tim bij
	tim bijve

Shembuj me rasën gjinore:

Marku, miku i tim biri, vate Palermë.

Vajza e tim biri mori diplomën.

## “jime bijë”

	<b>Njëjës</b>		<b>Shumës</b>
E.	jime bijë		time bija
Gj.	(i, ...) sime bije	(i, ...)	time bijave
Dh.	sime bije		time bijave
K.	time bijë		time bija
Rr.	sime bije		time bijave

**Shembuj me rasën gjinore:**

Djali i **sime bije** mori diplomën.  
Mara, mikja e **sime bije**, vate Palermë.



## Veta e dytë njëjës

### “jyt bir”

	<b>Njëjës</b>		<b>Shumës</b>
E.	jyt bir		tët bij
Gj.	(i, ...) tyt biri	(i, ...)	tët bijve
Dh.	tyt biri		tët bijve
K.	tët bir		tët bij
Rr.	tyt biri		tët bijve

**Shembuj me rasën gjinore:**

Marku, miku i **tyt biri**, vate Palermë.  
Vajza e **tyt biri** mori diplomën.



### “jot bijë”

	<b>Njëjës</b>		<b>Shumës</b>
E.	jot bijë		rët bija
Gj.	(i, ...) sat bije	(i, ...)	tët bijave
Dh.	sat bije		tët bijave
K.	tët bijë		tët bija
Rr.	sat bije		rët bijave

**Shembuj me rasën gjinore:**

Djali i **sat bije** mori diplomën.  
Mara, mikja e **sat bije**, vate Palermë.



## Veta e tretë njëjës

### “i biri”

	Njëjës		Shumës
E.	i biri		të bijtë
Gj.	(i, ...) të birit	(i, ...)	të bijvet
Dh.	të birit		të bijvet
K.	të birin		të bijtë
Rr.	të birit		të bijvet

#### Shembuj me rasën gjinore:

Marku, miku i të birit, vate Palermë.  
Vajza e të birit mori diplomën.



### “e bija”

	Njëjës		Shumës
E.	e bija		të bijat
Gj.	(i, ...) të* bijës	(i, ...)	të bijavet
Dh.	të* bijës		të bijavet
K.	të bijën		të bijat
Rr.	të* bijës		të bijavet

#### Shembuj me rasën gjinore:

Djali i të bijës mori diplomën.  
Mara, mikja e të bijës, vate Palermë.

\* Arbërisht vete mirë të thuash e të shkruash “të” te rasat gjinore, dhanore e rrjedhore të gjinisë femërore njëjës; shqip i duhet “së”:

Djali i së bijës mori diplomën. Mara, mikja e së bijës, vate Palermë.

## USHTRIME

1- Shkruaj edhe ti ca emra të gjirisë me mbiemrin pronor të vetës së tretë:

i kushëriu, e kushërita, i kunati,

---

---

---

---



2- Bëj lakimin e këtyre emrave të gjirisë me pronorin përpara.

	<b>Veta e parë</b> Njëjës jim vëlla	<b>Veta e dytë</b> Njëjës jyt vëlla	<b>Veta e tretë</b> Njëjës i vëllai
E.	_____	_____	_____
Gj.	_____	_____	_____
Dh.	_____	_____	_____
K.	_____	_____	_____
Rr.	_____	_____	_____

	<b>Shumës</b> tim vëllezër	<b>Shumës</b> tët vëllezër	<b>Shumës</b> të vëllezërit
E.	_____	_____	_____
Gj.	_____	_____	_____
Dh.	_____	_____	_____
K.	_____	_____	_____
Rr.	_____	_____	_____



	<b>Veta e parë</b> Njëjës jime motër	<b>Veta e dytë</b> Njëjës jot motër	<b>Veta e tretë</b> Njëjës e motra
E.	_____	_____	_____
Gj.	_____	_____	_____
Dh.	_____	_____	_____
K.	_____	_____	_____
Rr.	_____	_____	_____

	<b>Shumës</b> time motra	<b>Shumës</b> tët motra	<b>Shumës</b> të motrat
E.	_____	_____	_____
Gj.	_____	_____	_____
Dh.	_____	_____	_____
K.	_____	_____	_____
Rr.	_____	_____	_____

## Shembuj letrarë.

- Qyparis i hollë e i glat, /çë petk të taksi **yt' at?** / ..... / Se ti dhri e dhrizë e bardhë, /  
çë stolí të taks **jot' emë?**  
(CT - V - f. 8, vj. 7/8 e 22/23)

...kish të martonej me **të birin** e rregjit.  
(CT - Novelline popolari - I, f. 353, r. 8 )

...atë e bën dhëndërr me **të hijën** e një rregji...  
(CT - Novelline popolari - I, f. 353, r. 13 )

**E bija** e rregjit e **i biri** i bulkut.  
(CT - Novelline popolari - V, f. 372, titull)

...u jerdha këtu se dua **tër bijë** për grua.  
(CT - Novelline popolari - V, f. 373, e sprasmja)

...ngë dua të ket helm **jot' bijë!**  
(CT - Novelline popolari - V, f. 375, r. 7)

SQEVA - Kush jec me puntën ?!

MJESHTRI - **Jot' bijë**, Sqevë ! Jec me puntën të mos bunj batari...

SQEVA - O i bekuami ! Jec me puntën !

MJESHTRI - Sqevë ! Ë shentifiku: kur punta ë e grisur... "vuol diri se"... ka fullinie te  
trutë... se ngë isht më **jot' bijë !**

SQEVA - Ngë ë më **jime bijë ?!**

(GSMaj - Paja - Akti I, skena XIV , f. 23)



## MËSIMI 19M

Mbiemri pyetës.

?

Zglith e vëre' mirë

*Çili* djalë ngë pruri ushtrimet e skollës?

*Çila* vajzë i dha Markut ushtrimet?

Me *çilin* djalë dolle?



Me *çilën* vajzë dolle?

*Çilët* të ngrënë të pëlqen?

*Çë* shërbise janë këto?

*Sa* djem dinë të zgledhjën arbërisht?

*Sa* vajza dinë të këndojën litisht?

Çë janë

*çili, çila, çilin, çilën, çilët, çë, sa?*

Janë *mbiemra pyetës* (litisht: aggettivi interrogativi).

Edhe këtu vlen sa ke mësuar: të jenë *mbiemra pyetës* i duhet ngaherë te ana një emër me të çilin lidhen;

- çili, çila, çilët lakohen;
- çë e sa qëndrojnë ashtu si janë.

## MBIEMRI PYETËS

“çili ?”, mashkullor		
	Njëjës	Shumës
E.	çili djalë ?	çilët djem ?
Gj.	(i ...) çilit djalë	(i ...) çilëvet djem
Dh.	çilit djalë	çilëvet djem
K.	çilin djalë	çilët djem
Rr.	çilit djalë	çilëvet djem

“çila ?”, femëror		
	Njëjës	Shumës
	çila vajzë ?	çilat vajza ?
(i...)	çilës vajzë	(i...) çilavet vajza
	çilës vajzë	çilavet vajza
	çilën vajzë	çilat vajza
	çilës vajzë	çilavet vajza

“çilët ?”, asnjënjës		
	Njëjës	Shumës
E.	çilët mish ?	çilat mishra ?
Gj.	(i...) çilit mish	(i...) çilavet mishra
Dh.	çilit mish	çilavet mishra
K.	çilët mish	çilat mishra
Rr.	çilit mish	çilavet mishra



### USHTRIME

Zgllith mirë këta **shembuj letrarë** këtu poshtë e pra kërko tjerët vjershe te faqet e libretet “Canti tradicionali” e “Te dheu i huaj”, sa t’i mësosh e t’i mbash mend.

Tyj përpara **çila** zëmbërë / arbëreshe nuk u njom?  
(Dheu - Këngë IX, f. 340, vj. 6,7)

**Çe** perralla qet? ... **të cilin** / mal të that kujton?  
(Dheu - II - K. III - vj. 158/165)

Bòbo! Bòbo! Se jan’e na vijën! / Ka **çila** derë duan t’ na hijën?  
(CT - X, f. 12, vj. 6,7)

- Qyparis i hollë e i glat / **çë** petk të taksi yt’ at? / - Se ti dhri e drizë e bardhë, / **çë** petk më taksi tata?  
(CT - V, f. 8, vj. 7-10)

- Se ti dhri e drizë e bardhë, / **çë** stoli të taks jot’ emë? / - Kyparis i hollë e i glat, / **çë** stoli më taksi mëma?  
(CT - V, f. 8, vj. 22-25)

E **çë** zëmbërë t’ gurt’ u kam / në i padhëmbëshim po jam?  
(CT - f. 268, CXV, str. 1, vj.3,4)

Këtë fuqí, këtë zëmbërë t’ madhe / kush ja jep? **Çe** rrogë i dhanë?  
(CT - VI, f. 328, str. 5)

## MËSIMI 20M

Mbiemri me kuptim çuditës.



Vëre' !

Çë vajza të bukura çë kemi te Hora!



Çë mik çë kam!

Çë miq të fortë!

Me sa vajza fola prëmë!

Sa miq përpoqa te festat!



Sa vajzave i këndova poezi të bukura!

Sa miqve i dhashë ndihmë!



Çë janë

çë!, sa! ?

*Janë mbiemra me kuptim çuditës* (litisht: aggettivi esclamativi):

- çë! qëndron ashtu si ë;
- edhe sa! ngë ndërron.

## USHTRIME

Kërko te libret arbëreshë ca shembuj me **çë!** e **sa!** e shkruaji këtu poshtë. Kujto se fjalía sos me pikëçuditjen (litisht: il punto esclamativo).



### Ca shembuj letrarë.

**Sa** herë edhe bën këtë famasmë te zëmbra e njeriut!

(FZ – Viti i parë, n. 33, f. 2, sht. 2)

**Çë** hare, **çë** gëzim te zëmbra e asaj mëmë, një ment aqë e helmuame e naní me të birtin të ngjaghur!

(FZ – Viti i parë, n. 33, f. 2, sht. 1)

Oh **çë** thavmasmë!

(CT - LXXXIII, f. 225, str. 6, vj. 1)

**Çë** shërbes i madhi ky!

(CT - LXXXIX, f. 286, str. 2, vj. 1)

Oh **çë** krip të parrëfyem!

(CT - LXXXIX, f. 286, str. 40, vj. 1)

Mbi një qenq **sa** ulq kërcenjën!

Oh **sa** duar **çë** m'e rrëmbenjën!

(CT - XCIV, f. 266, str. 345, vj. 1,2)

**Sa** të keqe atje pësoi

për të vetëmin e 'saj!

(CT - XCVI, f. 271, str. 3, vj.2,3)

Oh **sa** r'ëmbla ditë m' shkuan / nd'anë tyj, o gjella e jime! / Oh **sa** pata ahierna gzime!

(CT - I, f. 316, str. 3)

## MËSIMI 21M

Mbiemri i pacaktuar.

Zglith e vëre' mirë!

*Çdo* (*çëdo*) djalë e *çdo* vajzë vete skolla!



*Çdo* të ngrënë më pëlqen!

*Nga* djalë e *nga* vajzë vete te skolla!

*Ndo* (*ndonjë*) herë kam vatur përjashta.

*Ca* miq e *ca* mike më duan vërtet mirë.

*Disa* herë më duket se ngë jemi miq.

*Gjithë* djemtë e *gjithë* vajzat ka venë te skolla.

Fola me *njetër* (= një *tjetër*) vajzë.

Luajta balunin me *njetër* (= një *tjetër*) mik.



Çë janë

*çdo* o *çëdo*, *nga*, *ndo* o *ndonjë*, *ca*, *disa*, *gjithë*, *njetër* (= një *tjetër*) ?

Janë *mbiemra të pacaktuar* (litisht: aggettivi indefiniti).

“Çdo” e “nga” janë vetëm mbiemra; tjerët mënd të jenë *përemra* kur ngë kanë emrin te ana.

## Mëso:

- *çdo* o *çëdo* ngë ndërron e përdoret vetëm te numri njëjës;
- *nga* ë si *çdo* tek na arbëreshë;
- *ndo* o *ndonjë* ngë ndërron te gjinia e te numri; kur përdorjëm *ndonjë* (= *ndo* + *një*) gjejëm se arbërisht ka lakimin, si për artikullin e pacaktuar "një":  
E. K. një  
Gj. Dh. Rr. njëi

### Shembuj:

Sjellja (litish: il comportamento) e *ndonjëi* djali ngë më pëlqen.  
Sjellja e *ndonjëi* vajzje ngë më pëlqen.

- *ca* ngë ndërron;
- *çilido*, *çilado*: lakohen vetëm "çili-" e "çila-"; -do qëndron si ë (shembuj: çilitdo, çilësdo);
- *disa* ë si *ca*;
- *gjithë* ngë ndërron; edhe *i gjithë*, *e gjithë*, *të gjithë*, *çë* lakohen si mbiemrat cilësorë;

### Shembuj:

*Gjithë* jeta vishet me lule.  
*Gjithë* voshku (pylli) u dogj.  
Shtura *gjithë* të ngrënit.  
*Gjithë* vajzat vanë te skolla.  
*Gjithë* djemtë vanë të luajën.

- *tjetër* vete bashkë me "një" e del kjo lidhje: një+tjetër = njetër.

## USHTRIME

Shkruaj ca shembuj me këta mbiemra të pacaktuar:

*çdo* - \_\_\_\_\_  
*nga* - \_\_\_\_\_  
*ndonjë* - \_\_\_\_\_  
*ca* - \_\_\_\_\_  
*disa* - \_\_\_\_\_

## Ndo shembull letrar

U djekshin pajë edhe **çë-do** stoli...  
(CT- Canti didascalici – f. 68, str. 26/1 )

**Çëdo** mizë ngë bën mjalt.  
(CT- Fjalë të motshëme – f. 88, n. 34)

Mbi **ndo një** muaj, atë e bën dhëndërr ...  
(CT – Novelline popolari – I, f. 353, radha 15)

**Gjithë** ditën e ditës rrij e mejtuar, e **gjithë** natën klaj.  
(CT – Novelline popolari- II, f. 358, radha e sprasme)

Kështu vdiq Dregji e kështu trimi liroi të bukurën e **gjithë** vashazit që ndodheshin të zëna tek ajo shpi e nëmurë.  
(CT – Novelline popolari – XI, f. 445, radha e sprasme)

**Çalo** shtezë ka edhe të vegjëjit e vet; **çëdo** dru qet pemë...  
(CT – Novelline popolari - XIII, f. 459, r. 4, 5)

**Gjithë** gjindëja atëherë deshë për Mbret Farasmënin...  
(CT – Novelline popolari - XY f. 480, r. 3 nga e sprasmja)

...as u largua / prej se **t' cilit do** rrëzik...  
(GS – Dheu – f. 140, vj. 100)

**Kemi njohur**  
*mbiemrat cilësorë*  
*mbiemrat dëftorë,*  
*mbiemrat pronorë,*

... *mbiemrat pyetës,*  
*mbiemrat me kuptim çuditës ...*

... *mbiemrat e pacaktuar ...*

**Për**  
*mbiemrin numëror*  
*vëre' te "Numëroti"!*

## « NUMËRORI »

### MËSIMI 1Nu

Numërorët themelorë.

Vëre' këto shenja:

1    2    3    4    5    6    7    8    9  
10    15    37    50    88    91  
100    335    727  
1492    2001

Çë janë ?

Janë numra!

Te gluha arbëreshe e shqipe numërori ë një pjesë e ligjëratës si *emri*, *mbiemri*, *etj.*



Numrat “1, 2, 3, 4, 5, etj...” thërriten *numërorë themelorë* (litisht: numeri cardinali), përçë janë numrat bazë (shqip: themel > themelor; litisht: base > basilare).



## NUMËRORËT THEMELORË

0 zero	60 gjashtëdhjetë
1 një	61 gjashtëdhjetë e një
2 dy	--
3 tre (mashkullor), tri (femëror)	70 shtatëdhjetë
4 katër	71 shtatëdhjetë e një
5 pesë	--
6 gjashtë	80 tetëdhjetë
7 shtatë	81 tetëdhjetë e një
8 tetë	--
9 nëntë	90 nëntëdhjetë
10 dhjetë	91 nëntëdhjetë e një
11 njëmbëdhjetë	--
12 dymbëdhjetë	100 njëqind
13 trembëdhjetë	101 njëqind e një
14 katërmëdhjetë	--
15 pesëmbëdhjetë	110 njëqind e dhjetë
16 gjashtëmbëdhjetë	111 njëqind e njëmbëdhjetë
17 shtatëmbëdhjetë	--
18 tetëmbëdhjetë	120 njëqind e njëzet
19 nëntëmbëdhjetë	121 njëqind e njëzet e një
20 njëzet	--
21 njëzet e një	130 njëqind e tridhjetë
22 njëzet e dy	131 njëqind e tridhjetë e një
23 njëzet e tre	--
24 njëzet e katër	140 njëqind e dyzet
25 njëzet e pesë	150 njëqind e pesëdhjetë
26 njëzet e gjashtë	160 njëqind e gjashtëdhjetë
27 njëzet e shtatë	170 njëqind e shtatëdhjetë
28 njëzet e tetë	180 njëqind e tetëdhjetë
29 njëzet e nëntë	190 njëqind e nëntëdhjetë
30 tridhjetë	200 dyqind
31 tridhjetë e një	300 treqind
--	400 katërqind
40 dyzet	500 pesëqind
41 dyzet e një	600 gjashtëqind
--	700 shtatëqind
50 pesëdhjetë	800 tetëqind
51 pesëdhjetë e një	900 nëntëqind
--	1.000 një mijë
	10.000 dhjetë mijë
	100.000 njëqind mijë
	1.000.000 një milion
	1.000.000.000 një miliard

- Numërori themelor përdorur si numër ngë ka lakim e gjini.

Shembuj:

**Katër** burra.



**Katër** gra.



- Ndërron gjini vetëm numri “3”: “tre” mashkullor e “tri” femëror.

Shembuj:

**Tre** burra.



**Tri** gra.



- Te *numri njëjës* ndodhet po numërori “një”; te *numri shumës* gjithë tjerët.

- Numërori kur ka prapa një emër shkon te kategoria e mbiemrit.

Shembull:

*Pesë* djem lozjën.

- Kur numërori emërzohet ka gjini e lakime.

Shembuj:

Te fusha i pashë *të dy* (burrat). *Të dya* (*dyja*) (gratë) ishën te kopshti.  
*Të tre* (burrat) vanë te fusha. *Të treve* i dhashë një rrigall (dhuratë).  
*Të tria* (gratë) rrinë te shpia. *Të triave* i dhashë një dhuratë.  
 I (u) fola *të pesëve*. I (u) fola *të pesave*.



Te matematika numrat shkruhen me çifra:

1 2 3 4 5 6 7 ...

Shkruhen me fjalë kur janë brënda njëi shkrimi:

Shembuj:

Bleva 2 bukë. > Bleva *dy* bukë.

Pashë 7 fëmijë. > Pashë *shtatë* fëmijë.

La' Gjergji ka 5 vajza. > La' Gjergji ka *pesë* vajza.

Ja thashë 100 herë. > Ja thashë *njëqind* herë.

Datat (ditët, muajt dhe viti) shkruhen

**kështu:** 15 gusht 2001

**o kështu:** 15/08/2001

**o edhe kështu:** 15.08.2001

Veprimet e matematikës (litisht: le operazioni matematiche), ë mirë t'i thomi me fjalë arbëreshe:

$2 + 2 = 4$     ♦ **dy e dy** bëjnë **katër**  
♦ **dy** shtuar **dy** bëjnë **katër**

$4 - 1 = 3$     ♦ **katër** pa **një** bëjnë **tre**  
♦ **katër** nxjerrë **një** bëjnë **tre**

$2 \times 3 = 6$     ♦ **dy** për **tre** bëjnë **gjashtë**  
♦ **dy** herë **tre** bëjnë **gjashtë**  
♦ **dy** shumëzuar për **tre** bëjnë **gjashtë**

$8 : 2 = 4$     ♦ **tetë** ndajtur për **dy** bëjnë **katër**

Mëso mirë edhe këto:

5% = **pesë për qind**

35% = **tridhjetë e pesë për qind**

10% = **dhjetë për qind**

2% = **dy për qind**

## USHTRIME

1- Shkruaj me fjalë numrat këtu poshtë:

7 _____	8 _____	4 _____	25 _____
9 _____	11 _____	6 _____	43 _____
10 _____	20 _____	27 _____	90 _____
14 _____	5 _____	15 _____	105 _____
33 _____	23 _____	29 _____	201 _____
16 _____	37 _____	41 _____	19 _____
49 _____	28 _____	32 _____	88 _____

2 - Shkruaj me çifra numrat që ndodhen me fjalë:

dy _____	një _____
dymbëdhjetë _____	njëzet e një _____
tre _____	tetëmbëdhjetë _____
shtatëmbëdhjetë _____	nëntëmbëdhjetë _____
tridhjetë _____	tridhjetë e gjashtë _____
pesëdhjetë _____	pesëdhjetë e një _____
katër _____	katërmëdhjetë _____

3 - Shkruaj me fjalë këta veprime:

$2 + 5 = 7$	_____
$3 + 5 = 8$	_____
$4 - 2 = 2$	_____
$9 - 4 = 5$	_____
$3 \times 6 = 18$	_____
$4 \times 4 = 16$	_____
$10 : 2 = 5$	_____
$21 : 3 = 7$	_____

4 - Shkruaj me fjalë këto përqindje:

25% = _____	32% _____
18% = _____	41% _____
50% = _____	39% _____
60% = _____	100% _____

# ORËT

Shihemi njetër  $\frac{1}{2}$  ore. > Shihemi njetër *gjymsë* ore.



## Çë her' ë ?

### ORËT SI THUHEN SOT

### SI MËND T' ISH MIRË TË THUHESHIN

12 e 5	<b>i dudhiçi e çinku</b>	dymbëdhjet' e pesë
12 e 10	<b>i dudhiçi e dheçi</b>	dymbëdhjet' e dhjetë
12 e 15	<b>i dudhiçi e un kuartu</b>	dymbëdhjet' e një çerek
12 e 20	<b>i dudhiçi e vinti</b>	dymbëdhjetë e njëzet
12 e 25	<b>i dudhiçi e vintiçinku</b>	dymbëdhjetë e njëzet e pesë
12 e 30	<b>i dudhiçi e menca</b>	dymbëdhjet' e gjymsë
12 e 35	<b>i dudhiçi e trentaçinku</b>	dymbëdhjetë e tridhjet' e pesë
12 e 40	<b>l'una menu vinti</b>	një pa njëzet
12 e 45	<b>l'una men' un kuartu</b>	një pa një çerek
12 e 50	<b>l'una menu dheçi</b>	një pa dhjetë
12 e 55	<b>l'una menu çinku</b>	një pa pesë
13 / 01	<b>l'una di pomerixhu / l'una di noti</b>	një ditën / një natën
14 / 02	<b>i dui di pomerixhu / i dui di noti</b>	dy pas-ngrëni / dy natën
15 / 03	<b>i tri di pomerixhu / i tri di noti</b>	tre pas-ngrëni / tri natën
16 / 04	<b>i patru di pomerixhu / ... di noti</b>	katër pas-ngrëni / ... natën
17 / 05	<b>i çinku di pomerixhu / ... di matina</b>	pesë pas-ngrëni / ... menatnet
18 / 06	<b>i sei di pomerixhu / i sei di matina</b>	gjashtë pas-ngrëni / ... menatnet
19 / 07	<b>i seti di sira / i seti di matina</b>	shtatë mbrëmanet / ... menatnet
20 / 08	<b>l'otu di sira / l'otu di matina</b>	tetë mbrëmanet / ... menatnet
21 / 09	<b>i novi di sira / i novi di matina</b>	nëntë mbrëmanet / ... menatnet
22 / 10	<b>i dheçi di noti / ... di matina</b>	dhjetë natën / dhjetë menatnet
23 / 11	<b>l'undiçi di noti / ... di matina</b>	njëmbëdhjetë natën / ... menatnet
24 / 12	<b>mencanoti / i dudhiçi</b>	mesnata / mesdita

një kuart  
menc' ura

një çerek  
gjyms' ore

## USHTRIME

1 – Prir arbërisht oraret që të ana gjen shkruar si i thomi sot, tuke vërejtur shembujt të “orët”.

### MBAJ MEND SE

**di matina** = menatnet

**di sira** = mbrëmanet

**te llarba** = kur bën (bëri) égjëll, kur bën ndriçull, kur gdhihet, kur u gdhi.

**di pomerixhu** = pas-ngrëni

**di noti** = natën

1 – Ai tri di noti vate përjashta.

2 – Dolli ai dui di pomerixhu.

3 – Te festa i vamë di sira.

4 – Te llarba vate të shërbej.

1 - Te ora tre të natës vate përjashta

2 - \_\_\_\_\_

3 - \_\_\_\_\_

4 - \_\_\_\_\_

2 – Shkruaj me fjalë orët e minutet këtu poshtë me numra:

01,10 = \_\_\_\_\_

03,15 = \_\_\_\_\_

05,40 = \_\_\_\_\_

07,09 = \_\_\_\_\_

09,16 = \_\_\_\_\_

11,53 = \_\_\_\_\_

13,07 = \_\_\_\_\_

15,21 = \_\_\_\_\_

17,22 = \_\_\_\_\_

19,29 = \_\_\_\_\_

21,41 = \_\_\_\_\_

23,34 = \_\_\_\_\_

02,25 \_\_\_\_\_

04,37 \_\_\_\_\_

06,11 \_\_\_\_\_

08,24 \_\_\_\_\_

10,39 \_\_\_\_\_

12,05 \_\_\_\_\_

14,33 \_\_\_\_\_


16,04 \_\_\_\_\_

18,12 \_\_\_\_\_

20,18 \_\_\_\_\_

22,02 \_\_\_\_\_

24,01 \_\_\_\_\_



**Numrat e delmerit!**



## Shembuj letrarë.

Vurava një qind e pesdhjet, / gjith burra si jeshë vet.  
(NF – Codice – f. 66, II, vj. 14, 15)

Sa e vogëlë ish molla / aqë të madhe hje më bëri / sa t' më rrin **dizet** Bularë / me të gjith  
Bularesha.  
(NF – Codice – f. 75, XIII, vj. 1/5)

Ti e zgledhura gjith / ndër **qind** edhe ndër **milë** / siri tënd si një zhiļj / i prier mbi dhe.  
(NF – Codice – f. 131, XXII, vj., 205/208)

Nga këta Gjige numëronen **katrëmbëdhjetë**  
(FZ – Viti i katrët - 28 të shkurturit 1915, n. 2, f. 3, sht. 2, r. 15, 16)

Mundësor, mbi **dizet** ditë, / te Parrajsi Krishti u ngjit...  
(CS – Shenjet e Rruazarit – f. 4, vj. 7)

Kostantini i vogëlthi / po **tri** ditë dhëndërr kle. / Perënduarë ato **tri** ditë / i jersh fjalë e  
rregjit t' Naplit...  
(CT – XXIV – f. 34, vj. 1,7)

...kur sosi **nëndë** vjetë...  
(CT – XXV – f. 40, vj. 4)

**Gjashtë e gjashtë dymëdhjetë**, / Doruntina e tremëdhjetëtë.  
(CT – XXVI – f. 44, vj. 1,2)

Si një trim ç' u zgjua nga gjumi / mbi **tri** ditë u ngjall i lumi.  
(CT – Canti Sacri – f. 126, str. 11, vj. 1, 2)

Dhelpra ka **nëndë-dhjetë e nëndë** dredhí, po i duhet edhe **një**, të ket **një qint**.  
(CT – Fjalë të motshëme – f. 94, 129)

Një herë e një herë ish një njeri shumë i qosëm, që kish **tre** bij.  
(CT – Novelline popolari – f. 475, XV, r. 1, 2)

Kur i jati vdiq e zgloodhën dhjåtën e tij, **dy** vëllezërit e mëdhenj ndajtrin petkun...  
(CT – Novelline popolari – f. 476, XV, r. 9, 10)

Më para ke t'urdhërosh t'i japjën zjarr një furri këlqerëje, për **shtat** ditë e **shtatë** netë...  
(CT – Novelline popolari – f. 480, XV, r. 6/8)

Si një helmë i hollë e i mpshehët / te **të shtatat** fletë t' shpyrtit / hyn kadalë e i zë të tëra...  
(Dheu – K. IV - f. 134, vj. 7/9)

## MËSIMI 2Nu

Numërorët rreshtorë.

E vëre':




Gjergji arruri *i pari*.

*E treta* e fteta! – thotë proverbi antik.

Mara ë *e pesta* te të bijtë e la' Gjergjit.

*Të parës* i nget një rrigall (dhuratë)!

*Të pesëmbëdhjetit* ngë i nget gjë!



Çë janë

i pari, e treta, e pesta, të parës, të pesëmbëdhjetit?

Janë numërorë rreshtorë (litisht: **numeri ordinali**).

Numërorët rreshtorë kur kanë te ana emrin janë mbiemra.

Shembuj:

*E para* herë çë pashë vulkanin Etna kle vjet.

*Të parat* ditë të skollës janë më të bukurat.

*I katërti* atlet ngë mori medhalje.

E mënd të emërzohen.

Shembuj:

*I katërti* e *i pesti* ngë patën medhalje.



## NUMERORËT RRESHTORË

1-ë	i, e parë (= i parë, e parë)	60-ë	i, e gjashtëdhjetë
2-ë	i, e dytë	61-ë	i, e gjashtëdhjetenjëjtë
3-ë	i, e tretë	---	---
4-ë	i, e katërt	70-ë	i, e shtatëdhjetë
5-ë	i, e pestë	71-ë	i, e shtaëdhjetenjëjtë
6-ë	i, e gjashtë	---	---
7-ë	i, e shtatë	80-ë	i, e tetëdhjetë
8-ë	i, e tetë	81-ë	i, e tetëdhjetenjëjtë
9-ë	i, e nëntë	---	---
10-ë	i, e dhjetë	90-ë	i, e nëntëdhjetë
---	---	91-ë	i, e nëntëdhjetenjëjtë
---	---	---	---
11-ë	i, e njëmbëdhjetë	100-ë	i, e njëqindtë
12-ë	i, e dymbëdhjetë	101-ë	i, e njëqindnëntë
13-ë	i, e trembëdhjetë	102-ë	i, e njëqindedytë
14-ë	i, e katërmëdhjetë	---	---
15-ë	i, e pesëmbëdhjetë	110-ë	i, e njëqinddhjetë
16-ë	i, e gjashtëmbëdhjetë	111-ë	i, e njëqindnjëmbëdhjetë
17-ë	i, e shtatëmbëdhjetë	---	---
18-ë	i, e tetëmbëdhjetë	300-ë	i, e treqindtë
19-ë	i, e nëntëmbëdhjetë	---	---
20-ë	i, e njëzetë	400-ë	i, e katërqindtë
---	---	---	---
21-ë	i, e njëzetnëntë	500-ë	i, e pesëqindtë
22-ë	i, e njëzetedytë	---	---
23-ë	i, e njëzetetretë	900-ë	i, e nëntëqindtë
24-ë	i, e njëzetekatërt	---	---
25-ë	i, e njëzetepesë	1.000-ë	i, e njëmijë
26-ë	i, e njëzetegjashtë	---	---
27-ë	i, e njëzeteshtatë	10.000-ë	i, e dhjetëmijë
28-ë	i, e njëzetetetë	---	---
29-ë	i, e njëzetnëntë	20.000-ë	i, e njëzetmijë
30-ë	i, e tridhjetë	---	---
---	---	100.000-ë	i, e njëqindmijë
31-ë	i, e tridhjetenjëjtë	---	---
---	---	1.000.000-ë	i, e njëmiliontë
40-ë	i, e dyzetë	---	---
41-ë	i, e dyzetnëntë	1.000.000.000-ë	i, e njëmiliardtë
---	---	---	---
50-ë	i, e pesëdhjetë	---	---
51-ë	i, e pesëdhjetenjëjtë	---	---
---	---	---	---

**1.000.000.000-ë > i, e njëmiliardtë !!!**

## USHTRIME

I - Mblo (plotëso) tabelat me numërorët rreshtorë, tuke vërejtur shembujt më sipër:

nga 31: njera te 40:

i tridhjetenjëjtë

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

i dyzetë

nga 41: njera te 50:

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

nga 61: njera te 70:

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

nga 91: njera te 100:

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

I pari !



## THYESAT

Mëso naní si thuhen ca shprehje të matematikës, ca “thyesa” (litishit: frazioni), ku hyjën numërorë themelorë e numërorë rreshtorë.

Sa pjesë të kësaj kasatje



qëndruan?


$$\frac{1}{2} = \text{një e dytë}$$




$$\frac{2}{3} = \text{dy të treta}$$



$$\frac{3}{4} = \text{tri të katërta}$$



$$\frac{5}{8} = \text{pesë të teta}$$



$$\frac{6}{12} = \text{gjashtë të dymbëdhjeta}$$



$$\frac{1}{4} = \text{një e katërt}$$



## USHTRIME

Shkruaj me fjalë thyesat këtu poshtë:

$$\frac{2}{4} = \underline{\hspace{4cm}}$$

$$\frac{2}{8} = \underline{\hspace{4cm}}$$

$$\frac{4}{5} = \underline{\hspace{4cm}}$$

$$\frac{4}{10} = \underline{\hspace{4cm}}$$

$$\frac{7}{12} = \underline{\hspace{4cm}}$$

$$\frac{8}{16} = \underline{\hspace{4cm}}$$



### Ca shembuj letrarë me numërorët rreshtorë.

Kush-do shërbeu çë tek **e para** orë, marshit rrogën çë i nget. Kush-do jerdhi pas **të tretës** orë, sot me gzim le të krëmptonjë tue u falur nderjes. Kush-do arruri pas **të gjashtës** orë, mos paçit ndërdie, pse edhe ngë do t' ket dëm. Kush-do u lips njera tek **e nëndëta** orë , le të qaset pa dre. Kush-do jerdhi vetëm tek **e njëmbëdhjetëta** orë , mos të trëmbet...  
(FZ – Viti **i parë** - 7 të prighit 1912, n. 7, f. 2, sht. 1, r. 9/19)

Kostantini i vogëlthi / po tri ditë dhëndërr kle. / Perënduarë ato tri ditë / i jersh fjalë e rregjit t' Naplit... / Ish **e treta** ç'i dërgoj, / ish **e treta** te tri ditë.  
(CT –XXIV – f. 34, **VI**, 1,7)

Gjashtë e gjashtë dymëdhjetë, / Doruntina **e tremëdhjetëtë**.  
(CT –XXVI – f. 44, **VI**, 1,2)

**E treta** e vërteta; / i Mallkuami te galëta.  
(CT – Fjalë të motshëme – f. 95, n. 144)

Tha **e dyta**: - U i jap pushtetin të ndërronet në sqyftër, kur t'i teket.  
E **e treta**: - U i fal zotësin të shndërronet në drangua...  
(CT – Novelline popolari – f. 440, **XI**, r. 8,11)

U pruar tek **i dyjti**, edhe ai ju përgjeq...  
(CT – Novelline popolari – f. 475, **XV**, r. 13)

Nun **i parë** i kurorës kle plaku...  
(CT – Novelline popolari – f. 480, **XV**, e sprasmja)

## « PËREMRI »

### MËSIMI 1P

Përemri: njohuri të përgjithshme.

Zglith këto fjali:

*U, ti, ai* e *ajo* jemi miq.

*Na* jo, po *ju* e *ata* jini gjiri.

*Kush* do t' vinj me *mua*?

*Akëcili më* tha se *ti* je i mirë.

*Kush t' e* tha? *M' e* tha Ndrica.

*T' e* tha *tyj* o *ia* tha *atij*?

*Mosnjeri e* di!



Çë janë

*u, ti, ai, ajo, na, ju, ata, kush, mua, akëcili, më, kush, t' e, m' e, tyj, ia, atij, mosnjeri, e?*

Janë përemra!

Përemri, si thotë fjala për + emër ë ajo pjesë e ndërrueshme e ligjëratës që vuhet te vendi i emrave, sa këta të mos përsëriten (rripitiren) shumë herë me disarmoni të fjalimevet (diskursevet) që bëjëm.

Shembuj me **emrat**:

**Marku** ë djalë i butë; **Marku** vete ngaditë te skolla.

**Buka** më pëlqen; **buka** e Horës më pëlqen më shumë.

e me **përemrat**:

**Marku** ë djalë i butë; **ai** vete ngaditë te skolla.

**Buka** më pëlqen; **ajo** e Horës më pëlqen më shumë.



Si shihet, shket më mirë fjalia me përemrat se ajo që përsërit emrat.

**Këta janë përemrat arbërisht:**

**Përemri vetor**

(litisht: pronome personale)

u, ti, ai, ajo, na, ju, ata, më, të ...



**Përemri dëftor**

(litisht: pronome dimostrativo)

ky, ai...



**Përemri pronor**

(litisht: pronome possessivo)

jimi, jyti, i tiji, i saji...



**Përemri lidhor**

(litisht: pronome relativo o congiuntivo)

çë, i çili, kush ...



**Përemri pyetës e  
përemri me kuptim çuditës**

(litisht: pronome interrogativo  
e pronome esclamativo)

kush? çë? sa?

kush! çë! sa!



**Përemri i pacaktuar**

(litisht: pronome indefinito)

ca, mosnjeri ...



## MËSIMI 2P

Përemri vetor: veta e parë.

### VETA E PARË

Zglith e vëre’.

*U* jam i butë.

*Na* jemi të butë.



Çë janë

*u, na?*

Janë *përemra vetorë të vetës së parë* (litisht: pronomi personali di prima persona) njëjës e shumës.

E çë vje’ më thënë *të vetës së parë*? Vje’ më thënë se kemi përpara *njeriun* çë *flet* te njëjësi: “*u*”  
e *njerëzit* çë *flasjën* te shumësi: “*na*”.

E nani:

*Mua më* nget të loz.  
Marku *më* huajti biçikletën.  
Për *mua* mënd t’ nisesh.  
Mara rri ndanëz *meje*.



*Neve na* nget të lozjëm.  
Marku *na* huajti biçikletën.  
Për *ne* mënd t’ nisesh.  
Mara rri ndanëz *nesh*.



**Format**

*mua, më*, (për) *mua*, (ndanëz) *meje*, *neve, na*, (për) *ne*, (ndanëz) *nesh*  
na thonë se *përemri vetor i vetës së parë* ka lakimin:

## VETA I

E.	Njëjës u (shqip: unë)	Shumës na (shqip: ne)
Gj.	-	-
Dh.	mua, më	neve, na
K.	mua, më	ne, na
Rr.	meje	nesh

**Arbërisht e shqip te veta e parë lipset rasa gjinore.** Megjithatë, Arbëreshët sot te gluha e përditshme, tuke gabuar (litisht: sbagliando), përdorjën *rasën gjinore* “të mua, të neve” në vend të *mbiemrit pronor*.

Kush njih gluhën, thotë mirë për shembull:

“Djali *jim* vete te skolla”

**e jo**

“Djali *të mua* vete te skolla”!



“Vajza *jime* vete te skolla”

**e jo**

“Vajza *të mua* vete te skolla”!

“Djali *ynë* vete te skolla”

**e jo**

“Djali *të neve* vete te skolla”!



“Vajza *jonë* vete te skolla”

**e jo**

“Vajza *të neve* vete te skolla”!

**Veta e parë e përemrit vetor ngë e ka *rasën gjinore* !**

### Mëso mirë:

Te rasat dhanore e kallëzore gjen edhe “ *më* ” e “ *na* ”.

Çë janë?

Janë *format e shkurttra* të përemrit vetor të vetës së parë.

Vëre’ si përdoren: *Mua më* nget të loz.

Marku *më* huajti biçikletën.

*Neve na* nget të lozjëm.

Marku *na* huajti biçikletën.

### Përemri vetvetor “*vetë o vet*”

*Veta e parë e përemrit vetor mënd të ketë bashkë përemrin vetvetor* (litisht: riflessivo) “*vetë*” (litisht: stesso), çë ndodhet po te të shkruamet.

Shembuj: *U vetë* e stisa atë shpi.

*Na vetë* e njohëm kush ë.



## MËSIMI 3P

Përemri vetor: veta e dytë.

### VEVA E DYTË


Zglith e vëre'.

*Ti* je i butë.

*Ju* jini të butë.

Çë janë

*ti, ju?*



Janë *përemra vetorë të vetës së dytë* (litisht: pronomi personal di seconda persona) njëjës e shumës.

E çë vje' më thënë të vetës së dytë? Vje' më thënë se kemi përpara *njeriun me të çilin flitet* te njëjësi: " *ti* "

e *njerëzit me të çilët flitet* te shumësi: " *ju* "

Nani vëre':

*Ty* të nget të luash.

Marku *të* huajti biçikletën.

Për *ty* mënd t' nisem.

Sara rri ndanëz *teje*.



*Juve* *ju* nget të luani.

Marku *ju* huajti biçikletën.

Për *ju* mënd t' nisem.

Mara rri ndanëz *jush*.



#### Format

*tyj, të, (për) tyj, (ndanëz) teje, juve, ju, (për) ju, (ndanëz) jush*  
na thonë se *përemri vetor i vetës së dytë* ka lakimin:

## VETA II

	Njëjës	Shumës
E.	ti	ju
Gj.	-	-
Dh.	tyj (shqip: ty), të	juve, ju
K.	tyj (shqip: ty), të	ju, ju
Rr.	teje	jush

**Arbërisht, si te veta e parë, edhe te veta e dytë lipset rasa gjinore.** Edhe këtu Arbëreshët sot, duke gabuar, përdorjën *rasën gjinore* "të tyj" e "të juve", në vend të *mbiemrit pronor*. Kush njihë gluhën thotë mirë:

"Djali *jyt* vete te skolla"

**e jo**

"Djali *të tyj* vete te skolla"!

"Vajza *jote* vete te skolla"

**e jo**

"Vajza *të tyj* vete te skolla"!

"Djali *jij* vete te skolla"

**e jo**

"Djali *të juve* vete te skolla"!

"Vajza *juaj* vete te skolla"

**e jo**

"Vajza *të juve* vete te skolla"!

**Veta e dytë e përemrit vetor ngë e ka *rasën gjinore* !**

### Mëso mirë:

Te rasat dhanore e kallëzore gjen edhe " të " e " ju ".

Çë janë?

Janë *format e shkurtra* të përemrit vetor të vetës së dytë.

Vëre' si përdoren: *Tyj të* nget të luash.

Marku *të* huajti biçikletën.

*Juve ju* nget të luani.

Marku *ju* huajti biçikletën.

#### Përemri vetvetor "vetë o vet"

Si *veta e parë*, edhe *veta e dytë* e përemrit vetor mënd të ketë bashkë përemrin vetvetor "vetë", çë ndodhet po te të shkruamet.

Shembuj: **Ti vetë** e stise atë shpi.

**Ju vetë** e njohët kush ë.

## MËSIMI 4P

Përemri vetori: veta e tretë.

### VETA E TRETË

Zglith e vëre’.

*Ai* ë i butë?

*Atá* janë të butë?



*Ajó* ë e butë.  
*Ató* janë të buta.



Ai, ata, ajo, ato çë janë?

Janë *përemra vetorë të vetës së tretë* (litisht: pronomi personali di terza persona) njëjës e shumës, mashkullore e femërore.

E çë vje’ më thënë të vetës së tretë? Vje’ më thënë se kemi përpara *njeriun për të çilin flitet* te njëjësi: “ ai, ajo ”

e *njerëzit për të çilët flitet* te shumësi: “ ata, ato ”.

**E vëre’:**

Djali i *atij* vete te skolla.

Vajza e *atij* vete te skolla.

*Atij i* nget të lozënj.

Marku *i* huajti biçikletën Vitot.

Për *atë* (burrë) mënd të veç ku do.

*Atë* (burrë) *e* pashë dje.

Mara rri ndanëz *atij*.

Gratë e *atyre* (burrave) janë mike.

*Atyre* (djemve) *i* (*u*) nget të lozjën.

Marku *i* (*u*) huajti biçikletën miqvet.

Për *ata* mënd t’ nisesh.

*Ata i* pashë dje.

Mara jec përpara *atyre* (djemve).



Çë janë

*i atij, e atij, atij, i, (për) atë, e, (ndanëz) atij, i atyre, (për) ata, (ndanëz) atyre?*

Janë forma të lakimit *mashkullor* të përemrit vetor të vetës së tretë.

Këtu kemi tabelen.

### VETA III MASHKULLORE

	Njëjës	Shumës
E.	ai	ata
Gj.	(i, e, të) atij	(i, e, te) atyre
Dh.	atij, i	atyre, i (u)
K.	atë, e	ata, i
Rr.	atij	atyre

Mëso mirë:

Te rasa dhanore gjen “i” te njëjësi e “i” (shqip: “u”) te shumësi; te rasa kallëzore gjen “e” te njëjësi e “i” te shumësi.

Ato janë *format e shkurtra* të përemrit vetor të vetës së tretë *mashkullore*.

Vëre’ si përdoren:

*Atij i* nget të lozënj.

Marku *i* huajti biçikleten.

*Atyre i (u)* nget të lozjën.

Marku *i (u)* huajti biçikletën *atyre*.

Arbërisht gjejëm edhe formën “*atyreve*”.



## Nani vëre':

Djali i *asaj* vete te skolla.  
Vajza e *asaj* vete te skolla.  
*Asaj i* nget të lozënj.  
Marku *i* huajti biçikleten Sarës.  
Për *atë* (vajzë) mënd t' nisesh.  
*Atë* (vajzë) *e* pashë dje.  
Mara rri ndanëz *asaj*.



Burrat e *atyre* (grave) janë miq.  
*Atyre* (vajzave) *i* (*u*) nget të lozjën.  
Marku *i* (*u*) huajti biçikletën mikevet.  
Për *ato* mënd t' nisesh.  
*Ato i* pashë dje.  
Mara rri ndanëz *atyre* (vajzave).



## Çë janë

*i asaj, e asaj, asaj, i, (për) atë, e, (ndanëz) asaj, i atyre, (për) ato, (ndanëz) atyre?*

Janë forma të lakimit *femëror* të përemrit vetor të vetës së tretë.

## VETA III FEMËRORE

	Njëjës	Shumës
E.	ajo	ato
Gj.	(i, e, të) <i>asaj</i>	(i, e, të) <i>atyre</i>
Dh.	<i>asaj, i</i>	<i>atyre, i (u)</i>
K.	<i>atë, e</i>	<i>ato, i</i>
Rr.	<i>asaj</i>	<i>atyre</i>

## Mëso mirë:

Te rasa dhanore gjen "i" te njëjësi e "i" (shqip: "u") te shumësi; te rasa kallëzore gjen "e" te njëjësi e "i" te shumësi. Ato janë *format e shkurtra të përemrit vetor të vetës së tretë femërore*.

Vëre' si përdoren:

*Asaj i* nget të lozënj.

Marku *i* huajti biçikletën Sarës.

*Atyre i (u)* nget të lozjën.

Marku *i (u)* huajti biçikletën *atyre*.

## SHËNIME.

● Te rasa kallëzore, veta e tretë ka edhe:

- formën e ngushtë “të” për njëjës mashkullor e femëror;

Shembuj:

Gjithë këto i bëra për **të** (= atë).

- formën e ngushtë “ta” për shumës mashkullor;

Shembuj:

Gjithë këto i bëra për **ta** (= ata).

- formën e ngushtë “to” për shumës femëror;

Shembuj:

Gjithë këto i bëra për **to** (= ato).

Këto forma këtu sipër i gjejëm shkruar te libret arbëreshë e jo të thëna te gluhja e folur sot, te ku qëndrojnë ashtu si janë: Gjithë këto i bëra për **ato**.

### Përemri “vetë o vet”

Si *veta e parë* e si *veta e dytë*,  
edhe *veta e tretë* e përemrit vetor  
mënd të ketë bashkë përemrin vetvetor “vetë”,  
çë ndodhet po te të shkruamet.

“Vet” mënd t’ rrie edhe vetëm o bashkë me një emër.

Shembuj: **Ai vetë** e stisi atë shpi.

**Ata vetë** e njohën kush ë.

**Vet** Marku e njeh kush ë.

Sara **vet** e njeh kush ë.

**Vet** e njeh kush ë.

## VETA III ASNJANËSE

Zglith.

**Atá** (të ngrënë) ë të mirë.

**Ató** (të ngrëna) janë të mira.



Përemri vetor ka gjininë asnjane vetëm te veta e tretë.  
Këtu kemi tabelen.

	Njëjës	Shumës
E.	atá	ato
Gj.	(i, e, të) atij	(i, e, te) atyre
Dh.	atij, i	atyre, i (u)
K.	atá, e	ato, i
Rr.	atij	atyre



### USHTRIME ME PËREMRRAT VETORË.

Thuaj çila ë veta e këtyre përemrave këtu poshtë, tuke bëre një vijë çë i lidh me kaselen çë i nget.



## Ca shembuj letrarë me përemrat vetorë.

E i ligjiruan fjalën e t'in Zoti **atij** e gjithë **atireve** që ishën te shpia e 'tijë. E tek ajo herë natën i mori me **'të** e i lajti lavomët e kle pagëzuar **ai** edhe gjithë të 'tijët te një ment.

(FZ – Viti i katërt 9 të majit 1915, n. 12, f. 3, sht. 1, r. 8/12)

“E thoshjën ndër **'to**: kush mënt t'na nxierënj gurin nka dera e varrit?”

(FZ – Viti i parë, n. 7 – 7 të prillit 1912 – f. 1, sht. 1)

“**Ai** i thot **atire**: Mos trëmbij: **ju** kërkoni Jisuin Nazarenin...: **Ai** u ngre, ngë isht këtu...”

(FZ – Viti i parë, n. 7 – 7 të prillit 1912 – f. 1, sht. 1,2)

“**Ai** mori e i tha...”

(FZ – Viti i parë, n. 7 – 7 të prillit 1912 – f. 4, sht. 2)

**Atij** e **tyj** u jipem

I 'tiji e i jyti jam;

Mbi mua po **juve** kam.

**Ti** e zonja, i zoti **ai**.

(CT – Canti sacri, XXXVIII, f. 166, str. 9)

Besë u kam te i madhi yn' Zot.

Kloft ashtu si ai po thot!

E ashtu kloft si **vet** dhe dua,

shoqe tënde të m' kesh mua!

(CT – Novelline popolari, 1 – f. 353, r. 4 nga e sprasmja)



## MËSIMI 5P

Përemrat vetorë: format e shkurtra të bashkuara.

Si shkruhen  
format e shkurtra të përemrave vetorë  
kur përpiqen te ligjërata?

Zglith mirë e vëre’.

Biçikletën *m’e* huajti Marku.  
Kush *t’e* huajti biçikletën?  
Biçikletën *ia* huajti Marku.



Biçikletën *na e* huajti Marku.  
Kush *jue* huajti biçikletën?  
Biçikletën *ia (ua)* huajti Marku.



Çë janë përemrat shkruar me gërma korsive?  
Janë format e shkurtra të bashkuara të përemrave vetorë.

Arbërisht format e shkurtra të përemrave vetorë të vetës së parë, të dytë e të tretë, çë ndodhen te rasa dhanore, kur përpiqen me format e shkurtra të vetës së tretë njëjës, çë ndodhet te rasa kallëzore, shkruhen kështu:

më + e = *m’e*

na + e = *na e*

të + e = *t’e*

ju + e = *jue*

i + e = *ia*

i (u) + e = *ia (ua)*

E zgjidh nani këto:

Biçikletat *m'i* huajti Marku.

Kush *t'i* huajti biçikletat?

Biçikletat *ia* huajti Marku.



Biçikletat *na i* huajti Marku.

Kush *ju i* huajti biçikletat?

Biçikletat *ia (ua)* huajti Marku.



Përemrat vetorë të vetës së parë, të dytë e të tretë, që ndodhen te rasa dhanore, kur përpiqen me format e shkurtura të vetës së tretë shumës, që ndodhet te rasa kallëzore, shkruhen kështu:

më + i = *m'i*

na + i = *na i*

të + i = *t'i*

ju + i = *ju i*

i + i = *ia*

i (u) + i = *ia (ua)*

### SHËNIM

Te gluha e sotme shqipe

*format e shkurtra*

i gjejëm kështu

kur përpiqen ndër to:

më + e = *ma*

na + e = *na e*

të + e = *ta*

ju + e = *jua*

i + e = *ia*

u + e = *ua*

e kështu:

më + i = *m'i*

na + i = *na i*

të + i = *t'i*

ju + i = *jua*

i + i = *ia*

u + i = *ua*

## Çë vjen më thënë ?!

			... + e		
më + e =	mua + atë =	<b>m'e</b>	<b>Shembuj:</b>	<i>M'e</i> dha lulen.	
të + e =	tyj + atë =	<b>t'e</b>		<i>T'e</i> dha lulen.	
i + e =	atij + atë =	<b>ia</b>		<i>Ia</i> dha lulen.	
i + e =	asaj + atë =	<b>ia</b>		<i>Ia</i> dha lulen.	
na + e =	neve + atë =	<b>na e</b>		<i>Na e</i> dha lulen.	
ju + e =	juve + atë =	<b>ju e</b>		<i>Ju e</i> dha lulen.	
i (u) + e =	atyre + atë =	<b>ia (ua)</b>		<i>Ia (ua)</i> dha lulen.	

			... + i		
më + i =	mua + ata, ato =	<b>m'i</b>	<b>Shembuj:</b>	<i>M'i</i> dha lulet.	
të + i =	tyj + ata, ato =	<b>t'i</b>		<i>T'i</i> dha lulet.	
i + i =	atij + ata, ato =	<b>ia</b>		<i>Ia</i> dha lulet.	
i + i =	asaj + ata, ato =	<b>ia</b>		<i>Ia</i> dha lulet.	
na + i =	neve + ata, ato =	<b>na i</b>		<i>Na i</i> dha lulet.	
ju + i =	juve + ata, ato =	<b>ju i</b>		<i>Ju i</i> dha lulet.	
i (u) + i =	atyre + ata, ato =	<b>ia (ua)</b>		<i>Ia (ua)</i> dha lulet.	



### USHTRIME

Vër format e shkurtra te vendi i përemraveve vetore që gjen shkruar.

- 1 – Marku *atyre ata* dha balunet.
- 2 – Sara *asaj atë* huajti biçikletën.
- 3 – Gjergji *neve atë* dha balunin.
- 4 – Vito *tyj ato* huajti lapset?
- 5 – Mara *juve atë* shkoi ushtrimin!

- 1 – Marku \_\_\_\_\_ dha balunet.
- 2 – Sara \_\_\_\_\_ huajti biçikletën.
- 3 – Gjergji \_\_\_\_\_ dha balunin.
- 4 – Vito \_\_\_\_\_ huajti lapset?
- 5 – Mara \_\_\_\_\_ shkoi ushtrimin!

### Shembull letrar

Ajo **j**-u përgjey: - Mosnjeri **m'e** mësoi mua; po kleva u çë **t'e** mësova tyj...  
(CT – Novelline popolari – f. 364, r. 14, 15)

## MËSIMI 6P

Përemrat dëftorë "ky, kjo, këta".



Zglith e vëre'

I prura librin Markut, po *ky* ngë do t'e zgledhënj.

I prura librin Sarës, po *kjo* ngë do t'e zgledhënj.

Më pëlqen të ngrënit, por *këta* jo.

Qeni jim leh shumë, *ky* i *këtyre* leh pak.



Çë janë

*ky, kjo, këta, këtyre* ?

Janë *përemra dëftorë* (litisht: pronomi demonstrativi), çë na thonë se një njeri, një kafshë o një shërbes, vendin e të çilëvet e merr përemri dëftor, janë *ndanëz* atij çë flet e atij çë gjegjet.

Tabelet e lakimit janë këto:

**ky**  
*mashkullor*

	Njëjës	Shumës
E.	ky	këta
Gj.	(i, e, të) këtij	(i, e, të) këtyre*
Dh.	këtij	këtyre*
K.	këtë	këta
Rr.	këtij	këtyre*

\* Arbërisht kemi edhe: këtyreve (vëre' te shembujt letrarë).

**kjo**  
*femëror*

	Njëjës
E.	kjo
Gj.	(i, e, të) kësaj
Dh.	kësaj
K.	këtë
Rr.	kësaj

	Shumës
	këto
(i, e, të)	këtyre*
	këtyre*
	këto
	këtyre*

\* Edhe: këtyreve (vëre' te shembujt letrarë).

**këta**  
*asnjans*

	Njëjës
E.	këta
Gj.	(i, e, të) këtij
Dh.	këtij
K.	këta
Rr.	këtij

	Shumës
	këta
(i, e, të)	këtyre*
	këtyre*
	këta
	këtyre*

\* Edhe: këtyreve (vëre' te shembujt letrarë).



## USHTRIME

Kërko te libret arbëreshë ca shembuj me përemrat dëftorë “ky”, “kjo” e “këta” e shkruaji këtu poshtë, tuke thënë nga çili libër, faqe e radhë i nxore.

---

---

---

---

---

---

### Shembuj letrarë

**Ktireve** edhe (lisúi) ... bë r'e shihjën të gjallë...  
(FZ - Viti i parë - 7 të prigit 1912, n. 7 - f. 4, sht. 1, r. 24)

Kur ishëj hera të çilej lufta ndër Israelitë e Filistenjë nga godhët e **këtireve** dolli një burrë që i thoshjën Goliath...  
(FZ - Viti i katrët - 9 të mait 1915, n. 12 - f. 3, sht. 1 - Dhiata e vjetër)

## Nani vëre':

Edhe sot, te të folurit tanë të përditshëm, na qëndruan këto forma të përemrit dëftor: “**këshije**, **këshoje**” (litish: di questa fatta, di tale fatta), që na përdorjëm vetëm te rasa rrjedhore njëjës e shumës:

### Mashkullor

	Njëjës	Shumës
Rr.	këshije	këshijesh

### Femëror

	Njëjës	Shumës
Rr.	këshoje	këshojesh

### Shembuj:

Ky **këshije** këtu që ë?

Kjo **këshoje** këtu që ë?

Kush e pruri këtë **këshije**?

Kush e pruri këtë **këshoje**?

Djallëri **këshijesh**!

Djallëri **këshojesh**!



## MËSIMI 7P

Përemrat dëftorë "ai, ajo, ata".



Nani vëre':

I qella librin Markut, por *ai* ngë do t'e zgledhënj.

I qella librin Sarës, por *ajo* ngë do t'e zgledhënj.

Më pëlqen të ngrënit, por *ata* jo.

Qeni jim leh shumë, *ai* i *atyre* leh pak.



Çë janë

*ai, ajo, ata, atyre?*

Janë *përemra dëftorë*, çë na thonë se një njeri, një kafshë o një shërbes, vendin e të çilëvet e merr përemri dëftor, janë *llargu* atij çë flet e atij çë gjegjet.

Përemrat dëftorë "ai, ajo, ata" i glasjën *vetës së tretë të përemrit vector*. (MËSIMI 4P).

Tabelet e lakimit janë këto:

**ai**  
*mashkullor*

	Njëjës	Shumës
E.	ai	ata
Gj.	(i,e,të) atij	(i,e,të) atyre*
Dh.	atij	atyre*
K.	atë	ata
Rr.	atij	atyre*

\* Arbërisht kemi edhe: atyreve (vëre' te shembujt letrarë).

**ajo**  
*femëror*

	Njëjës	Shumës
E.	ajo	ato
Gj.	(i, e, të) asaj	(i, e, të) atyre*
Dh.	asaj	atyre*
K.	atë	ato
Rr.	asaj	atyre*

\* Edhe: atyreve (vëre' te shembujt letrarë).

**ata**  
*unjtanës*

	Njëjës	Shumës
E.	ata	ato
Gj.	(i, e) atij	(i, e) atyre*
Dh.	atij	atyre*
K.	ata	ata
Rr.	atij	atyre*

\* Edhe: atyreve (vëre' te shembujt letrarë).



## USHTRIME

Kërko te libret arbëreshë ca shembuj me përemrat dëftorë “ai”, “ajo” e “ata” e shkruaji këtu poshtë, tuke thënë nga çili libër, faqe e radhë i nxore.

---

---

---

---

---

### Shembuj letrarë

E i ligjiruan fjalën e t'in Zoti atij e gjithë **atireve** që ishën te shpia e 'tijë.  
(FZ – Viti i katërt 9 të mairt 1915 , n. 12, f. 3, sht. 1, r. 8/9)

Ahierna ai ka t'i thet **atireve** te ana...  
(FZ – Viti i parë 26 të janarit 1913 , n. 49, f. 2, sht. 1, r. 10)



## E vëre':

Edhe sot, te të folurit tanë të përditshëm, na qëndruan këto forma të përemrit dëftor: “ashije, ashoje” (litisht: di quella fatta, di tale fatta), që na përdorjëm vetëm te rasa rrjedhore njëjës e shumës:

		Mashkullor	
	Njëjës		Shumës
Rr.	ashije		ashijesh
		Femëror	
	Njëjës		Shumës
Rr.	ashoje		ashojesh

### Shembuj:

Prura, si thuhet..., një ashije...  
Ajo ashoje aty që ë?

Kush e pruri atë ashije?  
Kush e pruri atë ashoje?

Djallëri ashijesh!  
Djallëri ashojesh!



### SHËNIM

Përemrat dëftorë, që sheh këtu përposh, na arbëreshë ngë i kemi te gluha e përditshme, por ë mirë të dish se gluha shqipe i ka:

- i tillë, e tillë (litisht: tale in generale);
- i këtillë, e këtillë (litisht: tale vicino);
- i atillë, e atillë (litisht: tale lontano).

## MËSIMI 8P

Përemri pronor.

Zglith e vëre' mirë!

*Jimi* o *jyti* ë paraç (gjithë një gjë).

Në ë *jimja* o *jotja* çë ndërron?

Tata jim e *jyti* janë miq.

Vajza jime e *jotja* janë mike.

*Jyni* o *jiji* ë paraç.

Prindrat tanë e *tajt* janë miq.

*Timtë* o *të tijtë* kush i njeh?

*Timet*, *të tijat* o *të sajat* janë paraç.

*Tonat* o *të tyret* për ne vete mirë.

*Të tijavet* e *të sajavet* ia prutë lulet?

Çë janë

*jimi*, *jyti*, *jimja*, *jotja*, *jyni*, *jiji*, *tajt*, *timtë*, *të tijtë*, *timet*, *të tijat*, *të sajat*, *tonat*, *të tyret*, *të tijavet*, *të sajavet*?

Janë *përemra pronorë* (litisht: pronomi possessivi).

***Përemrat pronorë***  
do t'i shohësh një për një  
sipas *vetës së parë*,  
*të dytë* e *të tretë*  
njëjës e shumës,  
si te *mbiemri pronor*.



## MËSIMI 9P

Përemrat pronorë "jimi, jimja, timtë".

### VETA E PARË NJËJËS

Zglith.

Gjithë balunet shfryhen, *jimi* jo.



Fuqia e *timvet* ë e madhe.  
(Flas për miqtë tim)

Çë janë: *jimi*, *timvet* ?

Janë përemra pronorë të vetës së parë njëjës mashkullore.

Vëre' tabelen.

**jimi**  
mashkullor

	Njëjës
E.	jimi (shqip: imi)
Gj. (i, e, të)	timit
Dh.	timit
K.	timin
Rr.	timit

	Shumës
	timtë (shqip: të mitë)
(i, e, të)	timvet (shqip: të mive)
	timvet (shqip: të mive)
	timtë (shqip: të mitë)
	timvet (shqip: të mive)

E nani zglidh.



Vajzat janë gjithë të bukura; edhe *jimja*.



Bukuria e *times* ë e madhe.  
(Flas për vajzën time)

Çë janë: *jimja*, *times* ?

Janë përemra pronorë të vetës së parë njëjës femërore.

Vëre' tabelen.

**jimja**  
femërore

	Njëjës
E.	jimja (shqip: imja)
Gj. (i, e, të)	times (shqip: simes)
Dh.	times (shqip: simes)
K.	timen
Rr.	times (shqip: simes)

	Shumës
	timet (shqip: të miat)
(i, e, të)	timevet (shqip: të miave)
	timevet (shqip: të miave)
	timet (shqip: të miat)
	timevet (shqip: të miave)

E vëre':



Të folurit tat me **timtë**  
ngë ka kifari (punë).



Brumit me lënk çë ha ti ngë i glet **timit**.

Çë janë: **timtë**, **timit** ?

Janë përemra pronorë të vetës së parë njëjës asnjane.

Vëre' tabelen.

**timtë**  
asnjane


	Njëjës
E.	timtë
Gj. (i, e, të)	timit
Dh.	timit
K.	timtë
Rr.	timit

	Shumës
	timet
(i, e, të)	timevet
	timevet
	timet
	timevet



**USHTRIME**

Lidh me një vijë këta përemra me kaselen (o me kaselet) e gjinisë ç' i nget.



## MËSIMI 10P

Përemrat pronorë "jyti, jotja, tatër".

### VETA E DYTË NJËJËS

Zglith.

Pashë djalin tim me *tëndin* që luajën.



Djemtë tim me *tatët* vanë te mali.

Çë janë *tëndin*, *tatët* ?

Janë përemra pronorë të vetës së dytë njëjës mashkullore.

Vëre' tabelen.

**jyti**  
mashkullor

	Njëjës
E.	jyti (shqip: yti)
Gj. (i, e, të)	tëndit
Dh.	tëndit
K.	tëndin
Rr.	tëndit

	Shumës
	tatët (shqip: të tutë)
(i, e, të)	tatëvet (shqip: të tuve)
	tatëvet (shqip: të tuve)
	tatët (shqip: të tutë)
	tatëvet (shqip: të tuve)

E nani zglidh.

I dhashë një lule vajzës time e *tëndes*.



Vajzat time lozjën me *totet*.

Çë janë *tëndes*, *totet* ?

Janë përemra pronorë të vetës së dytë njëjës femërore.

## Vëre' tabelen

**jotja**  
femërore

	Njëjës
E.	jotja
Gj. (i, e, të)	tëndes (shqip: sates)
Dh.	tëndes (shqip: sates)
K.	tënden
Rr.	tëndes (shqip: sates)

**Shumës**

totet (shqip: të tuat)
(i, e, të) totevet (shqip: të tuave)
totevet (shqip: të tuave)
totet (shqip: të tuat)
totevet (shqip: të tuave)

E vëre:

Këta ujë ë të pihet; **tatët** jo.

Ujë çë pi u, ngë i glet **tëndit**.



Çë janë tatët, tëndit ?

Janë përemra pronorë të vetës së dytë njëjës asnjane.

## Vëre' tabelen.

**tatët**  
asnjane

	Njëjës
E.	tatët
Gj. (i, e, të)	tëndit
Dh.	tëndit
K.	tatët
Rr.	tëndit

**Shumës**

totet (shqip: të tuat)
(i, e, të) totevet (shqip: të tuave)
totevet (shqip: të tuave)
totet (shqip: të tuat)
totevet (shqip: të tuave)

## USHTRIME

Lidh me një vijë këta përemra me kaselen (o me kaselet) e gjinisë ç' i nget.



## MËSIMI 11P

Përemrat pronotë " i tiji ", " i sajti ", " të tijtë "; " i veti - e veta ",

### VELA E TRETË NJËJËS

A

### Emri pronar mashkullor

**i tiji**  
mashkullor

	Njëjës
E.	i tiji
Gj. (i, e, të)	të tijit
Dh.	të tijit
K.	të tijin
Rr.	të tijit

	Shumës
	të tijtë
(i, e, të)	të tijvet
	të tijvet
	të tijtë
	të tijvet

Shembull: **Djali** jim vete te skolla; *i tiji* flë. (Vëre': **i tiji** - i të jatit, **mashkull**)



**e tija**  
femëror

	Njëjës
E.	e tija
Gj. (i, e, të)	të (së) tijës
Dh.	të (së) tijës
K.	të tijën
Rr.	të (së) tijës

	Shumës
	të tijat
(i, e, të)	të tijavet
	të tijavet
	të tijat
	të tijavet

Shembull: **Vajza** jime vete te skolla; *e tija* flë. (Vëre': **e tija** - e të jatit, **mashkull**)



**të tijtë**  
asnjanës

	Njëjës
E.	të tijtë
Gj. (i, e, të)	të tijit
Dh.	të tijit
K.	të tijtë
Rr.	të tijit

	Shumës
	të tijat
(i, e, të)	të tijavet
	të tijavet
	të tijat
	të tijavet

Shembull: **Te ngrënit** ë të thatë; *të tijtë* jo.

## B

### Emri pronar femëror

#### i saji mashkullor

	Njëjës		Shumës
E.	i saji		të sajtë
Gj.	(i, e, të) të sajit	(i, e, të)	te sajvet
Dh.	të sajit		të sajvet
K.	të sajin		të sajtë
Rr.	të sajit		të sajvet

Shembull: *Djali* jyt vete te skolla; *i saji* flë. (Vëre': *i saji* - i t' jëmës, *femre*)



#### e saja femëror

	Njëjës		Shumës
E.	e saja		të sajat
Gj.	(i, e, të) të sajës ( <i>shqip</i> : së sajës)	(i, e, të)	të sajavet
Dh.	të sajës ( <i>shqip</i> : së sajës)		të sajavet
K.	të sajën		të sajat
Rr.	të sajës ( <i>shqip</i> : së sajës)		të sajavet

Shembull: *Vajza* e tij vete te skolla; *e saja* flë. (Vëre': *e saja* - e t' jëmës, *femre*)



#### të sajtë anjanës

	Njëjës		Shumës
E.	të sajtë		të sajat
Gj.	(i, e, të) të sajtit	(i, e, të)	të sajavet
Dh.	të sajtit		të sajavet
K.	të sajtë		të sajat
Rr.	të sajtit		të sajavet

Shembull: *Të ngrenit* ë të thatë; *të sajtë* jo.





## i veti, e veta

Sot përdoret vetëm te gluha letrare përemri pronor “i veti, e veta” (litisht: proprio, propria):

### i veti

	Njëjës		Shumës
E.	i veti		të vetët
Gj. (i, e, të)	të vetit	(i, e, të)	të vetëve
Dh.	të verit		të vetëve
K.	të vetin		të vetët
Rr.	të verit		të vetëve

**Shembull:** Marku mban lik qenin e Vitot; **të vetin\*** e mban mirë.

\* Si pamë te mbiemri, edhe këtu thomir: “... **të tijin** e mban mirë”

### e veta

	Njëjës		Shumës
E.	e veta		të vetat
Gj. (i, e, të)	të (së) vetës	(i, e, të)	të vetave
Dh.	të (së) vetës		të vetave
K.	të vetën		të vetat
Rr.	të (së) vetës		të vetave

**Shembull:** Marku mban lik biçikletën e Vitot; **të vetën\*** e mban mirë.

\* Përdita thomir: “... **të tijën** e mban mirë”.



## USHTRIME

Lidh me një vijë këta përemra me kaselen (o me kaselet) e gjinisë ç’ i nget.



## USHTRIME PËRMBLEDHËS ME PËREMRAZ PRONORË

Vër te vendi që i nget vetën e parë, të dytë e të tretë njëjës të këtyre përemrave pronorë: *jimi, jyti, totevet, jotja, totet, tatëvet, i tiji, e saja, të tijtë, të sajat.*

- 1) Djali jyt e \_\_\_\_\_ vanë përjashta.
- 2) Djali jim e \_\_\_\_\_ shërbejën bashkë.
- 3) **Vajza jime e \_\_\_\_\_ venë te skolla bashkë.**
- 4) Vajzat time e \_\_\_\_\_ vanë te fusha.
- 5) Djemvet tim i thashë të flëjën; \_\_\_\_\_ i thashë të vejën te skolla.
- 6) Vajzat lozjën; \_\_\_\_\_ i thashë të shkruajën.
- 7) Marku e Sara ngë shihen nga ditë: shpia e tij ë te mali, ajo \_\_\_\_\_ te fusha.
- 8) Marku miqtë i ka Palermë; Luka \_\_\_\_\_ i ka te Hora.
- 9) Mara miket i ka llargu; Sara \_\_\_\_\_ i ka te Hora.
- 10) **Djali jim e \_\_\_\_\_ shkruajtën bashkë.**



### Shembuj letrarë me përemrat pronorë

E tek ajo herë natën i mori me 'të e i lajti lavomët e kle pagezuar ai edhe gjithë të 'tijet ...  
(EZ - Viti i katërt 9 të mait 1915 , n. 12, f. 3, sht. 1, r. 10/12)

**I jyti**, në të pjek, ngë të djek.  
(CT - Fjalë të motshëme - f. 98 n. 186)

Atij e tyj u jipem / **I 'tiji** e **i jyti** jam; / Mbi mua po juve kam. / Ti e zonja, i zoti ai.  
(CT - XXXVIII, f. 166, str. 9)

U jam e **jotëja!**  
(CT - Novelline popolari - V, f. 375, r. 2 nga e sprasmja)

Thuaj **tënden**, se **timen** e thash.  
(CT - Novelline popolari - XV, f. 481, e sprasmja)

## MËSIMI 12P

Përemrat pronorë "jyni, jona, tanër".

### VETA E PARË SHUMËS

Zglith.

Gjithë djemtë lozjën me balunin; *jyni* jo.

Gjithë djemtë lozjën me balunin; *tanët* jo.



Çë janë *jyni*, *tanët* ?

Janë përemra pronorë të vetës së parë shumës mashkullore.  
Vëre' tabelen.

#### jyni mashkullor

	Njëjës		Shumës
E.	jyni (shqip: yni)		tanët
Gj. (i, e, të)	tënit (shqip: tonit)	(i, e, të)	tanëvet
Dh.	tënit (shqip: tonit)		tanëvet
K.	tënin (shqip: tonin)		tanët
Rr.	tënit (shqip: tonit)		tanëvet*

\* Ndoherë te të folurit, po gjith' e gjithë te të shkruamet arbëreshe, ndodhet edhe kjo formë e pashquar/e shquar: tanësh/tanëshit. Shembull letrar: "... ju dot jini shërbëtorë t'anëshit". (FZ 1915, n. 12 – f. 3, sht. 2, 3 nga e sprasmja). Megjithëse ka emrin te ana, "tanësh" duket më shumë përemër se mbiemër.

E zglith.

I dha një lule vajzavet; edhe *tënës*.



Gjithë vajzat lozjën; *tonat* jo.

Çë janë *tënës*, *tonat* ?

Janë përemra pronorë të vetës së parë shumës femërore.

Vëre' tabelen.

**jona**  
femëror

	Njëjës
E.	jona
Gj. (i, e, të)	tënës (shqip: sonës)
Dh.	tënës (shqip: sonës)
K.	tënën (shqip: tonën)
Rr.	tënës (shqip: sonës)

	Shumës
	tonat
(i, e, të)	tonavet
	tonavet
	tonat
	tonavet



Nani:

Të ngrënit ë gjithë të mirë; **tanët** ë edhe të t'ëmbël.  
Klëmshit çë pini ju, ngë i glet **tënit**.



Çë janë **tanët**, **tënit** ?

Janë përemra pronorë të vetës së parë shumës asnjanesë.  
Vëre' tabelen.

**tanët**  
asnjanesë


	Njëjës
E.	tanët (shqip: ngë ë)
Gj. (i, e, të)	tënit
Dh.	tënit
K.	tanët
Rr.	tënit

	Shumës
	tonat
(i, e, të)	tonavet
	tonavet
	tonat
	tonavet



## USHTRIME

Lidh me një vijë këta përemra me kaselen (o me kaselet) e gjinisë ç' i nget.



## MËSIMI 13P

Përemrat pronorë "jiji, juaja, tajt".

### VETA E DYTË SHUMËS

Zglith.

Pashë djemtë që shërbejnë e *tëjin* që flëj.



Djemtë e skuadrës që mundi bëjnë festë; *tajt* jo.

Çë janë *tëjin*, *tajt* ?

Janë përemra pronorë të vetës së dytë shumës mashkullore.

Tabela.

#### jiji mashkullor

Njëjës

E.	jiji (shqip: juaji)
Gj. (i, e, të)	tëjit (shqip: tuajit)
Dh.	tëjit (shqip: tuajit)
K.	tëjin (shqip: tuajin)
Rr.	tëjit (shqip: tuajit)

Shumës

tajt (shqip: tuajt)
(i, e, të) tajvet (shqip: tuajve)
tajvet (shqip: tuajve)
tajt (shqip: tuajt)
tajvet * (shqip: tuajve)

\* Te të folurit, po gjith' e gjithë te të shkruamet arbëreshe, ndodhet edhe kjo formë e pashquat/e shquar/ tajësh/tajëshit. Shembull letrari "... na dot bënëmi shërbëtorë tajëshit". (FZ - 1915, n. 12 - f. 3, sht. 2, 5 nga e sprasmja). Megjithëse ka emrin te ana, "tajëshit" ë më shumë përemër se mbiemër.

E naní:



I dhashë një lule vajzavet; edhe *tëjës*.

Vajzat janë të bukura; ma (po) *tuajat* më shumë.

Çë janë *tëjës*, *tuajat* ?

Janë përemra pronorë të vetës së dytë shumës femërore.

## Tabelja.

### juaja femëror

	Njëjës		Shumës
E.	juaja		tuajat
Gj. (i, e, të)	tëjës (shqip: suajës)	(i, e, të)	tuajavet
Dh.	tëjës (shqip: suajës)		tuajavet
K.	tëjën (shqip: tuajën)		tuajat
Rr.	tëjës (shqip: suajës)		tuajavet



## E vëre'.

Të ngrënit ë të gjithë të mirë; *tajt* ë edhe të t'ëmbël.

Të ngrënit tanë, ngë i glet *tëjit*.



## Çë janë *tajt*, *tëjit* ?

Janë përemra pronorë të vetës së dytë shumës asnjansë.

## Tabelja.

### tajt asnjansë

	Njëjës		Shumës
E.	tajt (shqip: ngë ë)		tuajat
Gj. (i, e, të)	tëjit	(i, e, të)	tuajavet
Dh.	tëjit		tuajavet
K.	tajt		tuajat
Rr.	tëjit		tuajavet



## USHTRIME

Lidh me një vijë këta përemra me kaselen (o me kaselet) e gjinisë ç' i nget.



## MËSIMI 14P

Përemrat pronorë "i tyri, e tyrja, të tyrët".

### VETA E TRETË SHUMËS

#### i tyri mashkullor

	Njëjës		Shumës
E.	i tyri		të tyrët
Gj. (i, e, të)	të tyrit	(i, e, të)	të tyrevet
Dh.	të tyrit		të tyrevet
K.	të tyrin		të tyrët
Rr.	të tyrit		të tyrevet

**Shembull:** Pashë gjithë djemtë që luajën; *të tyrin* jo.

#### e tyrja femëror

	Njëjës		Shumës
E.	e tyrja		të tyre
Gj. (i, e, të)	të tyres (shqip: së tyres)	(i, e, të)	të tyrevet
Dh.	të tyres (shqip: së tyres)		të tyrevet
K.	të tyren		të tyre
Rr.	të tyres (shqip: së tyres)		të tyrevet

**Shembuj:** I dhashë një lule gjithë vajzavet; edhe *të (së) tyres*.  
Vajzat tona janë të buta; edhe *të tyre*.

#### të tyrët asnjanës

	Njëjës		Shumës
E.	të tyrët		të tyre
Gj. (i, e, të)	të tyrit	(i, e, të)	të tyrevet
Dh.	të tyrit		të tyrevet
K.	të tyrët		të tyre
Rr.	të tyrit		të tyrevet

**Shembull:** Të ngrenit ë gjithë të mirë; *të tyrët* ë edhe të t' ëmbël.

## USHTRIME

Lidh me një vijë këta përemra me kaselen (o me kaselet) e gjinisë ç' i nget.



## USHTRIME PËRMBLEDHËS ME PËREMRA PRONORË

Vër te vendi çë i nget vetën e parë, të dytë e të tretë shumës të këtyre përemrave pronorë:

*tanët, tëjtit, juaja, tajt, tuajat, tëjës, të tyret, tajt, të tyrët, të tyrevet.*

- 1) Djemtë taj e \_\_\_\_\_ gjetën shëbërtyrë.
- 2) **Mikut tënë i dhanë një medalje;** \_\_\_\_\_ jo.
- 3) Vajza jonë ka pesë vjeç; \_\_\_\_\_ sa ka?
- 4) Miqtë tanë vanë te mali; \_\_\_\_\_ te ku vanë?
- 5) Vajzat tona janë të bukura; \_\_\_\_\_ edhe të mira.
- 6) Djemtë tanë me \_\_\_\_\_ shkruajën nga ditë.
- 7) **Nonës tënë i thonë Marie ;** \_\_\_\_\_ si i thonë?
- 8) Brumit çë bën nona ë te mirë; ata \_\_\_\_\_ si ë?
- 9) Djemtë tanë e djemtë taj janë të zgjuar; \_\_\_\_\_ flënë shtuara.
- 10) Miqvet tanë e miqvet taj i dhashë një dhuratë; \_\_\_\_\_ mosgjë.





## MËSIMI 15P

Përemrat lidhorë: "çë, i çili".

Vëre' mirë këto fjali.

Librin, **çë** më huajti Marku, e zgjodha.



Djali, me **të çilin** rrodha, ish i lodhët.



Fola me atë vajzë **çë** më bëre të njihja dje.

Vajza, me **të çilën** u përpoqa dje, më qeshi.



Çë janë

çë, të çilin, të çilën ?

Janë *përemra lidhorë* (litisht: pronomi relativ i congiuntivi).

Thërriten *lidhorë* përçë lidhjen dy fjali (proposicionë): atë te ku ë emri e atë te ku ë përemri lidhor, çë merr vendin e emrit.

- Përemri *çë* qëndron gjithmonë ashtu si ë.
- Përemrat *i çili, e çila, të çilët* (litisht: il quale, la quale) kanë lakimin.

Pra kemi edhe tre tjerë, por të pacaktuar (litisht: indefiniti), që do të shohësh te MËSIMI që vjen:

“kush” (litisht: chi)

“çili, çila” (litisht: chi, quale)

“sa” (litisht: quanto, quel che)

Vëre' lakimet “i çili, e çila, të çilët”:

**i çili**  
mashkullor

	Njëjës
E.	i çili
Gj. (i, e, të)	të çilit
Dh.	të çilit
K.	të çilin
Rr.	të çilit

	Shumës
	të çilët
(i, e, të)	të çilëvet
	të çilëvet
	të çilët
	të çilëvet

Shqip: i cili, etj.

**e çila**  
femërore

	Njëjës
E.	e çila
Gj. (i, e, të)	të çilës
Dh.	të çilës
K.	të çilën
Rr.	të çilës

	Shumës
	të çilat
(i, e, të)	të çilavet
	të çilavet
	të çilat
	të çilavet

Shqip: e cila, së cilës, së cilës, të cilën, së cilës; të cilat, të cilave, të cilave, të cilat, të cilave.

**të çilët**  
asnjanës

	Njëjës
E.	të çilët
Gj. (i, e, të)	të çilit
Dh.	të çilit
K.	të çilët
Rr.	të çilit

	Shumës
	të çilat
(i, e, të)	të çilavet
	të çilavet
	të çilat
	të çilavet

## USHTRIME

Vër te fjalitë këtu poshtë përemrat lidhorë që të duken më të përshtashëm (litëshu adatti):  
çë, i çili, e çila, sipas lakimevet.

- 1 – Djali \_\_\_\_\_ pe dje, ishte i biri i la' Gjergjit.
- 2 – Biçikletës \_\_\_\_\_ i kisha huajtur, i lipset freni përpara.
- 3 – Djalnin me \_\_\_\_\_ fola për tyj, ngë e njihja.
- 4 – **Ajo profesoresë, \_\_\_\_\_ i dhashë ushtrimet, më tha se u vete mirë.**
- 5 – I biri i la' Gjergjit, \_\_\_\_\_ i dhashë balunin tim, ngë do të lozënj me mua.



### Shembuj letrarë.

Ai req. **çë** deshi të bëj arsiet me shërbëtorët e 'tij, ishte i madh' in' Zot, i **çili** na ndëjen mëkatën,  
**çë** ishte një dëtitë e madhe.

(FZ – Viti i parë – 11 t' gushtit 1912 - n. 25, f. 2, sht. 1, r. 12/16)

...u duk mirësia e pushteti i Perëndis i **Çili** ruajti popullin e zgledhur nga ndohtësia e nga pabesimi **çë** err mendien e than zëmbren.

(FZ – Viti i katrët – 28 të shkurtarit 1915, n. 2, f. 3, sht. 2, radhët e sprasme)

... e bija e rregjit vdiq, e tre muajë pas asaj vdiq edhe i jati, **çë** te dhiata i la kurorën atij **çë** gjithë dijen se ish i dhëndërrit, e **çë** u vu të mbretëroj me urtësi e me të drejt.

(CT – Novelline popolari – VI, f. 381, r. 23/26)

Bërësin e kriesës, përpara **të çilit** dridhen Engjëjitë...

(AGS – Libri i Kreshmëvet – vëllimi 1, f. 24, r. e parë)

## MËSIMI 16P

Përemrat lidhorë të pacaktuar: "kush, çë, çili, sa".

Nani vëre':

*Kush* ha o *kush* jep të hanj, bën drudhe.

Dolla me *kë* desha.

Lulet jipja *kujt* do.

Jam *çë* jam.

*Çili* lot më mirë, ka një dhuratë.

*Çila* këndon më mirë, ka një dhuratë.

Mirr *çilin* do.    Mirr *çilën* do.

Bëj *sa* të thashë.



Edhe kush, kë, kujt, çili, çila, çilin, çilën, sa janë *përemra lidhorë*, por të *pacaktuar* (litish: indefiniti).

Atá, me të vërtetë, kanë dy elemente me dy kuptime abrënda: njeri kuptimin e *përemrit dëftor* e tjetri kuptimin e *përemrit lidhor*:

● *kush* = "ai çë, ajo çë" (litish: colui-colei che), ka vetëm numrin njëjës e ngë ka gjini:

kush  
(i,e,të) kujt  
kujt  
kë  
kujt

● *çë* = atë çë (litish: quel che), qëndron ashtu si ë.

● *çili, çila* = "ai çë, ajo çë" (litish: quello-quella che, colui-colei che); bën si "i çili, e çila", (përdoret rallët te rasa gjinore);

● *sa* = "atë çë" (litish: quel che), arbërisht qëndron ashtu si ë pa lakim.

## USHTRIME

Vër te vendi përemrat lidhorë që të duken më të përshtashëm: kush, çili, çila, sa, sipas lakimevet, në i kanë.

- 1 – \_\_\_\_\_ ngë glitet, ngë mirret.
- 2 – **Qeni e (dë)fton** \_\_\_\_\_ **do mirë.**
- 3 – \_\_\_\_\_ jarrën e para, ka një rrigall (dhuratë)
- 4 – \_\_\_\_\_ te djemtë lot më mirë, ka një dhuratë.
- 5 – Dhurata i nget, \_\_\_\_\_ jarrën i pari.
- 6 – Bëj mirë \_\_\_\_\_ të thashë.
- 7 – \_\_\_\_\_ shumë ha, mbitet.



### Shembuj letrarë

**Kush** u mba e **kush** ngë u mba, të gjith nderni këtë ditë. **Kush** argjëroi, e **kush** ngë argjëroi, bëni sot hajdhí.

(FZ – Viti i parë – 7 të prillit, 1912 – n. 7, f.2, sht. 1, r. 2/4 nga e sprasmja)

E jam **çë** jam me hir të Perëndis...

(FZ – Viti i parë – 18 t' gushtit 1912 – n. 26, f. 3, sht. 2, r. 26)

## MËSIMI 17P

Përemri pyetës.

Zglith:



*Kush* ë më i urti (me tru) tek ju?

*Kush* je? Me *kë* jec? I *kujt* je bir?

*Çili* tek ju ngë pruri ushtrimet?

*Çila* tek ju i shkoi Markut ushtrimet?

Me *çilin* dolle? Me *çilën* dolle?

*Çë* janë këto?

*Sa* dinë të zgledhjën arbërisht?

*Sa* dinë të këndojnë?



Çë janë

*kush, kë, kujt, çili, çila, çilin, çilën, çë, sa ?*

Janë përemra pyetës. Të jenë përemra pyetës i duhet të gjëndet te fjalia pikëpyetja “?”.

Sa pamë te përemrat lidhorë vlen edhe këtu:

- *kush?* lakohet, si pamë, vetëm te numri njëjës e ngë ka gjini;
- *çili? çila? çilët?* lakohen si “i çili, e çila, të çilët”;
- *çë?* qëndron ashtu si ë;
- *sa?* arbërisht qëndron ashtu si ë.

## USHTRIME

Vër te vendi përemrat pyetës që të duken më të përshtashëm: kush?, çili?, çila?, çë?, sa?, sipas lakimevet, në i kanë.

- 1 - Me \_\_\_\_\_ ka veç te festa?
- 2 - \_\_\_\_\_ ka vinjë me ne?
- 3 - \_\_\_\_\_ ngak ju ë më e bukura?
- 4 - \_\_\_\_\_ ngak ju ë më i forti?
- 5 - E di \_\_\_\_\_ më ka bërë qeni jyt?
- 6 - \_\_\_\_\_ më thua mua?
- 7 - \_\_\_\_\_ ë bijë kjo vajzë?



### Ca shembuj letrarë.

- **Çilat** janë Theologat, e përse kshtu i thonë?  
(NF - Codice - f. 50, r. 206)

**Çë** m'i kle?  
(DHEU, II - K. III - vj. 749)

Po **kë** kemi na? **Kë** patëm? / **Kë** do t' kemi kurr për shokë? / **Kë** do t' kemi kurr për ndihmë?  
(DHEU, II - K. IV - vj. 553/555)

**Çë** të bëjëm pran?  
(DHEU, II - K. V - vj. 53)

**Kush** i shtyjtë, / e prej **kuj**, prej **kuj** Junanët / patën ndihmë edhe këshill / sa të ngrëjnë kryet e tyre? / Rrumellin **kush** e përziejtë / te gjithë anët? E **kush** kurr / u dha rraxhëvet guximin / sa të çoheshin të tërë...?  
(DHEU, II - K. V - vj. 158/165)

**Çë** përret përveç ndëshkimit / ç' i përket nga dora e Zotit...?  
(DHEU, II - K. V - vj. 178/179)

- Çe ke, zoti tatë? – Çe do t'kem, o bijëza e jime?  
(CT – Novelline populari – IX, f. 396, r. 4,5)

Me kë mënd t' prirej ai tek ajo herë? **Kuj** mënd t'i klahej? Nga **kush** mënd t' kish ndihmë e fuqi?  
(GS – Prose – XIX – f. 342, r. 861, 862)-

- Çe jerdha të bëja!... Çe vjen më rar?... Erdha sa të shihëja t'ime bijë!...  
(CT – Novelline populari – VI, f. 381, r. 10 nga e sprasmja)

Isht e del i bukri dielli;  
do t' na bjerë bukë e miell.  
Mi një kal të pa bërrore  
vete trimi e s' di sinòre;  
male e fusha e lume shkon,  
se të dashurën kërkon.  
**Kush** e ka? **Kush** e rrëmbeu?  
Dridhet era e dridhet dheu.  
U nxi jeta, shumë u nxi;  
zjarr e gjëmë, breshër, shi.  
Me një gjarpër mundet trimi.  
I tmeroshëm dyluftimi!  
Ai gjarpër ka tre krerë;  
j-a pret trimi me një herë,  
edhe qiellin na fjellon  
e të dashurën shpëton.

(CT – XXX – f. 342)

#### FJALOR

sinuar, sinori = **litisht**: confine  
rrembenj = zë fort, granfar  
breshër, -shri = ghrandulla  
i tmeroshëm = **litisht**: terribile  
dyluftim, -i = **litisht**: duello  
trim, -i = kopil i fort  
shpëtonj = **litisht**: salvare




## MËSIMI 18P

Përemri me kuptim çuditës.

Zglith!

Çë thotë, Marku!

*Kush* flet!



*Sa* shërbejën gratë!



Perëmrat *çë*, *kush*, *sa* te gluha jonë shprehjën edhe çudi e thirrje (litish: meraviglia, esclamazione), kur kanë te fjalia pikëçuditjen “! “:

- *kush!* lakohet në njëjës;
- *çë!* e *sa!* ngë ndërrojën.

### Ndo shembull letrar.

Ai, kur e pa, i tha me gac - Mirë se m'jerdhe, o e Bukura Fatë! E *çë!*... U martove?  
(CT - Novelline populari - I, f. 355, r. 6,7)

- Dua tri ditë sa të përgjegjem.. E djali: - *Sa* të duash, o zonja e jime!  
(CT - Novelline populari - V, f. 374, r. 15)

- *Çë* jerdha të bëja!... Çë vjen më rar?... Erdha sa të shihëja time bijël...  
(CT - Novelline populari - VI, f. 381, r. 10 nga e sprasmja)

*Çë* të thotë ballët, o zëmbëre!  
(CT - Novelline populari - IX, f. 396, r. 24, 25)

## MËSIMI 19P

Përemri i pacaktuar.

Zglith e vëre':

*Akëcili* më tha se ti je një vajzë e bukur.

*Akëcila* më tha se ti je një djalë i mirë.

*Disa* vanë te fusha e *disa* përjashta.

*Ndonjëi* ka t'i jap një shplakë!

I dhashë dy euro *njëi*.

*Gjithëve* ia thatë se Mara do Markun!

Jipja *kujtdo*!

*Njeri* rri Palermë, (*t*)*jetri* rri te Hora.

*Njera* rri Palermë, (*t*)*jetra* rri te Hora.

*Mosnjëri* e *mosnjera* bënë si i thashë.

Ngë të pa *mosnjëri*.

Ia the *ndonjëriu*?



Çë janë

*akëcili, akëcila, ndonjëi, njëi, disa, gjithëve, kujtdo, njeri, tjetri, njera, tjetra, mosnjëri, mosnjera, mosnjëri, ndonjëriu* ?

Janë përemra të pacaktuar (litisht: pronomi indefiniti).

Përemrat e pacaktuar ndërrojnë, si sheh te shembujt çë vijën.

## Mësoi një për një:

- *akëcili, akëcila* ndërron te gjinia, te rasa e te numeri:

	"akëcili"		"akëcila"	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
E.	akëcili	akëcilët	akëcila	akëcilat
Gj.	akëcilir	akëcilëve	akëcilës	akëcilave
Dh.	akëcilit	akëcilëve	akëcilës	akëcilave
K.	akëcilin	akëcilët	akëcilën	akëcilat
Rr.	akëcilit	akëcilëve	akëcilës	akëcilave

- *disa* ka vetëm shumësin e rasat:

E.	disa
Gj.	(i, e, të) disave
Dh.	disave
K.	disa
Rr.	disave

- (*i.e.të*) *gjithë* me o pa "një" ka lakimin shumë mashkullor e femëror/asnjës.

	mashkullor	femëror
E.K.	<i>gjithë o të gjithë</i>	<i>gjithë o të gjitha</i>
Gj.Dh.Rr.	<i>gjithëve o të gjithëve</i>	<i>gjithëve o të gjithave</i>

Shënim.

Kur thomi "gjithë Hora", "gjithë" ë mbiemër, si edhe kur thomi "të gjithë burrat, të gjitha gratë".

- *kushdo* ka lakimin njëjës e përdoret vetëm për njerëzit:  
E.: kushdo, Gj. Dh. Rr.: kujtdo, K.:këdo
- *mosnjëri, mosnjëra si njëri, njëra;*
- *mosnjëri* ngë ndërron gjini e ka vetëm rasat e njëjësit:  
E.K. mosnjëri  
Dh.Rr. mosnjëriu
- *ndonjëri* ("ndonjë + njëri ") si *mosnjëri*;
- *nganjëri* ("nga + njëri ") si *mosnjëri* ; shqip "çdonjëri, secili";

● *një* (ngë ka ndërronet me nyjën e pacaktuar o me numërorin) ë vetëm njëjës; arbërisht ka rasat:

E.K.	një
Gj.Dh.Rr.	njëi

● *ndonjë* si *një*;

● *njëri, njëra* rri në bashkëlidhje (korrelacion) me *(t)jetri, (t)jetra*, ndërron te gjinia e te rasat:

E.  
Gj.  
Dh.  
K.  
Rr.

njeri	Njëjës	njera
njëri		njera
(i, e, të) njerit	(i, e, të)	njerës
njerit		njerës
njerin		njerën
njerit		njerës

● *jetri, jetra* o *tjetri, tjetra*, rri vetëm si përemër i pacaktuar o në bashkëlidhje me *njeri, njera*; ndërron gjini, rasë, numër e ka formën e pashquar e e shquar:

### tjetër, tjetri

	Njëjës		Shumës	
	Forma e pashquar/e shquar		Forma e pashquar/e shquar	
E.	tjetër	tjetri	të tjerë	të tjerët
Gj.	(i, e, të) tjetri	(i, e, të) tjetrit	(i, e, të) të tjerëve	(i, e, të) të tjerëvet
Dh.	tjetri	tjetrit	të tjerëve	të tjerëvet
K.	tjetër	tjetrin	të tjerë	të tjerët
Rr.	tjetri	tjetrit	të tjerëve	të tjerëvet

### tjetër, tjetra

	Njëjës		Shumës	
	Forma e pashquar/e shquar		Forma e pashquar/e shquar	
E.	tjetër	tjetra	të tjera	të tjerat
Gj.	(i, e, të) tjetrje	(i, e, të) tjetrës	(i, e, të) të tjerave	(i, e, të) të tjeravet
Dh.	tjetrje	tjetrës	të tjerave	të tjeravet
K.	tjetër	tjetrën	të tjera	të tjerat
Rr.	tjetrje	tjetrës	të tjerave	të tjeravet

## USHTRIME

Zgllith këtë rrëfim e pra shkruaj gjithë përemrat e pacaktuar që përpoqe.

### Akëcili

Akëcili i biri i akëcilit, një ditë vate të gjej një mosnjeri e të dy zunë fill të flisjën kundra njëi e kundra disave. As njëri as tjetri ndëlgojën se bëjën lik të flisjën kundra ndonjeriu, ngase i dukej se kushdo mënd të flisëj si i vij për akëcilin e për akëcilën.

Akëcili me mosnjeriun flisjën edhe kundra gjithëve, sikurse gjithë jetën e kishën kundra. Një herë i përpoqi një e i tha se ngë kî' t' flisjën lik kundra këtij e kundra atij, kundra akëcilit e kundra akëcilës, përçë kushdo mënd të flisëj lik edhe kundra atyre. Kur ata gjegjën ashtu ngë folën më lik kundra gjithëve, se zunë fill të zësheshin ndër ta e ngë kishën më qëro t'i kushtojën (dedikarjën) tjerëvet. Nganjeri di atë që ka te thesi.

Përemrat e pacaktuar janë 21:

---

---

---

---

---

---



### Ndo shembull letrar

**Kush-do** duroi të argjëroj, paçit dënarin. **Kush-do** shërbeu që tek e para orë, marshit rrogën që i nget. **Kush-do** jerdhi pas të tretës orë, sot me gzim le të krëmptonjë tue u falur nderjes. **Kush-do** arruri pas të gjashtës orë, mos paçit ndërdie, pse edhe ngë do t' ket dëm. **Kush-do** u lips njera tek e nëndëta orë, le të qaset pa dre. **Kush-do** jerdhi vetëm tek e njëmbëdhjetëta orë, mos të trëmbet...

(E.Z. – Viti i parë - 7 të prighit 1912, n. 7, f. 2, sht. 1, r. 8/19)

-Zotëri, u jam **akëcili**, i biri i **akëcilit**...

(C.T. – f. 476, r. 2 nga e sprasmja)

Nga të bijtë e Adhamit **mosnjeri** ka mëkatruar si u.

(AGS – Libri i Kreshmëvet – vëllimi II, f. 505, r. 4 nga e sprasmja)

## MËSIMI 20P

Përemri i pacaktuar i pandërrueshëm.

Nani vëre’:

*Ca* vanë te mali e *ca* te fusha.

*Shumë* ngë do vijën te festa.

*Pak* do vijën te festa.



Çë janë

*ca, shumë, pak?*

Janë përemra të pacaktuar:

- “ca” o “dicá” arbërisht ngë ndërron kurrë; shqip ka lakimin: E.K. ca Gj.Dh.Re. caveç
- “pak” e “shumë” qëndrojnë ashtu si janë.

Vëre’ edhe këto:

Marku ha *çë isht isht*.

Mënd t’vinjë *kush isht isht*: u ngë qetem!



Arbërisht kemi ca shprehje (litisht: locuzioni) të bukura sa të flasjëm me gjallëri:

● *çë isht isht* thuhet për shërbiset; shqip del “çdo, çfarëdo”; me të vërtetë shprehja kle marrë nga djalekti siçiljan: “zoccu (ciò che) jè jè” e na e prorëm arbërisht;

● *kush isht isht* thuhet për njerëzit e vjen përkthyer nga djalekti siçiljan “cu jè jè”; shqip del “kushdo”.

## USHTRIME

Vër një vijë përposh përemrave “ca, pak, shumë”, tuke i ndajtur nga mbiemrat.

- 1 – Shumë gjinde dje ishën te festa.
- 2 – Shumë thonë se ngë ka bienj shi.
- 3 – Ca burra vanë te mali e ca te fusha.
- 4 – Pak vajza pashë te festa.
- 5 – **Pak e dinë ku lehet lumi Beliçe.**



### Shembuj letrarë

Kush thonë njerëzit se isht i Biri i njeriut? E ata: - **Ca** (vet thonë:) Jani Pagëzor...  
(FZ – Viti i parë – 30 të kjashtorit 1912 – n. 19, f. 4, sht. 1, r. 4/7)

Vërteta, **shumë** janë te ghrizurë, por **pakë** janë të sgledhurë.  
(FZ – Viti i parë – e 1\* e shtatorit 1912 – n. 28, f. 2, sht. 2, r. 7, 8)

Dolli njeriu çë mbieh, sa të mbihëj farën e 'tij: e si e mbolli **dica** ra për në dhromit e kle shkelur...  
(FZ – Viti i parë – 13 të tetorit 1912 – n. 34, f. 1, sht. 1, r. 2/5)

## FOLJA

### MËSIMI 1F

Folja: njohuri të përgjithshme.

Zglith mirë.

Ti **je** një djalë i butë.

Marku **ka** po një biçikletë.

Na **kemi klënë** me miqtë.

Vjet Sara **vate** Romë.

Qeni **hëngri** gjithë misht.

Miqtë **ka vijën** nestër.

**Jic** llargu! – i **tha** miu maçes.

Vito **lahet**.



Çë janë

je, ka, kemi klënë, vate, hëngri, vijën, jic!, tha, lahet ?

Janë folje (litisht: verbi).

Folja ë ajo pjesë e ndërrueshme e ligjëratës që mban gjithë të folurit, pa të çilën na ngë mënd të lidhjem e ngë mënd të thomi mirë pinceret (mendimet) tanë.

Folja “flet” për të klënit, për të bëmat, për gjëndjen e njerëzvet, të kafshëvet, të shërbisevet.





## Folja ka:

### • numër :



**njëjës**  
u shoh  
ti sheh  
ai, ajo sheh

**shumës**  
na shohjëm  
ju shihni  
ata, ato shohjën

### • veta:



**veta e parë:**  
**e dytë:**  
**e tretë:**

u ...      na ...  
ti ...      ju ...  
ai, ajo ...      ata, ato ...

### • forma:



**forma e shtjelluar:**  
kam, ke, ka ....

**forma e pashtjelluar:**  
pasur, për të pasur, tuke pasur.

### • mënyra:



◆ dëftore  
■ lidhore  
● kushtore  
- dëshirore  
▣ urdhërore

pjesore  
paskajore  
përcjellore

### • kohë:



▣ ● - ■ ◆ e tashme  
■ ◆ e pakryer  
◆ e kryer e thjeshtë  
◆ e ardhme

● - ■ ◆ e kryer  
■ ◆ e kryer e plotë  
◆ e kryer e tejshkuar  
◆ e ardhme e përparme

Gjithë këto shërbise çë sheh këtu sipër e ca të tjera do t'i njohësh dal'e dalë tuke zgledhur MËSIMET çë i ngasjën "foljes".

## MËSIMI 2F

Folja "kam" - mënyra dëftore: koha e tashme.

Zgllith mirë këto ligjëratat bërë të Rruga "8 Mars" e Horës së Arbëreshëvet:

- U *kam* telefoninin; e ti e *ke*?

- Jime motër e *ka*. Na te sh(të)pia *kemi* dy kompjuter!

- Uh, *kini* dy kompjuter! Gjithë sot *kanë* dy kompjuter: një i (të) vjetër e një i (të) ri!



Çë janë fjalët

*kam, ke, ka, kemi, kini, kanë ?*

Më parë se gjithqish thomi se janë *folje*, fjalët çë na shqiptojëm (thomi) më shumë ngaditë bashkë me tjerat, çë ke njohur: emra, mbiemra, përemra.

Pra pyejëm: *u kam, ti ke, ai ka, na kemi, ju kini, ata kanë* flasjën për naní, për dje o për nestër?

Flasjën për naní !

E atëherë kemi përpara vetat e foljes *kam* të koha e tashme e mënyrës dëftore (litisht: tempo presente modo indicativo) të *njëjësi* e të *shumësi* :

Vëre' e mëso' si këndon tabelja

### FOLJA "kam" MËNYRA DËFTORE KOHA E TASHME

Njëjës  
u kam  
ti ke  
ai, ajo ka

Shumës  
na kemi  
ju kini (shqip: kení)  
ata, ato kanë



- Marku, çë **ke** ?

- Ngë **kam** gjë.

- Na **kemi** pitit (uri).



- Ju **kini** pitit (uri) e ata **kanë** etë; e kush **ka** gjumë ?



## USHTRIME

Vër vetat e foljes "kam", çë lipsen, te *koha e tashme e mënyrës dëftore*.

- 1 - Marku e Gjergji kanë një biçikletë për nga një.
- 2 - Lia, \_\_\_\_\_ një lule te kriptë!
- 3 - Sarë, çë \_\_\_\_\_ te dora ?
- 4 - U \_\_\_\_\_ një rrashkun (gërvishtje) te dora.
- 5 - Mara e Serafina \_\_\_\_\_ gjumë.
- 6 - Na te sh(të)pia jonë \_\_\_\_\_ dy kompjuter e ju sa \_\_\_\_\_ ?
- 7 - Na \_\_\_\_\_ po një kompjuter e ju e \_\_\_\_\_ antenën parabolike?
- 8 - U \_\_\_\_\_ po një vëlla e ti sa \_\_\_\_\_ ?
- 9 - Kush \_\_\_\_\_ bukën ngë \_\_\_\_\_ drutë e kush \_\_\_\_\_ drutë ngë \_\_\_\_\_ bukën!
- 10 - Mikela, \_\_\_\_\_ një rrigall (dhuratë) për tyj.



## MËSIMI 3F

Folja "jam" - mënyra dëftore: koha e tashme.

Nani zgjith çë thonë te kjo ligjëratë:

- U *jam* Mara e ti kush *je* ?

- U *jam* Marku e kjo *ë (isht)* Lia: na *jemi* miq.



- *Jini* miq ?! Ngë *jini* nuse e dhëndër ?

- Jo, *jemi* vetëm miq! Pali e Kelja *janë* nuse e dhëndër!

Çë janë fjalët

*jam, je, ë (isht, është), jemi, jini, janë ?*

Janë veta të foljes *jam* te koha e tashme e mënyrës dëftore *njëjës e shumës* :

Vëre' e mëso' si këndon tabelja

### FOLJA "jam" MËNYRA DËFTORE KOHA E TASHME

Njëjës

u jam

ti je

ai ë (isht; shqip: është)

Shumës

na jemi

ju jini (shqip: jeni)

ata janë

- Ti kush **je** ?

- U **jam** Marku e ai **ë** Vito.

- E ju kush **jini** ?

- Na **jemi** Lia e Sara e ato **janë** miket tona.



## USHTRIME

Vër vetat e foljes "jam", çë lipsen, te *koha e tashme e mënyrës dëftore*.

- 1 - Lia, Mara, Mena, Kelja, Vitorja e Marieja janë mike.
- 2 - Na \_\_\_\_\_ miq të vjetër.
- 3 - Ajo vajzë kështu e bukur kush \_\_\_\_\_ ?
- 4 - Ata djem këtjje kush \_\_\_\_\_ ?
- 5 - Ata djem \_\_\_\_\_ miq tim.
- 6 - \_\_\_\_\_ e hollë si purtekë, bija jime !
- 7 - Tek e diellja u \_\_\_\_\_ Palermë.
- 8 - Sot \_\_\_\_\_ e martja o e mërkurja ?
- 9 - U \_\_\_\_\_ e shkurtur, ma (por) ti ngë \_\_\_\_\_ më e glatë se u.
- 10 - Ju \_\_\_\_\_ kriendulla o \_\_\_\_\_ të mëdhenj ?



## MËSIMI 4F

Folja "kam" - mënyra dëftore: koha e pakryer.

Pamë si thuhën foljet "kam" e "jam" të koha e tashme (arbërisht: e këtij mumenti, naní; shqip: taní, tash = e tashme).

E të koha e pakryer (litisht: tempo imperfetto), çë na përdorjëm sa të thomi kur një veprim (litisht: azione) ndurís (shqip: zgjat) të qëroi i shkuar, si bëjën ?

Zglith mirë këtu poshtë ku gjen *kobën e pakryer të mënyrës dëftore të foljes "kam"*.



- Kur *kisha* katër vjeç, *kisha* një biçikletë me katër rrotë si ato të fëmijëvet. E ti çë *kishe* ?



- U *kisha* pesë pupa copje; Sara e *kish* biçikletën.



- Sa shurbise çë *kishëm* ! Mara, ti me tèt motra i *kishët* pupat?



- Time kushërira i *kishën* pupat; u *kisha* kuçinën.



Vëre'

*kisha, kishë, kish, kishëm, kishët, kishën* janë vetat e *kobës së pakryer të mënyrës dëftore* (litisht: tempo imperfetto modo indicativo) të foljes "kam".

Vëre' tabelen!

FOLJA "kam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u kisha  
ti kishe  
ai kish

Shumës  
na kishëm (shqip: kishim)  
ju kishët (shqip: kishit)  
ata kishën (shqip: kishin)



## USHTRIME

Vër vetat e foljes "kam", çë lipsen, te *koha e pakryer e mënyrës dëftore*.

- 1 - Marku e Gjergji kishën një biçikletë për nga një.
- 2 - Lia, ti dje \_\_\_\_\_ një lule te kriptë.
- 3 - Sarë, çë \_\_\_\_\_ dje te dora ?
- 4 - **U njëditëz \_\_\_\_\_ një rrashkun (gërvishtje) te dora.**
- 5 - Mara e Serafina prëmë \_\_\_\_\_ gjumë.
- 6 - Na te shpia jonë vjet \_\_\_\_\_ dy kompjuter e ju sa \_\_\_\_\_?
- 7 - Na \_\_\_\_\_ po një kompjuter e ju e \_\_\_\_\_ vjet antenën parabolike?
- 8 - **U dy vjet prapa \_\_\_\_\_ po një balun e ju sa \_\_\_\_\_?**
- 9 - Kush \_\_\_\_\_ bukën ngë \_\_\_\_\_ drutë e kush \_\_\_\_\_ drutë ngë \_\_\_\_\_ bukën!
- 10 - Mikela, \_\_\_\_\_ një rrigall (dhuratë) për tyj.



## MËSIMI 5F

Folja "jam" - mënyra dëftore: koha e pakryer.

E folja "jam" si bën te koha e pakryer e mënyrës dëftore?

Zglith e vëre!



- Kur *isha* e vogël, *isha* më e bukura e gjithëve!  
E ti kur *ishe* e vogël e bukur *ishe*?



- U e bukur *isha* e jime motër *ish* më e bukur se ti!



- Ju të bukura? U e jime motër *ishëm* më të bukurat e Horës!



- Ju *ishët* më të bukurat e Horës? Më të bukura se ju *ishën* Kelja e Marta!



Çë janë

*isha, ishe, ish, ishëm, ishët, ishën?*

Janë vetat e kohës së pakryer të mënyrës dëftore të foljes "jam".



Vëre tabelen:

FOLJA "jam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u isha  
ti ishe  
ai ish

Shumës  
na ishëm (shqip: ishim)  
ju ishët (shqip: ishit)  
ata ishën (shqip: ishin)



## USHTRIME

Vër vetat e foljes "jam", çë lipsen, te *koha e pakryer e mënyrës dëftore*.

- 1 - Lia, Mara, Mena, Kelja, Vitorja e Marieja ishën mike.
- 2 - Na \_\_\_\_\_ miq një herë.
- 3 - Ajo vajzë ashtu e bukur kush \_\_\_\_\_ ?
- 4 - Ata djem kush \_\_\_\_\_ ?
- 5 - Ata djem \_\_\_\_\_ miq tim.
- 6 - Vjet \_\_\_\_\_ e hollë si purtekë, bija jime !
- 7 - Dje u \_\_\_\_\_ Palermë.
- 8 - Dje \_\_\_\_\_ e martja o e mërkurja ?
- 9 - U \_\_\_\_\_ e shkurtur, ma (por) ti ngë \_\_\_\_\_ më e glatë se u.
- 10 - Ju \_\_\_\_\_ miq ?



## MËSIMI 6F

Folja "kam" - mënyra dëftore: koha e kryer e thjeshtë.

Kur flasjëm pra për fakte të "qëroit të shkuar", përdorjëm vetat e foljevet kështu:



– U vjet *pata* si rrigall një balun; ti e *pate* kurrë një balun?



– Edhe u e *pata* vjet; jim vëlla e *pati* një muaj prapa.



– Te shpia jime na të vegjij e *patëm* gjithë një balun; e tek ju, Vito, e *patët*?



– E *patëm* gjithë; edhe te Mariu e *patën* gjithë.

Çë janë fjalët

*pata, pate, pati, patëm, patët, patën*

çë zglo dhëm të shkruara më gërma të trasha ?

Janë vetat e kohës së kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore (litisht: tempo passato remoto modo indicativo) të foljes "kam".

Shohjëm si bën tabelja.

FOLJA "kam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës  
u pata  
ti pate  
ai pati

Shumës  
na patëm  
ju patët  
ata patën



Nani ca **ushtrime** me *kobën e pakryer e me kobën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore të foljes "kam".*

### USHTRIME

Vër te vendi çë i duhet vetat e foljes të *së pakryerës e të së kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore.*

- 1 - Na **kishëm** po një biçikletë.  
- Na **patëm** po një biçikletë.
- 2 - Noni e nona \_\_\_\_\_ po një vajzë.  
- Noni e nona \_\_\_\_\_ po një vajzë.
- 3 - Ti e \_\_\_\_\_ biçikletën kur \_\_\_\_\_ katër vjeç?  
- Ti e \_\_\_\_\_ biçikletën kur \_\_\_\_\_ katër vjet?
- 4 - Ju, vajza, \_\_\_\_\_ një libër pullaresh.  
- Ju, vajza, \_\_\_\_\_ një libër pullaresh.
- 5 - **Marku** \_\_\_\_\_ **frevën** (ether).  
- **Marku** \_\_\_\_\_ **frevën** (ether).
- 6 - U e \_\_\_\_\_ një herë një mik shqiptar.  
- U e \_\_\_\_\_ një herë një mik shqiptar.



## MËSIMI 7F

Folja "jam" - mënyra dëftore: koha e kryer e thjeshtë.

Ë si bën *koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore* të foljes "jam"?

Zglith e vëre'



- U vjet *kleva* Rromë. Ti *kleve* Rromë ?



- I *kle* tata; na vjet *klemë* Napul.



- Ti e Marku vjet ngë *kletë* Kosencë ?



- *Klemë* te një horë ndanëz Kosencës.



- Vito e Linu *klenë* Mesinë.

Foljet *kleva, kleve, kle, klemë, kletë, klenë* janë vetat e kohës së kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore të foljes "jam".

Tabelja:

FOLJA "jam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës  
u kleva  
ti kleve  
ai kle

Shumës  
na klemë  
ju kletë  
ata klenë

Vër re

E kryera e thjeshtë e disa horëve arbëreshe si edhe ajo e shqipes bën kështu:

Njëjës  
u qeva (shqip: qeshë)  
ti qeve (shqip: qe)  
ai qe

Shumës  
na qemë  
ju qetë  
ata qenë



Këtu poshtë kemi ca **ushtrime** me *kohën e pakryer* (vëreje pameta) e me *kohën e kryer të thjeshtë* të mënyrës dëftore të foljes "jam".

USHTRIME

Vër te vendi që i duhet vetat e foljes të *së pakryerës* e të *së kryerës së thjeshtë* të mënyrës dëftore.

- 1 - Ju **ishër** të fortë vjet te baluni.  
- Ju **kletë** të fortë vjet te baluni.
- 2 - Mara e Mena \_\_\_\_\_ te kopshti për lule.  
- Mara e Mena \_\_\_\_\_ te kopshti për lule.
- 3 - Vito, ti \_\_\_\_\_ një djalë i mirë i vogël.  
- Vito, ti \_\_\_\_\_ një djalë i mirë i vogël.
- 4 - U \_\_\_\_\_ te skolla.  
- U \_\_\_\_\_ te skolla.
- 5 - Marku, Lia e u një muaj prapa \_\_\_\_\_ përjashta.  
- Marku, Lia e u një muaj prapa \_\_\_\_\_ përjashta.
- 6 - **Nona** \_\_\_\_\_ një grua me kulturë.  
- **Nona** \_\_\_\_\_ një grua me kulturë.



## MËSIMI 8F

Folja "kam": koha e ardhme.

E kur ka flasjëm për shërbise që ka ndodhen te "qëroi që ka vinjë" (*koha e ardhme* = litisht: tempo futuro), si e përdorjëm arbërisht foljen "kam"?

Zglith.



- U *ka kem* një euro ka (nga) Marku. Ti që *ka kesh*?



- U mosgjë. Vito *ka ketë* dy pendë biro ka (nga) Xhoi.



- Kush *ka ketë* gjagjë tek ju?



- Ti e u *ka kemi* dy çikullata. Ina, ti e Vito që *ka kini*?



- Na mosgjë. Salvino e Lluixhi *ka kenë* dy panine ka (nga) Mariu.

Çë janë ato

*ka kem, ka kesh, ka ketë, ka kemi, ka kini, ka kenë?*

Janë vetat e *kohës së ardhme* arbëreshe të foljes "kam".

**Vëre!**

Arbërisht *koha e ardhme* shkruhet edhe kështu:

*ka të kem o ka t' kem ...*

Më parë arbëreshët *kobën e ardhme* e thëshjën më komplikate:

*kam të kem  
ke të kesh  
ka të ketë  
kemi të kemi  
kini të kini  
kanë të kenë*

pra qëndroi vetëm pjesëza "*ka*" për të gjitha vetat.

Kjo *kobë e ardhme* me pjesëzën "*ka*" thërritet koha e ardhme e nevojës, e bëzonjës (litisht: futuro di necessità).



Ngë kemi sosur !

Arbërisht ndodhet edhe kjo formë: *do kem, do kesh, do ketë, do kemi, do kini, do kenë.*

**Vëre'!**

- E *do kem* kifari (punë) me atë?
  - Ti *do kesh* kifari (punë) me atë?
  - Edhe Marku ngë *do ketë* kifari (punë) me atë!
- Etjera....

Mënd të shkruhet edhe kështu:

*do të kem o do t' kem ...*

E edhe këtë formë më parë arbëreshët e thëshjën më komplikate:

*dua të kem  
do të kesh  
do të ketë  
duam të kemi  
doni të kini  
duan të kenë*

pra qëndroi vetëm pjesëza "*do*" për të gjitha vetat.

Kjo formë e *kobës së ardhme* me pjesëzën “do” thërritet koha e ardhme e vullnetit, e vullimit (litisht: futuro di volontà, volitivo) sipas foljes “dua” (litisht: volere).

Vëre' nani tablelet.

FOLJA “kam”  
MENYRA DËFTORE  
KOHA E ARDHME

Njëjës  
u ka kem  
ti ka kesh  
ai ka ketë

Shumës  
na ka kemi  
ju ka kini  
ata ka kenë

e

Njëjës  
u ka t' kem  
ti ka t' kesh  
ai ka t' ketë

Shumës  
na ka t' kemi  
ju ka t' kini  
ata ka t' kenë

e si thamë

Njëjës  
u do kem  
ti do kesh  
ai do ketë

Shumës  
na do kemi  
ju do kini  
ata do kenë

o

Njëjës  
u do t' kem  
ti do t' kesh  
ai do t' ketë

Shumës  
na do t' kemi  
ju do t' kini  
ata do t' kenë

**Shqip:** unë do të kem, ... ne do të kemi, ju do të keni, ...



**CA USHTRIME.**

Tue përdorur të dy format “ka” e “do”, prir në kohën e ardhme të foljes “kam”, këto fjali çë ndodhen në kohën e tashme.

- 1 - Vitorja ka një biçikletë të kuqe, si rrigall (dhuratë).
  - Vitorja ka ketë një biçikletë të kuqe, si rrigall.
  - Vitorja do ketë një biçikletë të kuqe, si rrigall.



- 2 - Marku e Vito kanë një balun të madh.  
 - Marku e Vito \_\_\_\_\_ një balun të madh.  
 - Marku e Vito \_\_\_\_\_ një balun të madh.

- 3 - Sara, ti ke fat të mirë te gjella!  
 - Sara, ti \_\_\_\_\_ fat të mirë te gjella!  
 - Sara, ti \_\_\_\_\_ fat të mirë te gjella!

- 4 - **Ju e kini një mik si u?**  
 - Ju \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ një mik si u?  
 - Ju \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ një mik si u?

- 5 - U kam një nuse arbëreshe.  
 - U \_\_\_\_\_ një nuse arbëreshe.  
 - U \_\_\_\_\_ një nuse arbëreshe.

- 6 - Na ngë kemi skollë të shtunë.  
 - Na ngë \_\_\_\_\_ skollë të shtunë.  
 - Na ngë \_\_\_\_\_ skollë të shtunë.



### Shembuj letrarë

... ti **ka t' kesh** një thësor te qiellja...  
 (FZ - Viti i parë - 18 t'gushtit 1912, n.26 - f. 1, sht.2, r.9)

Në ju doni mirë ata që ju duan mirë, që hjë **do t' kini?**  
 (FZ - Viti i parë - 29 te shtatorit 1912, n. 32 - f. 2, sht.2, r. 20,21)

Në ti po **do të kesh** bekim e uratë...  
 (CT - Canti didascalici, I - f. 56, e para)

... **ka t' më kesh** besë...  
 (CT - II - f. 316, vj. 3)

E dashura nga dielli / për burrë **ka të ket** / të birin e një rregji, / që rreq dhe ka të jet!  
 (CT - Novelline popolari - II, f. 359 - të sprasmet)

Tjerë djelmë e më të mirë / **do të kesh**...  
 (DHEU - K. II - f. 70, vj.13, 14)

Kë **do t' kemi** kurr për shokë?  
 (DHEU - K. IV - f. 172, vj. 554)

## MËSIMI 9F

Folja "jam": koha e ardhme.

Vemi te *koha e ardhme* e foljes *jam*.

Zglith këto shprehje.



- Nestër *ka jem* Palermë. Ti kur *ka jesh* Rromë?



- Vito dej *ka jetë* Napul. Të dy *ka jemi* Rromë të shtunë.



- Mëma e tata thonë se më parë *ka jemi* të mirë.



- Ju *ka jini* të mirë? Jo se *ka jenë* atá të mirë ?!

Ato *ka jem, ka jesh, ka jetë, ka jemi, ka jini, ka jenë* janë vetat e *kobës së ardhme* arbëreshe të foljes "jam".

E si pamë me foljen "kam", arbërisht *koha e ardhme* e foljes "jam" me pjesëzën "ka", që ë e ardhmja e nevojës, shkruhet edhe kështu:

*ka të jem* o *ka t' jem*...

Arbëreshët e vjetër e thëshjën kështu:

*kam të jem  
ke të jesh  
ka të jetë  
kemi të jemi  
kini të jini  
kanë të jenë.*

E te forma me pjesëzën “do”, e ardhmja e vullnetit, bën: *do jem, do jesh, do jetë, do jemi, do jini, do jenë.*

Çë mënd t' shkruhet edhe:

*do të jem o do t'jem ...*

Arbëreshët e vjetër e thëshjën kështu:

*dua të jem  
do të jesh  
do të jetë  
duam të jemi  
doni të jini  
duan të jenë.*

Vëre' tablelet.

FOLJA “**jam**”  
MENYRA DÉFTORE  
KOHA E ARDHME

Njëjës

u ka jem  
ti ka jesh  
ai ka jetë

Shumës

na ka jemi  
ju ka jini  
ata ka jenë

e

Njëjës

u ka t' jem  
ti ka t' jesh  
ai ka t' jetë

Shumës

na ka t' jemi  
ju ka t' jini  
ata ka t' jenë

e si thamë

Njëjës

u do jem  
ti do jesh  
ai do jetë

Shumës

na do jemi  
ju do jini  
ata do jenë

o

Njëjës

u do t' jem  
ti do t' jesh  
ai do t' jetë

Shumës

na do t' jemi  
ju do t' jini  
ata do t' jenë

**Shqip:** unë do të jem, ... ne do të jemi, ju do të jeni, ...

## CA USHTRIME.

Tuke përdorur të dy format “ka” e “do”, prir në kohën e ardhme të foljes “jam” këto fjali çë ndodhen në kohën e tashme.

- 1 - Lia, ti je më e bukura e gjithëve !  
- Lia, ti \_\_\_\_\_ më e bukura e gjithëve !  
- Lia, ti \_\_\_\_\_ më e bukura e gjithëve !
- 2 - Mara e Kele, ju jini të parat e skollës.  
- Mara e Kele, ju \_\_\_\_\_ të parat e skollës.  
- Mara e Kele, ju \_\_\_\_\_ të parat e skollës.
- 3 - Mena ë një vajzë e mirë.  
- Mena \_\_\_\_\_ një vajzë e mirë.  
- Mena \_\_\_\_\_ një vajzë e mirë.
- 4 - Vito, Mara e Mena janë miq për gjithë gjellën.  
- Vito, Mara e Mena \_\_\_\_\_ miq për gjithë gjellën.  
- Vito, Mara e Mena \_\_\_\_\_ miq për gjithë gjellën.
- 5 - Kelja e u jemi të lumtur.  
- Kelja e u \_\_\_\_\_ të lumtur.  
- Kelja e u \_\_\_\_\_ të lumtur.
- 6 - Lenë, po u jam dhëndri jyt !  
- Lenë, po u \_\_\_\_\_ dhëndri jyt !  
- Lenë, po u \_\_\_\_\_ dhëndri jyt !



### Shembuj letrarë

... **ka t' jini** dëshmorë...

(FZ - Viti i parë - 7 te prishit 1912, n. 7 - f. 4, sht.2, r. 4 nga e sprasmja)

... si **ka t' jet** këjo parkalesi ?

(FZ - Viti i parë - 12 të janarit 1913, n.47 - f. 3, sht.2, r.9)

E dashura nga dielli / për burrë ka të ket / të birin e një rregji, / çë rreq dhe **ka të jet!**

(CT - Novelline popolari - II, f. 359 - të sprasmet)

**Do t' jet** dhuratë e jotëja...

(CT - XXXIX - f. 167 - str. 4, vj. 1)

## MËSIMI 10F

Kohët e thjeshta të mënyrës dëftore të foljevet: *kam* e *jam*.

### Mëso

Foljet “kam” e “jam” thërriten folje ndihmëse (litisht: verbi auxiliari), se ndihjën tjerat folje të formojën *kohët e përbëra* (litisht: i tempi composti), si do të shohjëm më atej. Këtu poshtë kemi tabelat e *kohëvet të thjeshta* (litisht: tempi semplici) të mënyrës dëftore të foljevet “kam” e “jam”.

#### MËNYRA DËFTORE E FOLJES “KAM”

##### E TASHMJA

u kam  
ti ke  
ai ka  
na kemi  
ju kini  
ata kanë

##### E PAKRYERA

u kisha  
ti kishe  
ai kish  
na kishëm  
ju kishët  
ata kishën

##### E KRYERA E THJESHTË

u pata  
ti pate  
ai pati  
na patëm  
ju patët  
ata patën

##### E ARDHMJA

u ka kem  
ti ka kesh  
ai ka ketë  
na ka kemi  
ju ka kini  
ata ka kenë

#### MËNYRA DËFTORE E FOLJES “JAM”

##### E TASHMJA

u jam  
ti je  
ai ë (isht, është)  
na jemi  
ju jini  
ata janë

##### E PAKRYERA

u isha  
ti ishe  
ai ish  
na ishëm  
ju ishët  
ata ishën

##### E KRYERA E THJESHTË

u kleva  
ti kleve  
ai kle  
na klemë  
ju kletë  
ata klenë

##### E ARDHMJA

u ka jem  
ti ka jesh  
ai ka jetë  
na ka jemi  
ju ka jini  
ata ka jenë

Çë ë mënyra dëftore ?

Ë mënyra çë na thotë se një e bëmë (një punë, një veprim) ë e sigurtë, reale.

Mënyra dëftore ka tetë (8) kohë.

Katër (4) i njohjëm e janë *kobët e thjeshta*; të tjerat katra do t'i njohjëm, kur të vinjë hera, e janë *kobët e përbëra*.

Vëre' tabelen.

## MËNYRA DËFTORE

E TASHMJA

E KRYERA

E PAKRYERA

E KRYERA E PLOTË

E KRYERA E THJESHTË

E KRYERA E TEJSHKUAR

E ARDHMJA

E ARDHMJA E PËRPARME

E dini "mënyrën dëftore"  
të foljevet "kam" e "jam" ?

Uuuuuhhhh !!!!!



## MËSIMI 11F

Zgjedhimi i parë: koha e tashme e mënyrës dëftore.

Vëre' nani *zgjedhimin* (litisht: coniugazione) e foljevet të tjera.

Zglith mirë këtë përshkrim (litisht: descrizione).

### KA SHËNJANJI

Bukur ë kur *shkonj* ka ShënjANJI sa dielli *perëndon* aprapa malevet e *dërgon* rrezet lart te qielli mbi ca mjegulla që *shkëlqejën* të kuqe si kërshi.

Edhe kopshtet, sh(të)pitë, rrugët janë të kuqe, edhe lisat e njerëzit janë të kuq.

Ti *rron* ata pak minute të perëndimit si në ëndërr: natyra të *mblon* zemrën me zjarr, se pra njëze *rrotullojën* në qiell mbrëmja e nata.

Ma (por) prapa natës të gjithë *kërkojëm* pameta dritën e diellit.

Çë janë foljet

*shkonj, perëndon, dërgon, shkëlqejën, rron, mblon, rrotullojën, kërkojëm?*

Janë veta të *kobës së tashme* të mënyrës dëftore të zgjedhimit të parë.

Vëre' tabelen

### ZGJEDHIMI I PARË

FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës

u kërkonj (shqip: kërkuj)

ti kërkon

ai kërkon

Shumës

na kërkojëm (shqip: -jmë)

ju kërkoni

ata kërkojën (shqip: -jnë)

Si *kërkonj* zgjedhohen (konjugaren) të gjitha foljet e tjera që daljën

- me *-o-nj* (*shkonj, dërgonj, rronj, mblonj, rrotullonj, ...*).

Si foljet që daljen me *-o-nj*, zgjedhohen edhe foljet që daljen

- me *-a-nj* (bluanj, çanj, lanj, shkruanj, ...);
- me *-e-nj* (rrëfyenj, shkëlqenj, ...),
- me *-ë-nj* (bënj, ...);
- me *-i-nj* (fshinj, grinj, ...),
- me *-y-nj* (hynj).

Nani dimë se  
“**zgjedhimi I**” (i parë)  
mban folje që daljen  
me **-nj**.



## CA USHTRIME

Vër, te veta e duhur e kohës së tashme të mënyrës dëftore, foljet që ndodhen te ana.

- 1) bënj > Marku, ti \_\_\_\_\_ atë që do.
- 2) shkruanj > Marku e Vito \_\_\_\_\_ bashkë.
- 3) fshinj > Sara e Kele, ju ng' e \_\_\_\_\_ mirë dhomën (stancën) tëj.
- 4) vërenj > Lia e Mara \_\_\_\_\_ panoramin e Horës.
- 5) dërgonj > Ju për urdhuratat më \_\_\_\_\_ po mua!
- 6) rronj > Na \_\_\_\_\_ te Hora.
- 7) hynj > Këmba ngë më \_\_\_\_\_ te këpuca.
- 8) lanj > Makinën e \_\_\_\_\_ me duart tona.
- 9) ndenj > Ju pethkat i \_\_\_\_\_ te stendini.
- 10) shponj > **Glëmbat e trundafiles** \_\_\_\_\_.





## MËSIMI 12F

Zgjedhimi i dytë: koha e tashme e mënyrës dëftore.

Zglith mirë këtë përshkrim:

### TE GHAMILI I HORËS SË ARBËRESHËVET

- Lia, u të *pres* te Ghamili me biçikletën e pra *marrjëm* stratën (dhromin, rrugën) e Purteles: më parë *rrjedhjëm* te pujata (në të përpjetë) e pra te shinuta (në të tatëpjetë).

- Ëj, mirë! U *thërres* Marën, ajo *flet* me Sarën, *marrjëm* biçikletat e kush arrën i pari te Ghamili *pret*.

Bukur vend Ghamili! Ka (nga) Ghamili ke përposh syvet një pjesë të madhe të Horës: liqeni *merr* thujse gjithë fushën, honi *pret* malin Maghanuç ka (nga) mali Kumeta, Maghanuçi *shket* te liqeni e syu jynë *kumbis* thujse mbi ujërat atë shpatull e Kumetës, *çë jep* mbi Honin. Ka (nga) Ghamili *sheh* edhe Sëndastinën; më llargu *sheh* malet Madonie e më atëj se Honi *njeh*, në *hap* mirë sytë, edhe Kuntisën. Bukur vend ë Ghamili!

#### Çë janë foljet

*pres, marrjëm, rrjedhjëm, thërres, flet, pret (prita), merr, pret (preva), shket, kumbis, jep, sheh, njeh, hap?*

Janë veta të “kohës së tashme të mënyrës dëftore të zgjedhimit të dytë”.

Te “zgjedhimi i dytë” ndodhen të gjitha foljet *çë daljën*, te *veta e parë e kohës së tashme të mënyrës dëftore*, me ndonjë bashkëtingëllore (konsonante):

**-b, -dh, -h, -k, -l, -p, -q, -r, -rr, -s, -sh, -z.**

Si këto folje: *trëmb, rrjedh, njoh, pjek, vjel, hap, jap, beq, nxier e nxjerr, marr, pres (preva), pres (prita), flas, thërres, kumbis, shosh, dbez e ndez, ...*

Ca shembuj.

### ZGJEDHIMI I DYTË

FOLJA "hap"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u hap  
ti hap  
ai hap

Shumës  
na hapjëm (shqip: hapim\*)  
ju hapni  
ata hapjën (shqip: hapin\*)

\* Si shembull shqip për zgjedhimin e dytë.

Si "hap" zgjedhohen pa ndërruar mbaresa te numri njëjës i kohës së tashme të mënyrës dëftore: *rrjedb, trëmb, vjel, beq, kumbis, shosh, dhez e ndez, ...* (Kujto: *vjel, vjel, vjel; na vjeljëm, ju vilni, ata vjeljën*)

FOLJA "pres"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u pres  
ti pret  
ai pret

Shumës  
na presjëm  
ju prini  
ata presjën

Si "pres" zgjedhohen: *thërres, shes, flas (ti, ai flet; na flasjëm, ju flini, ata flasjën), ngas (ti, ai nget; na ngasjëm, ju ngini, ata ngasjën), shkas (ti, ai shket; na shkasjëm, ju shkini, ata shkasjën), vras (ti, ai vret; na vrasjëm, ju vrini, ata vrasjën), etj.*

FOLJA "njoh"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u njoh  
ti njeh  
ai njeh

Shumës  
na njohjëm  
ju njihni  
ata njohjën

Si "njoh" zgjedhohet folja *shoh*.

FOLJA "marr"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u marr  
ti merr  
ai merr

Shumës  
na marrjëm  
ju mirrni  
ata marrjën

Si "marr" qillet, për shembull, edhe "jap": *jap, jep, jep, japjëm, jipni, japjën.*

Nani dimë se  
"zgjedhimi II" (i dytë)  
mban folje që daljën  
me **bashketingëllore:**  
**-b,-dh,-h,-k,-l,-p,-q,-r,-rr,-s,-sh,-z.**

USHTRIME

Vër, te veta e duhur e kohës së tashme të mënyrës dëftore, foljet që ndodhen te ana.

- 1) pres > Sara, si i \_\_\_\_\_ ato lakra?
- 2) marr > Maçja \_\_\_\_\_ miun.
- 3) rrjedh > Vito \_\_\_\_\_.
- 4) shoh > Nona i \_\_\_\_\_ pak.
- 5) jap > **Vo' Rieja i \_\_\_\_\_ bukën njëi të vapku.**
- 6) shkas > Mara e Mena, ju \_\_\_\_\_ ngaherë tek ato ballata.
- 7) shkas > Mara \_\_\_\_\_ ngaherë kur bie shi.
- 8) thërres > Mëmat \_\_\_\_\_ bijtë.
- 9) marr > Ju shërbiset i \_\_\_\_\_ lik.
- 10) pres > Sara e Lia, ju më \_\_\_\_\_ ka Shën Gjergji.



## MËSIMI 13F

Zgjedhimi i tretë: koha e tashme e mënyrës dëftore.

### Kemi pra zgjedhimin e tretë!

Vëre' mirë si bien foljet te ky përshkrim.

#### TE SHËN MËRIA E DHITRJES

Kush zë dhromin e malit Picuta e vete te Shën Mëria e Dhitrjes, *di* se ajo ë rruga mali më e vjetër e Horës.

Kur jini atje lart, *vëni* re si klishtëza *rri* bukur te rrëzat e Picutës: t' Atërat (Etërit) tanë patën sy të mirë!

Te moi i gushtit, si menatnet njize i *bie* kambana e klishtëzës, na *vemi* te mesha me tjerët besimtarë.

Nga Shën Meria e Dhitrjes kemi përpara të lerit e diellit. E ë bukur kur besimtarët, si sos mesha, *zënë* fill këngat e kujtimit për Shqipërinë e për Morenë (O e bukura More!), *çë rrinë* këtë llargu, më atej se malet e malevet, më atej se dejtji.

Dielli nanë *shtie* rrezet e tij mbi klishtëzën e na *zëmë* fill njetër ditë.



#### Foljet

*zë, vete, di, vëni, rri, bie, vemi, zënë, rrinë, shtie, zëmë* *çë janë?*  
Janë veta të *kobës së tashme të mënyrës dëftore të zgjedhimit të tretë.*

Te zgjedhimi i tretë bëjën pjesë të gjitha foljet *çë daljën*, te *veta e parë e kobës së tashme të dëftores*, me ndonjë **zanore**

*-a, -e, -ë, -i,*

si foljet *ba, bie, shtie, vete, lë, vë, zë, di, pi, rri*.

## ZGJEDHIMI I TRETË

FOLJA "zë"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u zë  
ti zë  
ai zë

Shumës  
na zëmë  
ju zëni (shqip: zini)  
ata zënë

Si “zë” zgjedhohen te koha e tashme e mënyrës dëftore: *vë, lë, ha (ti, ai ha; na bamë, ju hani, ata hanë), di (ti, ai di; na dimë, ju dini, ata dinë), rri (ti, ai rri; na rrimë, ju rriini, ata rrinë), etj.*

FOLJA “**shtie**”  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës

u shtie  
ti shtie  
ai shtie

Shumës

na shtiem  
ju shtini  
ata shtien

Si “shtie” zgjedhohet te koha e tashme e mënyrës dëftore folja *bie*.

FOLJA “**vete**”  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës

u vete  
ti vete  
ai vete

Shumës

na vemë  
ju veni  
ata venë

Nani dimë se  
“**zgjedhimi III**” (i tretë)  
mban folje që daljen  
me **zanore**: *-a, -e, -ë, -i.*

### USHTRIME

Vër, te veta e duhur e kohës së tashme të mënyrës dëftore, foljet që ndodhen te ana.

- 1) lë > Maçja \_\_\_ maçiçelet vetëm.
- 2) ha > Lia e Marku \_\_\_ brumë me lënk.
- 3) pi > Lia e Marku nga menatë \_\_\_ klëmshit.
- 4) shtie > Mara \_\_\_ drudhet te dheu.
- 5) shtie > Ju ngaherë \_\_\_ drudhet te dheu.
- 6) vete > Ju \_\_\_ e vini ka Palerma ngaditë.
- 7) vete > **Ata \_\_\_ ngaditë Palermë.**
- 8) rri > Djali \_\_\_ mirë me ne.
- 9) di > Lia e Marku \_\_\_ gjithqish.
- 10) di > Te skolla: - Sara e Vito, ju sot ngë \_\_\_ gjë.



## MËSIMI 14F

Koha e pakryer e mënyrës dëftore.

Pamë si bën *koha e tashme e mënyrës dëftore* te të tre zgjedhimet.

Shohjëm nani si bën "*e pakryera*".

Zglith mirë këtë rrëfim.



### NONA NA RRËFYEJ

Nona na *rrëfyej* se aty te Kryqja e Palermës, përpara kapiluces së Shën Mërisë, ish një brivaturë si ajo te Shën Kolli, ku gratë *vijën e mblojën* ujët e *lajën* pethkat.

Ato çë *rrijën* te gjitonia, ujët *vijën e e mblojën* me kënatën, e ngë *bëjën* dhrome me nxiroten, se *mirrjën* ujët çë *dilëj* drejtpërdrejt nga kroi.

Kush *rrij* llargu, *vij* me nxiren (o nxiroten) e mbrazët e *vej* te shpia me nxiren (o nxiroten) e plotë mbi krahë. Te shpia ata ujë e *pijën*, *lajën e i shërbej* për tjera bëzonjë.

Kush *shkoj* tek ato anë *shihëj* gratë përposh barrës së nxires, por *mendoj* se ish detyrë grash e ngë *thëshëj* gjë.

U *ndëlgoja* se gratë antike *bëjën* më pak shëbërtirë se ato sot, ma (por), si më *thëshëj* noni, gjithë gratë ahierna *shërbejën* më shumë se një pelë.

Ngë *dije* çë ishën "nxirja" e "nxirotja"?

Ishën kaputë (reçipienti) druri, si mënd t' i shohësh sot te museu arbëresh.

Nona, më parë, kur ngë *dija* gjagjë më *jipëj* një cikitatë te faqja!

Marrjëm nga rrëfimi gjithë foljet, çë ngë njohjëm te forma:

*rrëfyej, vijën, mblojën, lajën, bëjën, mirrjën, dilëj, rrij, vij, vej, pijën, shërbej, shkoj, shihëj, mendoj, thëshëj, ndëlgoja, shërbejën, dije, dija, jipëj.*

Çë forma janë ?

Janë forma të së pakryerës dëftore.

Nani duhet t'i ndajëm sipas *zgjedhimit të parë, të dytë e të tretë.*

● Të *zgjedhimit të parë* (çë te koha e tashme e dëftores daljën me -onj, -anj, -enj, -inj) janë: *rrëfyej (rrëfyenj), vijën e vij (vinj), mblojën (mblonj), lajën (lanj), bëjën (bënj), dilëj (da(lë)nj), vij (vinj), shërbej e shërbejën (shërbenj), shkoj (shkonj), mendoj (mendonj), ndëlgoja (ndëlgonj).*

● Të zgjedhimit të dytë (çë te koha e tashme e dëftores daljën me bashkëtingëllore) janë: *mirrjën (marr)*, *shibëj (shob)*, *thëshëj (thom)*, *jipëj (jap)*.

● Të zgjedhimit të tretë (çë te koha e tashme e dëftores daljën me zanore) janë: *vej (vete)*, *pijën (pi)*, *dije e dija (di)*.



Është hera të vërejëm tabelat.

## ZGJEDHIMI I PARË

FOLJA “**kërkonj**”  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E PAKRYER

Njëjës	Shumës
u kërkoha	na kërkojëm (shqip: kërkonim)
ti kërkoi	ju kërkujtë (shqip: kërkonit)
ai kërkoi (shqip: kërkonte)	ata kërkujtë (shqip: kërkonin)

Si “kërkonj” zgjedhohen gjithë foljet e *zgjedhimit të parë*: (*shkonj*) *shkoja, shkoje, shkoj, ...*; (*lanj*) *laja, laje laj, ...*; (*rrëfyej*) *rrëfyeja, rrëfyeje, rrëfyej, ...*; (*vinj*) *vija, vije, vij, ...*; etj.

Folja e parregullt “da(lë)nj” te koha e pakryer bën kështu: *dilja, dilje, dilëj, diljëm, diljët, diljën*.



## ZGJEDHIMI I DYTË

FOLJA “**hap**”  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E PAKRYER

Njëjës	Shumës
u hapja	na hapjëm (shqip: hapnim)
ti hapje	ju hapjët (shqip: hapnit)
ai hapëj (shqip: hapte)	ata hapjën (shqip: hapnin)

Si “hap” zgjedhohen gjithë foljet e *zgjedhimit të dytë*: (*përpijek*) *përpiqja, përpiqje, përpiqëj, përpiqjëm, përpiqjët, përpiqjën*; etj.

Folje të parregullta të koha e pakryer:

- **flas** flisja, flisje, flisëj, flisjëm, flisjët, flisjën.
- **jap** jipja, jipje, jipëj, jipjëm, jipjët, jipjën.
- **marr** mirrja, mirrje, mirrëj, mirrjëm, mirrjët, mirrjën.
- **njoh** njihja, njihje, njihëj, njihjëm, njihjët, njihjën.
- **rrjedh** rridhja, rridhje, rridhëj, rridhjëm, rridhjët, rridhjën;  
e rrijdhja, etj...
- **shoh** shihja, shihje, shihëj, shihjëm, shihjët, shihjën.
- **thom** thëshja, thëshje, thëshëj, thëshjëm, thëshjët, thëshjën;  
e thoshja, thoshje, thoshëj, thoshjëm, thoshjët, thoshjën.
- **pres** prisja, prisje, prisëj, prisjëm, prisjët, prisjën.
- **vdes** vdisja, vdisje, vdisëj, vdisjëm, vdisjët, vdisjën.



## ZGJEDHIMI I TRETË

FOLJA "zë"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E PAKRYER

Njëjës

- u zëja (shqip: zija)
- ti zëje (shqip: zije)
- ai zëj (shqip: zinte)

Shumës

- na zëjëm (shqip: zinin)
- ju zëjët (shqip: zinit)
- ata zëjën (shqip: zinin)

Si "zë" zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të tretë: (ha) *baja, baje, haj, bajëm, bajët, bajën*; (lë) *lëja, lëje, lëj, lëjem, lëjët, lëjën*; (vete) *veja, veje, vej, vejëm, vejët, vejën*.

Folja "dua" bën kështu: *deja, deje, dej, dejëm, dejët, dejën*.

## USHTRIME

Vër të koha e pakryer këto folje që të ana ndodhen të koha e tashme e dëftores.

- 1) *lanj* - Lia laj xhubotin.
- 2) *shkruanj* - **Mara** \_\_\_\_\_ .
- 3) *rrëfyenj* - Nona \_\_\_\_\_ një pullare.
- 4) *kërkonj* - Ju kë \_\_\_\_\_ këtu ?
- 5) *shkul* - Era \_\_\_\_\_ fletët.
- 6) *hap* - Ju ngë i \_\_\_\_\_ sytë !
- 7) *hap* - **Sopata i** \_\_\_\_\_ **drutë**.
- 8) *përpyjek* - Dje Vito \_\_\_\_\_ miqtë.
- 9) *sos* - Festa \_\_\_\_\_ të hënë.
- 10) *zë* - Festa \_\_\_\_\_ të diel.





## Shembuj letrarë

... i çili **përisëj** edhe ai rregjërín e Perëndís...

(FZ – Viti i parë – 21 të prighit 1912 – n. 9, f. 1, sht. 1, r. 3)

E Marieja Madalenë e Marieja e Josefit **rrijën** e **vërrejën** ku e **vujën**.

(FZ – Viti i parë – 21 të prighit 1912 – n. 9, f. 1, sht. 2, r. 1/3)

E **thoshjën** ndër 'to....

(FZ – Viti i parë – 21 të prighit 1912 – n. 9, f. 1, sht. 2, r. 11)

Kështu na **rrefiejën** Atrat shejtë...

(FZ – Viti i parë – 28 të prighit 1912 – n. 10, f. 2, sht. 1, r. 18)

... vërteta **rrijën** të fshehurë te njetrë dhomë.

(FZ – Viti i katrët – 28 të marsit 1915 – n. 6, f. 3, sht. 2, r. 20)

Nga ditë ajo e **lodhëj** e e **sosëj** tue piejtur...

(FZ – Viti i katrët – 28 të marsit 1915 – n. 6, f. 3, sht. 2, 3 nga e sprasmja)

Ajo shpi **ishëj** plotë me burra e me gra, e atë **ishëjën** edhe të parët e Filistenjëvet, e rreth mbi shpin si tri mijë burra e gra që **vërrejën** si luaj Sansoni.

(FZ – Viti i katrët – 28 të marsit 1915 – n. 6, f. 4, sht. 2, r. 8/12)

... Zuri di kullonët mbi të çilat **rrij** shpia...

(FZ – Viti i katrët – 28 të marsit 1915 – n. 6, f. 4, sht. 2, r. 16)

Menatënet Miniú, kur **dilej** ndër trundafilet me kalin e 'tij, ish të vërrehej...

(CT – Novelline popolari –IV, f. 367, r. 14)

Po kush e **shihëj**?

(CT – Novelline popolari –IV, f. 367, r. 17)

... kur **sbrisëj** nga kali, **shklepoj**.

(CT – Novelline popolari –IV, f. 367, r. 24)

...ish e vetmja që **dij** sa Miniú **ish** i bukur menatënet... Më para se të dihej dita, kur **zëj** e **egjelloj**, ajo vëhej te dritësorja, tue pritur... të dashurin, që **vërrej** me gas e që **përziej** gjakun, me ata sy... Ngë shkoj shumë e vajza i tha rregjit se ajo **dej** Miniun për burrë.

(CT – Novelline popolari –IV, f. 367 e 368, të sprasmet e të parat e dy faqevet)

Gjërít e luftarët **ishën** e **pëlsisëjën** gazeshit, kur e pan, e i **thoshëjën**...

(CT – Novelline popolari –IV, f. 368, r. 17, 18)

Rregji **mirrëj** vesh pa shqepur buzë.

(CT – Novelline popolari –VI, f. 382, r. 15)

**Klaj** e shëmbej tue thënë...

(CT – Novelline popolari –VIII, f. 392, r. 2 nga e sprasmja)

... hiri te ëndërra e saj që **flej**...

(CT – Novelline popolari –VIII, f. 393, r. 11)

## MËSIMI 15F

Koha e kryer e thjeshtë.

Vemi te *koha e kryer e thjeshtë*,  
çë e ka vetëm *mënyra dëftore*.  
Vëre' ku ndodhet te rrëfimi këtu poshtë.



### TURISTI

Një herë *përpoqa* një turist liti' çë më *pyeji* kur Arbëreshët *stisën* klishën e Shë' Mitrin. U ngë kujtoja vitin, ma (por) pra *kërkova* te trutë e ashtu mbi një thërrime e *vërejta*, *fola*, e i *thashë* se Shë' Mitrin *zunë* fill t'e stisjen te viti 1589. Pra i *(dë)ftova* tabelen përpara façatës (ballinës) e i *thashë* se mënd t'e zglidhëj atje.

Turisti *deshi* të dijë tjera shërbise. U i *thashë* se klisha sot ka ikonostasin e ë klishë bizantine; ma (por) më para ish klishë gjymta litire, se pikturat i *bëri* Pietro Novelli nga Murrialli te vitet 1641-1644.

Ai turist *qëndroi*, *hapi* sytë e gojën se u dija gjithë këto shërbise e *zuri* fill të më pyej ku i *mësova*. U i *thashë* se m' i *mësoi* skolla "arbëreshe".

Ai më *tha* se isha një djalë i zgjuar e pra të dy *shkuam* te kafeu e më *bleu* një xhilat (i frohtë, akulllore).

Te kafeu pra *hyrën* ca burra e të gjithë *pinë* aperitivin çë *paguajti* turisti.

### Çë janë

*përpoqa*, *pyeji*, *stisën*, *kërkova*, *vërejta*, *fola*, *thashë*, *zunë*, *(dë)ftova*, *deshi*, *bëri*, *qëndroi*, *hapi*, *zuri*, *mësova*, *mësoi*, *tha*, *shkuam*, *bleu*, *hyrën*, *pinë*, *paguajti* ?

Janë veta të *kobës së kryer të thjeshtë* çë e ka vetëm *mënyra dëftore*.  
Nani duhet t'i ndajëm sipas *zgjedhimit të parë*, *të dytë* e *të tretë*.

● **Të zgjedhimit të parë** (çë te koha e tashme e dëftores daljën me **-onj**, **-anj**, **-enj**, etj.) janë: *pyeji* (*pyenj*), *kërkova* (*kërkonj*), *vërejta* (*vërenj*), *(dë)ftova* (*dë-ftonj*), *bëri* (*bënj*), *qëndroi* (*qëndronj*), *mësova* e *mësoi* (*mësonj*), *shkuam* (*shkonj*), *hyrën* (*bynj*), *paguajti* (*paguanj*).

● **Të zgjedhimit të dytë** (çë te koha e tashme e dëftores daljën me **bashkëtingëllore**) janë: *përpoqa* (*përppjek*), *stisën* (*stis*), *fola* (*flas*), *thashë* e *tha* (*thom*), *hapi* (*hap*).

● **Të zgjedhimit të tretë** (çë te koha e tashme e dëftores daljën me **zanore**) janë: *zunë* e *zuri* (*zë*), *deshi* (*dua*), *bleu* (*ble*), *pinë* (*pi*).

Vëre' tabelët.

## ZGJEDHIMI I PARË

FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës	Shumës
u kërkova	na kërkuan
ti kërkove	ju kërkuat
ai kërkoi	ata kërkuan

Si "kërkonj" zgjedhohen shumë folje të zgjedhimit të parë: (*shkonj*) *shkova, shkove, shkoi, shkuam, shkuat, shkuan*; (*qëndronj*) *qëndrova, qëndrove, qëndroi, qëndruam, qëndruat, qëndruan*; ... .

Edhe:

FOLJA "lanj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës	Shumës
u lajta	na lajtëm
ti lajte	ju lajtët
ai lajti	ata lajtën

Si "lanj" zgjedhohen shumë folje të zgjedhimit të parë : (*shkruanj*) *shkruajta, shkruajte, shkruajti, shkruajtëm, shkruajatët, shkruajtën*; (*rrëfyej*) *rrëfyejta, rrëfyejte, rrëfyejti, rrëfyejtëm, rrëfyejtët, rrëfyejtën*,...

Edhe:

FOLJA "bënj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës	Shumës
u bëra	na bëmë
ti bëre	ju bëtë
ai bëri	ata bënë

Folje të parregullta të koha e kryer e thjeshtë:

- da(lë)nj : *dolla, dolle, dolli, dollëm, dollët, dollën.*
- vinj : (*j*)*erdha, (j)erdhe, (j)erdhi, (j)erdbëm, (j)erdbët, (j)erdbën.*



## ZGJEDHIMI I DYTË

### FOLJA "hap" MËNYRA DËFTORE KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës  
u hapa  
ti hape  
ai hapi

Shumës  
na hapëm  
ju hapët  
ata hapën

Si "hap" zgjedhohen thujtse të gjitha foljet e zgjedhimit të dytë: (*përpyjek*) *përpoqa, përpoqe, përpoqi, përpoqëm, përpoqët, përpoqën; (shkul) shkula, shkule, shkuli, shkulëm, shkulët, shkulën; (sos) sosa, sose, sosi, sosëm, sosët, sosën; ...*

Folja "njoh": *njoha, njobe, njohu, njohëm, njohët, njohën.*

Edhe:

### FOLJA "shkas" MËNYRA DËFTORE KOHA E KRYER E THJESHTË

Njëjës  
u shkava  
ti shkave  
ai shkau

Shumës  
na shkamë  
ju shkatë  
ata shkanë

Si "shkas" zgjedhohen *vras, ngas, etj.*

Ca folje të parregullta të koha e kryer e thjeshtë :

- **flas** *folat, fole, foli, folëm, folët, folën.*
- **jap** *dhashë, dhe, dbe, dhamë, dhatë, dhanë.*
- **marr** *mora, more, mori, morëm, morët, morën ;*  
*e mora, more, mori, muar(t)ëm, muar(t)ët, muar(t)ën.*
- **mbjedh** *mbjodba, mbjodbe, mbjodbi, ...*
- **rrjedh** *rrodha, rrodbe, rrodhi, rrodhëm, rrodhët, rrodhën.*
- **shoh** *pashë, pe, pe, pamë, patë, panë.*
- **thom** *thashë, the, the, thamë, thatë, thanë.*
- **vdes** *vdiqa, vdiqe, vdiq, vdiqëm, vdiqët, vdiqën.*



## ZGJEDHIMI I TRETË

### FOLJA "zë" MËNYRA DËFTORE KOHJA E KRYER E THJESHTË

Njëjës  
u zura  
ti zure  
ai zuri

Shumës  
na zumë  
ju zutë  
ata zunë

Si "zë" zgjedhohet folja *vë*: *vura, vure, vuri, vumë, vutë, vunë.*

Edhe:

### FOLJA "di" MËNYRA DËFTORE KOHJA E KRYER E THJESHTË

Njëjës  
u dijta  
ti dije  
ai diji

Shumës  
na dijtëm  
ju dijtët  
ata dijtën

Si "di" zgjedhohet *ri*: *rrijta, rrijte, rrijti, rrijtëm, rrijtët, rrijtën.*  
Folja *flë* bën kështu: *flëjta, flëjte, flëjti, flëjtëm, flëjtët, flëjtën.*

Ca folje të parregullta të koha e kryer e thjeshtë :

- **bie** *prura, prure, pruri, prumë, prutë, prunë.*
- **bie** *rashë, re, re, ramë, ratë, ranë.*
- **dua** *desha, deshe, deshi, deshëm, deshët, deshën.*
- **ha** *hëngra, hëngre, hëngri, hëngrëm, hëngrët, hëngrën.*
- **lë** *lashë, le, la, lamë, latë, lanë.*
- **pi** *piva, pive, piu, pimë, pitë, pinë.*

### USHTRIME

Vër në kohën e kryer të thjeshtë këto folje që të ana ndodhen në kohën e tashme të dëftores

- 1) *lanj* - Lia lajti xhubotin.
- 2) *shkruanj* - Mara \_\_\_\_\_ një letër.
- 3) *rrëfyenj* - Nona \_\_\_\_\_ një pullare.
- 4) *kërkonj* - Ju kë \_\_\_\_\_ këtu ?
- 5) *shkul* - Era \_\_\_\_\_ fletët.
- 6) *hap* - Ju ngë i \_\_\_\_\_ sytë !
- 7) *hap* - Marku \_\_\_\_\_ dritaret
- 8) *përpyjek* - Dje Vito \_\_\_\_\_ miqtë.
- 9) *sos* - Festa \_\_\_\_\_ të hënë.
- 10) *zë* - Festa \_\_\_\_\_ të diel.

## MËSIMI 16F

Koha e ardhme.

Vemi te *koha e ardhme*,  
çë e ka vetëm *mënyra dëftore*.

Zglith e vëre' mirë.

### TE SHESHI

Te skolla *ka* na *lënë* një temë mbi klishtë e Horës e u *nestër do shkonj* te "Sheshi" e *do shoh* ku ndodhen e sa janë klishtë e Horës.

*Ka zë* fill *ka* (nga) rrëzat e malit Picuta, ku ndodhet klishtëza e Odhigjitrjes e *ka sos* te klishta e Shën Gjonit, përposh Sklicës.

Në mes të panoramit të Horës, *do zotërojën* kumbulluni i madh i Shën Mërisë Odhigjitrje te qaca e pak më atej kambanari i hollë e i glatë i Shën Gjergjit.

*Do vërenj* pra te ana e sipërme e Horës e *do shoh* façatën (ballinën) e bukur me shkallunerën e gjerë të klishtës së Shën Vitit, e pak më lart klishtën e Patrevet.

Te ana e poshtme e Horës *ka përseks* në mes të shpivët kambanarin e shkurtur, me majën guri të gjallë, të Shën Mitrit e, pak më atej, *ka kërkonj* kambanarin e vogël të Shën Mërisë së Rruzarit.

Pra, *ka prier* sytë drejt klishtës së Shën Kollit e, më tek e shtrëmbra, *ka hap* sytë mirë e *do shoh* klishtëzën e Shën Gjonit.

Kështu *ka di* ku janë e sa janë klishtë e Horës e te skolla *ka bënj* një temë të bukur.

Më parë se të ndajëm foljet e rrëfimit sipas zgjedhimevet, kujto se *koha e ardhme* tek na arbëreshë bëhet me ato dy pjesëza çë pamë: *ka* (e ardhmja e nevojës, e bëzonjës), e *do* (e ardhmja e vullnetit).

Vëre' nani çilat janë foljet te *koha e ardhme*:

*ka lënë, do shkonj, do shoh, ka zë, ka sos, do zotërojën, do vërenj, ka përseks, ka kërkonj, ka prier, ka hap, ka di, ka bënj.*



● **Të zgjedhimit të parë** (çë te koha e tashme e dëftores daljën me **-onj, -anj, -enj, ...** ) janë: *do sbkonj (sbkonj), do zotërojën (zotëronj), do vërenj (vërenj), ka kërkonj (kërkonj), ka bënj (bënj).*

● **Të zgjedhimit të dytë** (çë te koha e tashme e dëftores daljën me **bashkëtingëllore**) janë: *do shoh (shoh), ka sos (sos), ka përseks (përseks), ka prier (prier), ka hap (hap).*

● **Të zgjedhimit të tretë** (çë te koha e tashme e dëftores daljën me **zanore**) janë: *ka lënë (lë), ka zë (zë), ka di (di).*

Është hera të vërejëm tabelat!

### ZGJEDHIMI I PARË

FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E ARDHME

Njëjës

u ka kërkonj  
ti ka kërkosht  
ai ka kërkonjë

Shumës

na ka kërkojmë  
ju ka kërkonit  
ata ka kërkojnë

Edhe: u ka të kërkonj, ...; e: u ka t' kërkonj, ...

Me "do": u do kërkonj, ...; edhe: u do të kërkonj, ...; e: u do t' kërkonj, ...

Si "kërkonj" zgjedhohen të gjitha foljet e *zgjedhimit të parë*.



### ZGJEDHIMI I DYTË

FOLJA "hap"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E ARDHME

Njëjës

u ka hap  
ti ka hapësh  
ai ka hapënj

Shumës

na ka hapjmë  
ju ka hapnit  
ata ka hapjnë

Me "ka t'" e me "do t'" vëre' te zgjedhimi i parë.

## Vër re

- **flas** - *ka flas, ka flasësh (e ka flaç), ka flasënj; ka flasjëm, ka flini, ka flasjën.*
- **jap** - *ka jap, ka japësh, ka japënj; ka japjëm, ka jipni, ka japjën*
- **pres** - *ka pres, ka presësh (e ka preç), ka presënj; ka presjëm, ka prini, ka presjën*
- **rrjedh** - *ka rrjedh, ka rrjedhësh, ka rrjedhënj; ka rrjedhjëm, ka rridhni e ka rrjidhni, ka rrjedhjën.*
- **shes** - *ka shes, ka shesësh (e ka sheç), ka shesënj; ka shesjëm, ka shini, ka shesjën.*
- **shkas** - *ka shkas, ka shkasësh (e ka shkaç), ka shkasënj; ka shkasjëm, ka shkini, ka shkasjën.*
- **shoh** - *ka shoh, ka shohësh, ka shohënj; ka shohjëm, ka shibni, ka shohjën.*

etj.



## ZGJEDHIMI I TRETË

FOLJA "zë"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E ARDHME

Njëjës

u ka zë  
ti ka zësh  
ai ka zënj

Shumës

na ka zëmë  
ju ka zëni  
ata ka zënë

Me "ka t'" e me "do t'" vëre' te zgjedhimi i parë.

Si "zë" zgjedhohen të gjitha foljet e zgjedhimit të tretë.

Folja "vete" bën kështu: *ka vete, ka veç, ka ve, ka vemi, ka veni, ka venë.*



## USHTRIME

Vër në kohën e ardhme këto folje që te ana ndodhen në kohën e tashme të dëftores:

- 1) pres - Na \_\_\_\_\_ dy dërrasa me serrën
- 2) shkonj - Nestër u \_\_\_\_\_ te nona.
- 3) lë - Marë, lulet te bari \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ të rriten.
- 4) shes - Marku \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ biçikletën e tij.
- 5) ndërronj - Sara \_\_\_\_\_ shpi.
- 6) ndenj - Lia \_\_\_\_\_ mbaracet.
- 7) stis - Mas Gjergji \_\_\_\_\_ një shpi te Fusha.
- 8) zbill - E jëma e Maries \_\_\_\_\_ një putigë te Gamili.
- 9) pres - Kele, ku \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ miket ?
- 10) pres - Marë, Sarë e Lia, ku \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ Kelen ?
- 11) zë - Nestër \_\_\_\_\_ festa e Shën Mërisë.
- 12) jap - Ju, Vito e Marko, \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ këtë disk Marës.



### Shembuj letrarë.

Kush pi nga këta ujë, **do t' ket** pameta etë: po kush të pie nga ujët që u **dua t' i jap**, ngë **ka t' ket** më etë për gjithmonë: pse ujët që **ka t' i jap, do t' bënet**\* tek ai një krua ujësh, që **ka t' buronjë** për gjellë të pasosme...

(FZ - Viti i parë - 5 të mait 1912, n. 11 - f. 2, sht. 1, r. 2/10) \* forma pësore-vetvetore (shih)

... Mesia... kur **të vinjë** ai, **do të na dëftonjë** gjithqish.

(FZ - Viti i parë - 5 të mait 1912, n. 11 - f. 2, sht. 2, r. 11)

Rregjëria e Perëndis ngë isht të ngrënë e të pir...; andaj ngë **ka t' hijën** tek ajo të qosëmë...

(FZ - Viti i katrët - 21 të marsit 1915, n. 5 - f. 1, teksti r. 1 e 2)

Përçë **ka t' bujëm** luftë të gjithë? Sgëlidhëni një burrë ndër jush sa t' luftonjë me mua: në ai më munt' e më vret, na **do t' bënëmi**\* shërbëtorë t'ajëshit; po në munj u e e vras, ju **do t' jini** shërbëtorë t'anëshit.

(FZ - Viti i katrët - 9 të mait 1915, n. 12 - f. 3, sht. 2, r. 8/13 Dhiata e vietër) \* forma pësore-vetvetore

**Kam të rri** një muaj jashta shpis...

(CT - Novelline popolari - VIII, f. 392, r. 5 nga e sprasmja)

Klaj e shëmbej tue thënë: - E si **kam të bënj**, mjera u e mjera! **Si kam të bënj!**

(CT - Novelline popolari - VIII, f. 392, e sprasmja)

... i shoqi i tha: Naní, mbré gruaza e jime, ti ngë **ke të bësh** më gjë...

(CT - Novelline popolari - VIII, f. 393, r. 4 nga e sprasmja)

**Kam t' e vërrenj** u se si **do të bënj**...

(CT – Novelline popolari – IX , f. 396, r. 17)

- Naní **kam të marr** për grua të bijën e rregjit!

(CT – Novelline popolari – XI, f. 440, r. 19)

Ti s'më do, po fort u t' dua. / Domsodo **ke t' duash** ti mua!

(CT – Novelline popolari – XI, f. 440, r. 26, 27)

E lumeja u, që **ka t' e kem** burrë!

(CT – Novelline popolari – XI, f. 441, r. 24)

E ata: - **Ke të vish** me ne tek i biri i Mbretit, se ai të do për nuse.... - Mënt të jet kurr se i biri i Mbretit **ka t' marrënjë** për nuse mua të mjerën plakë?

(CT – Novelline popolari – XII, f. 451, r. 20 e 26/27)

- Çë ke, mame, që bën si maçëja kur ha mushkëri!

- Çë **do t' kem**, o bir!...

(CT – Novelline popolari – XII, f. 454, r. 12, 13)

KAFSHANJERIU – Ëj, zotëria juaj! U jam kafshë! Ma **ka t' vinjë** dita që gjithë kafshët e jetës **ka t' vuhën\*** bashkë e ...!

(GSMaj – Kërkuesit – Akti II, skena I) \* forma pësore-vetvetore (shih)

## MËSIMI 17F

**Kohët e përbëra: koha e kryer e mënyrës dëftore.**

Kemi mësuar si bëjnë arbërisht *koha e tashme, koha e pakryer, koha e kryer e thjeshtë, koha e ardhme*, që të gjitha bashkë thërriten: *kohë të thjeshta* (litisht: tempi simplici) të mënyrës dëftore.

Nani ka vërejëm *kohët e përbëra* (litisht: i tempi composti) të mënyrës dëftore.

### Zgllith e vëre' mirë

#### TE SHKËMBI

Nga herë që *kam klënë* te Shkëmbi, *kam parë* mirë se të Parët tanë e stisën te një gropë Horën e kjo gropë e *ka ruajtur* atë nga tëtimit e nga erërat e dimrit.

Arbëreshët e Horës *kanë zënë* fill të stisjën shpitë jashtë gropës vetëm nga vitet '50 (pesëdhjete) e '60 (gjashtëdhjete) e mënd të thuhet se që ahierna Hora *ka pasur* një zgjerim të math.

E erërat e ftohta ngë *kanë fryjtur* më te dimri?

*Kanë frijtur* gjithmonë, ma (po) gjindja *ka dijtur* të ruhet më mirë, përçë te këto vjet *ka kërkuar* të ketë te shpitë mjete (litisht: mezzî) moderne e i *ka bërë* ballë dimrit më mirë se të Vjetrit tanë.

Shkëmbi *ka klënë* gjithmonë një vend i rrallë.

U i *kam vatur* disa herë, se atje sipër *kam marrë* frymë e *kam mbluar* mushkритë me ajër të pastër.

### Çë janë

*kam klënë, ka parë, ka ruajtur, kanë zënë, ka pasur, kanë fryjtur, ka dijtur, ka kërkuar, ka bërë, ka klënë, kam vatur, kam marrë, kam mbluar ?*

Janë veta të *kobës së kryer* të mënyrës dëftore (litisht: tempo passato prossimo, modo indicativo).

Vëre' tabelat.

#### FOLJA "kam" MËNYRA DËFTORE KOHJA E KRYER

Njëjës  
u kam pasur  
ti ke pasur  
ai ka pasur

Shumës  
na kemi pasur  
ju kini pasur  
ata kanë pasur

FOLJA "jam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER

Njëjës  
u kam klënë  
ti ke klënë  
ai ka klënë

Shumës  
na kemi klënë  
ju kini klënë  
ata kanë klënë



Një shembull për të tre zgjedhimet.

FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E KRYER

Njëjës  
u kam kërkuar  
ti ke kërkuar  
ai ka kërkuar

Shumës  
na kemi kërkuar  
ju kini kërkuar  
ata kanë kërkuar

*Koha e kryer, zgjedhuar për foljen "kërkonj", vete mirë për të gjitha foljet e tjera të zgjedhimit të parë, të dytë e të tretë.*

Të formohet *koha e kryer*, si shohjëm më lart, vetavet të *kohës së tashme* të foljes ndihmëse "kam" i (u) shtonet *pjesorja* (shih) e foljevet.

Për shembull:

- kam + pjesorja e foljes "kam": *pasur* = kam pasur, ...;
  - kam + pjesorja e foljes "jam": *klënë* = kam klënë, ...;
  - kam + pjesorja e foljes "ruanj": *ruajtur* = kam ruajtur, ...;
  - kam + pjesorja e foljes "marr": *marrë* = kam marrë, ...;
  - kam + pjesorja e foljes "zë": *zënë* = kam zënë, ... ;
  - kam + pjesorja e foljes "vete": *vatur* = kam vatur, ...;
- etjera.



## USHTRIME

Vër në kohën e kryer të mënyrës dëftore foljet që te ana ndodhen në kohën e tashme e me pjesoren ndër kllapa (...).

- 1) shkonj (shkuar): - Mara ngë ka shkuar te nona.
- 2) thom (thënë) - Lia, i \_\_\_\_\_ gjë Markut ?
- 3) vë (vënë) : - Vito, ia \_\_\_\_\_ vajt te motori ?
- 4) jap (dhënë): - Ata ngë ia (ua) \_\_\_\_\_ dhuratat vajzavet.
- 5) shoh (parë) : - **Na ngë e \_\_\_\_\_ kurrë një festë kështu e (të) bukur!**



## MËSIMI 18F

Koha e kryer e plotë e mënyrës dëftore.

Nani vemi te *koha e kryer e plotë e mënyrës dëftore* (litisht: tempo trapassato prossimo, modo indicativo).

### Zglith e vëre'

#### TE MUSEU I HORËS

Kurrë *kisha klënë* te Museu i Horës. E *kisha xënë* se Museun e *kish vënë* te ca kambra (dhomë) ku një herë *kishën pasur* vend fûndaqet antikë e çë pra *kishën dërtuar* pameta sa t'ë bëjën musè, ma (por) e *kisha harruar*.

Museu ka gjithë shërbise antike.

U ngë *kisha parë* kurrë një brazherë e aty e pashë; ngë *kisha dijtur* kurrë se nonërat tanë laheshin te vaxhilli e aty pashë një vaxhill. Sa strumente sheh aty çë më parë i *kishën pasur* te duart pleqtë tanë!

Mënd të thom se kurrë *kisha kërkuar* me kaq interes këto shërbise antike, ma (por) nani vete i kërkonj e di çë janë e si i përdorjën ahierna.

### Vëre'

*kisha klënë, kisha xënë, kisha vënë, kishën pasur, kishën dërtuar, kisha harruar, kisha parë, kisha dijtur, kishën pasur, kisha kërkuar* janë veta të *kobës së kryer të plotë të mënyrës dëftore*.

### Tablet.

#### FOLJA "kam" MËNYRA DËFTORE KOHA E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u kisha pasur  
ti kishë pasur  
ai kish pasur

Shumës  
na kishëm pasur  
ju kishët pasur  
ata kishën pasur

#### FOLJA "jam" MËNYRA DËFTORE KOHA E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u kisha klënë  
ti kishë klënë  
ai kish klënë

Shumës  
na kishëm klënë  
ju kishët klënë  
ata kishën klënë

Një shembull për të ***tre zgjedhimet.***

FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHË E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u kisha kërkuar  
ti kisha kërkuar  
ai kisha kërkuar

Shumës  
na kishëm kërkuar  
ju kishët kërkuar  
ata kishën kërkuar

***Koha e kryer e plotë***, zgjedhuar për foljen "kërkonj", vetë mirë për të gjitha foljet e tjera të ***zgjedhimit të parë, të dytë e të tretë.***

Të formohet ***koha e kryer e plotë***, si shohjëm më lart, vetavet të ***kohës së pakryer*** të foljes ndihmëse "kam" i (u) shtonet ***pjesorja*** (shih) e foljevet.

Për shembull:

- kisha + pjesorja e foljes "kam": *pasur* = kisha pasur, ...;
  - kisha + pjesorja e foljes "jam": *klënë* = kisha klënë, ...;
  - kisha + pjesorja e foljes "harronj": *barruar* = kisha harruar, ...;
  - kisha + pjesorja e foljes "shoh": *parë* = kisha parë, ...;
  - kisha + pjesorja e foljes "vë": *vënë* = kisha vënë, ... ;
  - kisha + pjesorja e foljes "di": *dijtur* = kisha dijtur, ...;
- etjera.



## USHTRIME

Vër në ***kohën e kryer të plotë*** foljet çë te ana ndodhen në ***kohën e tashme e me pjesoren ndër kllapa (...)***.

- 1) lanj (larë): - Këtë xhubot Sara e kish larë vjet.
- 2) ha (ngrënë): - Djemtë i thanë nonës se ngë \_\_\_\_\_.
- 3) pres (pritur): - Marë, te çili kafë ti më \_\_\_\_\_ ?
- 4) pres (prerë): - Vestën kalivari ia \_\_\_\_\_ u Maries !
- 5) shes (shitur): - **Makinën na e \_\_\_\_\_ vjet.**



## MËSIMI 19F

Mënyra dëftore: koha e kryer e tejskUAR.

Arbërisht si edhe shqip përdoret shumë rrallë *koha e kryer e tejskUAR* (litishti tempo trapassato remoto)

Vëre' tabelat.

### FOLJA "kam" MËNYRA DËFTORE KOKHA E KRYER E TEJSKUAR

Njëjës  
u pata pasur  
ti pate pasur  
ai pati pasur

Shumës  
na patëm pasur  
ju patët pasur  
ata patën pasur

### FOLJA "jam" MËNYRA DËFTORE KOKHA E KRYER E TEJSKUAR

Njëjës  
u pata klënë  
ti pate klënë  
ai pati klënë

Shumës  
na patëm klënë  
ju patët klënë  
ata patën klënë

Një shembull për të tre zgjedhimet.

### FOLJA "kërkonj" MËNYRA DËFTORE KOKHA E KRYER E TEJSKUAR

Njëjës  
u pata kërkuar  
ti pate kërkuar  
ai pati kërkuar

Shumës  
na patëm kërkuar  
ju patët kërkuar  
ata patën kërkuar

*Koha e kryer e tejskUAR*, zgjedhuar për foljen "kërkonj", vete mirë për të gjitha foljet e tjera të zgjedhimit të parë, të dytë e të tretë.

Të formohet *koha e kryer e tejskUAR*, si shohjëm më lart, vetavet të kohës së kryer të thjeshtë të foljes ndihmëse "kam" i (u) shtonet *pjesorja* e foljevet.

Për shembull:

- pata + pjesorja e foljes "kam": *pasur* = pata pasur, ...;
  - pata + pjesorja e foljes "jam": *klënë* = pata klënë, ...;
  - pata + pjesorja e foljes "shoh": *parë* = pata parë, ...;
- etj.



## MËSIMI 20F

Mënyra dëftore: koha e ardhme e përparme.

Zglith mirë këtë shkrim:



### LIQENI I HORËS

Liqeni i Horës së Arbëreshëvet *ka ketë klënë* te vitet '20 (njëzet) një nga liqenet më të mëdhenj të Siçilljes, përçë liqenet ahierna te Siçillja ishën pak.

Edhe shëbërtyrët të ngrejën dighën *ka kenë klënë* të forta, përçë digha kle bërë gjithë me gurë të gjallë katërkëndëshë (litisht: sikuadrati).

Arbëreshët e Horës e të Sendastinës *ka kenë pasur* shëbërtyrë për ca vjet, si për një parë vjet e patën kur te vitet 1968/'69 u përforcua digha, çë tërmeti *ka ketë hapur* te disa vende.

Liqeni *ka ketë zënë* fill të mbjidhëj ujët e lumit "Belice", të "Drinjës" e të tjerëvet lume (lumenj) të Horës, çë nga viti 1923, data e shkruar e të lerit të tij; *ka ketë sosur* t'ë mblihdhëj te viti 1968 për tërmetin e *ka ketë shkuar* pameta te emri i liqenevet të gjallë kur ndërtnuan dighën te viti 1969/'70: njera më sot ngë u ka mbrazur më.

Ka (nga) liqeni duket gjithë kurora e malevet çë rrinë rreth Horës: kushedi sa herë arbëreshët e vitevet '20 *ka kenë kërkuar* e *ka kenë parë* këtë panoram!



Çë janë

*ka ketë klënë, ka kenë klënë, ka kenë pasur, ka ketë hapur, ka ketë zënë, ka ketë sosur, ka ketë shkuar, ka kenë kërkuar, ka kenë parë?*

Janë folje të të tre zgjedhimevet vënë në *kobën e ardhme të përparme* (litisht: tempo futuro anteriore) arbëreshe.

Tabelet !

FOLJA "kam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E ARDHME E PËRPARME

Njëjës

u ka kem pasur  
ti ka kesh pasur  
ai ka ketë pasur

Shumës

na ka kemi pasur  
ju ka kini pasur  
ata ka kenë pasur

u ka r' kem pasur	e	na ka r' kemi pasur
...		...
u do kem pasur	e me "do"	na do kemi pasur
...		...
u do r' kem pasur	o	na do r' kemi pasur
...		...



FOLJA "jam"  
MËNYRA DËFTORE  
KOHA E ARDHME E PËRPARME

Njëjës

u ka kem klënë  
ti ka kesh klënë  
ai ka ketë klënë

Shumës

na ka kemi klënë  
ju ka kini klënë  
ata ka kenë klënë

u ka r' kem klënë	e	na ka r' kemi klënë
...		...
u do kem klënë	e me "do"	na do kemi klënë
...		...
u do r' kem klënë	o	na do r' kemi klënë
...		...

Nani vëre<sup>7</sup> zgjedhimet.

**ZGJEDHIMI I PARË**  
**FOLJA “kërkonj”**  
**MËNYRA DËFTORE**  
**KOHA E ARDHME E PËRPARME**

**Njëjës**

u ka kem kërkuar  
ti ka kesh kërkuar  
ai ka ketë kërkuar

**Shumës**

na ka kemi kërkuar  
ju ka kini kërkuar  
ata ka kenë kërkuar

**Edhe**

u ka të kem kërkuar, ...  
**e**  
u ka t' kem kërkuar, ...

**Me “do”**

u do kem kërkuar, ...  
**edhe**  
u do të kem kërkuar, ...  
**e**  
u do t' kem kërkuar, ...

Shembulli këtu sipër vlen edhe për zgjedhimin e dytë e të tretë.

**Koha e ardhme e përparme**, ashtu si edhe pamë për *kobën e ardhme*, ndodhet vetëm te *mënyra dëftore*.

Ajo formohet me *kobën e ardhme* të foljes ndihmëse “kam” e me *pjesoren e foljes*.

Për shembull:

- ka kem + pjesorja e foljes “kam”: *pasur* = ka kem pasur, ...;
  - ka kem + pjesorja e foljes “jam”: *klënë* = ka kem klënë, ...;
  - ka kem + pjesorja e foljes “ruanj”: *ruajtur* = ka kem ruajtur, ...;
  - ka kem + pjesorja e foljes “marr”: *marrë* = ka kem marrë, ...;
  - ka kem + pjesorja e foljes “zë”: *zënë* = ka kem zënë, ... ;
  - ka kem + pjesorja e foljes “vete”: *vatur* = ka kem vatur, ...;
- etjera.

Edhe : do kem + pjesorja e foljes ....

## USHTRIME

Vër në kohën e ardhme të përparme këto folje që te ana ndodhen në kohën e tashme të mënyrës dëftore me pjesoren në kllapa:

- 1) shkonj (shkuar): - Një ditëz u ka kem shkuar te nona.
- 2) pres (prerë): - Na \_\_\_\_\_ dy dërrasa me serrën.
- 3) lë (lënë): - Mara, \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ të rriten ftonjtë te grasta!
- 4) shes (shitur): - Marku \_\_\_\_\_ ia \_\_\_\_\_ Ndricës biçikletën.
- 5) ndërronj (ndërruar): - Sara \_\_\_\_\_ shpi.
- 6) lanj (lajtur): - Lia \_\_\_\_\_ mbaracet.
- 7) stis (stisur): - Mas' Gjergji \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ atë shpi te Fusha!
- 8) zbill (zbillur): - Vo' Lena \_\_\_\_\_ atë putigë te Ghamili.
- 9) pres (pritur): - Ku \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ miket Kelja ?
- 10) pres (pritur): - Ku \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ miket Kelen ?



### Ndo shembull letrar

Kushedi si **do t'** m' i **ket sosur** sime motrë t' nguqëmes!

(CT – Novelline popolari – XII, f. 452, r. 5 nga e sprasmja)

I biri i Mbretit **do të të ket dhënë** ndo bar...

(CT – Novelline popolari – XII, f. 453, r. 26)

## MËSIMI 21F

Mënyra dëftore: gjithë kohës.

Këtu poshtë kemi tabelen complete të të gjitha *kobëvet të thjeshta e të përbëra të mënyrës dëftore*.

### MËNYRA DËFTORE

#### E TASHMJA

u kam

#### E PAKRYERA

u kisha

#### E KRYERA E THJESHTË

u pata

#### E ARDHMJA

u ka kem

#### E KRYERA

u kam pasur

#### E KRYERA E PLOTË

u kisha pasur

#### E KRYERA E TEJSHKUAR

u pata pasur

#### E ARDHMJA E PËRPARME

u ka kem pasur

Vëre' nani sa kohë ka *mënyra lidhore* (litisht: modo congiuntivo), çë do të shohjëm te MËSIMI çë vjen:

### MËNYRA LIDHORE

#### E TASHMJA

#### E PAKRYERA

#### E KRYERA

#### E KRYERA E PLOTË

Sa kohë ka *mënyra dëftore*  
e sa ka *mënyra lidhore*?



Pëna pameta, se ngë  
të gjejëm!!!



## MËSIMI 22

Mënyra lidhore: koha e tashme.

Mësojëm çë ë *mënyra lidhore*.

Zglith këtë tekst.

### TE RROKAT

- *Të zbyll o të hap* fjalorin, si thotë një mik jimi shqiptar, ngë i duhet gjë, ma (por) "rrokat" më duket fjalë litire.
- *T' e kërkosh* te fjalori bën mirë; ma (por) *të dish* se thërriten "Rrokat", përçë vendi ë gjithë një shkëmb i madh, çë alarta vete sos te Sheshi e aposhta te Shën Gjoni; e fjala ë arbëreshe.
- Përçë *t' Atërat tanë van' e stisën* shpitë mbi shkëmbet (shkëmbinjtë) e Rrokavet?
- *Të kesh* një thërrime tru e *të jesh* logjik: pë' gurët ata kishën vetëm të çajën shkëmbet (shkëmbinjtë), pa bërë shëbërtirën e të prurit nga tjerët vende; mjeshtërit e atëhershëm ishën shumë të vlefshëm pra *t' i jipjën* formën katërkëndëshe gurëvet themelore.
- *Të shkosh* te Rrokat o *t' i shobësh* së llargu, vendi ë shumë karakteristik: ti, si turist, *të zësh* poshtë ka (nga) Shën Kolli o *të zësh* lart ka (nga) Kriqja e Palermës sa *të veç* te Rrokat, sheh rrugë e angonë vërtet të bukura.

Çë janë

*të zbyll, të hap, të kërkosh, të dish, të kesh, të jesh, të shkosh, të shobësh, të zësh, të veç?*

Janë veta të *kobës së tashme të mënyrës lidhore*.

Përçë përdorjëm *mënyrën lidhore* te të folurit ?

E përdorjëm sa të thomi se një e bëmë, një veprim, mënd të bëhet o dishirojëm të bëhet o kemi dyshim (litisht: dubbio) se mënd të bëhet. Gjithë këto ndjenja i shprehjëm me katër (4) kohë, si pamë më lart.

**Vër re:**  
*Mënyra lidhore*  
arbërisht merr vendin  
e *paskajores*  
(litisht: modo infinito),  
çë na ngë kemi.

Këtu kemi tabelat:

FOLJA "kam"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u të kem  
ti të kesh  
ai të ketë

Shumës  
na të kemi  
ju të kini  
ata të kenë

FOLJA "jam"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u të jem  
ti të jesh  
ai të jetë

Shumës  
na të jemi  
ju të jini  
ata të jenë



E të tre zgjedhimet

ZGJEDHIMI I PARË  
FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u të kërkonj  
ti të kërkosh  
ai të kërkonjë

Shumës  
na të kërkojëm  
ju të kërkoni  
ata të kërkojën



ZGJEDHIMI I DYTË  
FOLJA "hap"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u të hap  
ti të hapësh  
ai të hapënj

Shumës  
na të hapjëm  
ju të hapni  
ata të hapjën



ZGJEDHIMI I TRETË  
 FOLJA "zë"  
 MËNYRA LIDHORE  
 KOHA E TASHME

Njëjës

u të zë  
 ti të zësh  
 ai të zën

Shumës

na të zëmë  
 ju të zëni  
 ata të zënë


Folja "vete" bën kështu: *të vete, të veç, të ve; të vemi, të veni, të venë.*



USHTRIME

Vër në kohën e tashme të mënyrës lidhore foljet që te ana ndodhen në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

- 1) *kam* - Të kesh durim (paçencë) Marë!
- 2) *jam* - Ata \_\_\_\_\_ o \_\_\_\_\_ mos \_\_\_\_\_ te festa, për ne ë paraç.
- 3) *bënj* - **Marku, \_\_\_\_\_ të mirin, kur vete te nona !**
- 4) *pres* - Ju thashë \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ mirë ato thele bukje.
- 5) *vete* - \_\_\_\_\_ o \_\_\_\_\_ mos \_\_\_\_\_ te skolla, dëmi ë jyt!





## MËSIMI 23F

Mënyra lidhore: koha e pakryer.



Zglith.

### TE SKLICA

Kur isha i vogël *të veja* te Sklica ish një aventurë e bukur. Rruga ish gjithë kthesa e *të hipesh*a me biçikletën më vij rëndë; *të jicja* më këmbë ngë më pëlqej se trëmbesha mos *të përpiqja* qentë, çë *të më lehtë*n e *të më rridhjen* aprapa ngë i duhej gjë.

Te Sklica më dukej sikurse *të isha* te një varkë e madhe çë jicëj te qiellja: bukur ish *të kisha* atje përpara gjithë panoramin e *të kërkoja* me sy liqenin, Honin, malet e gjymsën e Horës aprapa Sheshit!

Më pëlqej *të gjegjesha* menatnet këndimet e kallogjervet te klisja.

E pra *të shihja*, atje te Sklica, atë trujë dhëmbë-dhëmbë në majë (= te punta), ish për mua një ghrizje sa *të zëja* fill ëndrrat e *të byja* te një aventurë medievale (mesjetare).

Çë janë

*të veja*, *të hipesh*a\*, *të jicja*, *të përpiqja*, *të lehtë*n, *të rridhjen*, *të isha*, *të kisha*, *të kërkoja*, *të gjegjesha*\*, *të shihja*, *të zëja*, *të byja*?

\* Forma pësore-vetvetore.

Janë veta të *kobës së pakryer të mënyrës lidhore*.

Vëre' tabelat.

#### FOLJA "kam" MËNYRA LIDHORE KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u të kisha  
ti të kishe  
ai të kish

Shumës  
na të kishëm  
ju të kishët  
ata të kishën

#### FOLJA "jam" MËNYRA LIDHORE KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u të isha  
ti të ishe  
ai të ish

Shumës  
na të ishëm  
ju të ishët  
ata të ishën

## Të tre zgjedhimet

### ZGJEDHIMI I PARË FOLJA "kërkonj" MËNYRA LIDHORE KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u të kërkoja  
ti të kërkoje  
ai të kërkoj

Shumës  
na të kërkojëm  
ju të kërkojët  
ata të kërkojën

### ZGJEDHIMI I DYTË FOLJA "hap" MËNYRA LIDHORE KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u të hapja  
ti të hapje  
ai të hapëj

Shumës  
na të hapjëm  
ju të hapjët  
ata të hapjën

### ZGJEDHIMI I TRETË FOLJA "zë" MËNYRA LIDHORE KOHA E PAKRYER

Njëjës  
u të zëja  
ti të zëje  
ai të zëj

Shumës  
na të zëjëm  
ju të zëjët  
ata të zëjën



## USHTRIME

Vër në kohën e pakryer të mënyrës lidhore foljet që te ana ndodhen në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

- 1) *kam* - Edhe të kish ligj Marku, shërbiset ngë ndërrojën.
- 2) *jam* - Lia, mëma të tha \_\_\_\_\_ e butë me tët vëlla.
- 3) *ndërronj* - Gjithë këta qëro i rrijtët, sa \_\_\_\_\_ pethkat?
- 4) *shes* - \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ këto këpucë, më dejën 40 euro!
- 5) *rri* - Marku, sa \_\_\_\_\_ brënda te shpia, deshi një çikullatë.



## MËSIMI 24F

Mënyra lidhore: koha e kryes.

Zglith.

### TE BRINJA

I

Sot "Brinja" ë plot me shpi: *të ketë pasur* ndo herë natyrë të egër o *të ketë klënë* ndo herë vend me bimë (arvullamë), duket e pamundur.

Kur ti *t' e kesh kërkuar* te karta topografike "Brinjën", çë ke bërë? *Të ketë qëndruar* vetem emri, ë një mrakull !

Çë janë

*të ketë pasur, të ketë klënë, të kesh kërkuar, të ketë qëndruar ?*

Janë veta të *kohës së kryer të mënyrës lidhore*.

Vëre' mirë tabelat!

#### FOLJA "kam" MËNYRA LIDHORE KOHJA E KRYER

Njëjës

u të kem pasur  
ti të kesh pasur  
ai të ketë pasur

Shumës

na të kemi pasur  
ju të kini pasur  
ata të kenë pasur

#### FOLJA "jam" MËNYRA LIDHORE KOHJA E KRYER

Njëjës

u të kem klënë  
ti të kesh klënë  
ai të ketë klënë

Shumës

na të kemi klënë  
ju të kini klënë  
ata të kenë klënë



## Të tre zgjedhimet

### ZGJEDHIMI I PARË FOLJA "kërkonj" MËNYRA LIDHORE KOHA E KRYER

Njëjës  
u të kem kërkuar  
ti të kesh kërkuar  
ai të ketë kërkuar

Shumës  
na të kemi kërkuar  
ju të kini kërkuar  
ata të kenë kërkuar

### ZGJEDHIMI I DYTË FOLJA "hap" MËNYRA LIDHORE KOHA E KRYER

Njëjës  
u të kem hapur  
ti të kesh hapur  
ai të ketë hapur

Shumës  
na të kemi hapur  
ju të kini hapur  
ata të kenë hapur

### ZGJEDHIMI I TRETË FOLJA "zë" MËNYRA LIDHORE KOHA E KRYER

Njëjës  
u të kem zënë  
ti të kesh zënë  
ai të ketë zënë

Shumës  
na të kemi zënë  
ju të kini zënë  
ata të kenë zënë



## USHTRIME

Shkruaj vetat e kohës së kryer të mënyrës lidhore si të lyp ushtrimi, tuke vërejtur pjesoren ndër kllapa.

- 1) kam (pasur): e 2a njëjës e shumës = të kesh pasur, të kini pasur
- 2) jam (klënë): e 3a njëjës e shumës = \_\_\_\_\_
- 3) lanj (larë): e 2a shumës e 3a shumës = \_\_\_\_\_
- 4) sos (sosur): e 1a njëjës e 1a shumës = \_\_\_\_\_
- 5) lë (lënë) : e 3a njëjës e 2a shumës = \_\_\_\_\_

## MËSIMI 25F

Mënyra lidhore: koha e kryer e plotë.

Vazhdo (kontinuar) të zgledhësh.

### TE BRINJA

#### II

- I duhej se ti *t'* e *kishe parë* ndo tridhjetë vjet prapa: Brinja ish plot me vreshta e plot me këmbë

frutrash (pemësh) e vende vende plot me shkëmbe (shkëmbinj) e gurë karakteristikë.

- Bukur emër "Brinja"!

- T' Atërat tanë kur *t'* i *kishën dhënë* njetër emër, ngë do *t'* e kishën shprehur mirë idenë! Si kurmi jynë ka "brinjët", ashtu edhe Hora ka "brinjën" e saj!

- E çë ish "Çapelja" ?

- Sot ngë ë më, ma (por) një herë ndër Brinjë e Shesh, ndodhej "Çapelja e Drangoit", një si çapele e madhe mbi njetër çapele më të vogël, mbi njetër çapele më të madhe, çë rrij mbi njetër çapele më të madhe ankora: fenomene të natyrës!

- E përçë e thërritën "e Drangoit"?

- Emrin ia dha fantazia e gjindes se thomse përposh shkëmbit rrij ndo "drangua" e pullarevet.

- E kush e gorrromisi ?

- Kur ata çë stisën pallacet *t'* e *kishën lënë* shtuara në mes të shpivët o *t'* e *kishën rrethuar* me mure çimentit o *t'* e *kishën mbyllur* si te një vikarí (burg, filaqí), çë do të kishën bërë? Ashtu morën e e gorrromisën.

Çë janë

*të kishe parë (shoh), të kishën dhënë (jap), të kishën lënë (lë), të kishën rrethuar (rrethonj), të kishën mbyllur (mbyll) ?*

Janë veta të *kohës së kryer të plotë* të mënyrës lidhore.

Vëre' mirë tablelet.

### FOLJA "kam" MËNYRA LIDHORE KOHA E KRYER E PLOTË

#### Njëjës

u të kisha pasur  
ti të kishe pasur  
ai të kish pasur

#### Shumës

na të kishëm pasur  
ju të kishët pasur  
ata të kishën pasur



FOLJA "jam"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u të kisha klënë  
ti të kishe klënë  
ai të kish klënë

Shumës  
na të kishëm klënë  
ju të kishët klënë  
ata të kishën klënë

Të tre zgjedhimet

ZGJEDHIMI I PARË  
FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u të kisha kërkuar  
ti të kishe kërkuar  
ai të kish kërkuar

Shumës  
na të kishëm kërkuar  
ju të kishët kërkuar  
ata të kishën kërkuar

ZGJEDHIMI I DYTË  
FOLJA "hap"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u të kisha hapur  
ti të kishe hapur  
ai të kish hapur

Shumës  
na të kishëm hapur  
ju të kishët hapur  
ata të kishën hapur

ZGJEDHIMI I TRETË  
FOLJA "zë"  
MËNYRA LIDHORE  
KOHA E KRYER E PLOTË

Njëjës  
u të kisha zënë  
ti të kishe zënë  
ai të kish zënë

Shumës  
na të kishëm zënë  
ju të kishët zënë  
ata të kishën zënë

USHTRIME

Shkruaj vetat e kohës së kryer të plotë të mënyrës lidhore si të lyp ushtrimi.

- 1) kam (pasur): e 2a njëjës e shumë = të kishe pasur, të kishët pasur
- 2) jam (klënë): e 3a njëjës e shumë = \_\_\_\_\_
- 3) lanj (larë): e 2a shumë e 3a shumë = \_\_\_\_\_
- 4) sos (sosur): e 1a njëjës e 1a shumë = \_\_\_\_\_
- 5) lë (lënë): e 3a njëjës e 2a shumë = \_\_\_\_\_

## MËSIMI 26F

Mënyra kushtore: koha e tashme.

Mësojëm naní çë ë *mënyra kushtore*  
(litisht: modo condizionale).



### TE SHËN MËRKURI

Somenatë *ki' t' veja* te Shën Mërkuri e ngë i vajta.  
Atje *ki' t' vërejëm*, tata e u, një copë dhe të nonit.  
Edhe jím vëlla *dej t' vij*, ma (por) ë i vogel e *dej t' bij* bashkë maçen. *Ki' t' vij* edhe maçja? Më mirë në ish qen! Ashtù ngë i vamë.

U *dej t' i pyeja* tatës përçë ai vend thërritet "Shën Mërkuri". *Ki' t' ish* Shën Mërkuri ndo shejt arbëresh prurë këtu ka (nga) të Parët tanë?

Vendi ë plot me ullinj e ajri ë plot me hjauret (profumet) e bimëvet (= arvullamëvet).

*Ki' t' kish* më shumë vende si ai Hora.

Zglidhe pameta rrëfimin me variantet çë sheh:

### TE SHËN MËRKURI

Somenatë *kish veja* te Shën Mërkuri e ngë i vajta. Atje *kish vërejëm*, tata e u, një copë dhe të nonit. Edhe jím vëlla *dej vij*, ma (por) ë i vogel e *dej bij* bashkë maçen. *Kish vij* edhe maçja? Më mirë në ish qen! As<sup>1-2</sup> ngë i vamë.

U *dej i pyeja* tatës përçë ai vend thërritet "Shën Mërkur". *Kish ish* Shën Mërkuri ndo shejt arbëresh prurë këtu ka (nga) të Parët tanë?

Vendi ë plot me ullinj e ajri ë plot me hjauret (profumet) e bimëvet (= arvullamëvet).

*Kish kish* më shumë vende si ai Hora.

Çë janë

*ki' t' veja, ki' t' vërejëm, dej t' vij, dej t' bij, ki' t' vij, dej t' pyeja, ki' t' ish, ki' t' kish e*

*kish veja, kish vërejëm, dej vij, dej bij, kish vij, dej pyeja, kish ish, kish kish ?*

Janë veta të *kohës së tashme të mënyrës kushtore*.

*Mënyra kushtore* formohet kështu:

me pjesëzën *kish (ki')* + *e pakryera e lidhores*

me pjesëzën *dej* + *e pakryera e lidhores*



Tabelet.

FOLJA "**kam**"  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E TASHME

**Njëjës**  
u ki' t' kisha  
ti ki' t' kishe  
ai ki' t' kish

**Shumës**  
na ki' t' kishëm  
ju ki' t' kishët  
ata ki' t' kishën

**Edhe:** u kish t' kisha ...  
u de' t' kisha ...  
u de' kisha ...

FOLJA "**jam**"  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E TASHME

**Njëjës**  
u ki' t' isha  
ti ki' t' ishe  
ai ki' t' ish

**Shumës**  
na ki' t' ishëm  
ju ki' t' ishët  
ata ki' t' ishën

**Edhe:** u kish t' isha ...  
u de' t' isha ...  
u de' isha ...

Si te koha e ardhme e mënyrës dëftore, arbëreshët më parë mënyrën kushtore e thëshjën më komplikate:

<i>kisha</i>	të kisha
<i>kishe</i>	të kishe
<i>kish</i>	të kish
<i>kishëm</i>	të kishëm
<i>kishët</i>	të kishët
<i>kishën</i>	të kishën

pra qëndroi vetëm pjesëza *kish* o *ki'* për të gjitha vetat, si pamë e si do t' shohjëm. Mënyra kushtore me pjesëzën *kish* o *ki'* jep idenë "e nevojës, e bëzonjës" kushtore (litisht: *necessità condizionale*).



E me formën tjetër:

<i>deja</i>	të kisha
<i>deje</i>	të kishe
<i>dej</i>	të kish
<i>dejëm</i>	të kishëm
<i>dejët</i>	të kishët
<i>dejën</i>	të kishën

pra qëndroi vetëm pjesëza *dej'* për të gjitha vetat.

Kjo formë e mënyrës kushtore me pjesëzën *dej* jep idenë "e vullnetit, e vullimit" *kushtor* (litërisht: voluntà condizionale).



Të tre zgjedhimet.

**ZGJEDHIMI I PARË**  
FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u ki' t' kërkvoja  
ti ki' t' kërkvoje  
ai ki' t' kërkvoj

Shumës  
na ki' t' kërkvojëm  
ju ki' t' kërkvojët  
ata ki' t' kërkvojën

Edhe u dej t' kërkvoja ...

Si "kërkonj" zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të parë.

**ZGJEDHIMI I DYTË**  
FOLJA "hap"  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u ki' t' hapja  
ti ki' t' hapje  
ai ki' t' hapjë

Shumës  
na ki' t' hapjëm  
ju ki' t' hapjët  
ata ki' t' hapjën

Edhe u dej t' hapja ...

Si "hap" zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të dytë.

## ZGJEDHIMI I TRETË

### FOLJA "zë"

#### MËNYRA KUSHTORE

#### KOHA E TASHME

##### Njëjës

u ki' t' zëja

ti ki' t' zëje

ai ki' t' zëj

##### Shumës

na ki' t' zëjëm

ju ki' t' zëjët

ata ki' t' zëjën

Edhe u dejt' zëja ...

Si "zë" zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të tretë.



## USHTRIME

Shkruaj vetat e kohës së tashme të mënyrës kushtore si lyp ushtrimi.

- 1) kam: e 2a njëjës e shumës = ki' t' kishe, ki' t' kishët
- 2) jam: e 3a njëjës e shumës = \_\_\_\_\_
- 3) thom: e 2a shumës e 3a shumës = \_\_\_\_\_
- 4) dua: e 1a njëjës e 1a shum. = \_\_\_\_\_
- 5) vete : e 3a njëjës e 2a shumës = \_\_\_\_\_



### Shembuj letrarë

... **ki' t' vuajën** e **ki' t' durojën** pajt Vangjejit ...

(FZ – Viti i parë – 14 të korrikut 1912 – n. 21, f.2, sht. 1, r. 2, 3)

Pa dyshim, **kish të krisëj** ndo një luftë e madhe ndër dy mbretërat.

(CT – Novelline popolari – I, f. 354, r. 7)

Një ditë vate e gjeti rregjin një plakarushe... e i tha se e bija e 'tij **kish t' ish** mëmë...

(CT – Novelline popolari – II, f. 357, r. 7)

Si **kish të bëj** e mjera? Si **kish të bëj**?

(CT – Novelline popolari – II, f. 358, r. 14)

... ai kish shpëresë se... **kish të vej** edhe e jëma e krjentullës e se, pa dashur, **kish të sbełonej\***.

(CT – Novelline popolari – II, f. 358, r. 24, 25) \* forma pësore-vetvetore (shih)

... kush t' dej të bijën e 'tij për të shoqe, **kish t' ish** i zoti t' e gjej atje ku ajo ndodhej...

(CT – Novelline popolari – VII, f. 387, r. 8, 9)

...E si sosi? – Si **kish të sosej!**

(CT – Novelline popolari – IX, f. 399, r. 26,278)

T'ish ashtu, ngë **do të kisha** një glëmp te zëmbra....

(CT – Novelline popolari – XII, f. 453, r. 28)

Po çë **kish të bëj?** Ashtu e deshi, e ashtu **kish t' e mbaj...**

(CT – Novelline popolari – XIII, f. 459, r. 19)

Ë ary pat t'i thëshja se **ki' t' hipeshin\*** me mua këtu te mali e se më parë **ki' t' shkojën** provën....

(GSMaj –Kërkuesit – Akti III, skena III) \* forma pësore-vetvetore (shih)

...kunkursin **ki' t' e mundjën** ata!

(GSMaj –Kërkuesit – Akti III, skena III)

## MËSIMI 27F

Mënyra kushtore: koha e kryer.

Vëre' nani *kohën e kryer*

(litisht: passato) të *mënyrës kushtore*.



### TE GHRUTA E GHARRUNIT

Te "Ghruta e Gharrunit" i vajta po një herë. *Ki' t' i kisha vatur* më shumë se një herë, se vendi ë i bukur shumë, ma (por), tek ajo ditë që kleva atje, shkava e prora këmbën e mëma më tha se ngë *ki' t' i veja* më.

Në i kisha vatur pameta, *ki' t' jui kisha thënë* më mirë ndjenjat që ndien kush arrën atje lart, kur sheh te njera anë Horën e tërë me liqenin, e te jetra anë gjithë Murtilat e më llargu dejtin.

*Dej' kisha klënë* atje lart kur t'Atërat tanë, që vijën nga Murrialli, panë vendin që *ki' t' ish* pra Hora e tyre arbëreshe! *Dej' kisha pasur*, tek ai mument që ata arrunë te Ghruta e Gharrunit, një makinë fotografike sa të bëja ca fotografi e t'i shihjëm sot; ma (por) ahierna makinat fotografike ishën?

*Dej' t' i kisha vatur* pameta te Ghruta e Gharrunit, ma (por) ngë dija që mënd më thëshëj mëma.

### Çë janë foljet

*ki' t' kisha vatur, ki' t' kisha thënë, dej' kisha klënë, dej' kisha pasur, dej' t' kisha vatur* ?

Janë veta të *kohës së kryer* të *mënyrës kushtore* në të dy fomat:

*ki' t' kisha* (kish të kisha, kish kisha)...

*dej t' kisha* (dej të kisha, dej kisha) ... .

Përçë përdorjëm *mënyrën kushtore* te të folurit ?

E përdorjëm sa të thomi se një e bëmë, një veprim, mënd të ndodhet o mënd të bëhet, në vërtetohen (verifikaren) një o disa kushte (kondicionë).

*Mënyrën kushtore* e shprehjëm me **dy** (2) kohë, si pamë më lart:

## MËNYRA KUSHTORE

E TASHMJA

E KRYERA

*Koha e kryer formohet me kohën e tashme të mënyrës kushtore të foljes ndihmëse “kam” e me pjesoren e foljevet.*

Ca shembuj:

- ki' t' kisha + pjesorja e foljes “kam”: *pasur* = ki' t' kisha pasur;
  - ki' t' kisha + pjesorja e foljes “jam”: *klënë* = ki' t' kisha klënë;
  - ki' t' kisha + pjesorja e foljes “ruanj”: *ruajtur* = ki' t' kisha ruajtur;
  - ki' t' kisha + pjesorja e foljes “marr”: *marrë* = ki' t' kisha marrë;
  - ki' t' kisha + pjesorja e foljes “zë”: *zënë* = ki' t' kisha zënë;
  - ki' t' kisha + pjesorja e foljes “vete”: *vatur* = ki' t' kisha vatur; etjera.
- Ashtu edhe me pjesëzën “dej t' kisha ...” o shqip: “do të kisha”...

Vëre' tablelet:

FOLJA “**ka**m”  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E KRYER

Njëjës

u ki' t' kisha pasur  
ti ki' t' kisha pasur  
ai ki' t' kisha pasur

Shumës

na ki' t' kishëm pasur  
ju ki' t' kishët pasur  
ata ki' t' kishën pasur

Edhe: u dej (t') kisha pasur...

FOLJA “**ja**m”  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E KRYER

Njëjës

u ki' t' kisha klënë  
ti ki' t' kisha klënë  
ai ki' t' kisha klënë

Shumës

na ki' t' kishëm klënë  
ju ki' t' kishët klënë  
ata ki' t' kishën klënë

Edhe: u dej (t') kisha klënë ...

Të tre zgjedhimet

ZGJEDHIMI I PARË  
FOLJA “**ke**rkonj”  
MËNYRA KUSHTORE  
KOHA E KRYER

Njëjës

u ki' t' kisha kërkuar  
ti ki' t' kisha kërkuar  
ai ki' t' kisha kërkuar

Shumës

na ki' t' kishëm kërkuar  
ju ki' t' kishët kërkuar  
ata ki' t' kishën kërkuar

Edhe: u dej (t') kisha kërkuar ...



**ZGJEDHIMI I DYTË**  
**FOLJA "hap"**  
**MËNYRA KUSHTORE**  
**KOHA E KRYER**

**Njëjës**  
 u ki' t' kisha hapur  
 ti ki' t' kishe hapur  
 ai ki' t' kish hapur

**Shumës**  
 na ki' t' kishëm hapur  
 ju ki' t' kishët hapur  
 ata ki' t' kishën hapur

**Edhe:** u dej (t') kisha hapur ...



**ZGJEDHIMI I TRETË**  
**FOLJA "zë"**  
**MËNYRA KUSHTORE**  
**KOHA E KRYER**

**Njëjës**  
 u ki' t' kisha zënë  
 ti ki' t' kishe zënë  
 ai ki' t' kish zënë

**Shumës**  
 na ki' t' kishëm zënë  
 ju ki' t' kishët zënë  
 ata ki' t' kishën zënë

**Edhe:** u dej (t') kisha zënë ...



**USHTRIME**

Shkruaj vetat e kohës së kryer të mënyrës kushtore si të lyp ushtrimi.

- |  |   |  |
|--|---|--|
| 1) bënj (bërë): e 2a njëjës e shumës       | = | <u>ki' t' kishe bërë, ki' t' kishët bërë</u> |
| 2) shes (shitur): e 3a njëjës e shumës     | = | _____  |
| 3) jap (dhënë): e 2a shumës, e 3a shumës   | = | _____  |
| 4) pres (pritur): e 1a njëjës, e 1a shumës | = | _____  |
| 5) vë (vënë): e 3a njëjës, e 2a shumës     | = | _____  |

**Ndo shembull letrar**

... gjaku i valoi gjith te kryet e **do t' i kish vrar**, në syt s' i kishën vatur te shpata...  
 (CF - Novelline popolari - X, f. 425, r. 8 nga e sprasmja)

MOREOTI - ... **Ki' t' i kishët parë** vëllezërit tanë që jikhën nga turqit e që mbjidheshin te buzëdejt i Jonit...

(GSMaj - Për Tokën - Akti II, skena X)

## MËSIMI 28F

Mënyra dëshirore: koha e tashme.

Vëre' si thuhet e si shkruhet mënyra dëshirore (litisht: modo ottativo, desiderativo), duke zgleddhur mirë foljet korsive.

### TE FUSHA E PONTIT

Noni, mbrëmanet kur t'ujet te dera aty te Fusha e Pontit, ku duket kroi i vjetër me koritën e josur nga ujët, që ngë sos kurrë të rrjedhënj nga viti 1706, më thotë shumë shërbise, në u kam dishirim t'e gjegjem.



Ai më thotë se sot kopijtë e djemtë ngë flasjën mirë arbërisht e se vetëm ndo plak e flet mirë.

Më thotë edhe se po te ca këndime klishe sot ndodhen ankora fjalë që më parë thuheshin nga mument.

Noni vëren kroin e Fushës së Pontit e i bën: - "Rrofshin sa malet krojet tanë!" Pra më thotë se kur rrëfyejën pullaren e Kostantinit, pleqtë kujtojnë të thëshjën gjith'e gjithë këtë: "Kaha *vafshe* e kaha *jardhëshe*, bir bujari po më *shkofshe*!"

Kush e di sot që vje' më rarë ai urim ?!

Pleqtë pra kujtojnë të thëshjën, më parë se të zëjën fill të hajën: "Mirë ju *bëfshit*!"; e kur ata vejën o ndo njeri vej llargu Horës urojnë: "Yn' Zot na *ruashit*!" o "Yn' Zot të *ruashit*!"

Sot te Klisja ndo herë gjegjem te parkalesitë: "Lëvdi *pastë* ...", "... *ardhtë* rregjëria jote...", "Bekuar *kloftë* ...", "Ashtë *kloftë*", "Paçe lipisi"; e kur këndonet "Lazari", gjindja mbylljën këndimin me "Paçit hare, ejani zbyllni, bjerni ato ve!"

Mua gjithë këto fjalë antike më pëlqejën, megjithëse ngë ndëlgonj mirë që do të thenë. "Kaha *vafshe* e kaha *jardhëshe*...", "mirë ju *bëfshit*!", "ashtë *kloftë*", "paçe lipisi", "paçit hare!": më duket sikurse gjegjem nonërat tanë më të vjetër që flasjën bukur arbërisht!

Sot kemi ca shqiptarë te Hora, që, kur do falen, thonë: "Mirë u *pafshim*!" e edhe u e thom.

Çë janë

*rrofshin, vafshe, jardh(ë)she, shkofshe, bëfshit, ruashit, pastë, ardhhtë, kloftë, paçë, paçit, pafshim?*

Janë veta të kohës së tashme të mënyrës dëshirore.

Përçë përdorjëm *mënyrën dëshirore* te të folurit ?

E përdorjëm sa të shprehjëm një dëshirë, një dishirim, sa një shërbes të ndodhet, të bëhet.

Këto janë tablelet.

FOLJA "kam"  
MËNYRA DËSHIRORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u paça  
ti paçe  
ai pastë (paçit)

Shumës  
na paçim  
ju paçit  
ata paçin

FOLJA "jam"  
MËNYRA DËSHIRORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u klofsha  
ti klofshe  
ai kloftë (klofshit)

Shumës  
na klofshim  
ju klofshit  
ata klofshin



Të tre zgjedhimet.

ZGJEDHIMI I PARË  
FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA DËSHIRORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
u kërkofsha  
ti kërkofshe  
ai kërkofhtë

Shumës  
na kërkofshim  
ju kërkofshit  
ata kërkofshin



Folja "bënj": *bëfsha, bëfshë, bëfshit e bëftë; bëfshim, bëfshit, bëfshin.*

Folja "ruanj": *ruasha, ruashe, ruashit; ruashim, ruashit, ruashin.*

Folja "vinj": *ardhsha, ardhshë, ardhhtë; ardhshim, ardhshit, ardhshin.*



**ZGJEDHIMI I DYTË**  
**FOLJA "hap"**  
**MËNYRA DËSHIRORE**  
**KOHA E TASHME**

**Njëjës**  
u hapsha  
ti hapshe  
ai haptë

**Shumës**  
na hapshim  
ju hapshit  
ata hapshin

Folja "jap" bën kështu: *dhënsha (o dhënça), dhënshë, dhëntë; dhënshim, dhënshit, dhënshin.*

Folja "shoh": *pafsha, pafshë, pafhtë, pafshim, pafshit, pafshin.*



**ZGJEDHIMI I TRETË**  
**FOLJA "zë"**  
**MËNYRA DËSHIRORE**  
**KOHA E TASHME**

**Njëjës**  
u zëfsha  
ti zëfshë  
ai zëfshit (zëftë)

**Shumës**  
na zëfshim  
ju zëfshit  
ata zëfshin

Folja "dua": *dafsha, dafshë, dafhtë; dafshim, dafshit, dafshin.*

Folja "vete": *vafsha, vafshë, vafhtë; vafshim, vafshit, vafshin.*



## USHTRIME

1- Nënvizo' (sotolinear) te parkalesia "Ati jynë" vetëm ato folje që të duken se janë të mënyrës dëshirore e shkruaji veç.

"Ati jynë, që je ndë qiell, shejtëruar kloftë emri jyt, ardhhtë rregjëria jote, u bëftë\* vullimi jyt si në qiell ashtu në dhe. Bukën tënë të përditshme ëna neve sot, ndjena dëtyrët tona ashtu si na ia ndejëm dëtyruamvet tanë, e mos na le të biem në ngarje, po lirona nga i ligu. Ashtu kloftë".

\* "Bëftë" ë forma veprore (litisht: forma aktiva); "u bëftë" ë forma pësore (litisht: forma pasiva).

Te parkalesia "Ati jynë" foljet në mënyrën dëshirore janë:

2 - Zglith mirë e mëso' përmendsh këta vjershe të "Këngës së Kostantinit":

- Ëm uraten, tata i jim.
- Paç' uratën, birthi i jim.  
Kaha vafshe e kaha jardhëshe  
bir bujari po më shkofshe!
- Ëm uratën, mëma e jime.
- Paç' uratën, birthi i jim.  
Kaha vafshe e kaha jardhëshe  
po bir zonjëje më shkofshe!

(CT - XXIV - f. 34)

### Tjerë shembuj letrarë.

Yn' Zot ju ruashit nde jetë! / Po ju klofshin ditë e vjetë!  
(CT - XIV, f. 16, vj. 18, 19)

... në u zëfsha të këndonj / gjith' malet m' i kumbonj...  
(CT - XXII, f. 28, vj. 16)

Paçe më hje se fat!  
(CT - Fjalë të motshëme, n. 295 - f. 104)

E ngrata tha te kryet e 'saj: - Dafsha o mës dafsha kam të lith gajdhurin te ku do i zoti!  
(CT - Novelline populari - XII, f. 451, e sprasmja)

## MËSIMI 29F

Mënyra dëshirore: koha e kryer.

*Kohën e kryer të mënyrës dëshirore te të folurit tanë ngë e kemi. Edhe te gluha shqipe e përdorjën pak. Megjithatë vëre' si bën:*

### FOLJA "kam" MËNYRA DËSHIRORE KOHJA E KRYER

**Njëjës**  
u paça pasur  
ti paçe pasur  
ai pastë pasur

**Shumës**  
na paçim pasur  
ju paçit pasur  
ata paçin pasur

### FOLJA "jam" MËNYRA DËSHIRORE KOHJA E KRYER

**Njëjës**  
u paça klënë  
ti paçe klënë  
ai pastë klënë

**Shumës**  
na paçim klënë  
ju paçit klënë  
ata paçin klënë

## Të tre zgjedhimet.

### ZGJEDHIMI I PARË FOLJA "kërkonj" MËNYRA DËSHIRORE KOHJA E KRYER

**Njëjës**  
u paça kërkuar  
ti paçe kërkuar  
ai pastë kërkuar

**Shumës**  
na paçim kërkuar  
ju paçit kërkuar  
ata paçin kërkuar

### ZGJEDHIMI I DYTË FOLJA "hap" MËNYRA DËSHIRORE KOHJA E KRYER

**Njëjës**  
u paça hapur  
ti paçe hapur  
ai pastë hapur

**Shumës**  
na paçim hapur  
ju paçit hapur  
ata paçin hapur

ZGJEDHIMI I DYTË  
FOLJA “zë”  
MËNYRA DËSHIRORE  
KOHA E KRYER

Njëjës  
u paça zënë  
ti paçe zënë  
ai pastë zënë

Shumës  
na paçim zënë  
ju paçit zënë  
ata paçin zënë



“Koha e kryer” formohet me *kobën e tashme* të mënyrës dëshirore të foljes ndihmëse “kam” e me *pjesoren* e foljevet.

Ca shembuj:

- paça + pjesorja e foljes “kam”: *pasur* = paça pasur;
  - paça + pjesorja e foljes “jam”: *klënë* = paça klënë;
  - paça + pjesorja e foljes “shkonj”: *shkuar* = paça shkuar;
- etjera.

Mënyra dëshirore ka, si pamë, **dy** (2) kohë.



Dini gjithqish ?

Çë vje' më raaaaarë !!!!!



## MËSIMI 30F

Mënyra urdhërore: koha e tashme.

Ë mirë të njohjëm nani si thuhet e si shkruhet mënyra e urdhërit, vje' më rarë *mënyra urdhërore* (litisht: modo imperativo).

### KA MAGHANUÇI

Pjetri: - Marku, *eja* me mua e me Sarën Maghanuç! *Vër* te xaineti dy-tri panine, *blij* një butijë koka-kolë, *mirr* makinën fotografike e vemi më këmbë!

Marku: - E çë ka bëjëm Maghanuç?

Pjetri: - Ka shohjëm panoramin më të bukur të Horës e ka bëjëm ca fotografi. Kur shkon një orë, ka rrëzat e malit.

Pjetri: - Shih sa ë bukur, Sara! Hora duket skurse flë te glunjët e malit Picuta!

Marku: - *Vëreni* këtje lart: çë zoga janë ato?

Pjetri: - Ka jenë pallumbë!

Sara: - *Vëre'* aty përposh, Marku: duket gjithë liqeni!

Pjetri: - Sara e Marku, *jicni* më prapa se ju bënj një fotografi me Horën e liqenin. *Qishni*!

Sara: - *Shko* ti nani këtej, se jue bënj u fotografinë.

Pjetri: - *Mbaje* mirë atë makinë fotografike!

Sara: - *Kij* paçencë: qetu ca herë e *qish*! *Qishni* të dy!



Çë janë

*eja, vër, blij, mirr, shih, vëreni, vëre', jicni, qishni, shko, mbaj, kij, qetu* (formë pësore), *qish*?

Janë veta të kohës së tashme të mënyrës urdhërore.

*Mënyra urdhërore* ka vetëm dy veta: *vetën e dytë njëjës* e *vetën e dytë shumës*.

Përemri vetor arbërisht vëhet në përgjithësi prapa foljes.

Vëre' tabelet.

FOLJA "kam"  
MËNYRA URDHËRORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
---  
ki (kij)  
---

Shumës  
---  
kini  
---

FOLJA "jam"  
MËNYRA URDHËRORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
---  
ji  
---

Shumës  
---  
jini  
---

Të tre zgjedhimet.

ZGJEDHIMI I PARË  
FOLJA "kërkonj"  
MËNYRA URDHËRORE  
KOHA E TASHME

Njëjës  
---  
kërko  
---

Shumës  
---  
kërkoni  
---

Si "kërkonj" bëjnë të gjitha foljet e zgjedhimit të parë.

## Vër re !

*Mënyra urdhërore* ngjitur me format e shkurtra të përemrit vetor bën kështu:

kërkomë ti = kërko ti mua

kërkomëni ju = kërkoni ju mua

kërkome ti = kërko ti për mua atë

kërkomënie ju = kërkoni ju për mua atë

kërkoj ti = kërko ti atij, kërko ti ato

kërkoni ju = kërkoni ju atij, kërkoni ju ato

kërkoja	ti	=	kërko	ti	atë	atij
kërkonia	ju	=	kërkoni	ju	atë	atij
kërkoje	ti	=	kërko	ti	atë	
kërkoniae	ju	=	kërkoni	ju	atë	
kërkona	ti	=	kërko	ti	neve	
kërkonani	o na	kërkoni	ju	=	kërkoni	ju
					neve	



**ZGJEDHIMI I DYTË**  
**FOLJA "hap"**  
**MËNYRA URDHËRORE**  
**KOHA E TASHME**

Njëjës

---

hap

---

Shumës

---

hapni

---

Si "hap" bëjën të gjitha foljet e zgjedhimit të dytë.

Ca folje me mënyrën urdhërore të veçantë:

flas	<i>fol e flit, fli(t)ni</i>
jec	<i>jic, jicni</i>
jap	<i>jip, jipni</i>
marr	<i>mirr, mirrni</i>
mbjeth	(te letërsia arbëreshe edhe: mbleth) <i>mbjith, mbjidhni</i>
pres	<i>prit, pri(t)ni</i>
shoh	<i>shih, shihni</i>
thom	<i>thuj, thoni</i>
vdes	<i>vdis, vdisni</i>
etj.	

Me format e shkurtra të përemrit vetor:

hapëm e hapmë	ti	=	hap	ti	për	mua
hapmëni	ju	=	hapni	ju	për	mua
hapme	ti	=	hap	ti	për	mua
hapmënie	ju	=	hapni	ju	për	mua

hap <i>i</i> ti	= hap ti atij, hap ti ato
hapn <i>i</i> ju	= hapni ju atij, hapni ju ato
hapj <i>a</i> ti	= hap ti atë atij
hapn <i>a</i> ju	= hapni ju atë atij
hap <i>e</i> ti	= hap ti atë
hapn <i>e</i> ju	= hapni ju atë
hapn <i>a</i> ti	= hap ti për ne o neve
hapnani o na hapn <i>i</i> ju	= hapni ju për ne o neve



**ZGJEDHIMI I TRETË**  
**FOLJA "zë"**  
**MËNYRA URDHËRORE**  
**KOHA E TASHME**

Njëjës

ze (shqip: zër)

Shumës

zeni (shqip: zini)

Si "zë" bën edhe "lë": *le, leni*.

Folja "vë" del kështu: *vër (vur), vëni (vuni)*.

Folja "ha": *ha, hani*; folja "rri": *rri, rrini*.

Tjera folje:

<b>bie</b>	<i>bij, bini</i>
<b>bie</b>	<i>bjer, bjerni</i>
<b>flë</b>	<i>flëj, flëni</i>
etj.	

**Me format e shkurtra të përemrit vetor:**

zemë ti	= ze ti mua
zemëni ju	= zeni ju mua
zeme ti	= ze ti për mua atë
zemënie ju	= zeni ju për mua atë
zei ti	= ze ti atij, ze ti ato
zeni ju	= zeni ju atij, zeni ju ato



<i>zeja</i> ti	= ze ti atë atij
<i>zenia</i> ju	= zeni ju atë atij
<i>ze</i> ti	= ze ti atë
<i>zenie</i> ju	= zeni ju atë
<i>zena</i> ti	= ze ti neve
<i>zenani</i> o <i>na zeni</i>	= zeni ju neve

**Zemë!**



## USHTRIME

1 - Nënvizo te proverbat më poshtë vetëm ato folje që \*<sup>12</sup> luken se janë të mënyrës urdhërore e shkruaji veç.

- Kallamë? Shkil e lë!
- Eja, bukë, të të ha!
- Fol pak e gjegj shumë!
- Ruaju lumit që ngë trugullin!
- **Rrah hekurin kur isht i ngrohtë!**
- Përit, o kal, të binjë bari!

(CT - Fjalë të motshëme - n. 42, 140, 151, 320, 323, 498)



**Foljet te mënyra urdhërore janë :**

2 - Zglith mirë e mëso përmendsh (a memoria) këtë parkalesi e vjetër të zotit Nikola Brankato:

*Eja*, Shpirt e Perëndi,  
*përvëlomë* ti këtë gjë;  
u t' përes me dishirim;  
*shejtëromë* shpirtin tim.  
*Eja*, o Shpirti Shejt i jim,  
*eja e ndrite* shpirtin tim.  
Flakë e gjallë e Shpirtit Shejt,  
*dbizëm* zëmbërën me të shpejt.  
*Eja*, o Frymë e Parakletë,  
*ngushullomë* me t' vërtetë.  
O Parrajs i shpirtit tim,  
*mblomë* zëmbërën me gëzim.  
Dritën tënde, o Shpirt, *dhurona*,  
*dhis* me zjarrin zëmbërat tona.

(CT - XI - f. 134)

### Tjerë shembuj letrarë

Thot Pilati: *Mirrënie* ju e *kriqëzonic*.... E atë: *Mirre*, *mirre* e *vëre* ngriq.  
(FZ - Viti i parë - 15 të shtatorit 1912, n. 30 - f. 4, sht. 1, r. 2 e 26,27)

Në kalivët shtejtë *ze* një' angonë /.../ Mos shash atë, e këtë *le* zakonë...  
(NF - Codice - f. 55, vj. 78-80)

... *mirr* male e *le* horënë.  
(NF - Codice - f. 59, vj. 194)

...*le* të qaset...  
(NF - Codice - f. 116, XVIII, vj. 84)

Na të klahemi e ti *ruana*...  
(CT - XLII - f. 172, XVIII, vj. 84)

*Flej*, o i dashur, e mos *klaj*;  
*rri* nde prëhër; mos *bën* vaj.  
(CT - LXXXII - f. 222, str. 1, vj. 5,6)

Atë gjak të derdhet *le*...  
(CT - XCIV - f. 266, vj. 337)

*Bjernie* këtu, se dua t'i pi gjakun...  
(CT - Novelline popolarë - XI - f. 445, z. 19)

*Le* kujdeset / e mejtimit; *leja* Aliut / ngashërimet, e me gazin, /.../ shpirtin tim *qeto*.  
(Dheu - V - f. 200, vj. 250/254)

Të bukurit bijë t' mi  
vemi na te perivoli,  
sa të mbledhjem një tufë lule.  
- Pa *mblith* një degë mollë  
për mua që jam e hollë.  
- *Mblith* një degëzë kukuqe  
për mua që jam e kuqe.  
- Edhe *mblith* një degë dardhë  
për mua që jam e bardhë.

(CT - VI - f. 8)

## MËSIMI 31F

Format e pashtjelluara: pjesorja, paskajorja, përcjellorja.

Sosëm me *mënyrat e shtjelluara* (litisht: modi definiti), vje' më rarë me ato mënyra të foljes që ndërrojnë vetën (u, ti ai, ...) e numrin (njëjës e shumës), si kemi parë.

Nani vemi te *format e pashtjelluara* (litisht: modi indefiniti), vje' më rarë te format që ngë ndërrojnë e qëndrojnë gjithmonë ashtu si janë.

Zglith.

### TE PURTELJA

*Tue natyr* te Purtelja e Gjinestrës tek e Para e Majit, kam mësuar shumë shërbise, që ngë ndëlgoja mirë kush isha më i vogël.

Purtelja e Gjinestrës ë vendi që të jep mundësinë të *shkosh* në mes të malevet sa të *veç* te Murtilat e të *vish* te Hora ka (nga) Murtilat.



“Purtele” vje' më rarë “derë e vogël”, ma (por) *thënë* për këtë “derë” në mes të malevet ngë i rri; ki' t' ish më mirë të *thëshjëm* “derë e madhe”.

*Tue kërkuar* te biblioteka komunale, *tue zgledhur* libre e *tue gjegjur* ata më pleq, mësova se te Purtelja e Gjinestrës, te Festa e të Parës së Majit të vitit 1947, banda Xhuliano shkrehu e vrau njëmbëdhjetë njerëz - gra, djelm e burra - e shumë vetë plagósi (ferirti), të Horës e të Murtilavet.

Sot kush shkon te Purtelja sheh përmendoren (monumentin) *bërë* me gurë të mëdhenj, që duken të *'shterë vënë* shtuara o më glunj o *shturë* te dheu, si ndodhi tek ajo ditë e ligë të vitit 1947.

Ka Purtelja te njera anë ke faqen e madhe të Kumetës e te jetra anë shpatullën plot me gurë të Picutës; ka (nga) del dielli mënd të *shobësh* panoramin e liqenit e te ku dielli humb duket edhe dejeti.

Çë janë

*rarë, thënë, bërë, vënë, shturë*, që zgloodhe te rrëfimi këtu lart ?

Janë *pjesore* (litisht: participi) të foljevet *bie, thom, bënj, vë, shtie*.

Vëre' tabelat.

## PJESORJA

FOLJA "kam"

pasur

FOLJA "jam"

klënë

ZGJEDHIMI I

FOLJA "kërkonj"

kërkuar

ZGJEDHIMI II

FOLJA "hap"

hapur

ZGJEDHIMI III

FOLJA "zë"

zënë

### Ca folje të parregullta te pjesorja:

**I**

vinj = (j)ardhur

**II**

flas = folur

jap = dhënë

shoh = parë

prier = pjerrë

thom = thënë

pres = pritur

vdes = vdekur

**III**

bie = prurë

bie = rarë

dua = dashur

ha = ngrënë

vete = vatur

Kur i vëmë "nyjën" përpara, nga **pjesorja** formohen:

- **ca emra asnjës:** të ngrënë, -it ; të folur -it; të nisur, -it; etj.
- **ca mbiemra:** i dashur, i pjerrë, i ngrënë, etj.

### Ndo shembull letrar

... **të nisurit** çë nisem u, kat hijën ndër jush ulqë ...  
(FZ – Viti i katërt 16 të mait 1915 , n. 13, f. 2, sht. 1, r. 5)

**Të shkuarit** çë shkoj këtë fat, ajo kish t' ish zonjë e madhe...  
(CT – Novelline popolari -II, f. 357/358, r. e sprasmja e e para)

Vëre' nani **paskajoren** (litisht: modo infinito).

Te rrëfimi lart, që ë mirë të zgledhësh pameta, gjen këto veta të *mënyrës lidbore*, që tek na arbëreshë marrjën vendin e *paskajores* :

*të shkosh, të veç, të vish, të thëshjëm, të shohësh.*

### Mëso.

**Paskajorja** te gluha shqipe formohet tuke i shtuar **pjesores** së foljevet pjesëzat "**për të**".

Ca shembuj:

- shkonj : për të + pjesorja *shkuar* = për të shkuar
  - vete : për të + pjesorja *vatur* = për të vatur
  - vinj : për të + pjesorja *jardbur* = për të jardhur
  - thom : për të + pjesorja *thënë* = për të thënë
  - shoh : për të + pjesorja *parë* = për të parë
- etj.

Vëre' tabelat.

## PASKAJORJA

(shqip)

FOLJA "**kam**"  
për të pasur

FOLJA "**jam**"  
për të klënë

ZGJEDHIMI I  
FOLJA "**kërkonj**"  
për të kërkuar

ZGJEDHIMI II  
FOLJA "**hap**"  
për të hapur

ZGJEDHIMI III  
FOLJA "**zë**"  
për të zënë

E sprasmja formë e pashtjelluar e foljevet thërritet **përcjellore**.

Tuke vrejtur rrëfimin më lart, shohjëm:

*tue vatur, tue kërkuar, tue zgledhur, tue gjegjur*  
*çë janë forma të përcjellores.*

Arbërisht bëhet me pjesëzën “tue” o “tuke” (shqip: “duke”) bashkë me pjesoren.

Ca shembuj:

- shkonj : *tuke + pjesorja shkuar* = tuke shkuar
  - vete : *tuke + pjesorja vatur* = tuke vatur
  - vinj : *tuke + pjesorja jardhur* = tuke jardhur
  - thom : *tuke + pjesorja thënë* = tuke thënë
  - shoh : *tuke + pjesorja parë* = tuke parë
- etj.

Vëre<sup>7</sup> tablelet.

## PËRCJELLORJA

FOLJA “kam”  
tuke pasur

FOLJA “jam”  
tuke klënë

ZGJEDHIMI I  
FOLJA “kërkonj”  
tuke kërkuar

ZGJEDHIMI II  
FOLJA “hap”  
tuke hapur

ZGJEDHIMI III  
FOLJA “zë”  
tuke zënë

Sa njeh  
*pjesoren* e foljes  
mënd të bësh me lehtësi  
(me façilità)  
*paskajoren*  
e  
*përcjelloren.*

## USHTRIME

Nënvizo te fjalitë më poshtë vetëm ato folje që të duken se janë *pjesore*, *paskajore* (*lidhore*), *përcjellore* e shkruaji veç.

- 1 - Sosur ushtrimet e matematikës, Marku dolli me Viton.
- 2 - Tue kënduar e tue kërcyer, Sara isht e vete të lozënj me Marën.
- 3 - Lënë më një anë biçikletat, Lia e Sonia zunë fill të jicjën më këmbë.
- 4 - **Bukur ë të veç te fusha të vjelësh te moi i otuvrit (tetorit)!**
- 5 - Marku, ngrënë broshinen e tij, mori të haj atë të të motrës, që, tue klarë, thërriti mëmën.

Në pjesore janë: sosur, \_\_\_\_\_

Në paskajore (lidhore) janë: \_\_\_\_\_

Në përcjellore janë: \_\_\_\_\_



## MËSIMI 32F

Kuadri përmbledhës i foljes.

### TABELJA E TË GJITHA MËNYRAVET ME TË GJITHA KOHËT ARBËRESHE

#### MËNYRA DËFTORE

8 KOHË

E TASHMJA  
E PAKRYERA  
E KRYERA E THJESHTË  
E ARDHMJA

E KRYERA  
E KRYERA E PLOTË  
E KRYERA E TEJSHKUAR  
E ARDHMJA E PËRPARME

#### MËNYRA LIDHORE

4 KOHË

E TASHMJA  
E PAKRYERA

E KRYERA  
E KRYERA E PLOTË

#### MËNYRA KUSHTORE

2 KOHË

E TASHMJA

E KRYERA

#### MËNYRA DËSHIRORE

2 KOHË

E TASHMJA

E KRYERA

#### MËNYRA URDHËRORE

1 KOHË

E TASHMJA

PJESORJA

1 FORMË

PASKAJORJA

1 FORMË

PËRCJELLORJA

1 FORMË



## MËSIMI 33F

Zgjedhimi i foljevet ndihmëse.

### TABELJA PËRMBLEDHËSE E ZGJEDHIMEVET TË FOLJEVET NDIHMËSE

#### FOLJA "kam"

##### MËNYRA DËFTORE

###### E tashmja

kam  
ke  
ka  
kemi  
kini  
kanë

###### E kryera

kam pasur  
ke pasur  
ka pasur  
kemi pasur  
kini pasur  
kanë pasur

###### E pakryera

kisha  
kisha  
kish  
kishëm  
kishët  
kishën

###### E kryera e plotë

kisha pasur  
kisha pasur  
kish pasur  
kish pasur  
kishëm pasur  
kishët pasur  
kishën pasur

###### E kryera e thjeshtë

pata  
pate  
pati  
patëm  
patët  
patën

###### E kryera e tejshtuar

pata pasur  
(i rrallë)

###### E ardhmja

ka kem  
ka kesh  
ka ketë  
ka kemi  
ka kini  
ka kenë

###### E ardhmja e përparme

ka kem pasur  
ka kesh pasur  
ka ketë pasur  
ka kemi pasur  
ka kini pasur  
ka kenë pasur

Edhe: do kem ...

##### MËNYRA LIDHORE

###### E tashmja

të kem  
të kesh  
të ketë  
të kemi  
të kini  
të kenë

###### E kryera

të kem pasur  
të kesh pasur  
të ketë pasur  
të kemi pasur  
të kini pasur  
të kenë pasur

###### E pakryera

të kisha  
të kisha  
të kish  
të kishëm  
të kishët  
të kishën

###### E kryera e plotë

të kisha pasur  
të kisha pasur  
të kish pasur  
të kish pasur  
të kishëm pasur  
të kishët pasur  
të kishën pasur

##### MËNYRA KUSHTORE

###### E tashmja

ki' t' kisha  
ki' t' kisha  
ki' t' kish  
ki' t' kishëm  
ki' t' kishët  
ki' t' kishën

###### E kryera

ki' t' kisha pasur  
ki' t' kisha pasur  
ki' t' kish pasur  
ki' t' kish pasur  
ki' t' kishëm pasur  
ki' t' kishët pasur  
ki' t' kishën pasur

Edhet: dejt' (t') kisha ...

##### MËNYRA DËSHIRORE

###### E tashmja

paça  
paçe  
pastë (paçit)  
paçim  
paçit  
paçin

###### E kryera

paça pasur  
(i rrallë)

##### MËNYRA URDHËRORE

###### E tashmja

ki e kij  
kini

###### PJESORJA

pasur

###### PASKAJORJA

për të pasur

###### PËRCJELLORJA

tue (tuke, duke) pasur

## FOLJA "jam"

### MËNYRA DËFTORE

#### E tashmja

jam  
je  
ë (isht, është)  
jemi  
jini  
janë

#### E kryera

kam klënë  
ke klënë  
ka klënë  
kemi klënë  
kini klënë  
kanë klënë

#### E pakryera

isha  
ishe  
ish  
ishëm  
ishët  
ishën

#### E kryera e plotë

kisha klënë  
kishe klënë  
kish klënë  
kishëm klënë  
kishët klënë  
kishën klënë

#### E kryera e thjeshtë

kleva  
kleve  
kle  
klemë  
kletë  
klenë

#### E kryera e tejskuar

pata klënë  
(i rralë)

#### E ardhmja

ka jem  
ka jesh  
ka jetë  
ka jemi  
ka jini  
ka jenë

#### E ardhmja e përparme

ka kem klënë  
ka kesh klënë  
ka ketë klënë  
ka kemi klënë  
ka kini klënë  
ka kenë klënë

Edhe: do jem ...

### MËNYRA LIDHORE

#### E tashmja

të jem  
të jesh  
të jetë  
të jemi  
të jini  
të jenë

#### E kryera

të kem klënë  
të kesh klënë  
të ketë klënë  
të kemi klënë  
të kini klënë  
të kenë klënë

#### E pakryera

të isha  
të ishe  
të ish  
të ishëm  
të ishët  
të ishën

#### E kryera e plotë

të kisha klënë  
të kishe klënë  
të kish klënë  
të kishëm klënë  
të kishët klënë  
të kishën klënë

### MËNYRA KUSHTORE

#### E tashmja

k' t' isha  
k' t' ishe  
k' t' ish  
k' t' ishëm  
k' t' ishët  
k' t' ishën

#### E kryera

k' t' kisha klënë  
k' t' kishe klënë  
k' t' kish klënë  
k' t' kishëm klënë  
k' t' kishët klënë  
k' t' kishën klënë

Edhe: dejt' (t') isha ...

### MËNYRA DËSHIRORE

#### E tashmja

klofsha  
klofshe  
kloftë (klofshit)  
klofshim  
klofshit  
klofshin

#### E kryera

paça klënë  
(i rralë)

### MËNYRA URDHËRORE

#### E tashmja

j  
jini

#### PJESORJA

klënë

#### PASKAJORJA

për të klënë

#### PËRCJELLORJA

tue (tuke, duke) klënë

## MËSIMI 34F

Zgjedhimi vepror.

### TABELJA PËRMBLEDHËSE E ZGJEDHIMIT VEPROR

#### FOLJET "zgjonj", "mas", "vë" o "vu"

#### MËNYRA DËFTORE

##### E TASHMJA

zgjonj	mas	vë
zgjon	man	vë
zgjon	man	vë
zgjojëm	masjëm	vëmë
zgjoni	mani	vëni
zgjojnë	masjën	vënë

##### E PAKRYERA

zgjoja	masja	vëja
zgjoje	masje	vëje
zgjoj	masëj	vëj
zgjojëm	masjëm	vëjëm
zgjojët	masjë	vëjë
zgjojnë	masjën	vëjën

##### E KRYERA E THJESHTË

zgjova	mara	vura
zgjove	mate	vure
zgjoi	mati	vuri
zgjuam	matëm	vumë
zgjuat	matët	vutë
zgjuan	matën	vunë

##### E ARDHMJA

ka zgjonj	ka mas	ka vë
ka zgjosh	ka masësh	ka vësh
ka zgjonjë	ka masënj	ka vënj
ka zgjojëm	ka masjëm	ka vëmë
ka zgjoni	ka mani	ka vëni
ka zgjojnë	ka masjën	ka vënë

#### MËNYRA LIDHORE

##### E TASHMJA

të zgjonj	të mas	të vë
të zgjosh	të masësh	të vësh
të zgjonjë	të masënj	të vënj
të zgjojëm	të masjëm	të vëmë
të zgjoni	të mani	të vëni
të zgjojnë	të masjën	të vënë

##### E KRYERA

kam	zgjuar	matur	vënë
ke	"	"	"
ka	"	"	"
kemi	"	"	"
kini	"	"	"
kanë	"	"	"

##### E KRYERA E PLOTË

kisha	zgjuar	matur	vënë
kishe	"	"	"
kish	"	"	"
kishëm	"	"	"
kishër	"	"	"
kishën	"	"	"

##### E KRYERA E TEJSHKUAR

pata	zgjuar	matur	vënë
	(i rrallë)		

##### E ARDHMJA E PËRPARME

ka kem	zgjuar	matur	vënë
ka kesh	"	"	"
ka ketë	"	"	"
ka kemi	"	"	"
ka kini	"	"	"
ka kenë	"	"	"

##### E KRYERA

të kem	zgjuar	matur	vënë
të kesh	"	"	"
të ketë	"	"	"
të kemi	"	"	"
të kini	"	"	"
të kenë	"	"	"

**E PAKRYERA**

të zgjoja	të masja	të veja
të zgjoje	të masje	të veje
të zgjoj	të masëj	të vej
të zgjojmë	të masjem	të vejëm
të zgjojët	të masjët	të vejët
të zgjojnë	të masjnë	të vejën

**E KRYERA E PLOTË**

të kisha zgjuar matur vënë			
të kishe	"	"	"
të kish	"	"	"
të kishëm	"	"	"
të kishët	"	"	"
të kishën	"	"	"

**MËNYRA KUSHTORE****E TASHMJA**

ki' t' zgjoja	ki' t' masja	ki' t' veja
ki' t' zgjoje	ki' t' masje	ki' t' veje
ki' t' zgjoj	ki' t' masëj	ki' t' vej
ki' t' zgjojmë	ki' t' masjem	ki' t' vejëm
ki' t' zgjojët	ki' t' masjët	ki' t' vejët
ki' t' zgjojnë	ki' t' masjnë	ki' t' vejën

**E KRYERA**

ki' t' kisha zgjuar matur vënë			
ki' t' kishe	"	"	"
ki' t' kish	"	"	"
ki' t' kishëm	"	"	"
ki' t' kishët	"	"	"
ki' t' kishën	"	"	"

**MENYRA DËSHIRORE****E TASHMJA**

zgjoftsha	matsha	veftsha
zgjoftshe	matshë	veftshë
zgjoftë	mathtë	vefthtë
zgjoftshim	matshim	veftshim
zgjoftit	matshit	veftshit
zgjoftshin	matshin	veftshin

**E KRYERA**

paça zgjuar matur vënë  
(i rrallë)

**MËNYRA URDHËRORE****E TASHMJA**

zgjo	mat	vër
zgjoni	matni	vëni

**PJESORJA**

zgjuar          matur          vënë

**PASKAJORJA**

për të zgjuar          për të matur          për të vënë

**PËRCJELLORJA**

tue (tuke, duke) zgjuar          tue (tuke, duke) matur          tue (tuke, duke) vënë

## MËSIMI 35F

Zjedhimi vepror: folje kalimtare e jokalimtare.

Zgjidh mirë këto fjali.



Marku **ka vatur** përjashta.

Gjergji **rrjedh**.



Vito **çajti** kënatën.

Sara **hëngri** dardhën.



Kemi parë njera më naní folje të “zgjedhimit vepror” (litisht: coniugazione attiva), ku mbiemri “vepror” na thotë çila ë e si ë “vepra” (litisht: azione) e foljes: ë “aktive”, vje’ më rarë se ë kryefjala çë “bën veprën”.

**Shembull:** Gjergji **rrjedh**.

Folja “rrjedh”, pra, ë folje **jokalimtare** (litisht: verbo intransitivo), përçë “vepra” (e të rrjedhurit) *qëndron* te kryefjala, te *Gjergji*.

Kur pra nga kryefjala “vepra” *shkon* (shqip: kalon, kalim, kalimtar) te “kundrina e drejtë” (litisht: complemento oggetto), kemi përpara nesh folje **kalimtare** (litisht: verbo transitivo).

**Shembull:** Vito **çajti** kënatën.

*Vito*, kryefjalë, “vepron” e “vepra” e tij *shkon* te “kundrina e drejtë”, çë ë *këната*.

**Mëso mirë:**


Folja çë na jep ndihmë të zgjedhojmë *kobët e përbëra* te *zgjedhimi vepror* ë folja ndihmëse “kam”, e me folje **jokalimtare** e me folje **kalimtare**.

**Shembuj:** Marku **ka** vatur përjashta = *jokalimtare*.

Sara **ka** ngrënë dardhën = *kalimtare*.

## USHTRIME

Këtu ke pesë folje kalimtare e pesë jokalmtare; lidhi me kaselen që ti ndëlgon se isht ajo e tyrja.



## MËSIMI 36F

Zgjedhimi pësor e vetvetor: njohuri të përgjithshme.

### ZGJEDHIMI PËSOR

Nani zglith mirë këto fjali.



Kënata **kle çarë** nga Vito.



Dardha **kle ngrënë** nga Sara.



Kur kryefjala “pëson” (litisht: subisce) “veprën” e thënë te folja, atëherë kemi përpara nesh folje pësore e andaj zgjedhimin pësor (litisht: coniugazione passiva).


Shembull: Kënata **kle çarë** nga Vito.

*Kënata*, kryefjalë, “pëson veprën” e bërë nga *Vito*, që ë plotës vepruesi (litisht: complemento d’agente).

Kanë “zgjedhimin pësor” vetëm ato folje që janë “kalimtare”. Këtë mënd t’ë ndëlgojmë më mirë kur prierjëm **fjalinë veprore** (aktive) në **fjali pësore** e anasjelltas (litisht: viceversa).

Kështu: Vito **çajti** kënatën. > < Kënata **kle çarë** nga Vito.





Sara **hëngri** dardhën. > < Dardha **kle ngrënë** nga Sara

**Mëso:**

Folja çë na jep ndihmë të zgjedhojmë *kobët e përbëra te zgjedhimi pësor* ë folja ndihmëse "**jam**".

Shembull: Dardha **kle** ngrënë nga Sara.



**USHTRIME**

1 - Bëj pësore fjalitë këtu poshtë, çë ndodhen te diateza veprore.

- Marku hëngri brumit të djeshëm. \_\_\_\_\_ .
- Sara me një thikë shpoi balunin. \_\_\_\_\_ .
- Përjashta na poqëm misht dashi. \_\_\_\_\_ .
- Biçikletën e mori Marku. \_\_\_\_\_ .
- Kalin e qelli te fusha la' Gjerjgi. \_\_\_\_\_ .

2 - Bëj veprore fjalitë këtu poshtë, çë ndodhen te diateza pësore.

- Buka kle ngrënë ka (nga) qeni. \_\_\_\_\_ .
- Shpia kle stisur ka mas Gjergji. \_\_\_\_\_ .
- Dheu kle shitur ka noni i Markut \_\_\_\_\_ .
- Ushtrimet klenë bërë ka djali. \_\_\_\_\_ .
- Veja kle diganisur ka Sara. \_\_\_\_\_ .



## ZGJEDHIMI VETVETOR

E vëre' !

Gjergji **lahet**.



Sara **krihet**.



Marës, i vij **të hahej**!



Kur **kryefjala** bën një “vepër” që vete i sos asaj pameta, që bie mbi atë vetë, kemi përpara nesh folje **vetvetore** (litisht: verbi riflessivi) e andaj zgjedhimin **vetvetor** (litisht: la coniugazione riflessiva).

Te gluha arbëreshe e shqipe zgjedhimi vetvetor ë paraç si ai pësor.



### USHTRIME

Shkruaj ti ca folje vetvetore, te të çilat ka duket se e bëma (vepra) e kryefjalës priret te kryefjala vetë:

qëllonem, stolisem,  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## MËSIMI 37F

Zgjedhimi pësor-vetvetor.

*Zglith me vëmendje.*

### TE SHËN MITRI

Te Shë' Mitri, katedralja e Eparhisë së Horës (Eparhi, në të cilën janë mledhur edhe Munxifsi, Pallaci, Kundisa e Sëndastina), mbahen gjithë festat më të mëdha të besës katolike me ritin greko-bizantin.

Festa më e njohur ë ajo e Pashkëvet, me të cilën mbyllet "Java e madhe".

Turistët mbjdhën te Hora te dita e Pashkëvet, ma (por) "Java e Madhe" thuhet nga ditë karakterizohet për disa liturgji.

Me të vërtetë, liturgjitë te klisja zënë fill të mbahen dy ditë më parë se "Java e Madhe": tek e Shtunëja e Lazarit e tek e Diellja e Rombollidhëvet. Te vespri i të prëmtës këndonet "Lazari", më parë te Klisja, pra përpara monumentit (përmendores) për ushtarët tanë që ranë te Lufta e parë Botërore 1915/'18, e pra te gjithë vendet ku djemtë e vajzat e korit janë ghrizur.

Tek e Diellja e Rombollidhëvet, Eparhu vëhet kaluar te ghajdhuri e shkon tue bekuar nëpër rrugët e Horës, njera te Shë' Mitri ku bënet Pontifikali.



Tek e Injtja e Madhe te Pontifikali thuben parkalesitë që la Yn' Zot kur Apostojvet i dha kungimin me bukë e verë e i (u) laben nga Eparhu këmbët Apostujvet, që janë ca priftra tanë.

Tek e Prëmtja e Madhe menatnet *këndonen* "orët" e mbrëmanet, pas vesprit, *dilet* për procesjonën e Krishtit vdekur.

Tek e Shtunëja e Madhe te Pontifikali *këndonet* lajmi (litisht: l'annuncio) i të fluturuarit të t' Yn' Zoti e te mesnata e të Dielljës *mbahet* liturgjia "Krishti u ngjall".

Te Pontifikali i Pashkëvet vangjei *thubet* me shtatë gluhë, sa të *kujtonet* se ai vangjej *ka jetë qellur* të gjithë anët e botës.



E Diellja e Pashkëvet *mblonet* me kulture (ngjyra) e me gëzim: vajzat tona *vishen* me kostumin tradicional; njerëzit, arbëreshë e të huaj, *ndihen* marrë nga një atmosferë të rrallë. Pra *mbjidhen* gjithë te qaca; atje *dhuronen* vetë e kuqe e festa *mbyllet* tue rrnartur polezën (tue hedhur në short): një brez o një kurçetë për kë *u vesh* me kostumin e Horës së Arbëreshëvet.

**Çë janë foljet me shkronja korsive**

*janë mbledhur, mbahen, mbyllet, mbjidhen, karakterizonet, këndonet, janë ghrizur, vëhet, bënet, thuhen, laben, këndonen, dilet, këndonet, mbahet, thuhet, kujtonet, ka jetë qellur, mblonet, ndihen, mbjidhen, dhuronen, mbyllet, u vesh ?*

**Janë veta të kohëvet të zgjedhimit pësor-vetvetor.**

## TABELJA E ZGJEDHIMIT PËSOR - VETVETOR

FOLJET *zgjouem* o *zgjohem*, *matem*, *vëhem* o *vubem*

### MËNYRA DËFTORE

#### E TASHMJA

zgjouem	matem	vëhem
zgjone	mate	vëhe
zgjonet	matet	vëhe
zgjouemi	matemi	vëhemi
zgjoni	matij	vëhij
zgjonen	maten	vëhen

#### E KRYERA

jam	zgjuar	matur	vënë
je	"	"	"
ë	"	"	"
jemi	"	"	"
jini	"	"	"
janë	"	"	"

#### E PAKRYERA

zgjonesha	matesha	vëhesha
zgjoneshe	mateshe	vëheshe
zgjonej	matej	vëhej
zgjoneshim	mateshim	vëheshim
zgjoneshit	mateshit	vëheshit
zgjoneshin	mateshin	vëheshin

#### E KRYERA E PLOTË

isha	zgjuar	matur	vënë
ishe	"	"	"
ish	"	"	"
ishëm	"	"	"
ishët	"	"	"
ishën	"	"	"

#### E KRYERA E THJESHTË

u zgjova	u mata	u vura
u zgjove	u mate	u vure
u zgjua	u mat	u vu
u zgjuam	u matëm	u vumë
u zgjuat	u matët	u vutë
u zgjuan	u matën	u vunë

#### E KRYERA E TEJSHKUAR

kleva	zgjuar	matur	vënë
kleve	"	"	"
kde	"	"	"
klemë	"	"	"
kletë	"	"	"
klenë	"	"	"

#### E ARDHMJA

ka zgjounem	ka matem	ka vëhem
ka zgjounesh	ka matesh	ka vëhesh
ka zgjounet	ka matet	ka vëhet
ka zgjounemi	ka matemi	ka vëhemi
ka zgjounij	ka matij	ka vëhij
ka zgjounen	ka maten	ka vëhen

#### E ARDHMJA E PËRPARME

ka jem	zgjuar	matur	vënë
ka jesh	"	"	"
ka jetë	"	"	"
ka jemi	"	"	"
ka jini	"	"	"
ka jenë	"	"	"

### MËNYRA LIDHORE

#### E TASHMJA

të zgjounem	të matem	të vëhem
të zgjounesh	të matesh	të vëhesh
të zgjounet	të matet	të vëhet
të zgjounemi	të matemi	të vëhemi
të zgjounij	të matij	të vëhij
të zgjounen	të maten	të vëhen

#### E KRYERA

të jem	zgjuar	matur	vënë
të jesh	"	"	"
të jetë	"	"	"
të jemi	"	"	"
të jini	"	"	"
të jenë	"	"	"

#### E PAKRYERA

të zgjonesha	të matesha	të vëhesha
të zgjoneshe	të mateshe	të vëheshe
të zgjonej	të matej	të vëhej
të zgjoneshim	të mateshim	të vëheshim
të zgjoneshit	të mateshit	të vëheshit
të zgjoneshin	të mateshin	të vëheshin

#### E KRYERA E PLOTË

të isha	zgjuar	matur	vënë
të ishe	"	"	"
të ish	"	"	"
të ishëm	"	"	"
të ishët	"	"	"
të ishën	"	"	"

## MËNYRA KUSHTORE

### E TASHMJA

ki' t' zgjonësha	ki' t' matesha
ki' t' zgjonëshe	ki' t' mateshe
ki' t' zgjonëj	ki' t' marej
ki' t' zgjonëshim	ki' t' mareshim
ki' t' zgjonëshit	ki' t' matëshit
ki' t' zgjonëshin	ki' t' matëshin

ki' t' vëhësha
ki' t' vëhëshe
ki' t' vëhej
ki' t' vëhëshim
ki' t' vëhëshit
ki' t' vëhëshin

### E KRYERA

ki' t' isha	zgjuar	matur	vënë
ki' t' ishte	"	"	"
ki' t' ish	"	"	"
ki' t' ishëm	"	"	"
ki' t' ishët	"	"	"
ki' t' ishën	"	"	"

## MËNYRA DËSHIRORE

### E TASHMJA

u zgjoftsha	u matsha
u zgjoftshe	u matshe
u zgjoftë	u matrë
u zgjoftshim	u matshim
u zgjoftshit	u matshit
u zgjoftshin	u matshin

u vëftsha
u vëftshe
u vëftë
u vëftshim
u vëftshit
u vëftshin

### E KRYERA

kloftsha	zgjuar	matur	vënë
kloftshe	"	"	"
kloftë	"	"	"
kloftshim	"	"	"
kloftshit	"	"	"
kloftshin	"	"	"

## MËNYRA URDHËRORE

### E TASHMJA

zgjou  
zgjonij

matu  
matij

vuru e vëru o vëhu  
vëhij

zgjuar

### PJESORJA

matur

vënë

për t' u zgjuar

### PASKAJORJA

për t' u matur

për t' u vënë

### PËRCJELLORJA

tue (tuke, duke) u zgjuar

tue (tuke, duke) u matur

tue (tuke, duke) u vënë



Me gjithë këto  
çë dimë, e shihni  
sa u kemi rritur ?



## MËSIMI 38F

Mbi "foljen".

*Të kujtosh !*

1 "Kam" e "jam" thuhet *folje ndihmëse* kur ndodhen përpara pjesores së foljevet.  
**Shembuj:** **kam** larë, **jam** larë; **kisha** larë, **isha** larë; etj.

2 "Këpujore" thuhet folja "jam" kur lidh *kryefjalën* (emrin etj.) me *kallëzuesin emëror* (litisht: *predicato nominale*).

**Shembull:** Ti **je** i mirë.

Ti = kryefjalë

**je** = këpujë (litisht: copula)

**i mirë** = kallëzues emëror.

3 Folje "kalimtare" thuhet ajo që merr prapa asaj *kundrinën e drejtë*, që te forma pësore-vetvete bëhet kryefjalë.

**Shembull:** Marku **hëngri** bukën. > Buka **kle ngrënë** ka Marku.

Marku = kryefjalë

Buka = kryefjalë

**hëngri** = kallëzues foljor

**kle ngrënë** = kallëzues foljor

bukën = kundrinë e drejtë.

ka Marku = plotës vepruesi

4 Folje "jokalimtare" thuhet ajo që ngë merr *kundrinën e drejtë* e veprimi qëndron te *kryefjala*.

**Shembull:** Marku **rrjedh**.

Marku = kryefjalë

**rrjedh** = kallëzues foljor.

5 Folje "njëvete" thuhet ajo që përdoret vetëm te *veta e tretë* njëjës e shumës.

**Shembuj:**

a) Kali **hëngëllis**. Kuejt **hëngëllisjën**. Qeni **leh**. Qentë **lehjën**.

b) **Bie** (shī). **Fryn** (erë).

c) **Dihet** se Hora ë e Arbëreshëvet.

**Duket** se vemi mirë.

**Dihet** = fjali kryesore

se Hora ë e Arbëreshëvet = fjali e varur kryefjalore.

**Duket** = fjali kryesore

se vemi mirë = fjali e varur kryefjalore (litisht: *proposizione subordinata soggettiva*).

6 Folje "pavetore" ë folja që ka po *vetën e tretë* njëjës e ngë ka kryefjalë.

**Shembuj:** **Gjëmon**.

**Bën rëtim**.

SA JANË PJESËT E LIGJËRATËS ÇË NGË NDËRROJËN?  
JANË PESË:

NDAJFOLJA, PARAFJALA, LIDHËZA, PJESËZA, PASTHIRRMA



## MËSIMI I Nd

*Ndajfolja.*

Zglith këtë rrëfim.

### RRETH HORËS

*Sot këtu te Hora o më mirë rreth Horës, alarta e aposhta ku janë malet e ku ë liqeni, kanë zënë fill të vijën zoga që më parë ngë kishën jardhur kurrë, veç thomse ndo treqind vjet prapa e më shumë, kur voshqet antikë ishën ankora të tërë.*



Çë vje' më rarë se vijën zogat? Vje' më rarë se ambienti ka më shëndet se më parë, përçë kemi më shumë arvullamë, megjithëse kemi edhe më shumë shpi këtë lart te Gamili, këtë poshtë te Shënjani e gjithasajtëna, ndanëz e llargu.

Te vitet 50 (pesëdhjetë) aty rreth liqenit rriteshin po tri arvullamë, tri plepe, e aty te kampusanti i vjetër ndo shtatë qiparise; sot një kordele pinjollësh, plepesh, lisash, eukaliptesh rrethon liqenin.



Te dhromi i Sëndastinës te shtazhuna, *kur* bëj ajo vapë që të josëj *ajashta e abrënda*, ngë kishe *ku* të gjeje një thërrime hje në jicje më këmbë. *Sot* hjen e gjen përposh eukaliptevet, po kush ë që jec më këmbë? Ti sheh mdonjeri që jec më këmbë? *Ëj o jo? Jo!* E megjithatë të pëlqen, si shkon me makinën, të gjesh ca hje te dhromi i Sëndastinës *kur* bën vapë .

*Më mirë sot se dje e e thomi: më mirë nestër se sot*, në te gjindja rritet dashuria për ambientin.

*Kështu* më jerdhi të thëshja e *kështu* thashë.

**Çë janë gjithë ato fjalë shkruar me gërma korsive?  
Janë ndajfolje” (litisht: avverbi).**

**Ndajfolja** ë ajo pjesë e pandërrueshme e ligjëratës që shërben të caktonjë (determinarënj), të plotësonjë o të ndërronjë më pak o më shumë atë që do të thomi me foljen, me mbiemrin o me ndajfoljen.

**Ndajfoljet** te rrëfimi më sipër ndahen kështu:

● **të vendit:** *këtu, ku, alarta, aposhta, këtë, poshtë, gjithasajhtëna, ndanëz, llargu, aty, ajashta, abrënda; ca tjera* *atej, atje, këtej, këtë, lart, (a)mandajashta, (a)mandabrënda, mbatanë, përknahu, sipër o siprë, jashtë, brënda, përpara, prapa, etj.*



● **të kohës:** *sot, më parë, kurrë, prapa, ankora, kur, dje, nestër; ca tjera: nani, ndëvonë, pran, njize, gjithmonë, kurdoherë, gjithbashkë, gjithnjibashku, gjithnjiberje, sonte, natën, ditën, mbrëmanet e mbrëmënet, menatnet, kosdej, ngrystë;*

● **të mënyrës:** *më mirë, kështu; ca tjera: ashtu, bukur, lig, mirë; arbërisht, mjerisht*

● **të sasisë** (litisht: *quantità*): *më shumë, më; ca tjera: ndutu, pak, më pak, shumë, sa;*

● **të pohimit** (litisht: *affermazione*): *ëj; edhe: oraëj e araëj (Sendastinë: ara');*

● **të mohimit** (litisht: *negazione*): *jo, ngë; së e s' (më shumë shqip);*

● **të dyshimit** (litisht: *dubbio*): *thomse; ca tjera: kushedi, ndoshta;*

Kemi pra te të folurit e më shumë te gluha e shkruar disa **shprehje ndajfoljore** (litisht: *locuzioni avverbiali*):

● **të vendit:** rreth e rrotull;

● **të kohës:** për gjithmonë, një ditëz, natë e ditë o nat' e ditë, n'dita n'dita, ditë për ditë, javë për javë, vit për vit, një ditë e një orë, etj.;

● **të mënyrës:** abarkeza, abrendazë, akatrakëmbëza, ashtu ashtu, copa copa, dalë e dalë o dal' e dalë, dorë më dorë o dora dora, drej për drejt, glu më glu, gojë më gojë, kështu e kështu, krah për krah, më këmbë, valë e valë o val' e valë, etj.; e **këto:** një e një, dy e dy, tre e tre, katr' e katrë, pes' e pesë, etj.;

● **të sasisë:** a pancata (shqip: me bollëk, sa të duash);

● **të pohimit:** ëngjeq.

#### SHËNIM.

Edhe **ndajfolja ka shkallët si mbiemri.**

**Shembuj:** mirë, më mirë, shumë mirë;

pak, më pak, shumë (më) pak;

etj.

**Vëre'** edhe këtë sistem të ndari të ndajfoljevet sipas formimit.

Kemi:

● **ndajfolje të parme** (litisht: *avverbi primitivi*), vje' më rarë se ngë vijën nga tjera fjalë të ligjëratës:

afër, ashtu, atje, aty, kështu, këtej, këtu, lart, llargu, mirë, pas, posht o poshtë, prapa, sonte, sot, etj.;

● **ndajfolje të prejardhura** (litisht: avverbi derivati), që vijën nga tjera pjesë të ligjëratës:

● **nga emra:** abarkëza (bark, -u), arbërisht (arbëresh, -i), ditën (ditë, -a), menatnet (menatë, -a), mbrëmanet (mbrëmë, -a), natën (natë, -a), një ditë, një natë, prëmë (mbrëmë, -a), rreth (rreth, -i), rrotull (rrotull, -a), vjet (vit, -i), etj.

● **nga mbiemra:** bukur (i bukur), drejt (i drejt), fort (i fort), lig o lik (i lig), mirë (i mirë), rëndë (i rëndë), rrallë (i rrallë),

● **nga folje:** frohtë (ftoh), ngrohtë (ngroh), ngrystë (ngrys), thatë (thanj), etj.

● **ndajfolje të përngjitura** (litisht: avverbi composti) që daljën tuke ngjitur dy o tri pjesë të ligjëratës:

atëherë	>mbiemri atë + emri herë, -a;
gjithmonë	>mbiemri gjithë + emri mon, -i;
gjithnjë	>mbiemri gjithë + numërori një;
gjithnjibashku	>mbiemri gjithë+nyja e pacaktuar një+ndajfolja bashkë
gjithnjisherje	>mbiemri gjithë+nyja e pacaktuar një+emri herë, -a
gjithasajtën	>mbiemri gjithë + ndajfolja asajtën
kudo	>përemri ku + folja do;
kurdoherë	>ndajfolja kur + folja do + emri herë, -a;
ndërkaq	>parafjala ndër + ndajfolja kaq;
ngaherë	>mbiemri nga + emri herë, -a;
rrallëherë	>ndajfolja rrallë + emri herë, -a;
sado	>përemri sa + folja do;
etj..	

#### SHËNIM.

Mos ndërro disa ndajfolje me parafjalët paraç.

Për shembull: "ndanëz" mënd të jetë

ndajfolje: Më rri **ndanëz**.

e parafjalë: **Ndanëz** meje rri Pali.

Ca tjera janë këto: afër, llargu, rreth.



## USHTRIME

Vër te vendi që i nget këto ndajfolje: abarkëza, ngaherë, kudo, sot, rrallë.

- 1 - Mikun tim që rri Torino e shoh \_\_\_\_\_.
- 2 - Fëmija jiku ka djeba e jicëj \_\_\_\_\_.
- 3 - \_\_\_\_\_ ka përpiqem me miqtë.
- 4 - \_\_\_\_\_ më thotë se ë mik jimi.
- 5 - Mënd t'ë kërkosh \_\_\_\_\_, ma pendën e zборе.



### Shembuj letrarë.

E të bijët e rregjëris ka t' jen shtur te të më-t-ertit **mantajáshta...**  
(E.Z. - Viti i parë - 23 të kqershorit 1912, n. 18, faqe 1, sht. 21, tek e sprasmja)

Ki, si pati këtë urdhurim, i shtu në fulaqi **abrëndazë** e i shtrëngoi këmbët e 'tyre te druri.  
(E.Z. - Viti i katrët - 9 të maít 1915, n. 12, faqe 2, shryllë 1, radhë 18, 19, 20)

Po **mjerisht**, thonë të Shkruamet Shejte, si vdisëj Gjiku populli pameta bij te mëkata..  
(E.Z. - Viti i katrët - 28 të shkurturit 1915, n. 2, f. 3, sht. 2, r. 10/12)

**Gjithnjíherie** jerdhi një dhe-tundie...  
(E.Z. - Viti i katrët - 9 të maít 1915, n. 12, faqe 2, shryllë 1, radhë 23, 24)

E kështu bëri për dizetë ditë, **menatënet** e **mbrëmanet** ...  
(E.Z. - Viti i katrët - 9 të maít 1915, n. 12, faqe4, shryllë 1, radhë 3, 4)

**Ndëvonë** i lypí ndjesë....  
(C.T. - Novelline popolari, X - f. 426, r. 3)

## MËSIMI I Par

Parafjala.

Zglith e vëre'.

### RRUGA PIETRO NOVELLI

*Për mua si edhe për ty janë thuajse të panjohura qantimët (bimët) e vogla që rriten te rrethi i Horës.*

*Të fushat, te arat, te rehjet, te gropat, njera (ngjer) te shpatullat e malevet e mbi majat, kemi aq shumë lloje barërash se i duhen tru t'i kujtosh të gjitha.*

*Rrëzë stratëvet (rrugëvet), mbi ndo vërë te muret e shpivët, buzë llavinarëvet, përposh gurëvet e disa herë sipër gurëvet, anë lumevet, ku ish isht, sheh qantimë (bimë) të gjelbëra (virdi) me ndo lule në majë.*

*I duhej të jicjëm bashkë me një ekspert që na thëshëj gjithë emret e barëravet që shihjëm!*

*Një herë më dhanë një numër të rivistës "Mondo Albanese" ku zgloodha sa barëra diljën glatë rrugës Pietro Novelli te ana e Shën Mitrit.*

*Nga faqja që zgloodha nxier këtë frazë: "Gjejëm urdhin, krietëzën, tërshërën, sulën, ashprelen, splitrin, graminjën, égjërën, krinjën, mutrërën, mëllagën, bukëljepurin".*

*Te revista janë shkruar edhe tjerë barëra që rriten tue marrë ushqim (të ngrënë) nga ajo pak botë në mes të shkallunerës të (së) rrugës Pietro Novelli: "paporinë, dhiozmë e egër (që thomse ë menta e egër), gluhëkau, kërshill, thundër, bar i crës, bukëvaj" e tjerë.*



*U pra vajta me një mik te rruga Pietro Novelli të shihja në barërat ishën atje si i kisha zgledhur te revista. Gjithë atje ishën!*

*Me mikun tim pashë dy llapsana prapa njëi shkalluni të çarë e pashë një vërrajne nën një gur të pjerrë: llapsanat e vërrajnat i njoh se vete me nonin t'i mbjeth përplashta.*

## Çë janë

*për, te, njera te (ngjer te), mbi, rrëzë, buzë, përposh, sipër, anë, me, në, bashkë me, glatë, nga, në mes, prapa, nën?*

Janë **parafjalë** (litisht: prepozizioni).

**Parafjala** ë ajo pjesë e pandërrueshme e ligjëratës që shërben të na thetë çilën ndërlidhje kanë dy fjalë tek e njëjta fjali.

Thuhet **parafjalë** përçë vuhet gjithmonë “para (përpara)” emrit, numërorit, përemrit.

## **Parafjalët** mënd të jenë:

- **të thjeshta:** mbi, me, më, ndër, në, nën, nga (ka), pa, për, prej, te e tek, etj.;
- **të përngjitura** (litisht: **composte**): mbatanë (mbë+atë+anë), nëpër (në+për), përkrahu (për+krahu), përmbi (për+mbi), përpara (për+para), përposh (për+posht), sipas (si+pas), etj.;
- **me origjinë emrash:** ballë, buzë, faqe, mes, rrëzë;
- **me origjinë ndajfoljesh:** brënda, glatë, jashtë, kundra, ndanëz, llargu, etj.;
- **lokucjone:** bashkë me, ndanëz, në mes, njera te (ngjer te), në vend (të), për në, për në mes, etj.

**Parafjalët** mbajën emrin, numërorin, përemrin në rasat emërore, gjinore, kallëzore, rrjedhore.

- **me emëroren e shquar e të pashquar:** nga, ka e kak (o nga e ngak), te e tek.  
**Shembuj:** **Nga dita** e parë shkolla më pëlqeu.  
Vinj **ka (nga)** Palerma.  
**Kak (ngak)** na mos prit vetëm fjalë.  
Sara ë **te** shpia.  
Vete **te** Hora.  
Eja **tek** u.
- **me gjinoren e shquar:** në vend (të), për hir (të) (litisht: grazie a).  
**Shembuj:** I vëllai vate të shërbej **në vend** të prindit.  
**Për hir të** mikut gjeti maçën e zbjerrë.
- **me kallëzoren e shquar e të pashquar:** bashkë me, mbi, me, më, ndër, në, nën, ndër, pa, për, për në, nëpër.

**Shembuj:** Jim vëlla rri bashkë **me** mua.  
 Eja **me** mua te skolla!  
 Kërcej (sotarëj) **me** gëzimin.  
**Më** 12 tetor 1492 u zbulua Amerika.  
 Buka ë **mbi** tryes (tryezë).  
 Hora ë më e madhja **ndër** horët arbëreshe.  
 Sara ë **në** (**ndë**) shpi.  
 Maçi ë **nën** tryes (tryezë).  
 Rrijti një ditë **pa** bukë e **pa** ujë.  
**Për** mua e **për** Markun dy broshine!  
**Për** nestër kam shumë ushtrime (kompiti).  
 Ngë dua njeri **për në** këmbë.  
 Vemi tue jecur **nëpër** rrugët e Horës.

● **me rrjedhoren e shquar e të pashquar:** buzë, drejt, kundër e kundra, ndanëz, në mes, llarg e llargu, mbatanë, ndaj, ndër, për, pajt, pas, përpara, përposh, prapa, prej, rrezë, sipër e sipra o asipra, veç, rreth (*litisht:* intorno).

**Shembuj:** **Buzë** lumit rriten lule të egëra.  
 Jecjëm **drejt** kursit Kastriota.  
 Qeni u sul **kundra** meje.  
**Ndanëz** meje rri Sara.  
**Në mes** voshkut (pyllit) pashë ca kupurdha.  
**Llargu** Horës Marku ndien nostalgji.  
**Mbatanë** lumit kemi një copë dhe.  
 Pali qillet (kumpurtaret) mirë **ndaj** miqvet.  
**Ndaj** (*litisht:* verso) të gdhiri zogat zënë fill cicërimat.  
**Ndër** nesh ndëlgonemi.  
 E zura **për** qafje.  
**Pajt** meje e pate dhuratën.  
**Pas** vitit 1488 u stis Hora.  
 Markun e pashë **përpara** kafeut.  
 Maçi u fsheh **përposh** tryesës.  
 Sara rri **prapa** Shën Gjergjit.  
**Prej** jush ngë e prisja.  
**Rrezë** shpisë e kam kopshtin.  
**Sipër** qeramidhevet të shpisë zogat stisën folenë!  
**Veç** Markut ngë jerdhi njeri.  
 Fluturat fluturojnë **rreth** lulevet.

## USHTRIME

Vër këto parafjalë përpara rasës ç' i nget: me, kundra, përposh, te, rrëzë, për, në mes.

- 1 - Maçi u fsheh \_\_\_\_\_ tryesës.
- 2 - \_\_\_\_\_ Hora vijën shumë turistë.
- 3 - \_\_\_\_\_ mua mënd të veç kudo.
- 4 - \_\_\_\_\_ lumit rriten lule t' egëra.
- 5 - Janë të gjithë \_\_\_\_\_ meje !
- 6 - \_\_\_\_\_ mikun tim nestër ka vete Palermë.
- 7 - Hora kle stisur \_\_\_\_\_ të malevet.



### Ca shembuj letrarë.

... ki t' durojën **pajt** Vangjejit...  
(FZ - Viti i parë - 14 të korrikut 1912 - n. 21, f. 2, sht. 1, r. 3)

Përse në u ju helmonj, kush pra isht ai çë do t' të gëzonjë mua, veç se ai çë kle **ngak** u helmuar?  
(FZ - Viti i parë - 1 e shtatorit 1912, n. 28, f. 3, sht. 2, r. 20)

**Tek** ai qëro u hip lisui **në** Jerosolím.  
(FZ - Viti i parë - 28 të prillit, 1912, n. 10, f. 1, sht. 1, r. 1)

... shumë patën besë **tck** in' Zor.  
(FZ - Viti i parë - 28 të prillit, 1912, n. 10, f. 3, sht. 2, e sprasmja)

**Tek** ato ditë **për** duarshit e Apostojëvet **te** gjindja bëneshin shumë shengje e famasmë...  
(FZ - Viti i parë - 11 të prillit 1915, n. 11, f. 1, sht. 1, r. 1)

Zgjidhëni një burrë **ndër** jush sa t' luftonjë **me** mua...  
(FZ - Viti i katrët - 9 të majit 1915, n. 12, f. 3, sht. 2, Dhiata e vietër)

... **nd' anëzë** Romës...  
(FZ - Viti i parë - 15 të shtatorit 1912, n. 30, f. 3, sht. 1, r. 5)

...ka t' hijën **ndër** jush ulqë ....  
(FZ - Viti i katrët - 16 të majit 1915, n. 13, f. 2, sht. 1, r. 6)

... ai isht burrë i ler e i rritur **ndër** lufta...  
(FZ – Viti i katrët - 9 të majit 1915 , n. 12, f. 4, sht. 1, r. 16)

... pameta **ndër mes** të Israelit hiri urdhëri ...  
(FZ – Viti i katrët - 28 të shkurtorit 1915 , n. 2, f. 3, sht. 2, r. 8)

... u i rrodha prapa e i shkula delen **nga** grika e pran i zura **për** qafje e i vrava.  
(FZ – Viti i katrët - 9 të majit 1915 , n. 12, f. 4, sht. 1, r. 22, 23)

... si e pa e vërrejtí **çë te** kriet **njera te** këmbët ...  
(FZ – Viti i katrët - 9 të majit 1915 , n. 12, f. 4, sht. 1, e sprasmja)

“E çë jam qen u, çë vjen **kundra** meje **me** shkopin? ...”. Po Davidi u përgjeq Filisteut:  
“Ti vien **kundra** meje **me** shpatë e **me** shtizë; e u vinj **kundra** teje **në** embër të t’in Zoti ...  
Sot Zoti të jep **te** duart time ...”.  
(FZ – Viti i katrët - 9 të majit 1915 , n. 12, f. 4, sht. 2, r. 2/12)

Edhe **për në mes** t’juve do t’ ngrëhen burra tue mbësuar të shtrëmbëra ...  
(FZ – Viti i katrët - 16 të majit 1915 , n. 13, f. 2, sht. 1, r. 7)

Farje së nderme **në** Kuntisë u bi  
Kolë Ketta, vllastar i t’ arbrit dhe;  
shkoi **n’** Palermë pra **tek** e Arbrit shpi,  
ç’e reshti, si zogun rep **ndë** folé.  
(CT –VII, f. 328, str. 1))

**Mbi** ndo një muaj, atë e bën dhendërr ...  
(CT – Novelline popolari, 1 – f. 353, r. 13)

... kujtoj se kish t’ish e mirë **për** t’ë ...  
(CT – Novelline popolari, 1 – f. 353, r. 14,15)

Dielli u fal jetjes / **brënda** dejtít vate u fshoh; / e këta njerzë, **vëç** të falin / hort e tite andaj-  
andaj, / gjith u pruartin **nka** Lemí...  
(FCG – MT – f. 25/26, Canto XVII, vj. 1-5)

Shkulën bronja, gardankafa, / kulumbri, kokuta e ferre, / e çë i vijën **për ndë** duar / çë i  
cënojnë po glishtrat.  
(FCG – MT – f. 30, Canto XIX, vj. 7-10)

... tue glar t’in’ Zoti **paj** të Besës.  
(AGS – Libri i Kreshmëvet, vëllimi 1 – f. 24, r. e sprasmja)




## MËSIMI 1L

Lidhëza.

Zglith e vëre'.

### QENI E BALUNI

- O ti o u! – i thashë Markut, kur më pyeji kush ki' t' vej e mirrëj balunin, çë kish vatur e sosur ndanëz njëi qeni, çë lehëj kundra neve te një kopsht.



Zë áje o ngë zë áje qeni? Marku e u e vërejëm e ngë tundeshim. Megjithatë, i thashë Markut se balunin vej' e e mirrja u, se u isha më i hollë e rridhja më fort.

Marku m'u përgjegj se ai e dij se ish më i trashë se u, ma (por) ish edhe më i fuqishëm; andaj të dy bëjëm po të folura e mosnjeri tundej.



Ma (por) në u (as) në (as) Marku bëmë heronjtë, se jerdhi i zoti i kopshtit e i qenit e na i thamë të na jipëj balunin.

Edhe këtë:

### KAFSHËT SHTËPIAKE

Çë kur leva mënd të thom se më pëlqejën më shumë qentë, megjithëse më pëlqejën edhe maçet.

Me qentë ndodhem një thërrime më mirë, përçë mënd t'i qellësh me tij kudo e mënd t'i luash bashkë aqë se disa herë të duken se janë më shumë miq se miqtë.



Maçet ngë i duhet gjë *sa* t'i duash mirë, ma (por) ato qëndrojnë si të egëra, *skurse* (*sikurse*) ë ndo gjagjë që i mban llargu, *edhe kur* i ke ndanëz.

Në ke një qen o një maçe, e ndëlgon mirë atë që do të thom, *përçë* kam besë *se* edhe ti kërkon të njohësh mirë animejt (kafshët) që rrojnë me njerëzit. E ti e di *se* kafshët shtëpiake (e shpisë, domestike) na bëjnë kumpanji (shoqëri) *sa* të kenë ngak na dashuri e kujdes.



**Çë janë**

*o ... o, o, e, megjithatë, ma (por), edhe, andaj, në (as)* tek i pari rrëfim e

**çë janë**

*çë kur, se, megjithëse, përçë, aqë se, sa, skurse (sikurse), edhe kur, në* tek i dyti rrëfim?

Janë **lidhëza** (litisht: congiunzioni).

**Lidhëza** ë ajo pjesë e pa ndërrueshme e ligjëratës që shërben të lidhënj dy fjalë, dy o më shumë mendime me të çilët bëhet ligjërata.

**Lidhëzat** mënd të jenë:

● të parme (litisht: congiunzioni primitive): as, dhe, e, edhe, në, o, po, por;

● jo të parme:

● të dala nga tjera pjesë të ligjëratës:

nga përemri: çë, sa, se;

nga ndajfolja: ku, kur, nga, si, veç;

nga folja: do, kloftë;

nga mbiemri: gjah (gjallë; si; siçilljam; preçisu);  
etj.

● të përngjitura:

nëse (lidhëz+lidhëz), sesa (lidhëz+lidhëz),

kurse (lidhëz+lidhëz), posa (lidhëz+lidhëz),

porsa (lidhëz+lidhëz), porse (lidhëz+lidhëz),

porsi (lidhëz+lidhëz), sikur (lidhëz+lidhëz),

sikurse (lidhëz+lidhëz+lidhëz); mbasi (parafjale+lidhëz),

ndërsa (parafjalë+lidhëz), ngase (parafjale+lidhëz),

megjithëse (parafjale+përemër+lidhëz);

megjithatë (parafjalë+përemër+përemër), etj.

● **lokucione lidhëzore:**

aqë sa, ashtu edhe, çë kur, edhe në, ngaherë çë,  
në kloftë se, njera (ngjer)kur, për shkak se; sa herë çë,  
vetëm se, vje' më rarë, vje' më thënë, etj.;

kloftë...kloftë, jo vetëm...por edhe, si...ashtu edhe,  
le se...por edhe, etj.,



**Lidhëzat** te funksioni sintaksor ndahen kështu:

● **lidhëza bashkërenditëse** (litisht: congiunzioni coordinative), vje' më thënë se lidhjen dy fjale o dy mendime të pavarur (litisht: indipendenti); shembuj:

O ti o u!  
Zë aje o ngë zë aje qeni?  
Marku e u e vërejëm e ngë tundeshim.

O ti o u! =  $\frac{o \text{ (vete)}}{1} \text{ ti } \frac{o \text{ (vete)}}{1} \text{ u}$  > janë dy fjali të pavarura >

njera ngë varet nga jetra, ma të dya rrinë lidhur tek i njëjti nivel me ndihmën e lidhëzës "o".

● **lidhëza nënrenditëse** (litisht: congiunzioni subordinative), vje' më thënë se lidhjen dy o më shumë mendime, të të cilëvet njeri varet nga tjetri; shembuj:

Thom **se** më pëlqejën më shumë qentë.

Thom

1 se më pëlqejën më shumë qentë > janë dy fjali ku e para ë  
2

ajo çë mban shtuara ligjëratën e e dyta ajo çë varet (dipindir) nga e para me lidhëzen "se".



Vëre' naní ca lidhëza të të dy grupevet.

## LIDHËZA BASHKËRENDITËSE

• **lidhëza këpujore** (litisht: congiunzioni copulative):

- ♦ **pohore:** e, dhe, edhe, si, si edhe, e...e, do...do, si...si, si...ashtu edhe.

**Shembuj:**

Marku e Sara janë miq.  
Me ne te festa jerdhi edhe Mara.  
Marku ë i rrallë e për burrëri e për butësi.  
Marku ë i rrallë si për burrëri si për butësi.  
Marku ë i rrallë si për burrëri ashtu edhe për butësi.

- ♦ **mohore:** as (litisht: né), **as...as** (litisht: né...né), **as edhe** (litisht: neanche).

**Shembuj:**

Qeni jynë as hengri as deshi të pij.  
Maçja jonë ngë do as të hanj as të pie.  
Maçja jonë ngë do as të hanj as edhe të pie.

### SHËNIM

Arbërisht, te gluha e përditshme, na thomi te vendi i "as, as...as, as edhe":

Qeni jynë né hengri né deshi të pij.  
Maçja jonë ngë do né të hanj né të pie.  
Miku jynë ngë hengri né manku deshi të pij.  
Miku jynë né hengri né manku deshi të pij.

• **lidhëza veçuese** (litisht: disgiuntive): a (te letërsia), o, o...o, kloftë...kloftë.

**Shembuj:**

O ti o u!  
Kloftë qen kloftë maçe, u i dua gjithë mirë!

• **lidhëza kundërshtore** (litisht: avversative): kurse (sot arbërisht: mentri), ma (por), megjithatë, ndërsa (sot arbërisht: mentri), po, por, vetëm, vetëm se, etj.

**Shembuj:**

Ditën vete ku do, kurse natën vuhet e shkruan.  
Vitoria do të lozënj, ma (por) Mara ngë do.  
Vito ngë më flet, mëgjithatë u e dua mirë.  
Marku ha brumit, ndërsa (mentri) vëren televizionën.  
Pali ë një djalë i zgjuar, vetëm se skollë ngë do.

• **lidhëza përmyllëse** (litisht: conclusive): andaj, prandaj (sot arbërisht: kuindi, përçò).

### Shembuj:

Këto dardha janë të kalbëta, andaj qillja kujt t'i shiti.

- **lidhëza të shkallëzimit** (litisht: comparative): jo vetëm (se) ...ma (por) edhe, jo vetëm (se) ...ma (por) manku (as), le se ...por edhe, etj.

### Shembuj:

Jo vetëm se bie shi, ma (por) edhe fryn ftohtë.

Jo vetëm se ngë do skollë, por manku (as) shëbërtirë.

Le se ngë do skollë, por edhe të bënë rrëmujë (batar)!

- **lidhëza shpjeguese a sqaruese** (litisht: dichiarative): domëthënë, vje' më rarë, vje' më thënë, për shembull, si.

### Shembuj:

Vito e Marku, domëthënë dy miq të vjetër, u zunë.

Ë një busull, vje' më rarë një strument që na jep Veriun.

Vajzat, për shembull Mara e Sara, lozjën me pupat.

Miqtë tim, si Marku e Vito, venë te skolla Palermë.

## USHTRIME

Vër te vendi që i nget këto lidhëza bashkërenditëse: andaj, edhe, për shembull, o, por (ma).

- 1 - Thashë të vërtetën, \_\_\_\_\_ mosnjerrë më pati besë.
- 2 - \_\_\_\_\_ Sara nanë ka biçikletën.
- 3 - Kjo biçikletë u ça, \_\_\_\_\_ ë mirë të e lësh më nj'anë.
- 4 - Djemtë, \_\_\_\_\_ Marku e Pali, zgledhën vetëm libret e skollës.
- 5 - Mara lot balunin po me Sarën \_\_\_\_\_ me Marien.



### Shembuj letrarë

Shtrejtësia isht **gjah** ai që ka ether: po dhizet të ket e po ngë ndien që bën.

(FZ - Viti i parë - 18 t' gushtit 1912, n. 26, f. 2, sht. 2, r. 4 nga e sprasmja)

... vjen më thënë se ajo zëmbërë isht si një vent i hapt për që-do mëkatë, **kloft** e ndëjeshme, **kloft** vdektare.

(FZ - Viti i parë, 13 te tetorit 1912, n. 34, f. 2, sht. 2, r. 12/15)

**Përandaj** i duhet se na të vum më shumë kujdes ...

(FZ - Viti i katërt, 28 të shkurtit 1915, n. 2, f. 2, sht. 1, r. 6)

... kish t' isht e mirë për 'të, **do** për qozmë **do** për bukuri.

(CT - Novelline populari, 1 - f. 353, r. 15)

## LIDHËZA NËNRENDITËSE

- lidhëz ftilluese (litisht: *esplicativa, dichiarativa*): *se*;

### Shembuj:

Marku e di **se** Sara e do mirë.  
Shërbesi ë **se** mosnjeri thotë gjë.

- lidhëza kohore (litisht: *temporali*): *kur, sa, si, ndërsa* (sot arbërisht: *mentri*), *njera* (ngjer) *çë, sapo, ngaherë çë, më para se, çë kur, etj.*

### Shembuj:

Rrini pa folë, **kur** flas u.  
**Sa** del dielli, jeta zgjonet.  
**Si** vjen Marku, vemi përjashta..  
Ngë dua flas, **ndërsa** (mentri) ha.  
Fol, fol, **njera** (ngjer) *çë* ka lodhesh.  
**Sapo** të pashë, jerdha tek ti.  
**Ngaherë çë** flet, gjithë shqirren me gaze.  
Mirr borsën, **më para se** të vemi te supermercati.  
**Çë kur** leu, Sara ë e bukur.

- lidhëz qëllimore (litisht: *finale*): *sa*;

### Shembull:

Marku, **sa** të jarrënj i pari, rrjedh më fort se gjithë.

- lidhëza shkakore (litisht: *causali*): *përçë, se, porsa, posa çë, ngase, për shkak se* (litisht: *a causa di*), *etj.*

### Shembuj:

Dje ngë dolla **përçë** bij shi.  
Dje ngë dolla **se** bij shi.  
**Porsa** ngë pati miq, naní rri vetëm.  
**Posa çë** ngë do t' rrih me mua, u marr e vete.

- lidhëza vendore (litisht: *locative*): *ku, ka o nga, kudo, kudo çë, njera* (ngjer) *ku, etj.*

### Shembuj:

**Ku** rri Marku, rri Sara.  
**Ka** (nga) vjen shiu, vjen era.  
Shko **kudo** të shkosh.  
Shko **kudo çë** do t' shkosh.  
U dua t' arrënj **njera** (ngjer) ku arruri miku jim.

- **lidhëza lejore** (litisht: concessive): megjithëse, ndonëse (litisht: benchë), edhe përçë, etj.

**Shembuj:**

**Mejthëse** jemi miq, nganjëri ka trutë e tija.  
**Ndonëse** jam i lodhët, do t' vij në festa.  
 Ky vend ë i mirë për ne, **edhe përçë** ngë kemi tjerë.

- **lidhëza kundërvënëse** (litisht: antonimiche): ndërsa (sot arbërisht: mentri), në, nëse, në vend se, sa rri të,

**Shembuj:**

**Ndërsa** Marku kla, Sara qesh.  
**Në** Marku kla, Sara qesh.  
**Në vend se** të gëzonet, Vito mërihet (o mbrihet).  
**Sa** rri të gëzonet, Vito mërihet (o mbrihet).

- **lidhëza krahasore-mënyrore** (litisht: comparative e modali): sa, se, si, posí, sikurse e skurse, ashtú si, etj.

**Shembuj:**

**Sa** më shumë lurin, më pak e gjegjemi.  
 Bëri punën **se** më mirë ngë mënd.  
 Bëj shërbiset **si** të thashë.  
 Bëj shërbiset **posí** të thashë.  
 Pali shërben drurin **sikurse** ë mjeshtër.  
 Bëri shërbiset **ashtú si** i thashë.

- **lidhëza kushtore** (litisht: kondizionali): në, nëse, kur, në isht se, etj.

**Shembuj:**

**Në** bie shi, ngë mënd të lozjëm.  
**Kur** të kish jardhur me ne, çë kishëm bërë ?  
**Në isht se** thua ashtú, ashtú bëhet.

- **lidhëza rrjedhimore** (litisht: consecutive): sa, se, aqë sa, aqë se, çë, etj.

**Shembuj:**

Vito rrodhi **aqë se (sa)** jui bë e kuqe fixha (fytyra).  
 Marku u trëmb **aqë se** i shkaftuan (shkaktuan) lot.  
 U ngë jam ndo djalë **çë** lë shërbiset te gjyma.

- **lidhëza të përjashtimit** (litisht: eccezionale): veç se, vetëm se,

**Shembuj:**

Ngë mënd t' bëj gjë tjetër, **veç se** të klaj.  
 Foli mirë, **vetëm se** ngë i ndëlgova gjë.

- lidhëza të pyetjes së zhdrejtë (litisht: interrogative indirette): në, përçë;

Shembuj:

Të pyeta **në** ke vatur Palermë.  
Thuamë **përçë** bën këto shërbise.

- lidhëza të dyshimit (litisht: dubitative): në, ndëse o nëse;

Shembuj:

Ngë e di **në** ka i vete te festa.



## USHTRIME

Vër te vendi çë i nget këto lidhëza nënrënditëse: përçë, ngaherë çë, megjithëse, sikurse, ku.

- 1 - Marku \_\_\_\_\_ lot me balunin, harron gjithqish.
- 2 - Dje ngë mbjodha kërshitë, \_\_\_\_\_ zuri shiu.
- 3 - \_\_\_\_\_ jemi miq, Marku ngë do t' lozënj me mua.
- 4 - Sara flet \_\_\_\_\_ ë nje grua e madhe.
- 5 - **Qenin tim** \_\_\_\_\_ e lë rri.



### Shembuj letrarë

... **megjithse** ish e varfërë edhe e vapkë, kish të martonej me të birin e rregjit.  
(CT - Novelline popolari, 1 - f. 353, r. 7,8)

Vajza, **porsa** ngë pati tjetër **sa** t'i jipëj, mori e i dha një mbulesë të leshtë.  
(CT - Novelline popolari, 1 - f. 353, r. 9, 10)

**Porsanith** jemi të gjithë të vdekjes, ... edhe rregji vate gjeti të parët...  
(CT - Novelline popolari, 1 - f. 354, r. 4 nga e spramja)



## MËSIMI 1Pj

Pjesëza.

Zglith e vëre'.

### KALI



Kali ë një nga kafshët shtëpiake që dua më mirë, *pa* harruar se dua mirë edhe gjithë kafshët e buta e të egëra.

U një herë *u* vura kaluar te kali i të jatit të njëi miku jimi e *pa* *u* trëmbur jeca një bukur copë. U *dej' t'* e lëja të rridhëj kalin, ma (por) miku jim më tha se ngë *ki' t'* bëja lënësi.

*Tue* jecur kaluar ndihesha njetrë: ndihesha i fortë si ata kauboj amerikanë, aqë i fortë se shtura një ulurimë si bëjën ata. Ma kali *u* zmeks e zuri fill të rridhëj!

Këtë herë *u* zmeksa *u*, kur pashë se kali zuri fill të rridhëj, e kërkoja të mbaja fort retnat sa të bëja të qëndroj.



Miku jim si *pa* ashtu i shturi kalit një frushkullimë e ai qëndroj gjithëbashkë si kali i Zorrot.

Ma (por) *u* ngë isha Zorro, përçë si kali qëndroj gjithëbashkë, vajt' e sosa te një trofë e madhe barërash e rashë butë.

Miku, kur *pa* se isha i tërë, *tue* qeshur, më pyeji: - *Ka* vuhesh pamet kaluar? U e vërejta e si *u* përgjegja, i thashë: - Nestër!

Megjithëse rashë ka kali, *u* kuejt i dua mirë e i kam lypur tatës të më blenj një, kur *do* të jem më i math.

Çë janë

*pa* (harruar), *u* (vura, trëmbur, etj.), *dej' t'*, *të*, *ki' t'*, *tue*, *ka*, *do*?

Janë *pjesëza* (litisht: particelle).

*Pjesëza* ë ajo pjesë e pandërrueshme e ligjëratës, që shërben sa të marrjen formë disa mënyra të foljes.

Arbërisht *pjesëzat* janë këto:

- *dej'* për kohët e mënyrës kushtore;  
shembull: *dej' t'* e lëja te rridhëj;
- *do* për format e kohës së ardhme; të mënyrës kushtore te letërsia;  
shembull: *do* të jem më i madh;
- *ka* për format e kohës së ardhme;  
shembull: *ka* vuhesh pamet kaluar?
- *kish* o *ki'* për format e mënyrës kushtore;  
shembull: ngë *ki' t'* bëja lënësi;
- *pa* me pjesoren e pashtjelluar mohore;  
shembull: *pa* harruar;
- *për* me emrin asnjans (çë vjen nga folja) për të formuar *paskajoren* ;  
shembull nga gluhja letrare arbëro-shqipe: *për* të thënë;
- *të*, *t'* për mënyrën lidhore, kushtore, paskajore;  
shembull: u *dej' t'* e lëja *të* rridhëj; ngë *ki' t'* bëja lënësi; për *të* thënë;
- *tue* o *tuke* me *përcjelloren* ;  
shembull: *tue* jecur kaluar; *tue* qeshur;
- *u* me disa forma pësore-vetvetore të foljevet;  
shembull: u një herë *u* vura kaluar; *u* zmeksa.

### Vëre'!

Gramatikat shqiptare thonë se pjesëzat janë këto këtu poshtë e shumë të tjera; ti zglidhi e mësoi, ato çë ngë njeh, edhe sa të qosësh fjalorin tënd.

As (litisht: né), bilé (litisht: anzi), gati (litisht: quasi), ja (litisht: ecco), jo, kushedi, madjë (litisht: anzi), mos, ndoshta (litisht: forse), ngjer, nja (litisht: circa), nuk (= ngë), pa, patjetër (litisht: senz'altro), pikërisht (litisht: precisamente), po, posi (= si jo; litisht: senz'altro, certamente), pra (litisht: dunque), që, qysh, rreth (litisht: attorno, intorno), sa, sapa, sikur, thuajse o pothuajse (litisht: quasi), vetëm, vetëm e vetëm, etj.

Arbërisht kemi ndo shprehje me "çë" e te letërsia ndoherë me "qysh":

Çë (qysh) femijë dija të flisja dy gluhë.

Ato çë e qysh te gluhja jonë kanë funksion parafjalje.

## USHTRIME

Vër te vendi çë i nget këto pjesëza: tue, ka, do, pa, të.


1 - Marku \_\_\_\_\_ t' vinjë me mua \_\_\_\_\_ lozënj balunin.

2 - Kur \_\_\_\_\_ vish e më gësh?

3 - Sara vete te skolla \_\_\_\_\_ kënduar e \_\_\_\_\_ qeshur!

4 - Mori e vate \_\_\_\_\_ thënë gjë njeriu.

5 - Ai djalë ngë do \_\_\_\_\_ lozënj me tyj.



### Ndo shembull letrar

**Qysh** atë herë ai, nga menatë, vëhej te dritësorëja e, **tue** qeshur, i këndoj së varfërës ...

(CT - Novelline populari, I - f. 353, r. 16, 17)

**Tue** u dridhur ajo j-u përgjeq: - Prir syt për rreth e **do t'** e shohësh...

(CT - Novelline populari, X - f. 422, r. 24, 25)

- **Do të** më vësh në lojë? Mos **të** më bësh **të** lodhem më; ndomòs mënt **t'** e harronj se ti je grua!

(CT - Novelline populari, X - f. 423, r. 4, 5)

Rrim e vërrejëm **pa** bur gjë, **pa** thënë gjë, **pa** ftohur gojën...

(GS - Prose - III, f. 321, r. 12)

Për tri ditë e për tri netë, **pa** ngrënë, **pa** pir, **pa u** prëjtur kurr, ata vanë atej e këtej, alarta e aposhta **tue** vërrejtur gjithasajtëna, **tue** piejtur gjirivet...

(GS - Prose - x, f. 330, r. 10/12)

## MËSIMI 1Pas

Pasthirrma.

### PASTHIRRMA

Zglith e vëre’.

#### TE MASARIA

Një ditë një mik jimi, Marku, më qelli te masaria e tij e atje pashë “arkën e Noeut”: një luzmë kafshësh çë tundeshin, jicjën, rridhjën, vejën e vijën pa pasur bent (vend): pula, gjele, zogj, dhi, një derr, një gajdhur, një mushk, një pelë, dy lopë, një viç, pesë maçe e te një angonë tre qen, çë flëjën me gjithë atë rrëmujë (kunfusjonë).



Si hyra te masaria jui fala kafshëvet: - *Mirëdita!*

E kafshët si shenjë gëzimi zunë fill të më faleshin nga njeri me vjershin e tij.

Gjeli zuri fill me një “*kirikikiùùù!*” çë zgjoi dhjetë pallumbë: “*frë-frë-frë*” bëjën krahët e tyre.

Pra zunë pulat të kokorisjën: - *Kokodë, kokodë!*

Kur gjegji gjithë ata këndime, gajdhuri, pa pasur bëzonjë (nevojë) të ia lypje, zbylli grykën e pëlliti: - *Iiiààà, iiiààà!*

E u thashë: - *Mbre Marku, rroftë gajdhuri!*

Gajdhurit jui përgjegj lopa: - *Muuuuu! Muuuuu!* - e pela hëngëllisi: - *Eeeeeeeeee!*

- *Oh, sa gëzim çë më bëni!* - e i haristisa: - *Faleminderit!*

Pra gjithbashkë u zmol një erë, çë thomse kish dishirim të mirrëj pjesë te këndimet e kafshëvet, e zuri fill të fryj si e lënë: - *Fjuuuuuuuuuuu!*

Kur gjegjën frushkullimën e erës kafshët u tërbuan. Derri, tue vatur këtej e atej, hungëroj skurse ish e e thirjën: - *Iiiiiiiii!*

Qentë u zgjuan e tue kërcyer (sotartur) lehjën kundra gjithëve: - *Ba...ba...ba...!*  
- bëj njeri; e jetri: - *U...u...u...!*

I treti qen thomse ish i biri i tyre e kish marrë ca ka njeri e ca ka jetri: - *Ba...u, ba...u, ba...u!* - lehëj!

- *Ou, qetij! Shëëët!* - i uluriti Marku e gjithëbashkë mori një shkop e e shturi në mes kafshëvet.



Shkopi trëmbi më shumë ankora kafshët e gjithë e gjithë maçet, çë kërcyen, mjaullisën e jikën ka gjithë anët: - *Mjaaaaau! Mjaaaaau!*

- *Ha-ha-ha!* - qishja u, tue marrë pjesë te kori i rrallë, megjithëse më dishpëlqej për kafshët, çë u kishën trëmbur.

**Çë janë**

*Mirëdita!, mbre!, rroftë!, oh!, faleminderit!, ou!, shëëët! ?*

Janë **pasthirrma** (litisht: interiezioni o esclamazioni).

**Pasthirrma** ë ajo pjesë e pandërrueshme e ligjëratis, çë na shërben sa të dëftojm në mënyrë të gjallë atë çë ndiejm (ndjenjat) me shprehje gëzimi, dhëmbje, etj.

*Pasthirrmat onomatopeike* o më mire *tingullimitimet* si *kikirikì, kokodè, mjau, ha ha ha, etj.* na japjën shkruar ata që janë tingujt (litisht: i suoni), zëret, etj., të njerëzvet, të kafshëve, të shërbësve, me një fjalë, të “jetës” të ku rrojëm.

*Pasthirrma* do gjithmonë pikëçuditësen (litisht: il punto esclamativo).

*Pasthirrmat* mënd të jenë:

- *të parme* (litisht: **interiezioni primitive**): a, e, ë, i, u, ah, eh, ai, ei, oi, mbre, etj.;
- *jo të parme, vje’ më thënë se vijën nga tjera pjesë të ligjëratës (emra, mbiemra, folje, etj.)*: forca!, i mjeri!, mjerziu!, rroftë!, etj..

*Pasthirrmat* mënd të ndahen edhe sipas ndjenjës që shprehjën:

- **çudi** (litisht: **meraviglia**): ah!, oh!, u!, uh!, etj.
- **dhëmbje**: ái! ái!, oi! oi!, ui! ui!
- **dyshim** (litisht: **dubbio**): mah!
- **entuziazëm**: rroftë!, urra!
- **frikë o dre**: bóbo! bóbo!, pópo! pópo!
- **gëzim**: o!, ah!, oh!, urra!
- **lutje** (litisht: **preghiera**): o!, mrè! (**o** mërè! **o** mbrè! **o** morè! ), moj!
- **nxitje** (litisht: **incoraggiamento**): forca!
- **padurim** (litisht: **impazienza**): ufa!, qafa!
- **pohim** (litisht: **affermazione**): majde!, majdhe!
- **përbuzje** (litisht: **disprezzo**): iii!, puh!
- **thirrje**: o!, more!, moj!

*Shprehje pasthirrmore*:

- **thirrje**: bekuar ti!, mjeri u!, mjeri ti!, etj.;
- **urim**: mirëdita, mirëmbërëma, natën e mirë, udha e mbarë! (litisht: buon viaggio!), mirë se na jerdhe!, mirë se ju gjeta!, ju bëfshit mirë!, etj.;
- **mallkim**: të zëshit hëna!, etj..

**Pasthirrma onomatopeike o tingullimitime (te rrëfimi lart):**

*kirikiklililil!, frë-frë-frë, kokodë, iiiààà!, muuuuuuu!, eeeeeeeeeee!, fjuuuuuuuuuuu!,  
iiiiiiiiiii!, ba...u, ba...u, ba...u!, mjaaaaau!, ha-ha-ha!*



**USHTRIME**

**1 – Vër te vendi që i nget këto pasthirrma:** oh, mbrë, ju bëfshit mirë, mirëdita,  
ai! ai!

- 1 - \_\_\_\_\_, **më dhëmb glishti!**
- 2 - \_\_\_\_\_, sa qëro ka që ngë të shoh!
- 3 - \_\_\_\_\_ la' Gjergj, sot djemtë kanë gjithqish!
- 4 - \_\_\_\_\_ gjithëve!
- 5 - Hani, hani, e \_\_\_\_\_!



**2 - Lidh kafshët o gjërat me tingujt që dërgojën:**

miu  
zoga  
qeni  
maçja  
dera  
era  
gazi  
të diganisurit

çip, çip, çip  
xërrrrrrrrrr  
shëeeeeee  
fjuuuuuuuuu  
ha-ha-ha  
ciu, ciu, ciu  
bau, bau, bau  
mjau, mjau, mjau



## Shembuj letrarë

Të parën fjalë, **mërë** Teofil, e bëra mbi gjith atë që lisiu zu të bëj edhe të mësoj...  
(FZ – Viti i katrët - 7 të prillit 1912 , n. 12, f. 4, sht. 1, r. 16)

**Ajli!** Dielli perëndoi / E s'e pash...  
(GS – Milo – XVII – f. 264, vj. 54)

**Ajli,** o i madhi in' Zot!  
(GS – Prose – f. 310, r. 277)

...E na e zëj!... **Bóbol! Bóbol!**... Atëherë e bukura ish zbjerrel...  
(CT – Novelline populari, XI – f. 444, r. e sprasme)

E zeza plakë rrij rrij e lurij: - **Uii Uii!** Më vjen të shuanj!  
(CT – Novelline populari, XII – f. 454, r. e tretë nga e sprasmja)

**Alfa,** mëma e jime!  
(CT – Novelline populari, XIII – f. 460, r. 9 nga e sprasmja)

E ngrata zonjë, **tënk tënk,** pati t'vej prap tek ajo grua...  
(CT – Novelline populari, XIII – f. 462, r. 7)

**Pópo!... Pópo!...** E si jerdhe te këto ditë?  
(CT – Novelline populari, XV – f. 476, r. e sprasme)

**Oi** ti mal sot zmolul...  
(FCG – Mbi malin e trundafilet – faqe 14, IX, vjer. 1)

.. si flutura lihnari... /... nkë din se lodra i bie, / **majdhe-majdhe** te shpovia !  
(FCG – Mbi malin e trundafilet – f. 33, XXI, vj. 8/11)

KAFSHANJERIU - (Nga jashtë, pëllet si gomar) **Éaaaaah, ah, ah!**  
OSHËTARI - Çë ke, Kafshë, çë pëllet si gajdhur!  
(GSMaj – Kërkuesit – Akti III, skena II)



## MËSIMI PËRMBLEDHËS i Pjesëvet të Ligjëratës

### HORËT ARBËRESHE TË SIÇILLJES

Te moi i majt, me skollën vënë të shihjëm **HORËT ARBËRESHE** që ndodhen këtu te Siçillja, vje' më rarë, Sëndastinë (Santa Cristina Gela), Mencujusin (Mezzojuso), Pallacin (Palazzo Adriano) e Kuntisën (Contessa Entellina). Ato bashkë me Horën e Arbëreshëve (Piana degli Albanesi) bëjnë pjesë te Eparhia bizantine.

Të vemi **SËNDASTINË** ka Hora ngë i rrimë mosgjë: te më pak se dhjetë minute, ndodhemi përpara tabeles që na thotë ku jemi. Më parë se gjithqish shohjëm Bashkinë, që na thërresjëm "Municipju". Kjo ndërtesë ë e re, se më parë Municipji ish te qaca, te ana e klishës.



Qaca ë e madhe: aty jep klisa, brënda të çilës ndodhet statulla e Sëndastinës; te ana e derës së klishës ndodhet një krua.

Panorami që duket ka Sëndastina me malet tanë e me liqenin ë madhështor.

Sëndastinë flasjën si te Hora, ma kanë ndo gjagjë që ndërron: për shembull, sëndastinarët thonë "arà" kur ka thenë "oraëj" o "ëj" e thonë *vetën e tretë njëjës të kohës së ardhme të mënyrës dëftore* kështu: "ka t' vije". Arbëreshët e Horës e ata të Sëndastinës nderonen, se rrinë ndanëz e se kanë rrenjët përbashkë.

Sosur vizita Sëndastinë, vemi **MENCUJUS**, ku arrëjëm te më pak se një orë.



Nga super-rruga Palermo-Agrixhento duket mirë Mencujusi e kur e kemi përpara syvet, prierjëm e zëmë dhromin çë na qell atje.

Mblen bukur së llargu Mencujusi, me ata pallace të mëdhenj, m'i madhi i të çilëvet ë pa tjetër Monastiri i kallogjervet basiljanë. Te qaca, ku qëndrojëm, kemi dy klishtë te ana: njera bizantine e jetra latine. Janë të dya të bukura e neve na duket shërbes normal të shohjëm dy klishtë ku gjindja parkales me dy gluhë të ndryshme (litishe differenti). Mencujusi ka klënë djeba e kulturës bizantine të horëvet tona, më parë me kallogjerit grekë e pra me priftrat arbëreshë. Mencujusi ka dy bibliotekë të mira: më e vjetër ë ajo e Monastirit basilian; më e re ajo komunale. Mencujus ndihe te shpia jote, përçë ndodhe në mes vëllezërvet, megjithëse këta ngë flasjën më gluhën arbëreshe. Mencujusar ish *Nicola Figlia*, vepra letrare e të çilit ndodhet te "Il Codice Chieutino". Nga Mencujusi zëmë pameta dhromin e vemi **PALLAC**.



Pallaci ë një horë e bukur shumë: atje shpitë, klishtë, qaca, kronjet me koritën guri të gjallë, i duken turistit gjithë me masa (litishe: misure) të mëdha! E me të vërtetë, pallacjotët kur flasjën, për shembull, për "qacën" e thërresjën " *'a chiazza gra'*" (siçilljan: granni), kur flasjën për "kroin" e thërresjën " *'a funtana gra'*"; etjera. Në ata i thërrisjën " *qaca e madhë*" e " *kroi i math*" mënd t' ishën edhe sot arbëreshë me gjithë kartët në rregull. Te qaca mblejën klishta bizantine e klishta latine: ajo ë qaca më madhështore e më e bukur e gjithë horëvet arbëreshe të Siçilljes. Te klishta bizantine zgledhjëm ca rrasa (litishe: lapidi) shumë të vjetra shkruar arbërisht.

Na të Horës pallacjotët i kemi dashur gjithmonë mirë se na lidhjën kultura arbëreshe e riti bizantin. Pallaci ka pasur shkrimtarë e poetë të mirë, si *Monsignor Giuseppe Crispi*, *Gabriele Dara Senjor e Dara i Riu*, at e bir, *Pietro Chiara*, *Francesco Crispi Glaviano*. Pallacjotët janë krenarë (litishe: orgogliosi) se *Francesco Crispi* (1818-1901), kryeministër i Italisë te vitet çë mbilljën shekullin XIX, vij nga një familje pallacjote. I sprasmi pallacjot çë flisëj arbërisht vdiq ndo njëzet vjet prapa. Mosnjeri mënd t' qëndronj i thatë kur gjegjet këto shërbes.

Parë gjithë atë që mënd t' shihjëm abrënda e ajashta horës, lëmë Pallacin e zëmë udhën që na qell **KUNTISË**.



Kuntisa ë hora arbëreshe që kemi te zëmra, përçë aty flitet edhe sot arbërisht. Të folurit ndërron një thërrime nga ata të Horës, ma kur flasjëm ndëlgonemi. Për shembull ata fjalën "lule" e thonë "lulje", ma kush ngë e ndëlgon? Bukur ë të jecësh brënda Siçilljes e të gjesh gjinde që flasjën arbërisht! Oh, Kuntisa! Këtu ngë kemi hapësirat (litish: gli spazi) që kemi Pallac, ma hora ë e bukur, përçë ë e mbjedhur gjithë mbi një vend, thomi për horën e vjetër. Rreth horës sot ndodhen shpi të reja, gjith'e gjithë ato të stisura pas dhetundjes (shqip: tërmetit) të vitit 1968. Nga Kuntisa ë *Nicolò Chetta* (1742-1803), i çili ish krenar se kish lerë arbëresh e Kuntisë; zgldh që shkruaj për atë vetë:

- 1 - Farie së nderme në Kuntisë u bi  
Kolë Ketta, vllastar i t' arbrit dhe;  
shkoi n' Palermë pra tek e Arbrit shpi,  
ç'e rështi, si zogun ndë folë.
- 2 - E veshi e e ngjeshi me zakon, me urtësi;  
për në vapët e përtrijti ndënë hje,  
si të veshkurin rrëmp stolis një dhri;  
e naní prift klisha kurorë e vë.
- 3 - Si zok i sbjerrë pra t' dy krahët çoi  
në Palermë e n' Kuntisë, po ktei e atei;  
ndern' e Arbreshet te gjithë gramët kërkoj.
- 4 - Si krymp mundafshi gjith u svis vetëhej  
e ktë vistar tuar, qëndisi e shkroi,  
se të qosëj gjith Arbrin ndjer përtei.  
(CT - VII , f. 328, 330)

Kuntisë mbillet dhromi që bëmë te Horët Arbëreshe të Siçilljes.

Fotografia e Mancujusit ë nxjerrë nga një depliani i "Associazione Turistica Pro Loco" di Mezzojuso; fotografitë e Pallacit janë nxjerrë nga libri "Palazzo Adriano - Territorio e Storia" di Fabio Oliveri; fotografia e Kuntisë ë nxjerrë nga libri "Arti della Giornata Culturale dedicata a Nicolò Chetta", 1982. Fotografitë Sëndastinës ia bëti Giuseppe Stasi.

## USHTRIME

Shkruaj te “Pjesët e Ligjëratës” këtu poshtë, një, dy o tre shembuj për nga kasele, nxjerrë nga përshkrimi lart i “Horëvet Arbëreshe”.

emri
mbiemri
numërori
përemri
folja
ndajfolja
parafjala
lidhëza
pjesëza
pasthirrma

**RROFSHIN E TRASHGOFSHIN  
ATA ÇË MËSUAN GJITHQISH !**



**Finito di stampare  
nel mese di dicembre 2001  
dalla Tipografia Lussografica  
di Caltanissetta**

